

HETIMET FINANCIARE DHE KONFISKIMI I PRODUKTEVE TË KRIMIT NË SHQIPËRI

Petrit Bushi

Dorëzuar

Universitetit European të Tiranës

Shkollës Doktorale

Në përmbushje të detyrimeve të programit të Doktoratës në
Shkenca Juridike, profili “E drejtë penale”, për marrjen e gradës shkencore
“Doktor”

Udhëheqës shkencor: **Prof. Dr. VASILIKA HYSI**

Numri i fjalëve: 55,203

Tiranë, Janar 2016

DEKLARATA E AUTORËSISË

Nën përgjegjësinë time deklaroj se punimi është origjinal dhe nuk përmban, sipas njohurisë time, asnjë material të botuar ose të shkruar nga një person tjetër, përveç siç deklarohet në brendi të tekstit. Ideve të dikujt tjetër Ju është atribuar autorësia në formë referencë/citim, sipas rregullave të shkrimit akademik, duke respektuar të drejtën e autorit, për të gjitha publikimet e shtypura apo printuara.

Me përgjegjësi të plotë deklaroj se është punë origjinale dhe në përputhje me parimet etike të publikimeve dhe se jam i vetëdijshëm për pasojat e një deklarimi të rrejshëm.

Emri i Autorit: Doktorant Petrit Bushi

Nënshkrimi: _____

Tiranë, Janar, 2016

ABSTRAKTI

Ky punim doktoral është një studim juridiko penal dhe procedural penal mbi hetimin financiar në Shqipëri gjatë periudhës 2004-2014. Trajton problemet dhe sfidat e hetimit financiar dhe konfiskimit të produkteve të krimit. Në vecanti trajton efektshmërinë e zbatimit të masave parandaluese, ligjore, institucionale dhe operacionale në fazat e hetimit, gjykimit dhe administrimit të pasurive të sekuestruara dhe të konfiskuara. Interesi i një studimi të tillë qendron tek fakti se për një kohë të gjatë, krimi i organizuar dhe korrupsioni, janë luftuar kryesisht përmes masave represive. Mirëpo, fenomeni i globalizmit të shoqërive bashkëkohore, proceset integruese, lëvizja e lirë e njerzve, kapitaleve, pajisjeve, zhvillimi teknologjik etj., kanë krijuar mundësi të reja për krimin e organizuar, pastrimin e parave, trafikimin, korrupsionin dhe financimin e terrorizmit.

Ky studim bën një rishikimit të literaturës dhe akteve juridike ndërkombëtare dhe kombëtare duke e kombinuar atë me një qasje empirike e cila është ndërtuar përmes pyetësorëve për mbledhjen e të dhënave dhe marrjen e mendimeve të ekspertëve. Këta pyetësorë u janë shpërndarë drejtuesve të institucioneve për secilën fazë të hetimit financiar: hetimit (prokurorisë), gjykimit dhe administrimit të pasurisë së sekuestruar e konfiskuar. Studimi sjell rezultate konkrete lidhur me zbatimin e masave parandaluese nëpërmjet hetimit financiar dhe konfiskimit.

Identifikimi i gjetjeve, mangësive, pengesave dhe analiza e faktorëve ka bërë të mundur nxjerrjen e disa konkluzioneve dhe rekomandimeve të vlefshme, si rishikimi i veprave penale për të cilat bëhen hetime financiare, ndryshimin e rrethit të personave për të cilët bëhen hetime financiare, si dhe krijimin e një agjensie kombëtare multidisiplinare me kompetenca të qarta dhe qasje në institucionet që disponojnë të dhëna lidhur me objektet e hetimeve financiare, mënyrën e jetesës, pasuritë, veprimtaritë ekonomike dhe burimet e të ardhurave.

Fjalë kyçe: Krim i organizuar, hetim financiar, korrupsion, sekuestrim, konfiskim.

ABSTRACT

This doctoral work is a criminal legal and procedural criminal financial investigation in Albania over the period 2004-2014. It studies problems and challenges of financial investigation and confiscation of proceeds of crime. In particular, it handles the effectiveness of the preventive measures on legal, institutional and operational phases of the investigation as well as the adjudication and administration of seized and confiscated assets. The interest of such a study lies in the fact that for a long time, organized crime and corruption are fought mainly through repressive measures. However, the phenomenon of globalization of the contemporary societies, the integration processes, free movement of people and capitals, the equipment and development technology etc., have created new possibilities for the organized crime, money laundering, trafficking, corruption and terrorist financing.

This study makes a review of the literature of national and international legal acts, combining it with an empirical approach which is built through questionnaires that aimed to collect data and obtain the experts' opinions. These questionnaires were distributed to the heads of institutions at every stage of the financial investigation : the investigation (prosecutor) and judgment and management of the seized property.

The study provides concrete results associated with the implementation of preventive measures through financial investigation and confiscation. The analysis of the identification of findings, gaps, obstacles and factors made it possible to extract some important conclusions and recommendations such as the review of criminal acts for which financial investigations are launched, the change of the environment of persons for whom financial investigations are made and the creation of a national multidisciplinary agency with clear powers as well as institutions that would have access to data on financial investigations facilities, lifestyle, property, economic activities and income sources.

Keywords: organized crime, financial investigations, corruption, seizure, confiscation

DEDIKIMI

Ky punim i dedikohet familjes time dhe përkrahësve, për nxitjen, inkurajimin e mbështetjen që unë të arrij deri këtu.

FALENDERIME

Para së gjithash do të doja të falenderoj UET, për mundësinë që na dha për ndjekjen e studimeve të nivelit të tretë dhe stafin akademik për mbështetjen e tyre të madhe gjatë procesit për të përfunduar këtë doktoraturë. Pa mbështetjen e tyre kjo nuk do të kishte qenë e mundur.

Së dyti, një falenderim i veçantë shkon për udhëheqësen e temës, Prof.Dr. Vasilika Hysi, e cila në mënyrë të vazhdueshme më është përgjigjur dhe ndihmuar për strukturimin e temës dhe trajtimin e kapitujve dhe gjithë punimit në mënyrë shkencore. Rekomandimet e saj për literaturën dhe metodat e hulumtimit, ma kanë lehtësuar kryerjen e këtij punimi. Pa ndihmën e Saj nuk do të kisha arritur.

Së treti, një mirënjohje e madhe shkon për Kolegjin AAB, Prishtinë, i cili më krijoi kushtet për të shkruar këtë punim dhe duke më mbështetur financiarisht, pa ndihmën e të cilit do e kisha të pamundur.

Ka shumë njerëz që unë duhet të falënderoj: Prof.Ass.Dr.Anton Vukpalaj, i cili ishte gjithmonë i gatshëm për të dëgjuar dhe për të ndihmuar, Z. Adnand Xholi, Z. Kosta Beluri, Z.Hekuran Vladi, Z.Artur Kaja të cilët më ndihmuan për plotësimin e pyetësorëve, të dhëna statistikore dhe mendime eksperti.

Falenderoj familjen time, bashkëshorten dhe tre djemtë, të cilët patën durimin dhe më mbështetën gjatë këtyre tre viteve, duke ma bërë më të lehtë shkrimin e punimit.

Për të tjerët që kam harruar të përmend, Ju jam mirënjohës.

PËRMBAJTJA

KAPITULLI I: HYRJE	1
1.1 Qëllimi i studimit	5
1.2 Objektivat e studimit	6
1.3 Kufizimet e studimit	7
1.4 Organizimi i studimit	7
KAPITULLI II: OBJEKTI DHE METODOLOGJIA	14
2.1 Hipoteza dhe pyetja kërkimore	14
2.2 Metodologjia	17
KAPITULLI III: HYRJE NË HETIMET FINANCIARE DHE KONFISKIMIN E PRODUKTEVE TË KRIMIT	23
3.1 Kuptimi i hetimit financiar dhe dallimet me konfiskimin dhe pastrimin e parave	23
3.1.1 Hetimi financiar, elementët, masat për hetimet financiare	25
3.1.1.1 <i>Ndaj kujt bëhen hetimet financiare</i>	33
3.1.1.2 <i>Për çfarë bëhen hetimet financiare</i>	35
3.1.1.3 <i>Lidhur me se bëhen hetimet financiare</i>	36
3.1.1.4 <i>Mjetet financiare</i>	37
3.1.1.5 <i>Pasuritë</i>	39
3.1.1.6 <i>Veprimtaritë ekonomike</i>	41
3.1.1.7 <i>Mënyra e jetesës</i>	42
3.1.1.8 <i>Burimet e të ardhurave</i>	43
3.1.1.9 <i>Analizë rezultati</i>	44
3.1.2 Konfiskimi si masë dhe konfiskimi si dënim, llojet e konfiskimit	45

3.1.3 Dallimi dhe lidhja ndërmjet konfiskimit dhe hetimit financiar	47
3.2 Nocioni i krimeve që sjellin dobi pasurore të paligjshme	48
3.2.1 Krimi ekonomik	50
3.2.2 Krimi financiar	53
3.2.3 Krimi i organizuar	55
3.2.4 Trafikimi i paligjshëm	58
3.2.5 Korrupsioni	59
3.2.6 Pastrimi i parave	69
3.2.7 Krimi kibernetik	77
3.3 Vështrim historik i hetimeve financiare dhe konfiskimit të produkteve të krimit	82
3.3.1 Hetimet financiare dhe konfiskimi i produkteve të krimit para hyrjes në fuqi të ligjit për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar	84
3.3.2 Hetimet financiare dhe konfiskimi i produkteve të krimit pas hyrjes në fuqi të ligjit për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar dhe trafikimit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë	89
3.4 Përmbledhje e kapitullit	95
KAPITULLI IV: TEORITË DHE INSTRUMENTET JURIDIKË MBI HETIMET FINANCIARE DHE KONFISKIMIN E PRODUKTEVE TË KRIMIT	98
4.1 Pikëpamjet mbi hetimet financiare dhe konfiskimin	98
4.2 Instrumentet juridikë mbi hetimet financiare	100
4.2.1 Instrumentet juridikë ndërkombëtarë	101
4.2.1.1 Konventa e Vjenës	102
4.2.1.2 Konventa e Strasburgut	107

4.2.1.3 Konventa e Palermos.....	111
4.2.1.4 Konventa e Varshavës	115
4.2.2 Instrumentet juridikë regional	117
4.2.3 Instrumentet juridikë kombëtar	120
4.2.3.1 Ligji për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar në këndvështrim të Vendimit Unifikues të Gjykatës së Lartë.....	122
4.2.3.2 Ligji për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar dhe trafikimit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë në këndvështrim të Vendimit të Gjykatës Kushtetuese	129
4.2.3.3 Praktika e Gjykatës Europiane e të Drejtave të Njeriut	139
4.3 Përmbledhje e kapitullit	143
KAPITULLI V: ANALIZA E INSTRUMENTEVE JURIDIKË DHE EFEKTIVITETI I ZBATIMIT TË TYRE NË HETIMET FINANCIARE PËR PERIUDHËN 2004 – 2015 NË SHQIPËRI	145
5.1 Faza e hetimit	153
5.2 Faza e gjyqimit	157
5.3 Faza e administrimit të aseteve kriminale	161
5.4 Përmbledhje e kapitullit	182
KAPITULLI VI: VËSHTRIM KRAHASUES I LEGJISLACIONIT ME VENDET E BALLKANIT PERËNDIMOR	185
6.1 Të përgjithshme	185
6.2 Kroaci	186
6.3 Bosnje-Hercegovinë	190

6.4 Serbia	191
6.5 Mali i Zi	192
6.6 Maqedoni	192
6.7 Kosova	193
6.9 Përmbledhje e kapitullit	196
KAPITULLI VII: PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME	198
7.1 Të përgjithshme	198
7.2 Gjetjet kryesore të punimit dhe problematika	201
7.3 Rekomandime	209
BIBLIOGRAFI	211
SHTOJCA 1	220
SHTOJCA 2	228

LISTA E TABELAVE, FIGURAVE DHE DIAGRAMEVE

Tabela 1: Hetimi financiar, konfiskimi dhe menaxhimi

Tabela 2 Ndaj kujt bëhen hetimet financiare

Tabela 3 Për çfarë bëhen hetimet financiare

Tabela 4: Lidhur me se bëhen hetimet financiare

Tabela 5: Mjetet financiare

Tabela 6: Pasuritë

Tabela 7: Veprimtaritë ekonomike

Tabela 8: Mënyra e jetesës

Tabela 9: Burimet e të ardhurave

Tabela 10: Analiza e rezultatit

Tabela 11: Statistikat 2004-2014, sipas veprave penale, në Shqipëri

Tabela 12: Statistika për çështjet e hetimit financiar 2004-2014, në Shqipëri

Tabela 13: Raste, për hetime financiare dhe diferenca sipas viteve, në Shqipëri 2004-2014

Tabela 14: Koeficientët në përqindje dhe vlerësimi sipas viteve nga nota 1-5

Tabela 15: Vlerësimi i variablave sipas fazave të hetimit financiar

Tabela 16: Përmbledhëse e urdhrave të sekuestrimit dhe vendimeve të konfiskimit

Tabela 17: Urdhëra të Ministrit të Financave për sekuestrimin e pasurive, 2004-2014

Tabela 18: Vendime të Gjykatës së Krimeve të Rënda, 2004-2014

Tabela 19: Përmbledhëse e Urdhërave të Minsitrit dhe Vendimeve të GJKR

Tabela 20: Krahësimi i gjetjeve të Shqipërisë me 15 vendet e Bashkimit Europian

Figura 1: Treguesit e korrupsionit 2003-2013, në vendet e Ballkanit Perëndimor

Figura 2: Rritja ekonomike 2004-2012, në vendet e Ballkanit Perëndimor

Figura 3: Korrupsioni dhe rritja ekonomike 2004-2012, në Shqipëri

Figura 4: Ryshfeti pjese e ekonomise informale

Figura 5: Cikli i qarkullimit të parave të pista dhe riciklimi

Figura 6: Dallimi i hetimit financiar me pastrimin e parave

Figura 7: Statistika sipas veprave penale, për periudhën 2004-2012, në Shqipëri

Figura 8: Paraqitja në formë grafike, statistikave 2004-2013, sipas veprave penale, në Shqipëri

Figura 9: Raste, për hetime financiare dhe diferenca sipas viteve, në Shqipëri 2004-2013

Figura 10: Trendi i rasteve dhe kërkesave

Figura 11: Kërkesa në gjykatë për sekuestime/konfiskime, për periudhën 2004-2013

Figura 12: Paraqitja grafike sipas fazave të hetimit financiar

Figura 13: Paraqitja grafike Urdhërave të Minsitrit

Figura 14: Paraqitja grafike e Vendimeve të GJKR

Figura 15: Paraqitja grafike e Urdhërave të Minsitrit dhe Vendimeve të GJKR

Figura 16: Paraqitja grafike e krahasimit të rezultateve të Shqipërisë me 15 vendet e BE-së

LISTA E SHKURTIMEVE DHE E FJALORIT

AAPSK	Agjencia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara
AP	Autoritetet portuale
APSK	Agjencia e Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara
BE	Bashkimi Europian
BSH	Banka e Shqipërisë
CEPOL	Kolegji i Policive Europiane
CIA	Agjencia Qëndrore e Informacionit
DPP	Drejtoria e Përgjithshme e Policisë
DPPPP	Drejtoria e Përgjithshme për Parandalimin dhe Pastrimin e Parave
DRRPP	Drejtoria e rregjistrimit të pasurive të palujtshme
DSHTR	Drejtoria e Shfrytëzimit të transportit rrugor
EC	Komisioni Europian
EEC	Komiteti Ekonomik Europian
EGMONT	Rrjeti i Njësisë të Inteligjencës Financiare në Botë
EMCDDA	European Monitoring Centre for Drugs and Drug Addiction
EUROPOL	European Police Office (Zyra Europiane e Policisë)
FATF	Grupi i Veprimit Financiar
FIC	Financial Investigation Unit
FMN	Fondi Monetar Ndërkombëtar
G-7	Grupi i shtatë vendeve më të zhvilluara të botës
GDP	Produkti i Përgjithshëm Bruto
GJEDNJ	Gjykata Europiane e të Drejtave të Njeriut

GJKR	Gjykata e Krimeve të Rënda
GRECO	Grupi i Shteteve Kundër Korrupsionit
HI	Hetim Financiar
IB	Institucionet bankare
ICITAP	International Criminal Investigative Training Assistance Program
IF	Institucionet financiare
I-joF	Institucionet jo-financiare
ILDKPKI	Inspektoriati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe KI
KE	Këshilli i Europës
KEDNJ	Konventa Europiane e të Drejtave të Njeriut
KP	Kodi Penal
KPP	Kodi i Procedurës Penale
LKPP	Ligji për kontrollin e pastrimit të parave
MF	Ministria e Financave
ML	Pastrimi i Parave
MONEYVAL	Komiteti i ekspertëve për vleresimin e masave kundër PP/FT
OECD	Organization Economic Co-operation and Development
OJQ	Organizatë Jo Qeveritare
OSCE	Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Europë
PKR	Prokuroria e Krimeve të Rënda
PP	Prokuroria e Përgjithshme
RAD	Raporti i Aktivitetit të Dyshimtë
SHISH	Shërbimi Inforativ i Shtetit

SOCTA	The EU Serious and Organised Crime Threat Assissment
TF	Task forca
TI	Transparenca Ndërkombëtare
UNDCP	Zyra e Kombeve të Bashkuara për Drogat dhe Krimin
UNDP	United Nations Development Program
UNRIC	Qendra e informacionit regjional të Kombeve të Bashkuara
USD	Dollar amerikan

KAPITULLI I: HYRJE

Punimi doktoral “Hetimet financiare dhe konfiskimi i produkteve të krimit”, është një përpjekje për të analizuar dhe trajtuar një fushë të re në studimet shqiptare.

Lufta ndaj krimit në përgjithësi dhe krimit të organizuar dhe korrupsionit në vecanti, është bazuar në konceptin klasik të masave represive, nëpërmjet dënimit. Globalizimi dhe proceset integruuese, lëvizja e lirë e njerzve, kapitaleve, pajisjeve, zhvillimi teknologjik, përveç zhvillimeve dhe progresit, krijojnë edhe rreziqe dhe mundësi për krimin e organizuar, pastrimin e parave, trafikimin, korrupsionin dhe financimin e terrorizmit. Përfitimi është qëllimi i vetëm i krimit të organizuar. Masat represive kundër krimit të organizuar dhe atij serioz, janë të pamjaftueshme për luftën ndaj krimit të organizuar dhe korrupsionit, dhe aq më pak për parandalimin e krimit. Kapja dhe ndëshkimi i autorëve nuk pengon zhvillimin e aktivitetit kriminal, pasi burimet financiare, personat e tjerë të grupit, korruptimi i zyrtarëve të zbatimit të ligjit e mundësojnë lehtësisht kryerjen e krimit. Kjo është dhe arsyeja pse politikbërësit ndërkombëtar rimenduan për strategji të reja të luftës dhe parandalimit të krimit nëpërmjet masave paraprake të konfiskimit të pasurisë.

Nga rishikimi i literaturës, vërehet se aspekte të veçanta të komponentëve përberës të hetimeve financiare dhe konfiskimit të produkteve të krimit kanë filluar të ceken në studimet shqiptare, por ende mungon një studim i mirëfilltë, gjithpërfshirës dhe i fokusuar drejtpërdrejtë në hetimet financiare, si mjeti më i rëndësishëm në parandalimin dhe luftën kundër krimit. Kohët e fundit janë trajtuar pjesë të veçanta në studime doktorale, artikujt në media, konferenca, seminare, trajnime të strukturave të zbatimit të ligjit, por ende nuk ka një studim të plotë e të thelluar, lidhur me hetimin financiar dhe efektshmërinë e zbatimit në

praktikë në rastin e Shqipërisë. Studimi i hetimeve financiare bëhet mjaft i rëndësishëm për shumë arsye, por ndër më themeloret është se pritshmëritë e rezultateve nëpërmjet hetimeve financiare, janë të larta në raport me rezultatet e arritura në të gjitha fazat e procesit të hetimit financiar, konfiskimit dhe menaxhimit të aseteve kriminale. Nga ana tjetër përmbushja e misionit përfshin dy aspekte që plotësojnë njëra tjetrën, parandalimin dhe luftën, aspekte shumë komplekse, të cilat kërkojnë respektivisht masa preventive dhe represive, ose parandaluese dhe ndëshkuese. Këto masa do të trajtohen më gjerësisht në kapitujt në vijim.

Krimi i organizuar, në veçanti krimi i organizuar ndërkombëtar, si edhe llojet e tjera si: krimi i trafikimit të drogave, trafikimi me qenieve njerëzore, trafikimi i automjeteve, armëve, municioneve, terrorizmi, janë bërë kërcënimi më serioz për sigurinë dhe ekonominë e vendeve. Të ardhurat nga aktivitete kriminale mundësojnë rritjen e burimeve financiare të grupeve të organizuara kriminale, të cilat i përdorin për shtimin e aktiviteteve të tyre kriminale me qëllim rritjen e të ardhurave të tyre. Masat e marra për luftimin e këtyre aktiviteteve dhe ndëshkimin e personave që kryejnë dhe janë përfshirë në këto aktivitete të paligjshme, si masa represive, nuk kanë mundur të ndalojnë këtë fenomen. Kjo për arsye, *së pari*, kapja dhe ndëshkimi i autorëve nuk pengon zhvillimin e aktivitetit kriminal, pasi janë burimet financiare si edhe personat e tjerë të grupit të cilët vazhdojnë aktivitetin e tyre kriminal, *së dyti*, duke patur burime financiare, korruptimi i zyrtarëve të zbatimit të ligjit ka ardhur në rritje. Edhe masat për kriminalizimin e qarkullimit të parave si produkte krimi, dhe parashikimin e sanksioneve të rënda mbi kryesit e këtyre veprave, nuk kanë bërë të mundur ndalimin e këtyre aktiviteteve kriminale. Lëvizja e lirë e njerzve, mallrave dhe kapitaleve, e ka vështirësuar akoma më shumë suksesin e luftës kundër krimit, sidomos të atij të organizuar dhe krimit të organizuar ndërkombëtar, në veçanti. Bashkëpunimi mes grupeve

kriminale, kombëtare dhe ndërkombëtare, pavarësisht masave të kontrollit, dhe pengesave, është favorizuar për shkak të lëvizjes së lirë dhe zhvillimit teknologjik, janë më praktike dhe në kohë të shpejtë, ndryshe nga bashkëpunimi i strukturave ligjzbatuese të shteteve, të cilat kërkojnë procedura burokratike më të gjata, dhe për pasojë ju japin kohë kriminelëve për të kryer këta aktivitete dhe për të fshehur të ardhurat e tyre. Vitet 1980, në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, prodhimi i paligjshëm dhe trafikimi i drogës u rrit shpejt, fuqia financiare e grupeve kriminale u rrit ndjeshëm, duke bërë të mundur korrupsionin e zyrtarëve të zbatimit të ligjit dhe depërtimin e parave të pista në sistemin ligjor¹. Mjeti tradicional i përdorur për luftimin e krimit, burgimi, ishte krejtësisht i pamjaftueshëm duke patur parasysht fuqinë financiare të sipërmarrjeve kriminale, të ardhurat nga krimi, se sa dënimi me burg i personit. Kjo ishte dhe arsyeja që politikbërësit ndërkombëtar rimenduan për strategjitë e reja të luftës kundër krimit të organizuar dhe atij ndërkombëtar, sipas sloganit “të ashpër mbi pasuritë kriminale”², i cili u përhap shpejt edhe në vendet e Bashkimit Europian, ku theksi vihet mbi të ardhurat kriminale, për konfiskimin e të ardhurave nga krimi.

Teza doktorale fokusohet në dy pjesë a) hetimi financiar dhe b) konfiskimi i produkteve të krimit, duke trajtuar instrumentet juridikë dhe analizuar efektshmërinë në praktikë të zbatimit të këtyre instrumenteve në Shqipëri, për një periudhë 10 vjeçare. Hetimi financiar nuk ka një përkufizim përfundimtar të konceptit. Në shtete të ndryshme, kohra të ndryshme dhe sisteme të ndryshme gjenden koncepte dhe praktika të ndryshme. Pikërisht për faktin se nuk gjendet një përkufizim i plotë, edhe në literaturë shpesh përdoren terma si krim financiar,

¹ Vettori, B, “Tough on Criminal Wealth: Exploring the Practice of Proceeds from Crime Confiscation in the EU”, Springer, 2006, fq. x.

² Po aty, fq.xi.

konfiskim produkteve, konfiskim asetesh, pastrim parash, duke e ndërlikuar më shumë kuptueshmërinë e termit hetim financiar dhe njëzuar me konfiskimin e produkteve të krimit. Për të dhënë një kontribut në literaturë mendoj së është e nevojshme hulumtimi i kësaj teze në përpjekje për të përkufizuar hetimin financiar. Hetimi financiar ka të bëjë me procedurat që ndiqen për zbulimin, identifikimin, ngrirjen, bllokimin, sekuestrimin, konfiskimin e tyre, me qëllim shpërblimin e viktimave dhe rishpërndarjen e të ardhurave për fuqizimin e kapaciteteve të institucioneve të zbatimit të ligjit, dhe përdorimin për qëllime sociale. Konfiskimi i produkteve të krimit nuk është qëllimi përfundimtar i hetimit financiar, por është pjesë e hetimit financiar. Qëllimi i hetimit financiar është së pari: në marrjen e vlerave të produkteve të krimit, për ti hequr mundësitë financiare kryesve të krimeve për të zhvilluar aktivitetin kriminal dhe së dyti, rishpërndarjen e të ardhurave duke kompensuar të dëmtuarit dhe përdorimin e tyre për të rritur aftësitë e strukturave të zbatimit të ligjit dhe nevoja sociale. Në këtë këndvështrim hetimi financiar është tërësia e procedurave për hetimin, gjykimin dhe menazhimin e produkteve të krimit në tre faza:

1) Faza e hetimit, 2) faza e gjykimit, 3) faza e menaxhimit të asetëve

Faza e hetimit, përfshin procedurat për zbulimin, identifikimin, ngrirjen, sekuestrimin, dhe kërkesat për konfiskim të tyre, institucionet që përfshihen dhe bashkëpunimin.

Faza e gjykimit, përfshin shqyrtimin gjyqësor për kërkesat e sekuestrimit dhe konfiskimit dhe vendimet lidhur me to, si edhe vendimet ose autorizimet për përdorimin e metodave dhe mjeteve speciale të hetimit, gjatë fazës së hetimeve paraprake.

Faza e menaxhimit të asetëve, përfshin masat që merren për administrimin zhvillimin e pronës së sekuestruar dhe konfiskuar si dhe shpërndarjen.

1.1 Qëllimi i studimit

Punimi doktoral përfaqëson një studim juridiko penal dhe procedural penal të koncepteve të hetimit financiar dhe konfiskimit të produkteve të krimit duke u përpjekur të sjellë elementët përbërës të hetimit financiar, llojet e hetimit financiar, trajtimin sipas instrumenteve juridikë ndërkombëtare, regjional dhe kombëtarë, raportin me konfiskimin e produkteve të krimit dhe pastrimin e parave, si dhe efektshmërinë e zbatimit të ligjit për hetimet financiare dhe konfiskimin e produkteve të krimit, për periudhën e studimit.

Qëllimi i këtij punimi është që të shqyrtojë praktikën e zbatimit të ligjit për hetimin financiar, konfiskimin, dhe menaxhimin e të ardhurave nga krimi , për të kuptuar se si dispozitat ligjore për hetimin financiar, sekuestrimin, konfiskimin dhe menaxhimin e të ardhurave nga krimi janë zbatuar në Shqipëri. Rezultatet e hulumtimit dhe analiza e tyre në kapitujt në vijim, do të identifikojnë faktorët që kanë ndikuar në zbatimin ose pengesat kryesore për zbatimin e dispozitave të konfiskimit, si dhe e praktikave të mira që do të mund të ndiqen nga organet e zbatimit të ligjit.

Punimi merr përsipër të hulumtojë lidhur me efektshmërinë e masave të konfiskimit të pasurisë për periudhën 2004 – 2014, në Shqipëri.

Përveç prodhimit të njohurive të reja dhe sistematike mbi këtë temë, studimi ka si qëllim të japë një përkufizim të parë, elementët termit hetim financiar, në mënyrë që të stimulojë hulumtime të mëtejshme.

Një analizë e hollësishme lidhur me aplikimin në praktikë të hetimeve financiare dhe efektshmërinë e zbatimit të tyre për një periudhë 10 vjeçare, është një ilustrim për të parë diferencën ndërmjet ligjit në fuqi dhe zbatimit të tij në praktikë. Analiza krahasuese me vendet e rajonit dhe me vendet e BE-së, është një mundësi shtesë për të arritur në

konkluzione dhe për të bërë rekomandime politikbërëse. Kjo është trajtuar në kapitullin e fundit.

1.2 Objektivat e studimit

Punimi doktoral hulumton lidhur me efektshmërinë e zbatimit të kësaj mase parandaluese dhe zbatimin e saj në praktikë, duke i dhënë përgjigje pyetjes kërkimore: Cili është efektiviteti i masave ligjore, institucionale dhe operationale në fazat e a) hetimit, b) gjykitit dhe c) administrimit të pasurive të sekuestruara dhe konfiskuara. Kërkimi është fokusuar në Shqipëri, për një periudhë kohore 2004-2014. Përvec rishikimit të literaturës dhe akteve juridike ndërkombëtare dhe kombëtare, janë përdorur pyetësor për mbledhjen e të dhënave dhe marrjen e mendimeve të ekspertëve, nëpërmjet pyetjeve të hapura të përfshira në këtë pyetësor, i cili Ju është shpërndarë drejtuesve të institucioneve për secilën fazë, hetimit, gjykitit dhe administrimit të pasurisë së sekuestruar e konfiskuar. Analiza e rezultateve për secilin variabel, ka sjellë rezultate konkrete të zbatimit të masave parandaluese nëpërmjet hetimit financiar dhe konfiskimit, si dhe pengesat kryesore. Një studim i thelluar për identifikimin e gjetjeve, mangësive, pengesave dhe analiza e faktorëve ka bërë të mundur nxjerrjen e disa konkluzioneve dhe dhënien e rekomandimeve të vlefshme, të përfshira në fund të punimit.

Disa nga *objektivat* kryesore të këtij punimi janë: *së pari*, ky studim synon të analizojë hetimet financiare, konfiskimin e produkteve të krimit dhe administrimin e pasurive të sekuestruara dhe të konfiskuara si dhe faktorët që kanë ndikuar në ybatimin e masave për hetimet financiare. Një nga dilemat kryesore që shtrohet në këtë rast është nëse ekziston apo jo qartësia lidhur me koncepte të tilla si hetim financiar, hetim pasuror, konfiskim

sequestrim, pastrim parash. *Së dyti* synohet që përmes përdorimit të metodave shkencore të hulumtimit, të identifikohen faktorët e brendshëm ligjorë, institucional dhe operacional që ndikojnë në hetimet financiare. *Së treti*, përmes këtij studimi synohet të ndërgjegjësohen politikbërësit për ndërmarrjen e reformave të thella dhe mbështetëse për institucionet që merren me hetimet financiare sipas fazave hetimit, gjykimit dhe administrimit të pasurive të sekuestruara dhe të konfiskuara në veçanti.

1.3 Kufizimet e studimit

Duhet pranuar se në këtë punim kanë ndikuar edhe disa kufizime. Një i tillë është mungesa e studimeve të mëparshme sistematike mbi hetimet financiare dhe konfiskimin e produkteve të krimit. Ky punim merr përsipër të kryejë vlerësime empirike nëpërmjet të dhënave statistikore duke shfrytëzuar treguesit e analizave për periudhën në studim, por mungesa e statistikave të standartizuara është një kufizim tjetër dhe vështirësi në studime të thelluara sipas fazave të hetimit, gjykimit dhe administrimit të pasurive të sekuestruara dhe të konfiskuara. Një tjetër kufizim është fakti se instrumentet juridikë ndërkombëtarë janë përkthyer dhe në disa raste përshtatja e termave nuk jep kuptimin që përdoret në gjuhën zyrtare të instrumentit juridik të përkthyer.

1.4 Organizimi i studimit

Për qëllimet e këtij punimi, zhvillimi teorik është kryer duke rishikuar instrumuntet juridikë ndërkombëtarë, të drejtën e brendshme dhe në veçanti ligjin specifik për hetimet financiare. Trajtohen dhe raste të veçanta trajtohen dhe praktika gjyqësore duke bërë dhe krahasime ndërmjet teorisë dhe praktikës gjyqësore. Theks në këtë disertacion i jepet analizës së ligjit

nr. 10192, datë 3.12.2009 “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar dhe trafikimit nëpërmjet masave të konfiskimit të pasurisë”, ndryshuar me ligjin 24/2014.

Punimi është strukturuar në 7 kapituj, i cili fillon me “Hyrje”, ku trajtohet në formë të përmbledhur një historik i hetimeve financiare, dhe nevoja për krijimin e instrumenteve juridikë ndërkombëtarë dhe mbaron me “Konkluzione dhe rekomandime”. Në mënyrë të veçantë, ai është strukturuar si më poshtë:

Kapitulli 1, Hyrja paraqet në formë të përmbledhur një sintezë të problemit që shtrohet në punimin doktoral lidhur me hetimet financiare dhe konfiskimin e produkteve të krimit. Shtrimi i problemit, konceptet, elementet e hetimit financiar, një këndvështrim historik lidhur me hetimet financiare në të drejtën e brendshme, në fushat legjislative, institucionale dhe operacionale. Ky kapitull paraqet në formë të përmbledhur të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me hetimet financiare, sekuestrimin, konfiskimin dhe administrimin e pasurisë së fituar nga krimi. Qëllimi i këtij kapitulli është që të jepet një kuptim i përgjithshëm mbi hetimet financiare dhe konfiskimin e produkteve të krimit, lidhjen ndërmjet hetimit financiar dhe konfiskimit, konceptimi i hetimit financiar para hyrjes në fuqi të ligjit antimafia dhe pas hyrjes së tij në fuqi, konceptimin e objektit dhe metodologjisë së përdorur për argumentimin e tezës, të cilat në formë më të zgjeruar trajtohet në kapitujt në vijim, nocionet e krimeve që sjellin dobi pasurore dhe që për të cilat duhet ose bëhen hetime financiare, një përmbledhje e teorive lidhur me hetimet financiare dhe instrumentet juridikë, analiza dhe vështrim krahasues të legjislacionit me vendet e Ballkanit Perëndimor. Një vend të rëndësishëm në këtë kapitull zë dhe arsyetimi përse është marrë përsipër hulumtimi i kësaj temë, si dhe qëllimi i studimit, objektivat, kufizimet dhe organizimi i studimit.

Kapitulli 2, Objekti dhe metodologjia, trajton objektin e temës doktorale, “Hetimi financiar dhe konfiskimin e produkteve të krimit”, me fokus të vecantë në efektshmërinë në praktikë, gjatë periudhës 2004-2014 në Shqipëri. Kapitulli trajton dy çështje, atë të hipotezës dhe pyetjes kërkimore si dhe metodologjinë e përdorur për ti dhënë përgjigje pyetjeve kërkimore dhe argumentimin e tezës. Meqenëse fusha e studimit ka të bëjë me ligje dhe norma juridike të shkruara, me teori të cilat shpjegojnë fenomenet dhe përcaktojnë rregulla sjellje të përgjithshme, lidhur me hetimet financiare, konfiskimet, dhe duke qenë se objekt i hulumtimit është edhe efektshmëria në praktikë e zbatimit të këtyre dispozitave, janë përdorur metoda cilësore dhe sasiore. Të dhënat janë marrë nga raportet vjetore të publikuara të institucioneve që merren me hetimet financiare dhe konfiskimin e menaxhimin e pasurive të sekuestruara e të konfiskuara, si dhe nëpërmjet pyetsorëve janë marrë vlerësime dhe shpjegime nëpërmjet pyetjeve të hapura, nga drejtuesit e institucioneve të zbatimit të ligjit. Metoda deduktive dhe induktive janë përdor duke qenë se kemi të bëjmë me rregulla të shkruara të miratuara dhe me raste konkrete studimi.

Kapitulli 3, Hyrje në hetimet financiare dhe konfiskimin e produkteve të krimit, trajton çështje të kuptimit të hetimit financiar, pikëpamjeve mbi hetimet financiare, atë të nocionit të krimeve që sjellin dobi pasurore, duke ju referuar teorisë dhe së drejtës së brendshme, krime për të cilat bëhen ose duhet të bëhen hetime financiare, si dhe një vështrim historik dhe legjislativ për hetimet financiare dhe konfiskimin e produkteve të krimit para dhe pas hyrjes në fuqi të ligjit antimafia. Në Shqipëri, masat paraprake për konfiskimin e pasurisë, bëhen vetëm për një kategori të veprave penale, të përcaktuar në ligjin Nr. 9284, datë 30.09.2004, “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, (Ligji Antimafia), ndryshuar me Ligjin Nr.10192, datë 3.12.2009, “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të

organizuar dhe trafikimit nëpërmjet masave prandaluese kundër pasurisë”, ndryshuar me ligjin 24/2014. Në këtë kapitull si nënçështje trajtohen hollësisht elementët e hetimeve financiare, masat për hetime financiare lidhur me ndaj kujt bëhen hetimet financiare, për çfarë bëhen, lidhur me se bëhen hetimet financiare, si edhe jepen kuptimet e termave mjete financiare, pasuri, veprimtari ekonomike, burime të ardhurash, ku dhe si mund të gjenden ato, mënyra e marrjes, dhe referenca ligjore ku bazohemi për marrjen e tyre.

Nocioni i krimeve që sjellin dobi pasurore, trajton pikërisht faktin që të gjitha krimet të përfshira në këtë nocion, krijojnë përfitime të paligjshme dhe potencialisht duhej të përfshiheshin në marrjen e masave për konfiskimin e pasurisë. Konfiskimi i produkteve të krimit në Shqipëri bazohet edhe në dispozitat e Kodit penal, Kodit të procedurave penale dhe në dispozitat e ligjit Antimafia, i cili përcakton procedurat, kompetencat dhe kriteret e zbatimit të masave prandaluese kundër pasurisë së personave që janë subjekt i këtij ligji, si të dyshuar për pjesëmarrje në krimin e organizuar dhe trafikim. Një analizë e efekteve që sjell korrupsioni në ekonomi, ndikimin që sjell në krimin e organizuar dhe efikasitetin e zyrtarëve të zbatimit të ligjit, si dhe efektet e krimeve kibernetike, nevojën për përdorimin e mjeteve speciale për identifikimin, zbulimin, kapjen, sekuestrimin me qëllim konfiskimin e të ardhurave nga këto vepra penale, mendoj se do të ishte një risi për legjislacionin shqiptar dhe një mundësi tjetër për rritjen e efikasitetit të zbatimit të masave kundër pasurisë.

Kapitulli 4, Teoritë dhe instrumentet juridikë mbi hetimet financiare dhe konfiskimin e produkteve të krimit, është një rishikim i teorive për hetimet financiare, si masë efikase në luftën dhe sidomos në parandalimin e krimit, si dhe instrumentet juridikë, ndërkombëtare, regjional dhe kombëtar, dhe një trajtim të vecantë të procedurave të konfiskimit të produkteve të krimit. Plotësimi i analizës teorike me raste konkrete të marra nga praktika e

Gjykatës së Krimeve të Rënda, (GJKR), Gjykatës Europiane të të Drejtave të Njeriut, (GJEDNJ), vendimeve të Gjykatës së Lartë, (VGJL), dhe vendimet e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë (GJK), kanë qartësuar konceptet mbi hetimet financiare, sekuestrimin, konfiskimin e pasurisë që rrjedh nga krimi dhe ju ka dhënë përgjigje pyetjeve që kanë të bëjnë me parimin e ligjshmërisë, prezumimit të pafajsisë, barrën e provës, të drejtat e njeriut, të drejtën e pronës. Qartësimi i këtyre parimeve dhe instituteve për hetimet financiare dhe konfiskimin e produkteve të krimit, kanë ndihmuar për një analizë më të detajuar, dhe gjetjet e faktorëve që ndikojnë në efikasitetin e zbatimit të masave kundër pasurisë, trajtuar në kapitujt në vijim.

Kapitulli 5, Analiza e instrumenteve juridikë dhe efektiviteti i zbatimit të tyre në hetimet financiare për periudhën 2004 – 2014 në Shqipëri, nxjerr treguesit konkretë të rezultateve të zbatueshmërisë së legjislacionit në praktikë, në tre fazat e hetimit, gjyqimit dhe aloqimit, menaxhimit, administrimit të pasurisë së sekuestruar dhe konfiskuar, duke dhënë dhe një pasqyrë me tregues dhe gjetje lidhur me diferencën ndërmjet ligjit dhe zbatimit në praktikë. Analiza është mbështetur në praktikën që është përdorur në vendet e Bashkimit Europian për vlerësimin e efikasitetit të masave parandaluese kundër pasurisë. Analiza është bërë për secilën fazë, hetimi, gjykimi dhe administrimi, duke përdorur pyetësor për mbledhjen e të dhënave dhe marrjen e komenteve dhe mendimit të ekspertëve të institucioneve që merren me hetimet financiare, konfiskimin e produkteve të krimit dhe menaxhimin e pasurive që rrjedhin nga krimi. Me interes ka qënë mbledhja e mendimeve të ekspertëve duke ju përgjigjur pyetjes së shënuar në pyetësor, “Pse e zgjidhni këtë përgjigje dhe cili është mendimi Juaj”. Marrja e mendimeve nga ekspertët ka ndihmuar në identifikimin e faktorëve që

ndikojnë në variablat e përcaktuara në pyetsor dhe ka mundësuar nxjerrjen e konkluzioneve sa më reale dhe rekomandime në fund të punimit.

Kapitulli 6, Vështrim krahasues i legjislacionit me vendet e Ballkanit Perëndimor, është bërë krahasimi i legjislacionit dhe institucioneve, me vendet e Ballkanit Perëndimor, Kroacinë, Serbinë, Malin e Zi, Maqedoninë dhe Kosovën. Këta shtete kanë qënë pjesë e projekteve të përbashkëta të organizuara nga Këshilli i Europës dhe IOM, për zhvillimin e sistemeve të besueshme dhe funksionale të policive dhe nxitjes së luftës ndaj aktiviteteve kryesore kriminale dhe bashkëpunimit policor për mjetet kundër krimit ekonomik dhe atij të organizuar dhe trafikimit të qenjeve njerzore, kontrabandës dhe migrimit ilegal, për të zbatuar zotimet e marra në kuadër të Deklaratës së Londrës “Për mundjen e krimit të Organizuar në Europen Jug-Lindore”, Nëntor 2002, të Deklaratës së Brukselit, “Mbi trafikimin e qenjeve njerzore”, Prill 2003, dhe Procesit të Stabilizim Asocimit. Rezultat i këtij projekti janë hartuar dhe nënshkruar strategji rajonale “Mbi instrumentet e krimit të organizuar dhe krimit ekonomik”, miratuar më 23 Shtator 2005, në Brijuni, Kroaci. Në këtë strategji rajonale përfshihet dhe strategjia, me synime të qarta, për hetimet financiare dhe konfiskimin e produkteve të krimit.

Kapitulli 7, Konkluzione dhe rekomandime, trajtohet një përmbledhje e gjetjeve të këtij punimi doktoral dhe rekomandime, të cilat mendoj se janë të vlefshme për tu marrë parasysh. Ky kapitull përmbledh të gjitha gjetjet e përgjithshme të punimit të cilat në formë të detajuar pasqyrohen në kapitujt gjatë punimit si dhe në formë të përmbledhur në fund të kapitujve. Lidhur me hetimet financiare, konfiskimin e produkteve të krimit dhe menaxhimit të pasurive të sekuestruara dhe të konfiskuara në Shqipëri, pas vitit 2004 ka patur përpjekje për të kryer hetime financiare dhe kjo reflektohet në masat legislative, institucionale dhe

operacionale që Shqipëria ka marrë gjatë këtyre viteve për hetimet financiare. Megjithëse masat ligjore janë në përputhje me standartet ndërkombëtare, mbetet dhe shumë për të bërë në fushën institucionale dhe operationale, dhe kjo reflektohet në zbatimin e ligjit në Shqipëri në fazën e hetimit 39%, në fazën e gjykimit 45% dhe në fazën e administrimit të aseteve të sekuestruara dhe të konfiskuara në masën 25 %. Gjetjet dhe konkluzionet në fund të punimit japin përgjigje pyetjeve kërkimore dhe provojnë plotësisht hipotezat e ngritura në fillim të punimit.

Gjithashtu në fund të këtij kapitulli jepen rekomandime konkrete të cilat mendoj se duhet të merren parasysh nga politikbërësit për të ndryshuar masat për hetimet financiare me qëllim ndryshimin e treguesve për hetimet financiare, konfiskimin dhe administrimin e pasurive që rrjedhin nga aktivitetet kriminale. Gjetjet dhe rekomandimet adresohen në tre drejtime kryesore si në fushën legjislative, për ndryshime të dispozitave të ligjit specifik për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit dhe korrupsionit, nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë, institucionale, për ngritjen e strukturave të reja ose ndryshimin e strukturave ekzistuese, si dhe mbështetjen me burime njerëzore, financiare dhe teknologjike të strukturave përgjegjëse për hetimet financiare, konfiskimin dhe menaxhimin e aseteve të sekuestruara dhe të konfiskuara.

KAPITULLI II: OBJEKTI DHE METODOLOGJIA

2.1 Hipotezat dhe pyetja kërkimore

Hetimi financiar është një procedurë relativisht e re jo vetëm për Shqipërinë por edhe për vendet e tjera. Krimi i organizuar, kombëtar e transnacional dhe krimi financiar, gjatë viteve të fundit janë bërë një problem serioz për sigurinë dhe ekonominë e vendeve të botës. Gjenerimi i mjeteve financiare të organizatave kriminale dhe korrupsioni i zyrtarëve të zbatimit të ligjit, pavarësisht marrjes së masave represive ndaj kriminelëve, nuk mundën të shënojnë uljen e nivelit të krimeve, kjo për faktin se ekonomikisht këta organizata janë të fuqishme. Përpjekjet për të gjetur zgjidhje u shtuan pas viteve '80, ku mendimtarë, jurist, zyrtarë të zbatimit të ligjit, organizata, institucione dhe shtete u përfshinë në iniciativat për gjetjen e rrugëve të tjera të luftës kundër krimit, dhe sidomos atij të organizuar dhe trafikimit të çdo lloji. Karakteristikë e krimit të organizuar dhe qëllimi final ishte përfitimi. Pikërisht fitimet kolosale nga veprimtaria kriminale u bënë dhe gjeneratori kryesor për fuqizimin e organizatave kriminale. Kriminelët jo vetëm që përballonin shpenzimet në organizatat e tyre dhe jetën lluksoze, por e lehtësonin dhe vënjen e tyre përpara organeve të drejtësisë, pasi zyrtarë të zbatimit të ligjit korruptoheshin, duke sjellë dhe moseficencën e organeve dhe strukturave ligjzbatuese. Lind si domosdoshmëri gjetja e formave të reja të luftës kundër krimit në përgjithësi dhe atij të organizuar në veçanti, duke krijuar instrumente juridikë ligjorë, masa institucionale dhe operacionale për të goditur dhe ndëshkuar kriminelët dhe asetet e gjeneruara nga veprat penale. Parë në këtë këndvështrim mund të thuhet se hetimi financiar është një procedurë subjektive dhe relativisht e re. Duke qënë se instrumentet juridikë janë akte të reja, ngritja e institucioneve dhe zbatimi në praktikë i instrumenteve ligjorë ka vështirësi, dhe si e tillë gjithmonë ka nevojë për përmirësime. Ky ndryshim i

instrumenteve ligjorë të së drejtës ndërkombëtare, Konventa e Vjenës³, Konventa Strasburgut⁴, Konventa e Palermos⁵, Konventa e Varshavës⁶, justifikohet si domosdoshmëri për përmirësimin dhe plotësimin e instrumenteve juridikë në përballjen me krimin në përgjithësi dhe krimin e organizuar në veçanti. Në përgjithësi këta konventa detyronin shtetet palë për marrjen e masave ligjore, institucionale dhe operacionale e menaxheriale, për luftën kundër krimit në përgjithësi dhe dispozita të vecanta rekomandonin dhe sjelljen ligjore të këtyre shteteve për sa i përket pasurisë së fituar në rrugë kriminale. Analiza e këtyre instrumenteve ndërkombëtarë do bëhet në kapitujt në vazhdim. Në këtë punim doktoral fokusi kryesor është tek normat juridike të këtyre instrumenteve që garantojnë hetimin financiar me qëllim konfiskimin e produkteve të krimit. Prandaj, duke u nisur nga përvoja ime personale dhe njohuritë profesionale synoj që të sjell me anë të këtij studimi disa gjetje dhe mendime, të cilat, sipas mendimit tim, do ta bënin më efikas hetimin financiar në Shqipëri, jo vetëm në aspektin ndëshkimor por kryesisht në atë parandalues. Duhet specifikuar se natyra subjektive e hetimit financiar çon në një debat të gjerë të formave ligjore, institucionale dhe operacionale efikase, por me anë të këtij studimi të bazuar kryesisht në përvoja të aplikuara në vende të ndryshme të botës synoj që të sjell formën më të mirë dhe të argumentoj pse ajo është më e mira për Shqipërinë.

Qëllimi i punimit mund të prezantohet i përmbledhur në disa drejtime kryesore si:

³ Miratuar me Ligj nr.8722, datë 26.12.2000, Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në “Konventën e Kombeve të Bashkuara kundër trafikut të paligjshëm të drogave narkotike dhe të lëndëve psikotrope” (Vjena)

⁴ Miratuar me Ligj nr.8646, datë 20.7.2000, Për ratifikimin e Konventës Europiane “Për pastrimin, depistimin, kapjen dhe konfiskimin e produkteve të krimit” (Strasburg)

⁵ Miratuar me Ligj nr.8920, datë 11.7.2002, Për ratifikimin e Konventës së Kombeve të Bashkuara kundër krimit të organizuar ndërkombëtar dhe dy protokolleve shtesë të saj (Palermo)

⁶ Ligj nr.9646, datë 27.11.2006, Për ratifikimin e Konventës Europiane “Për pastrimin, depistimin, kapjen dhe konfiskimin e produkteve të krimit dhe financimin e terrorizmit” (Varshavë)

Së pari, të shqyrtojë konceptin e hetimit financiar si proces me disa faza dhe përpjekjet për të dhënë elementët e hetimit financiar në përgjithësi dhe sipas fazave në veçanti.

Së dyti, të shqyrtojë praktikën e zbatimit të ligjit për hetimet financiare dhe konfiskimin e të ardhurave nga krimi, për të kuptuar se si dispozitat ligjore të konfiskimit të të ardhurave nga krimi janë zbatuar në Shqipëri. Trajtimi sipas drejtimeve të mësipërme do të identifikojë pengesat kryesore në zbatimin e dispozitave të konfiskimit, dhe efikasitetin e rezultateve për periudhën e studimit duke testuar hipotezat e punimit si më poshtë:

H.0 Hetimet financiare të përcaktuara në instrumentet ligjore nuk kanë sjellë rezultatin e pritur gjatë zbatimit të tyre në praktikë në periudhën 2004-2014 në Shqipëri.

H.1 Mungesa e rezultateve të pritura është pasojë e masave të pamjaftueshme institucionale dhe operacionale, për zbatimin e ligjit në fushën e hetimeve financiare.

Pyetja kryesore kërkimore

Cili është efektiviteti i masave ligjore, institucionale dhe operacionale në fazat e a) hetimit, b) gjyqimit dhe c) administrimit të pasurive të sekuestruara dhe konfiskuara për periudhën 2004-2014, në Shqipëri?

Për të dhënë përgjigje pyetjes kryesore të punimit, është e nevojshme ngritja e disa pyetjeve të tjera ndihmëse si:

- Sa dhe si zbatohen dispozitat ligjore në hetimet financiare dhe konfiskimin e të ardhurave nga krimi në Shqipëri?
- Cilat janë pengesat kryesore për zbatimin të tyre, në lidhje me praktikën më të mirë?
- Cilat janë masat ligjore, organizative dhe operacionale për hetimet financiare në Shqipëri,
- Cilat janë institucionet përgjegjëse për hetimet financiare?

- Cili është niveli i bashkëpunimit mes institucioneve të përfshira në hetimet financiare dhe konfiskimin e produkteve të krimit?

- A përdoren mjetet e posaçme të hetimit për identifikimin e aseteve kriminale, dhe në çfarë shkalle përdoren ato?

- Cili është niveli i kalimit të barrës së provës për asetet e sekuestruara dhe konfiskuara,

- Si bëhet dhe cili është efektiviteti i menaxhimit aktiv të pasurive të sekuestruara dhe konfiskuara?

Përgjigjet e pyetjeve ndihmëse japin përgjigje pyetjes kryesore të punimit doktoral duke testuar plotësisht hipotezat e punimit.

2.2 Metodologjia

Qasja hulumtuese dhe studimore e këtij punimi doktoral është mbështetur në ndërthurjen e metodave në mbledhjen, përpunimin dhe analizimin e të dhënave kërkimore.

Kryesisht punimi është mbështetur në kërkime për materiale, artikuj, raporte, studime, strategji e projekte që lidhen me hetimet financiare në vendet e ndryshme të botës, dhe në Shqipëri, sipas metodës kërkimore *desktop based research*, pra kërkimi kompjuterik përmes internetit dhe rishikimi i literatures dhe praktikave gjyqesore. Literaturë lidhur me libra dhe artikuj në fushën e hetimeve financiare dhe konfiskimin e produkteve të krimit janë gjetur në platformat e arkivave elektronike JSTOR dhe EBSCO. Gjithashtu kërkimi i literaturës së botuar në Shqipëri, si doktoratura të mëparshme, manual për hetimet financiare, strategji për hetimet financiare, më kanë ndihmuar të pasuroj me tej fondin e literaturës së konsultuar, për zhvillimin e punimit.

Gjithashtu, për të kuptuar qëllimin, synimin e përshtatjes së legjislacionit dhe ndryshimet e vazhdueshme ligjore, organizative dhe operacionale për hetimet financiare, ka qenë e rëndësishme eksperiencia shumëvjeçare në hetimin e krimit në përgjithësi dhe krimit ekonomik, pastrimit të parave dhe korrupsionit në veçanti, si edhe pjesëmarrja e vazhdueshme si ekspert, në projektin CARPO, Moduli 1, Instrumentet kundër krimit të organizuar dhe krimit ekonomik, rezultati 1.2 *“Zhvillimi i sistemeve policore të besueshme dhe funksionuese si dhe nxitja e luftimit të aktiviteteve kryesore kriminale dhe i bashkëpunimit policor”*, projekti teknik i përbashkët, me kohëzgjatje 30 muaj, (Mars 2004-Shtator 2006), financuar nga Këshilli i Europës dhe Bashkimi Europian, i cili përfshinte: Shqipërinë, Bosnje Hercegovinën, Kroacinë, Kosovën, Malin e Zi, Serbinë dhe Maqedoninë. Eksperiencia si trajner rajonal për hetimet financiare, koordinator në vendet e Ballkanit, për bashkëpunimin rajonal për hetimin e krimit, dhe si ligjërues i lëndës Krimi financiar është një mundësi tjetër shtesë për zhvillimin e punimit.

Pas mbledhjes së literaturës së shumëllojshme, në gjuhë të huaj dhe shqip, shkrimi i punimit bazohet në hapat metodologjik si vijon: rishikim i literaturës, mbledhja e të dhënave, përpunimi dhe analiza të dhënave, (Michael G.Maxfield, Earl R.Babbie, 2008, p. 49); analizën ligjore të materialit normativ vendas për hetimet financiare, përfshirjen e konventave ndërkombëtare në të drejtën e brendshme dhe hartimin për herë të parë të ligjit “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar”, viti 2004, i quajtur ndryshe dhe ligji antimafia, ndryshuar me ligjin 10192, të vitit 2009, “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar dhe trafikimit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”, ku u përcaktua dhe strategjia për hetimet financiare në Shqipëri, -përshkrimin e historikut të hetimeve financiare dhe konfiskimit të produkteve të krimit në Shqipëri, përshkrimin e

parimeve, procedurave, institucioneve kompetente në fushën e hetimeve financiare dhe konfiskimit të produkteve të krimit, referuar në parashikimet konkrete ligjore dhe nënligjore, interpretimeve gjyqësore bazuar në vendimet e Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë dhe Vendimet e Gjykatës Kushtetuese, dhe Gjykatës së të Drejtave të Njeriut, dhe Gjykata e Strasburgut.

Metoda krahasuese, sidomos për institutet e hetimeve financiare dhe konfiskimit të pasurisë që rrjedh nga krimi, të cilat zbatohen në vendet e Bashkimit Europian dhe kanë një experience më të gjatë, dhe vendet e rajonit, për sa i takon masave ligjore, institucionale dhe operacionale, parimet ku bazohen për konfiskimin e produkteve të krimit.

Metoda interpretuese (Pound R. , 1923, p. 20), sidomos për interpretimin e normave dhe termave për sekuestrimin e konfiskimin e produkteve të krimit, gjetjeve, konkluzioneve të punimit. Metoda kronologjike, historike, me anë të të cilave është dhënë në punim kronologjia sipas zhvillimit historik të ngjarjeve, dhe përpjekjeve për përshtatjen e legjislacionit, dhe krijimin e normave dhe strategjive të reja lidhur me hetimet financiare.

Metodën sasiore, (analizat statistikore) dhe cilësore, të studimit të materialeve të shumta, si dhe në studimin e statistikave në tre fazat: a) hetimit, b) gjyqimit dhe c) administritimit të pasurive të sekuestruara dhe konfiskuara, të cilat nxjerrin në pah efektivitetin e masave legjislative, institucionale dhe operacionale si dhe zbatimin e ligjit, duke dhënë tregues të qartë për diferencën ndërmjet ligjit në fuqi dhe zbatimit të tij në praktikë në Shqipëri, e njohur ndryshe dhe si “*law in books*” dhe “*law in the action*” (Pound R. , 1924, p. 19).


Për realizimin e punimit, arritjen e synimeve, vërtetimin e hipotezave dhe dhënjen e përgjigjeve pyetjeve kërkimore, janë të domosdoshme metodat deduktive dhe induktive, cilësore dhe sasiore, për këto arsye:

Së pari, deduktive, pasi kemi të bëjmë me dispozita ligjore, të cilat ose janë krijuar, ose janë ndryshuar, ose janë importuar nga konventa dhe të drejta të tjera, të cilat kanë nevojë për tu kuptuar, përshtatur dhe më pas zbatuar në të drejtën e brendshme.

Së dyti, induktive, sepse gjatë punimit është trajtuar dhe rast studimi të praktikës shqiptare dhe praktikave nderkombetare çeshtje të caktuara mbi hetimet financiare dhe konfiskimin e produkteve të krimit, duke pretenduar argumentimin e teorisë.

Së treti, cilësore (qualitative) sepse kemi të bëjmë me teori, përshkrime, interpretime, kuptime të termave përmes të cilave synohet të shpjegohet procesi i hetimit financiar dhe konfiskimit të pasurisë dhe sfidat që ka procesi në Shqipëri.

Së katërti, sasiore (quantitative), sepse jemi përpjekur nëpërmjet të dhënave sasiore, parësore dhe dytësore, për periudhën në studim, të gjejmë treguesit dhe tendencat e zbatimit të ligjit, sipas variablave të përcaktuara dhe sipas fazave të procesit të hetimit financiar dhe konfiskimit të produkteve të krimit. Hapat metodologjik janë si më poshtë:



Hapi 1. Ndarja e konceptit të hetimit financiar dhe konfiskimit të produkteve të krimit sipas fazave, a) hetimit, b) gjykimit, 3) administrimit.

Hapi 2. Përgatitja e pyetësorit, me variablat sipas fazave të mësipërme dhe dërgimi i tyre në formë elektronike drejtuesve të institucioneve të përfshira në hetimin, gjykimin dhe administrimin e pasurive. Pyetësorët kanë për qëllim të mbledhin të dhëna statistikore për secilin variabël sipas fazave, si edhe për të marrë mendimin e ekspertëve të fushës së zbatimit të ligjit sipas institucioneve përgjegjëse.

Hapi 3. Ndërtimi i profilit të vendit që përshkruan zbatimin e ligjit dhe ligjin në fuqi në Shqipëri për periudhën e studimit 2004-2014 sipas fazave a) hetimit, b) gjykimit, 3) administrimit.

Hapi 4. Analiza e të dhënave statistikore nga institucionet përgjegjëse për hetimet financiare mbi rezultatet e arritura për këtë periudhë studimi.

Bazuar në të dhënat sipas pyetësorëve dhe komentet nga ekspertët në pyetjet e hapura të shprehura në këtë pyetësor, sipas fazave, variablate ju janë dhënë një notë nga 1 në 5, dhe për secilin variabël sipas shkallës së renditjes janë dhënë vlerat nga 0 në 100. Kjo metodë jep rezultatet e zbatimit të ligjit si dhe nxjerr gjetjet se në cilin variabël sipas fazave kemi të meta, duke dhënë mundësinë e rekomandimeve sipas variablate dhe fazave për përmirësimin dhe arritjen e treguesve të lartë, referuar dhe praktikave më të mira në fushën e hetimit financiar dhe konfiskimit të produkteve të krimit, sipas fazave, të hetimit, gjykimit dhe administrimit të pasurive të sekuestruara dhe të konfiskuara.

Koncepti i hetimit financiar është një koncept i ri, është kompleks, ka nevojë për njohuri në disa fusha dhe jo vetëm në ato juridike. Burimet e informacionit janë të kufizuara. Ka nevojë për tu zhvilluar dhe kuptuar si koncept e më pas për tu zbatuar. Sqarimi dhe zhvillimi i

koncepteve të hetimeve financiare, sekuestrimit, konfiskimit, si dhe matja me rezultate konkrete të implementimit të tyre në praktikën juridike, ka përcaktuar dhe metodën e kërkimit, cilësore, sasiore dhe mikse (Bob Matthews, Liz Ross, 2010). Përgatitja e pyetsorëve dhe përfshirja në të e pyetjeve të hapura dhe të strukturuara, ka bërë të mundur analizën cilësore të fenomeneve dhe atë sasiore, duke nxjerrë tregues konkret për zbatimin e ligjit të shkruar për një periudhë të caktuar, të përzgjedhur kërkimi. Si burime të informacionit kanë shërbyer instrumentet juridikë ndërkombëtar, konventat nga dhe janë marrë dispozitat e përfshira në të drejtën e brendshme, Kushtetuta, kodi penal dhe procedural penal, dhe ligje specifike, që përcaktojnë sjelljen, raporte vjetore të institucioneve të ngarkuara për zbatimin e këtyre dispozitave si: raportet e analizave vjetore të Prokurorisë së Krimeve të Rënda, të Gjykatës së Krimeve të Rënda, për periudhën që hulumtohet, raporte vlerësimi periodik nga Institucionet Ndërkombëtare si: raportet e vlerësimit mbi gjendjen e krimit të organizuar dhe krimit ekonomik në Europën Juglindore, të viteve 2005, 2006, 2007, raport progreset për Shqipërinë, vendime të Gjykatës Europiane për të Drejtat e Njeriut, (GJEDNJ).

KAPITULLI III: HYRJE NË HETIMET FINANCIARE DHE KONFISKIMIN E PRODUKTEVE TË KRIMIT

3.1 Kuptimi i hetimit financiar dhe dallimet me konfiskimin dhe pastrimin e parave

Ky kapitull, siç dhe titullohet, trajton konceptet e hetimit financiar dhe konfiskimin e produkteve të krimit, duke trajtuar në mënyrë të hollësishme kuptimin e secilit term, ndryshimin ndërmjet hetimit financiar dhe konfiskimit të produktit të krimit, nocionet e krimeve që sjellin dobi pasurore të paligjshme si krimi ekonomik, financiar, krimet e lidhura në kuptimin e lidhjes me krimin e organizuar dhe që kërkojnë një vëmendje të vecantë në marrjen e masave për luftën dhe parandalimin e tyre, për shkak të rrezikshmërisë më të madhe dhe pasojave ekonomike, sociale dhe politike që sjellin, siç janë krimi i organizuar, trafikimi i paligjshëm i qënjeve njerëzore, armëve muncioneve, mjeteve motorike, korrupsioni, pastrimi i parave dhe krimi kibernetik. Çështje të rëndësishme trajtohen lidhur me kuptueshmërinë e nocioneve dhe dallimet midis tyre si: 1) çfarë është hetimi financiar, elementet e hetimit financiar, masat për hetimet financiare; 2) konfiskimi si masë dhe konfiskimi si dënim, llojet e konfiskimit; 3) dallimi dhe lidhja ndërmjet konfiskimit dhe hetimit financiar.

Termi hetim financiar edhe në literaturë gjendet në disa kuptime, dhe shpesh edhe nga juristët flitet për hetime financiare dhe kuptojnë konfiskimin, ose pastrim parash. Ndarja dhe qartësimi i termave hetim financiar, konfiskim dhe pastrim parash do të jetë dhe një nga objektivat e këtij punimi. Në kuptim të përgjithshëm, nisur nga fjalët përbërëse, “hetim” dhe “financë” janë dy termat që duhen shpjeguar për të kuptuar togfjalëshin hetim financiar. Hetim do të thotë gjurmim, ndjekje, kapje, identifikim, bllokim, sekuestrim.

Kryerja e këtyre veprimeve kërkon organizim, kompetencë për ti kryer. Pikërisht procedurat e formalizuara për të kryer veprimet e gjurmimit, ndjekjes, kapjes, identifikimit, bllokimit dhe sekuestrimit japin kuptimin e termit “hetim”. Por të kujt? Financave. Çfarë është financa? Cili mund të jetë kuptimi i përdorur në hetime financiare? Se çfarë është financa shpjegohet nga shkenca e financës, dhe në kuptimin e përdorur në hetim financiar ka të bëjë me të ardhurat dhe shpenzimet. Për qëllimet e punimit duhen qartësuar termat “hetim financiar”, dhe “hetim financiar penal”. Hetimi financiar në kuptimin e përgjithshëm bëhet për shumë arsye, për njohjen e gjendjes financiare të një kompanie, subjekti juridik, shteti të caktuar, për një periudhë të caktuar etj. Qëllimi është njohja e gjendjes mbi të ardhurat e shpenzimet dhe marrjen e masave për gjetjen dhe përcaktimin e politikave të reja. Në kuptimin penal, hetimet financiare, kanë të bëjnë me masat, procedurat e lejuara me ligj, për të kryer veprimet e gjurmimit, ndjekjes, kapjes, identifikimit, bllokimit dhe sekuestrimit të të ardhurave nga aktivitete kriminale. Ndërsa konfiskimi është marrja e përhershme e së drejtës mbi këto të ardhura. Nga ky përkufizim i hetimit financiar del qartë se konfiskimi është qëllim i hetimit financiar. Dhe vetë hetimi financiar është një proces me shumë veprime dhe masa, të cilat kërkojnë kompetenca të shkruara, formale, njerëz profesionistë, burime njerëzore, materiale dhe financiare për ti kryer ato, duke respektuar të drejtat e njeriut dhe të drejtën mbi pronën. Një tjetër element i domosdoshëm për kryerjen e hetimeve financiare është koha në dispozicion. Nëse themi që konfiskimi është qëllimi i hetimit financiar, kuptohet që arritja e këtij qëllimi është dhe përmbushja e të gjithë elementëve, kërkesave të mësipërme për arritjen e qëllimit, që në rastin e hetimeve financiare penale është konfiskimi i të ardhurave nga krimi. Ndarja e procesit të hetimit financiar penal, në faza, do të jepte një kuptim më të plotë dhe të saktë të kuptimit të këtij termi. Pasi për secilin operacion kërkohen

masa dhe veprime operationale dhe kompetenca konkrete, duke ju dhënë përgjigje pyetjeve çfarë ka ndodhur, sa ka përfituar, kush ka përfitur, ku janë fshehur, si janë transferuar, çfarë autorizimesh kërkohen për tu marrë, cili është organi kompetentë për lëshimin e autorizimeve apo vendimeve etj. I gjithë ky proces kompleks përcakton dhe procedurat, kriteret, kompetencat për zbatimin e masave për hetimet financiare dhe konfiskimin e produkteve të krimit.

Një ndarje tjetër e hetimit financiar, nisur nga praktika që përdoret është: Hetim financiar gjatë proceseve civile dhe hetim financiar gjatë proceseve penale. Në këtë punim do të fokusohemi tek hetimet financiare që kryhen gjatë, në, ose jashtë procesit penal, që do të thotë do të fokusohemi në hetimet financiare që kanë të bëjnë me produktet e krimit. Nuk është e domosdoshme të provojmë krimin për të filluar hetimet financiare, por është e nevojshme dhe e domosdoshme të krijojmë bindjen “se ekziston një dyshim i arsyeshëm i bazuar në indicje”.

3.1.1 Hetimi financiar, elementët, masat për hetimet financiare

Në literaturë, hetimi financiar si koncept përmendet për herë të parë në Rekomandimin e Këshillit të Europës, datë 25 prillit 2002 “Mbi përmirësimin e metodave të hetimit në luftën kundër krimit të organizuar të lidhur me trafikun e drogës: hetimeve të njëkohshme në trafikun e drogës nga organizatat kriminale dhe financave e aseteve të tyre”(Gazeta Zyrtare C 114). Ky akt rekomandon shteteve anëtare aplikimin e metodave të hetimit në luftën kundër krimit duke përfshirë krimin e lidhur me trafikimin e organizuar të drogës, i cili përfshin hetimin në të gjitha frontet, që në fillim, çdo aktivitet lidhur me trafikimin e paligjshëm të drogës dhe identifikimin financave dhe pasuritë e organizatës.

Rekomandimi synon përdorimin e metodave të reja në luftën kundër krimit dhe në veçanti për krimet e lidhura me trafikimin e organizuar të drogës, duke u shprehur për një hetim të gjithanshëm, lidhur me identifikimin e financave dhe pasurive që në fillim.

Për rritjen e efikasitetit të hetimeve financiare rekomandimi shprehet se duhet inkurajuar ngritja e grupeve të përhershme ose të përkohshme të specializuara në hetimin e aseteve, për të promovuar efikasitet më të madh në metodën e hetimit financiar.

Sygjerimi për ngritjen e grupeve të specializuara për hetimin e aseteve dhe hetimit financiar është një tjetër masë e rëndësishme që rekomandohet.

Sipas pikës C, D, E dhe F, rekomandohet bashkëpunimi institucional dhe ndërkombëtar, duke përfshirë në këtë proces institucionat e brendshme të cilat disponojnë të dhëna për financat dhe pasuritë e organizatave kriminale si:

C. Për të forcuar ose për të lehtësuar bashkëpunimin në mes të organeve të zbatimit të ligjit, gjykatave dhe autoritetet e taksave dhe personat përgjegjës për regjistrat e ndryshme publike apo private të pronësisë të cilat mbajnë informacion për pasuritë e çfarëdo natyre, duke përshpejtuar përpunimin e kërkesave për informacione, të bëra nga këto autoritete .

D. Për të nxitur krijimin e ekipeve të përbashkëta hetimore ndërmjet Shteteve Anëtare në përputhje me instrumentet ligjore të Bashkimit Evropian duke aplikuar metoda të tilla në rastet kur hetimi në organizatën kriminale përfshiin trafikun e drogës në më shumë se një Shtet Anëtar.

E. Për të ftuar Europol -in, në përputhje me Rekomandimin e Këshillit të datës 30 Nëntor 2000 për kërkesat në lidhje me ndihmën e Europolit për ekipet e përbashkëta hetimore të ngritura nga Shtetet Anëtare.

F. Për të përdorur mundësitë e ofruara nga CEPOL (Kolegji Policia Evropiane) në hartimin e moduleve specifike të trajnimit në përdorimin e kësaj teknike speciale të hetimit”(Gazeta Zyrtare C 114).

Rekomandimi i Këshillit të Europës, datë 25 prillit 2002 “Mbi përmirësimin e metodave të hetimit në luftën kundër krimit të organizuar të lidhur me trafikun e drogës, hetimeve të njëkohshme në trafikun e drogës nga organizatat kriminale dhe financave e aseteve të tyre rekomandon tre çështje të rëndësishme si: përdorimin e metodës së re të hetimit financiar në

luftën kundër krimit, krijimin e strukturave të specializuara si dhe bashkëpunimin institucional dhe ndërkombëtar.

Në librin e saj “Vështirësia mbi pasuritë kriminale”, lidhur me hetimin financiar, Barbara Vettori, shprehet:

“Ky evolucion i konfiskimit është shoqëruar me forcimin e kompetencave të kërkuesve për të mbledhur informacion mbi gjendjen financiare të dyshuarit. Kjo ka ardhur për shkak se hetimet financiare janë portë për konfiskim. Prandaj, njësitë hetimore financiare me përgjegjësi të veçantë për aspektet financiare të krimit janë ngritur në shumicën e shteteve anëtare të BE-së dhe janë rritur kompetencat për të marrë informacion dhe për të përdorur mjete të posaçme hetimore, edhe përmes miratimit të rregulloreve kunder pastrimit të parave” (Vettori, 2006, p. 10).

Nga ky qëndrim i autores del qartë se hetimet financiare, marrja e masave për të mbledhur informacion lidhur me gjëndjet financiare, është domosdoshmëri për të bërë të mundur konfiskimin e produkteve të krimit duke rritur kompetencat për të marrë informacion dhe për të përdorur mjete të posaçme hetimore.

Në manualin trajnues “Hetimet financiare dhe konfiskimi i produkteve të krimit” përgatitur për autoritetet e zbatimit të ligjit dhe për organet e sistemit gjyqësor, me fokus forcimin e kapaciteteve kundër krimeve të rënda në Europën Juglindore, jepet një nocion më i gjerë dhe më i plotë i termit hetim financiar si dhe elementet përbërës të tij. Goditja e produkteve të krimit në luftën kundër korrupsionit, krimit të organizuar, pastrimit të parave dhe llojeve të tjera të krimit ekonomik si dhe kryerja paralelisht e hetimeve të integruara financiare, që kanë për qëllim të identifikojnë, sekuestrojnë dhe konfiskojnë produktet e krimit duhet të jenë, gjithsesi, pjesë e çdo strategjie të luftës kundër krimeve të rënda dhe kundër krimit të organizuar⁷. Duke dashur të bëhet e qartë dallimi mes hetimit financiar dhe hetimit penal, në manualin e sipërcituar theksohet qëllimi që ndjek hetimi financiar. Sipas këtij manuali,

⁷ Manuali mbi hetimet financiare dhe konfiskimi i produkteve të krimit, 2006, Strasburg

hetimi financiar është një pjesë, e cila kryhet në mënyrë paralele me hetimin penal dhe ka për qëllim zbulimin e produkteve të krimit, identifikimin e pronës që mund të konfiskohet dhe sigurimin e përkohshëm (sequestrimin) të kësaj prone, për të lejuar konfiskimin përfundimtar në të ardhmen. Ndërkohë që qëllimi i hetimit penal është zbulimi i një vepre penale dhe e autorit të saj si dhe mbledhja e provave për procedurat penale, qëllimi i hetimit paralel financiar është të konfiskojë produktet e krimit. Prandaj, është e rëndësishme që hetimi financiar të fillojë në fazat e para të hetimit penal, meqenëse rezultatet e të dy këtyre hetimeve mund të jenë të rëndësishme për arritjen e qëllimeve të tyre respektive. Zbulimi i suksesshëm dhe sequestrimi i përkohshëm i pronës parandalon fshehjen dhe eliminimin e saj, si dhe lejon një konfiskim përfundimtar të efektshëm në mbyllje të procedurave penale⁸. Bazuar në vështirësitë që paraqet hetimi financiar, ky i fundit duhet të përmbajë disa elementë: *së pari*, hetimi financiar duhet të jetë një procedurë standarde që aplikohet gjatë hetimit të produkteve të gjeneruara nga krimi; *së dyti*, hetuesit duhet të jenë të specializuar në fushën e hetimeve financiare; *së treti*, ekzistenca e një bashkëpunimi të ngushtë me hetuesit që janë të ngarkuar me hetimet penale.

Krahas këtyre elementëve një hetim i suksesshëm financiar nënkupton një hetim të integruar financiar që përfshin një numër veprimesh për identifikimin, zbulimin dhe marrjen e masave të përkohshme mbi pasurinë si: mbledhja e provave mbi autorin e krimit dhe mbi veprën penale (si pjesë e hetimit penal); përcaktimi i produkteve të krimit (lloji dhe sasia); përcaktimi i pronës që mund të konfiskohet (identifikimi i personave, i pronës që është e

⁸ Manual mbi hetimet financiare dhe konfiskimin e produkteve të krimit, (2006), Strasburg

konfiskueshme në kuadër të konfiskimit sipas vlerës, apo në kuadër të konfiskimit të zgjeruar); përcaktimi i kushteve për masat e përkohshme (sekuestrimi/ngrirjen/bllokimi)⁹.

Hetimi financiar është një proces kompleks, i cili kërkon shumë veprime, masa, bashkëpunim me institucione që disponojnë të dhëna, data baza. Gjithashtu ai është i lidhur, ngushtësisht me konfiskimin e produkteve të krimit, i cili është dhe qëllim i hetimit financiar, i cili nga ana e tij lidhet ngushtë me administrimin/ menaxhimin e pasurive të konfiskuara, që në thelb është dhe vetë qëllimi i konfiskimit dhe i drejtësisë penale.

Rekomandimet e Konventave dhe akteve të tjera ndërkombëtare të miratuara në këtë fushë fokusohen në domosdoshmërinë e ndërmarrjes së hetimeve financiare me qëllim konfiskimin e produkteve të krimit të organizatave kriminale duke bërë të mundur identifikimin e financave dhe pasurive të organizatës kriminale, ngritjen e grupeve të përhershme ose të përkohshme për hetimet financiare, rritjen e bashkëpunimit mes institucioneve dhe mes shteteve, duke përfshire dhe kërkesat e vazhdueshme dhe ndihmën e EUROPOL- it dhe CEPOL- it. Para hyrjes në fuqi të ligjit antimafia¹⁰, elementë të hetimit financiar, si sekuestrimi dhe konfiskimi, janë parashikuar në dispozitat e Kodit penal, dhe Kodit të procedurës penale, konkretisht në dispozitën e nenit 36 të KP, nenit 274 të KPP.

Legjislacioni nuk ishte i qartë për sa i përket fazave të identifikimit, zbulimit, ngrirjes, bllokimit, sekuestrimit, konfiskimit dhe menaxhimit të pasurive dhe produkteve të krimit.

Ligji antimafia, solli qartësim të konceptit të hetimit financiar, duke parashikuar elementët sipas fazave të mësipërme duke përcaktuar operacionet, institucionet që merren me hetimet

⁹ COUNCIL RECOMMENDATION, of 25 April 2002, on improving investigation methods in the fight against organised crime linked to organised drug trafficking: simultaneous investigations into drug trafficking by criminal organisations and their finances/assets. (2002/C 114/01)

¹⁰ Ligj nr. 9284, datë 30.9.2004, "Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar"

financiare, fazat e hetimit, gjykimit dhe menaxhimit të pasurisë së konfiskuar dhe shpërndarjes së saj, si dhe nevojën e bashkëpunimit me institucionet që disponojnë të dhëna. Nga përmbajtja e dispozitave të ligjit, në formë të përmbledhur hetimi financiar, konfiskimi dhe administrimi/ menaxhimi, operacionalizimi i proceseve, lidhja mes tyre, dhe organet përgjegjëse si dhe institucionet me të cilat kërkohet bashkëpunim paraqiten në pasqyrën e mëposhtme:

HETIMI FINANCIAR – KONFISKIMI - MENAXHIMI

Operacionet	Identifikimi	Zbulimi	Ngjirje/sekuestrim	Konfiskim	Menaxhim
	I kujt?	Me se?	Si?	Për se?	Ku?
	Mjete jetese Pasuri Veprimtari ekonomike/ tregtare/ profesionale Burim i të ardhuravë	Mjetet e kërkimit të provës: Kqyerjet Kontrollet Sekuestrimet Përgjimet (Mjetet dhe teknikat speciale të hetimit)	Sekuestro preventive Sekuestro paraprake Sekuestro konservative	Heqjen e përhershme të së drejtës së pronësisë	Administrimit menaxhimit të aseteve kriminale dhe shpërndarjes për: viktimat, trajnime, qëllime sociale
Institucionet	POLICIA - PROKURORIA			GJYKATA	AGJENSIA
Fazat	HETIMI			GJYKIMI	MENAXHIMI
Bashkëpunimi	Me insititucionet që disponojnë të dhëna si: Tatime, Dogana, DPPP, ILKDP, SHISH, IB, IF, I-joF, DSHTR, DRRPP, AP, AAC,				

Tabela 1: Hetimi financiar, konfiskimi dhe menaxhimi

Sipas pasqyrës së mësipërme, shihet se procesi i hetimit financiar, konfiskimit dhe menaxhimit të asetëve është i lidhur, dhe secili operacion i shërben operacionit pasardhës,

hetimi i shërben konfiskimit dhe konfiskimi i shërben shpërndarjes (menaxhimit dhe shpërndarjes ose përdorimit të të ardhurave të konfiskuara. Nga kjo paraqitje del qartë se konfiskimi është qëllim i hetimit financiar, ndërsa qëllimi final dhe tregues i efektshmërisë së hetimit financiar është konfiskimi, nëpërmjet së cilës realizohet marrja përfundimtare e pasurive të paligjshme grupeve kriminale, duke garantuar parimin se “askush nuk mund të gëzojë pasuri të fituara në rrugë të paligjshme”, heqja mundësive financiare të organizatave kriminale për financimin e krimeve të tjera, parandalimi i kryerjes së krimeve të tjera dhe financimin e terrorizimit, shpërblimi i palëve të dëmtuara, rritja e mundësive financiare për forcimin e institucioneve të zbatimit të ligjit, trajnimet e punonjesve të zbatimit të ligjit, edukimi i shoqërisë në rritjen e kulturës së zbatimit të ligjit dhe bashkëpunimit.

Procesi i hetimit financiar, konfiskimit dhe menaxhimit/ administrimit të aseteve kriminale i jep përgjigje pyetjeve: Identifikimi i kujt kërkohet? Me cilat mjete ligjore bëhet zbulimi? Cilat janë masat paraprake ligjore për ngrirjen/ bllokimin/ sekuestrimin? Cili është qëllimi i hetimit financiar? Ku shkojnë të ardhurat e konfiskuara?

Në përgjigje të këtyre pyetjeve, sipas fazave të procesit të hetimit financiar, konfiskimit dhe menaxhimit, kuptohet përmbajtja e secilit term si më poshtë:

Identifikim, procesi i gjurmimit për mjete jetese, pasuri, veprimtari ekonomike/ tregtare/ profesionale, burim i të ardhurave. Ky proces bën të mundur përllogaritjen e pasurive dhe të ardhurave financiare si dhe burimet e tyre, nga krahasimi i të cilave sipas raportit të ardhura të disponueshme/ burime të ligjshme, rezulton nëse jemi apo jo në një rast të dyshuar. Ky proces bëhet veç e veç për secilin anëtar të grupit, apo të dyshuar, dhe për secilin person përcaktuar në nenin 3 pika 2 dhe 3 të ligjit Nr. 10192, datë 3.12.2009.

Zbulim, bëhet nëpërmjet përdorimit të mjeteve ligjore të kërkimit të provës si: kqyerjet, kontrollet, sekuestrimet, përgjimet (mjetet dhe teknikat speciale të hetimit), duke siguruar parimin e ligjshmërisë në marrjen e provave.

Ngrirje/ sekuestrim, janë masat paraprake të vendosura nga gjykata apo autoritete të tjera të përcaktuara me ligj, si prokuroria, policia gjyqësore, me qëllim heqjen e mundësisë së fshehjes apo transferimit të pasurisë, deri në marrjen ose jo të vendimit për konfiskim.

Konfiskim, është heqja e përhershme e së drejtës mbi pasurinë, me një vendim gjykate, duke garantuar një proces ligjor të rregullt, nga një gjykatë e pavarur dhe garantuar të drejtat e ankimit.

Menaxhim, administrimi/ shpërndarja janë pjesë të vendimit të gjykatës dhe administrohet nga agjensi të krijuara dhe të specializuara. Administratori ka për detyrë të ruaj, administrojë, rrisë, nëse është e mundur, vlerën e këtyre pasurive, nisur nga parimet e miradministrimit të pasurisë (GZ, 2009).

Sipas kompetencave ligjore, fazave të procesit të hetimit financiar, përcaktohen dhe institucionet që merren me hetimet financiare, konfiskimin dhe menaxhimin/ administrimin e pasurisë së sekuestruar/ konfiskuar si:

Në fazën e hetimit, përfshihen institucionet përgjegjëse siç janë policia dhe prokuroria, si dhe institucione të tjera të cilat disponojnë të dhëna, databaza, të nevojshme dhe të domosdoshme për të bërë të mundur identifikimin e financave dhe pasurive.

Në fazën e gjykimit, gjykata e caktuar sipas kompetencës, e cila shqyrton dhe vendos për kërkesat e sekuestrimit dhe konfiskimit të pasurisë.

Në fazën e menaxhimit/ administrimit, përfshihen agjensi të caktuara, të specializuara, siç është Agjencia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara, në Shqipëri.

Për suksesin në arritjen e qëllimit gjatë hetimeve financiare kërkohet bashkëpunim efektiv i institucioneve që disponojnë të dhëna, bashkëpunimi ndërinstitutional, si dhe të dhëna nga shtete të tjera, nëpërmjet bashkëpunimit ndërkombëtar.

Për të kuptuar domosdoshmërinë e bashkëpunimit të institucioneve në procesin kompleks të hetimeve financiare mendoj se duhet të trajtohen disa çështje kryesore të cilat dalin nga studimi dhe analiza e detyrimeve ligjore në fuqi, si: ndaj kujt bëhen hetimet financiare, për çfarë bëhen hetimet financiare, lidhur me se bëhen hetimet financiare, mjetet financiare, pasuritë, veprimtaritë ekonomike, mënyra e jetesës, burimet e të ardhurave, analiza e rezultatit. Trajtimi i këtyre çështjeve hedh dritë në disa drejtime si: kuptimin e termit hetim financiar, kompleksitetin dhe vështirësinë e hetimeve financiare, domosdoshmërinë e bashkëpunimit ndërinstitutional.

3.1.1.1 Ndaj kujt bëhen hetimet financiare

Një nga çështjet më të diskutuara është se ndaj kujt bëhen hetimet financiare. Mundësitë që kanë autorët e veprave penale për të kaluar pasurinë në emër të personave të tjerë, kanë detyruar ligjbërësit të parashikojnë në dispozitat ligjore dhe rrethin e personave¹¹ ndaj të

¹¹ Në nenin 3, Fusha e zbatimit, të ligjit 10192, datë 3.12.2009, thuhet: Dispozitat e këtij ligji zbatohen për pasuritë e personave, mbi të cilët ekziston një dyshim i arsyeshëm, bazuar në indicie, për:

a) pjesëmarrje në organizata kriminale ose në grupe të strukturuar kriminale, sipas parashikimeve të neneve 333 dhe 333/a të Kodit Penal dhe për kryerje të krimeve prej tyre;

b) pjesëmarrje në organizata terroriste ose në banda të armatosura, sipas parashikimeve të neneve 234/a dhe 234/b të Kodit Penal dhe për kryerje të krimeve prej tyre;

c) kryerjen e veprave të tjera, për qëllime terroriste, të parashikuara në pjesën e posaçme kreu VII i Kodit Penal;

ç) kryerjen e krimeve të parashikuara në nenet 109, 109/b, 110/a, 114/b, 128/b, 278/a, 282/a, 283, 283/a, 284/a të Kodit Penal.

d) kryerjen e krimeve për qëllime të fitimit të pasurive të paligjshme, të parashikuara në nenet 114/a dhe 287 të Kodit Penal.

2. Dispozitat e këtij ligji zbatohen edhe ndaj pasurive të:

a) personave të afërm (bashkëshorti, fëmijët, të paralindurit, vëllezërit, motrat, ungjërit, emta, nipërit, mbesat, fëmijët e vëllezërve dhe të motrave, vjehrra, vjehri, dhëndri, nusja, kunata, kunati, bashkëjetuesi, thjeshtri, thjeshtra, njerku dhe njerka) të subjekteve të pikës 1 të këtij neni;

cilëve bëhen hetime financiare. Nga përmbajtja e nenit 3 të ligjit nr.10192, datë 3.12.2009, “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar dhe trafikimit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”, përcaktohet, së pari kushti “ekzistenca e dyshimit të arsyeshëm, bazuar në indicje”¹², si edhe ndaj kujt bëhen hetimet financiare.

Në formë të përmbledhur se ndaj kujt bëhen hetime financiare pasqyrohen në tabelën 2, si më poshtë:

X1	X2	X3		Xi	Autorë
X1B	X2B	X3B		XiB	Bashkëshortë
X1F	X2F	X3F		XiF	Fëmijët
X1A	X2A	X3A		XiA	Të afërmit
X1Pfj	X2Pfj	X3Pfj		XiPfj	Persona fizik dhe juridik

Tabela 2 Ndaj kujt bëhen hetimet financiare¹³

Siç duket dhe nga tabela e mësipërme, kategoritë e personave ndaj të cilëve mund të bëhen hetime financiare është shumë e gjerë, pasi për secilin autorë duhet të bëhen hetime për bashkëshortët, fëmijët, të afërmit dhe personat fizik e juridik të secilës kategori. Pretendimi se shprehja “dyshim i arsyeshëm bazuar në indicje”, parashikuar nga neni 3 paragrafi 1 i ligjit nuk është në përputhje me standartin “dyshim i arsyeshëm”, parashikuar nga neni 27 paragrafi 2 shkronja “c” të Kushtetutës, të nenit 5 paragrafi 1 të KEDNJ-së dhe në nenin 228 paragrafi 1 të Kodit të Procedurës Penale, Gjykata Kushtetuese¹⁴ në vendimin nr.4, datë 23.02.2011, rrëzon kërkesën e Komitetit Shqiptar të Helsinkit për shfuqizimin sit ë

b) personave fizikë ose juridikë, për të cilët ka të dhëna të mjaftueshme se pasuritë ose veprimtaritë e tyre zotërohen, pjesërisht ose plotësisht, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, a janë përdorur, kanë lehtësuar apo në një formë kanë ndikuar në kryerjen e veprimtarive të jashtëligjshme nga personat e parashikuar në pikën 1 të këtij neni.

3. Masat parandaluese mund të kërkohen dhe ndaj trashëgimtarëve të personit, subjekt i zbatimit të këtij ligji, por, në çdo rast, jo më vonë se 5 vjet nga data e vdekjes.

4. Ky ligj zbatohet edhe për pasuritë e personave, të krijuara përpara hyrjes në fuqi të këtij ligji, me kusht që pasuritë të jenë vënë gjatë përfshirjes së dyshuar të tij në veprimtarinë kriminale, sipas këtij ligji.

¹² Neni 3, pika 1 e ligjit Nr.10192, datë 3.12.2009 “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar dhe trafikimit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”.

¹³ Tabela është bërë nga autori, duke patur parasysh kërkesat e nenit 3 të ligjit të sipërcituar.

¹⁴ Gjykata Kushtetuese, Vendimi nr.4, date 23.02.2011

papajftueshmë me Kushtetutën dhe Konventën Europiane të Drejtave të Njeriut (KEDNJ) të ligjit nr.10192, datë 03.12.2009, “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar dhe trafikimit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”, ku në pjesën arsyetuese të vendimit¹⁵ shprehet se kërkesa e prokurorit për sekuestrimin e pasurisë përmban indicjet, në të cilat bazohet dyshimi i arsyeshëm, si dhe arsyetimin për të paktën një prej kushteve të pikës 1 të nenit 11 të ligjit. Vendimi i Gjykatës Kushtetuese ka qartësuar kushtin “ arsyetim i arsyeshëm bazuar në indicje”, megjithatë rrethi i personave është shumë i gjerë. Mendoj se rishikimi i rrethit të personave duhet të rishikohet nga ligjbërësi.

3.1.1.2 Për çfarë bëhen hetimet financiare

Lidhur se për çfarë bëhen hetimet financiare përcaktohet në përmbajtjen e nenit 4 të ligjit ku parashikohen masat parandaluese¹⁶ për mjetet financiare, pasuritë, veprimtaritë ekonomike, tregtare dhe profesionale të personave të përcaktuar në nenin 3 të ligjit nr. 10192, të ndryshuar me ligjin nr. 24/2014¹⁷. Tabela 3, pasqyron në formë të përmbledhur kategoritë për të cilat bëhen hetime financiare. Shqyrtimi i këtyre kategorive lidhur me çfarë kuptojmë, ku mund të gjenden, si mund të merret informacioni trajtohen në çështjet në vijim.

Mjete financiare
Pasuritë
Veprimtaritë ekonomike
Mënyra e jetesës
Burimet e të ardhurave

Tabela 3 Për çfarë bëhen hetimet financiare¹⁸

¹⁵ Gjykata Kushtetuese, Vendimi Nr. 4, datë 23.02.2011, fq.12

¹⁶ Neni 4, në kuptim të këtij ligji, “Masë parandaluese” është çdo masë me karakter pasuror, që gjykata vendos në një procedim gjyqësor, nëpërmjet sekuestrimit të pasurive, veprimtarisë ekonomike, tregtare dhe profesionale të personave, si dhe nëpërmjet konfiskimit të tyre.

¹⁷ Ligj nr. 24/2014, “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.10192, datë 3.12.2009, “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar dhe trafikimit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”

¹⁸ Neni 4, pika 1 e ligjit nr.9284, datë 30.09.2004, “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar”

Studimi i termave të mësipërme, dhe trajtimi i tyre në nënçështjet në vijim qartëson kuptimin e termit, adreson ligjzbatuesit se ku gjendet informacioni, si merret, si dhe referenca ligjore ku bazohemi në marrjen e këtij informacioni.

3.1.1.3 Lidhur me se bëhen hetimet financiare

Hetimet financiare bëhen në veçanti për secilin person¹⁹ të përcaktuar në tabelën 2, nëse *ata zotërojnë* leje, liçensa, autorizime, konçensione, veprimtari ekonomike, veprimtari tregëtare, veprimtari profesionale, nëse *ata përfitojnë* kontribute, financime dhe kredi të çdo lloji *nga* shteti, entet, personat juridik publik, organizatat dhe institucionet ndërkombëtare. (Tabela 4)

Hetimet financiare kryhen në veçanti për çdo X-i		
Nëse Xi-të zotërojnë:	Nëse Xi-të përfitojnë:	Nga:
Leje	Kontribute	a) Shteti
Liçensa	Financime	b) Entet
Autorizime	Kredi të çdo lloji	c) Persona juridik publik
Konçensione		d) Organizata
Veprimtari ekonomike		e) Institucione ndërkombëtare
Veprimtari tregëtare		
Veprimtari profesionale		

Tabela 4: Lidhur me se bëhen hetimet financiare²⁰

Në përmbajtjen e nenit 6, objekt i verifikimeve, të ligjit 10192, datë 3.12.2009, “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar dhe trafikimit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë” kërkohet dhe verifikimi nëse pasuritë, veprimtaritë apo të drejtat pasurore janë të përligjura²¹. Në aspektin praktik verifikimi i të gjithë këtyre kategorive të përcaktuara në tabelën 4, është një punë voluminoze dhe kërkon burime

¹⁹ Në pikën 2 të nenit 4, të ligjit nr.9284, datë 30.09.2004, “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar”, përcaktohet se hetimet bëhen, në veçanti, për të verifikuar nëse këta persona janë zotërues të lejeve, liçencave, autorizimeve, konçensioneve dhe të drejtave të tjera për të ushtruar veprimtari ekonomike tregtare dhe profesionale, si dhe për të verifikuar nëse ata përfitojnë kontribute, financime ose kreditime të çdo lloji, të dhëna apo të përfituara nga shteti, ente a persona juridikë publikë, organizma ose institucione ndërkombëtare.

²⁰ Neni 4, pika 2 e ligjit nr.9284, datë 30.09.2004, “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar”

²¹ Neni 6 i ligjit nr.10192, datë 3.12.2009, “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar dhe trafikimit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”

njerëzore dhe kohë për marrjen e gjithë këtij informacioni. Gjithashtu ky informacion gjendet në disa institucione të shpërndara dhe jo në një bankë të dhënash ku oficeri i policisë gjyqësore apo prokurori të mund të marrë këtë informacion me lehtësi.

3.1.1.4 Mjetet financiare

Autorët e veprave kriminale zakonisht i fshehin, ose i maskojnë produktet direkte nga krimi, sepse ato përbëjnë prova. Përveç kësaj, ata i fshehin gjithashtu edhe pronat që kanë në zotërim. Përkatësisht, kur produktet direkte nga krimi nuk mund të konfiskohen (të gjenden), bëhet i mundur konfiskimi i pronës (së ligjshme) që i korrespondon vlerës së produkteve të paligjshme. Kështu, një pjesë e rëndësishme e hetimit financiar është përcaktimi i pronave në zotërim të autorit të veprës penale, apo të personave prej të cilëve kjo pronë mund të konfiskohet²². Një nga këto pasuri janë paratë (cash), të cilat mund të përdoren nga autorët e veprave penale ose nga personat prej të cilëve mund të konfiskohen. Të dhënat për paratë, mjetet financiare (cash) mund të sigurohen nëpërmjet informacioneve, intervistave gjatë pyetjes në procesin penal, kontrolleve në banesa apo vende të tjera etj. Një kategori tjetër e mjeteve financiare janë llogaritë bankare²³, letrat me vlerë, aksionet, çeqet e ndryshme. (Tabela 5). Për të siguruar të dhënat mbi llogaritë bankare, nevojitet zakonisht një urdhër gjykatë si edhe në me rëndësi është dhe aksesit tek informacioni mbi llogaritë bankare që

²² Manual mbi hetimet financiare dhe konfiskimin e produkteve të krimit, Strasburg 2007, fq.43

²³ *Neni 210 i Kodit të Procedurës Penale*: “Gjykata mund të vendosë sekuestrimin pranë bankave të dokumenteve, letrave me vlerë, shumave të depozituara në llogari rrjedhëse dhe cdo gjëje tjetër, edhe nëse gjenden në kasetat e sigurisë, kur ka arsye të bazuara për të menduar se ato kanë lidhje me veprën penale, edhe kur nuk i përkasin të pandehurit, ose kur nuk janë në emër të tij. Në raste të ngutshme, ky veprim mund të merret edhe nga prokurori. *Neni 191 i Kodit të Procedurës Penale* mbi marrjen e dokumenteve me anë të fotokopjes: “lejohe marrja e dokumenteve, që përfaqësojnë fakte, persona ose sende nëpërmjet fotografimit, filmimit, fonografimit ose cdo mjeti tjetër. Kur origjinali i një dokumenti është prishur, ka humbur, ose është zhdukur, mund të merret kopja e tij.

posedon i dyshuari. Një vëmendje e veçantë në analizimin e llogarive bankare i duhet kushtuar identifikimit të llojeve të tjera të pasurive, ose elementëve të veprës penale të pastrimit të parave.

Mjetet	Ku gjenden	Mjeti i kërkimit	Referenca ligjore
CASH	Arka biznesi Banesa Në përdorim	Kontroll biznesi Kontroll banese Kontroll personi	Kodi i procedurës penale Kodi Penal
Llogari bankare	Banka brenda vendit Banka jashtë vendit Çek bankar Çek udhëtimi Çertifikata depozite Kartë krediti	Nëpërmjet FIU Prokurorit Kontrolleve	Ligj Nr.10192, datë 3.12.2009, ndryshuar me ligjin 24/2014
Letra me vlerë	Aksione Bono thesari		
Çertifikata ari	Banka		

Tabela 5: Mjetet financiare²⁴

Të dhënat mbi poseduesin e llogarisë bankare mund të gjenden në dosjet qendrore të bankës qendrore, ndërsa në rast të kundërt, është e nevojshme të verifikohen të dhënat në të gjitha bankat dhe institucionet financiare.²⁵ Të dhënat mbi llogaritë mund të sigurohen, gjithashtu, nga tatimet mbi të ardhurat, deklaratat mbi gjendjen e llogarive bankare, të cilat mund të gjenden gjatë kontrolleve të ndryshme. Por, megjithëse paratë përbejnë llojin e pronës që mund të sigurohet apo të ruhet më lehtësisht, përkohësisht, është e nevojshme të përcaktohen edhe prona të tjera në zotërim të dyshuarit.

²⁴ Neni 6 pika 1 e ligjit nr.10192, datë 3.12.2009, “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar dhe trafikimit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”

²⁵ Normalisht përpjekjet gjatë hetimeve duhet të përqendrohen për të zbuluar llogaritë bankare të të dyshuarit. Nëse kjo nuk rezulton e suksesshme, nuk ka një standard të tillë ndërkombëtar, që informacioni mbi llogaritë bankare të të pandehurit duhet të jepet (shin nenet 7 dhe 17 të Konventës së vitit 2005 si dhe Kapitujt 2.3 dhe 2.5.1). Në disa vende, praktika gjyqësore nuk e lejon për momentin një qarkullim të tillë të kërkesave për informacion.

3.1.1.5 Pasuritë

Pasuritë²⁶ që duhen verifikuar për kryerjen e hetimeve financiare mund të ndahen në tre kategori, të paluajtshme, të luajtshme, dhe jashtë vendit. Në formë të përmbledhur llojet e pasurive dhe ku mund të gjenden pasqyrohen në tabelen 6.

Pasuritë	Ku gjenden	Mjeti i kërkimit	Referenca ligjore
Objekte ndërtimi	Zyrat e regjistrimit të pasurive të paluajtshme ILDKPKI	Kërkesa administrative	Kodi i procedurës penale Kodi Penal Ligj Nr.10192, datë 3.12.2009, ndryshuar me ligjin 24/2014
Truall	Zyrat e regjistrimit të pasurive të paluajtshme ILDKPKI	Kërkesa administrative	
Automjete	Drejtoria e shfrytëzimit të transportit rrugor ILDKPKI	Kërkesa administrative	
Mjete lundrimi	Ministria e Transportit Ministria e Mjedisit ILDKPKI	Kërkesa administrative	
Sende me vlerë	Banesë Ambiente të tjera ILDKPKI	Kontrolle Kërkesa administrative	
E drejtë autori	Regjistri tregëtar Akademia e shkencave etj.	Kërkesa administrative	

Tabela 6: Pasuritë²⁷

Për pronat e luajtshme, të dhënat mbi makinat zakonisht janë nën kompetencën e Ministrisë së Transporteve. Gjithashtu duhet të tregohet kujdes për makinat që përdor i dyshuari pavarësisht se ato formalisht nuk janë pronë e tij. Rrethanat e një përdorimi të tillë duhet të hetohen (marrje me qera, pronësi fiktive në emër të një shoku, partneri, etj.). Përsa i përket

²⁶ Neni 2, gërma (d), e Konventës së Kombeve të Bashkuara kundër krimit të organizuar ndërkombëtar, ratifikuar me Nr. 8920, date 11.7.2002, për ratifikimin e "Konventës së Kombeve të Bashkuara kundër krimit të organizuar ndërkombëtar" dhe dy protokolleve shtesë të saj, temi "Pasuri" nënkupton pasuritë e çdo lloji, fizike ose jofizike, të luajtshme ose të paluajtshme, reale ose joreale, dhe dokumentet ose instrumentet ligjore, të cilat vërtetojnë një titull ose interes tek këto pasuri.

²⁷ Neni 6 pika 1 e ligjit nr.10192, date 3.12.2009, "Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar dhe trafikimit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë"

mjeteve të lundrimit dhe të fluturimit, mbahen zakonisht të dhëna të centralizuara mbi pronësinë. Lidhur me pronat e paluajtshme, burimi i informacionit është regjistri i tokës. Në qoftë se regjistri i tokës nuk është i centralizuar në një sistem kompjuterik të dhënash, marrja e këtyre të dhënave mund të jetë më e vështirë. Të dhënat mbi pronësinë zakonisht mund të përftohen edhe nëpërmjet shërbimit të taksave (taksa mbi shitjen e pronës së paluajtshme, taksa e pronës së paluajtshme).

Një vështirësi tjetër në identifikimin e pasurive është fakti se autorët e veprave penale mund t'i fshehin (t'i kenë) pronat e tyre jashtë vendit. Veçanërisht gjatë hetimit të veprave penale të kryera nga grupe kriminale ndërkombëtare, është e nevojshme të verifikohet nëse autorët e krimeve kanë ndonjë pronë jashtë vendit. Në raste të tilla bashkëpunimi ndërkombëtar i policisë ose prokurorisë është shumë i rëndësishëm. Një person kontakti në një polici të huaj mund japë këshilla rreth të dhënave që mund të merren nga burimet publike, nëpërmjet bashkëpunimit ndërmjet policive ose nëpërmjet një letër- porosie. Një informacion i tillë mund ta bëjë mbledhjen e të dhënave shumë herë më të lehtë dhe më të shpejtë. Rrjeti i Agjencive Camden për Rimarrjen e Pasurive (CARIN), me EUROPOL-in si sekretariat të tij, është një shembull i këtij bashkëpunimi.

Hetimi financiar gjithashtu mund të zbulojë një raport të zhdrejtë midis pronës së ligjshme (të deklaruar) të të dyshuarit dhe pronës së tij aktuale. Kjo është e rëndësishme në sistemet ligjore ku është i mundur konfiskimi i zgjeruar i të ardhurave dhe ku i pandehuri duhet të provojë origjinën e ligjshme të pronës, përndryshe prona e tij mund të konfiskohet.

Me qëllim zhvillimin e hetimit financiar nevojitet të vihen në praktikë, njohuri ndërdisiplinore dhe njohuri mbi një spektër të gjerë legjislacioni (civil, bankar, për taksat, sigurimet dhe kompanitë). Hetimi financiar lehtësohet dhe shpejtohet nëqoftëse të dhënat e

nevojshme ekzistojnë, nëqoftëse ato janë të përditësuara dhe nëqoftëse sigurohet një akses i shpejtë tek këto të dhëna dhe kjo nënkupton përsëri një bashkëpunim të mirë midis institucioneve të ndryshme. Njohja me rregullat që i referohen aksesit tek të dhënat dhe me personat e kontaktit nëpër institucione është e një rëndësie të veçantë për hetuesit financiar.

3.1.1.6 Veprimtaritë ekonomike

Marrja e informacionit nga hetuesit financiarë për veprimtaritë ekonomike duhet të fokusohen në dy drejtime kryesore: veprimtaritë ekonomike të personave fizik dhe veprimtaritë ekonomike të personave juridikë siç pasqyrohen në tabelën 7.

Veprimtaritë	Ku gjenden	Mjeti i kërkimit	Referenca ligjore
Person fizik A) Tregëtar B) Jo tregëtar	Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve	Kërkesa administrative	Kodi i procedurës penale Kodi Penal Ligj Nr.10192, datë 3.12.2009, ndryshuar me ligjin 24/2014
Person juridik	Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve	Kërkesa administrative	

Tabela 7: Veprimtaritë ekonomike²⁸

Të dhënat për identifikimin e tyre gjenden në databazat e Qendrës Kombëtare të Regjistrimit²⁹, të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve³⁰, si dhe në regjistrat e Gjykatave për regjistrimet si person juridik. Analiza e veprimtarive ekonomike ka rëndësi të veçantë për identifikimin e burimit të pasurisë së ligjshme dhe raportin me pasurinë që disponon i dyshuari. Kjo analizë kërkon specialist të fushës dhe sjell domosdoshmërine që hetuesit

²⁸ Neni 6 pika 1 e ligjit nr.10192, date 3.12.2009, “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar dhe trafikimit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”

²⁹ <http://www.qkr.gov.al/nrc/default.aspx>

³⁰ <https://www.tatime.gov.al/sq-al/us/Drejtoria%20e%20P%C3%ABrgjithshme%20e%20Tatimeve/Pages/default.aspx>

financiar duhet të kenë tranimet e nevojshme ose struktuart e hetimit financiar të përfshijne edhe specialist të fushës.

3.1.1.7 Mënyra e jetesës

Një drejtim tjetër ku duhet të përqendrohen hetuesit financiarë është dhe mënyra e jetesës se autorëve të veprave penale ose personave ndaj të cilëve mund të zbatohen masat parandaluese kundër pasurisë është dhe mënyra e jetesës. Identifikimi i shpenzimeve nga mënyra e jetesës ndihmon hetuesit financiarë për identifikimin e shpenzimeve dhe përcaktimin e raportit të ardhura të ligjshme me shpenzimet totale që ai kryen. Gjithashtu hetimi i mënyrës së jetesës shërben dhe identifikimin e lidhjeve të tij me persona të tjerë.

Mënyra e jetesës	Ku gjenden	Mjeti i kërkimit	Referenca ligjore
Pagesat konsumatore me anë të kontratave	CASH Telekom Ujsjellës Taksa etj	Kërkesa administrative Informacione	Kodi i procedurës penale Kodi Penal Ligj Nr.10192, datë 3.12.2009, ndryshuar me ligjin 24/2014
Pagesa të tjera	Informacione	Kërkesa administrative Informacione	

Tabela 8: Mënyra e jetesës³¹

Për llogaritjen e mënyrës së jetesës, përveç përdorimit të mjeteve speciale të hetimit, merret dhe nëpërmjet informacioneve gjatë intervistave të pyetjes së personave, si edhe nëpërmjet verifikimit të pagesave konsumatore me anë të kontratave të nënshkruara ashtu edhe nëpërmjet pagesave të tjera që mund të merren nëpërmjet informacioneve nga organe të tjera të zbatimit të ligjit, siç pasqyrohen në tabelën 8. Edhe për identifikimin e mënyrës së jetesës kërkohet bashkëpunimi ndërinstitucional.

³¹ Neni 6 pika 1 e ligjit nr.10192, date 3.12.2009, “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar dhe trafikimit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”

3.1.1.8 Burimet e të ardhurave

Për hetimin financiar të plotë e të gjithanshëm të produkteve të krimit është e nevojshme dhe e domosdoshme edhe identifikimi i burimeve të të ardhurave³². Në aspektin praktik hetimet për burimet e të ardhurave bëhen lidhur me veprimtaritë prodhuese, tregëtare, profesionale, kontributeve, financimeve, donacioneve, kredive, pagave, interesave që personi ndaj të cilit ekziston një dyshim i arsyeshëm bazuar në indicje, parashikuar si subjekt në nenin 3, të ligjit 10192, ndryshuar me ligjin 24/2014. Tabela 9, pasqyron llojet e burimeve, ku mund të gjenden dhe si mund të merret ky informacion, bazuar në referencat ligjore.

Burimet	Ku gjenden	Mjeti i kërkimit	Referenca ligjore
Veprimtaritë Prodhuese Tregëtare Profesionale	Drejtoria e Përgjithshme e Tatime Drejtoria e Përgjithshme e Doganave		Kodi i procedurës penale
Kontribute	Institucionet	Kërkesa administrative	Kodi Penal Ligj Nr.10192, datë 3.12.2009, ndryshuar me ligjin 24/2014
Financime	Regjistri tregëtar	Vendime sekuestrimi	
Donacione	Bankat	Informacione	
Kredi	Informacione		
Paga	Listat e pagave		
Interesa	Institucione financiare		
Të tjera			

Tabela 9: Burimet e të ardhurave³³

Hetimi i burimeve ka një rëndësi të veçantë në hetimin financiar, pasi krahasimi i tyre me shpenzimet në veçanti për çdo subjekt të ligjit, do të bënte të mundur marrjen e masave parandaluese kundër pasurisë dhe do të realizohej dhe qëllimi i ligjit, parandalimi dhe goditja

³² Neni 8 pika 3të ligjit nr.10192, date 3.12.2009, “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar dhe trafikimit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”

³³ Neni 6 pika 1 dhe nenit 8 të ligjit nr.10192, date 3.12.2009, “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar dhe trafikimit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”

ndaj krimit të organizuar, trafikimit dhe korrupsionit, të cilët kanë një nivel të pajustificuar ekonomik, si rezultat i veprimtarisë së dyshuar kriminale³⁴.

3.1.1.9 Analizë rezultati

Një analizë e plotë dhe llogaritje e saktë e burimeve dhe shpenzimeve dhe krahasimi i tyre do të mundësonte marrjen e një vendimi të drejtë për të kërkuar në gjykatë masën e konfiskimit, duke hequr çdo dyshim dhe alibi nga ana e personit të dyshuar për justifikimin a pasurisë që disponon. (Tabela 10).

			000/lekë
Burimet e të ardhurave	Vlera	Asetet/Shpenzimet	Vlera
Paga/Shtesa mbi pagë	70	Banesa	50
Të ardhura si person juridik	130	Objekte për ushtrim aktiviteti	100
Të ardhura si person fizik	0	Truall	15
Kredi	50	Tokë	10
Donacione	0	Automjete	8
Interesa	10	Mjete lundrimi	25
Të tjera	28	Letra me vlerë	0
		Aksione	20
		Llogari bankare	70
		CASH	70
TOTALI	288	TOTALI	488

Tabela 10: Analiza e rezultatit

Të ardhurat (288) – Asetet/shpenzimet (488) = -200 (Rast i dyshuar)

Hetimi i plotë dhe i gjithanshëm për mjetet financiare, pasuritë, veprimtaritë ekonomike, mënyrën e jetesës si shpenzime dhe burimet e të ardhurave, si edhe krahasimi ndërmjet tyre do të krijonte bindjen e prokurorit dhe gjyqtarit për marrjen e vendimeve të drejta dhe do të vështirësonte ose do të bënte të pamundur justifikimin palës për të legjitimuar prejardhjen e pasurisë në rrugë të ligjshme.

³⁴ Neni 2 e ligjit nr.10192, date 3.12.2009, “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar dhe trafikimit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”, ndryshuar me ligjin 24/2014.

3.1.2 Konfiskimi si dënim plotësues dhe konfiskimi si masë parandaluese, llojet e konfiskimit

Kushtet për marrjen e masave³⁵ në kuadër të hetimeve financiare si dhe roli i shërbimeve të ngarkuara me këto hetime, në fazat paragjyqësore të procedurave penale, varen nga legjislacioni kombëtar dhe praktika gjyqësore. Në raport me standardet ndërkombëtare dhe legjislacionin ekzistues në vendet që kanë ratifikuar konventat përkatëse ndërkombëtare, mund të ekspozohen elementet e mëposhme:- Konfiskimi është i mundur për instrumentet, për produktet, pronat e nga/ ose të siguruara në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë nga veprat kriminale, dhe për pronat e ligjshme në vlerën që ato i korrespondojnë vlerës³⁶ së produkteve të krimit.

Sipas legjislacionit shqiptar, konfiskimi përdoret edhe si dënim plotësues, edhe si masë parandaluese. Konfiskimi si dënim plotësues përdoret në kuptim të nenit Neni 30 të Kodit penal, “Dënime plotësuese”, i cili parashikon se për personat që kanë kryer krime ose kundërvajtje penale, bashkë me dënimin kryesor, mund të jepen edhe një ose disa nga këto dënime plotësuese³⁷: (...) 2. Konfiskimi i mjeteve të kryerjes së veprës penale dhe produkteve të veprës penale. Kjo masë si dënim plotësues, është një mundësi që ligji penal shqiptar parashikon, për të bërë të mundur konfiskimin e produkteve të veprës penale, për të gjitha llojet e veprave penale, krime dhe kundërvajtje, pra për të gjithë veprat penale që sjellin dobi pasurore, duke respektuar dispozitat e Kodit të Procedurës Penale. Statistikat tregojnë përdorimin pak ose aspak të dënimeve plotësuese, për shkak të disa faktorëve si: kultura e mosndëshkimit të veprave penale, për shkak të korrupsionit të gjyqtarëve dhe

³⁵ Në rastet kur legjislacioni lejon konfiskimin e zgjeruar dhe përmbysjen e barrës së provës

³⁶ Legjislacioni përcakton kushtet dhe standardet e provave për masat në funksion të hetimeve financiare dhe të autoriteteve përkatës kompetente për vendosjen e masave dhe për ekzekutimin e tyre.

³⁷ Ndryshuar pika 2, me ligjin nr.9086, datë 19.6.2003, neni 3

prokurorëve, vështirësia e identifikimit të produkteve të veprës penale, konfiskimi si masë parandaluese³⁸, përdoret në kuptim të neneve 21 deri 25 të kreut IV “Konfiskimi i pasurisë së sekuestruar”, të ligjit nr. 10192, datë 3.12.2009, “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar dhe trafikimit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”. Siç del dhe nga qëllimi dhe përmbajtja e këtij ligji, kjo masë zbatohet vetëm për një numër të kufizuar të veprave penale, dhe personave, të përcaktuara në nenin 3 pika 1, 2 dhe 3 të këtij ligji, i cili adresohet kundër pasurive të personave, mbi të cilët ekziston një dyshim i arësyeshëm, bazuar në indicie (GZ, 2009).

Konfiskimi i produkteve të krimit ka efekte të shumta ku më kryesoret janë: ka efekt parandalues, meqenëse përfitimi ekonomik është motivi i shumicës së veprave penale, parandalon infiltrimin e përfitimeve të paligjshme dhe korrupsionit në ekonominë e ligjshme, largon instrumentet që mund të përdoren për kryerjen e krimeve të tjera në të ardhmen, ndihmon në goditjen e drejtuesve të lartë të organizatave kriminale, ruan shtetin e së drejtës dhe parimin moral që asnjëri nuk duhet të përfitojë nga krimi. Nga pikëpamja teorike, por në mënyrë të veçantë praktike, ka rëndësi njohja dhe zbatimi i konfiskimeve të ndryshme. Në literaturën juridike, bazuar në objektin e konfiskimit dallojmë: a) Konfiskim të mjeteve të kryerjes së veprës penale (*instrumentum sceleris*); b) Konfiskim të produkteve të veprës penale (*producta/fructa/sceleris*); c) Konfiskim të objektit të krimit (*objectum*

³⁸ Ligj nr. 9284, datë 30.9.2004, “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar”, shfuqizuar me Ligjin nr. 10192, datë 3.12.2009, “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar dhe trafikimit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”, dhe ndryshuar me ligjin nr. 24/2014, “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 10 192, datë 3.12.2009, “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar dhe trafikimit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”.

sceleris); d) Konfiskim i vlerës (pasuri të ligjshme deri në vlerën e përlogaritur të pasurisë së paligjshme)

3.3.3 Dallimi dhe lidhja ndërmjet konfiskimit dhe hetimit financiar

Hetimi financiar është procedura që kryhet për identifikimin, zbulimin dhe sekuestrimin e produkteve të krimit, dhe ka të bëjë me mbledhjen e informacionit për mjete jetese, pasuri, veprimtari ekonomike/ tregtare/ profesionale, burim i të ardhurave, dhe marrjen e masave për ngrirjen dhe sekuestrimin, me qëllim konfiskimin, veprime këta që kryhen nga policia dhe prokuroria si organi i vetëm i ndjekjes penale në Shqipëri.

Ndërsa konfiskimi, është masa, nëpërmjet një vendimi gjykate, me anë të të cilit, i merret përgjithmonë e drejta e pronësisë, pronarit apo poseduesit të pasurisë. Nga kuptimi i termave “hetim financiar” dhe “konfiskim”, si dhe nga periudha se kur kyhet dhe organet të cilat i kryejnë, dallimi ndërmjet tyre shprehet në disa drejtime si: a) hetimi financiar është procedurë para konfiskimit; b) organet që merren me hetimet financiare janë organet e ndjekjes penale, prokuroria, e cila ka në vartësinë e saj dhe policinë; c) konfiskimi është vendimi, që merr përfundimisht të drejtën mbi pronësinë; d) Vendimi i konfiskimit merret gjithmonë nga gjykata kompetente, sipas përcaktimit në të drejtën e brendshme.

Në literaturë dhe në ligje të shteteve të ndryshme termi konfiskim, gjendet i përdorur si konfiskim i përkohshëm³⁹ dhe konfiskim si për shembull, në nenin 3, pika 1, paragrafi 1.5 të ligjit nr. 04/l-140, “Për kompetencat e zgjeruara për konfiskimin e pasurisë së përfituar me vepër penale”, dhe në nenin 267 të Kodit Procedurës Penale të Republikës së Kosovës.

³⁹ Neni 3, pika 1, paragrafi 1.5 i Ligji nr. 04/l-140, “Për kompetencat e zgjeruara për konfiskimin e pasurisë së përfituar me vepër penale”, dhe neni 267 i Kodit Procedurës Penale të RKS-së

Konfiskimi i përkohshëm, ka kuptimin e sekuestrimit i cili përdoret në Kodin Penal dhe Kodin e Procedurës Penale shqiptare.

3.2. Nocioni i krimeve që sjellin dobi pasurore të paligjshme

Përhapja e krimit të organizuar në mbarë botën, kohët e fundit ka nxitur veprime të konsiderueshme kombëtare dhe ndërkombëtare. Pjesa më e madhe e kundërmasave është shfaqur vitet e fundit dhe mund të thuhet se pjesa më e madhe e mjeteve që përdoren në përgjigje të sfidave të krijuara nga krimi i organizuar janë ende duke u testuar. Vështirësitë në hartimin e kundërmasave kanë qenë në disa drejtime si: mungesa e informacionit në atë se çfarë është krimi i organizuar në të vërtetë, njohja e efektivitetit të masave të përdorura. Ky diskutim ka kapërcyer kufijtë kombëtarë të një vendi, duke marrë karakter ndërkombëtar, është penguar nga mungesa e një përkufizimi të krimit të organizuar, pasi disa flasin për trafikun e drogës, disa për trafikimin me migrantë, disa për shantash dhe korrupsion. Pavarësisht nga mungesa e një përkufizimi të krimit të organizuar, të gjitha format e tij duke përfshirë edhe krimin ekonomik e financiar, kanë vetëm një qëllim, përfitimin e dobive pasurore të paligjshme në formën e pasurisë materiale ose monetare, në rrugë të paligjshme. Për të dhënë një pamje më të plotë për krimet të cilat sjellin dobi pasurore të paligjshme, në interes studimi është njohja e llojeve më të rëndësishme të krimeve të cilat sjellin përfitime ose produkte në vlera të konsiderueshme, një ndikim të fuqishëm negativ në fushën ekonomike, sociale, politike deri në vënien në rrezik të demokracisë. Analiza e këtyre veprave penale nuk do të ishte e mjaftueshme nëse nuk analizohej efektshmëria e masave ligjore dhe institucionale në fazat e hetimit, gjyqimit dhe menazhimit të aseteve kriminale. Në këtë këndvështrim disa pyetje duhet të marrin përgjigje si: cilat janë krimet që sjellin

dobi pasurore të paligjshme, cila dobi pasurore i nënshtrohet procedurave për hetimet financiare dhe konfiskimin e tyre. Në këtë këndvështrim gjykojmë se një ndarje e koncepteve shkelje administrative dhe shkelje penale është e domosdoshme. Kjo ndarje do të qartësonte dhe bënte më të kuptueshëm objektin e këtij punimi, i cili fokusohet në hetimet financiare dhe konfiskimin e produkteve të krimit gjatë hetimit dhe lidhur me veprën penale, sipas fazave të përcaktuara në tezën doktrinale dhe pyetjet kërkimore. Nevoja e qartësimit diktohet nga disa arsëye, *së pari*, termi hetime financiare bëhen në fushën administrative dhe në fushën penale. *Së dyti*, institucionet që merren me hetimet financiare janë të ndryshme dhe qëllimi i hetimeve është e ndryshëm. Gjithashtu konfiskimi i pasurive materiale dhe monetare, të identifikuara gjatë një hetimi financiar zbatohen nga disa institucione dhe në disa fusha si: tatime, dogana, institucione financiare dhe organet e parandalimit dhe hetimit të krimit.

Bazuar sa më sipër objekt i punimit është trajtimi ligjor dhe efektshmëria në praktikë e masave në fushën e hetimit financiar dhe konfiskimit jo të çdo dobie pasurore të paligjshme, por për pasuritë, materiale ose monetare, të cilat rrjedhin nga vepra penale. Në vijim do të trajtojmë disa lloje krimesh të cilat sjellin dobi pasurore të paligjshme, në kuptimin e përgjithshëm, por duke iu referuar anës formale, se për cilat vepra kryhen hetime financiare, duhet t'i referohemi ligjeve përkatëse në fuqi në secilin shtet. Për shembull, sipas ligjit shqiptar, hetimet financiare bëhen për një kategori veprash, të përcaktuara në nenin 3 të ligjit Antimafia. Sipas instrumenteve juridikë ndërkombëtare dhe kombëtare veprat penale të cilat sjellin produkte krimi dhe për të cilat kanë nevojë të kryhet hetim financiar dhe konfiskimi janë të ndryshme.

3.2.1 Krimi ekonomik

Lidhur me krimin ekonomik nuk mund të gjendet një përkufizim i saktë dhe i plotë, mbi bazën e të cilit të gjykohet për rezultatet konkrete, treguesit e matjes dhe pasojave që sjell ky krim në ekonominë e një vendi, përfshirë edhe atë shqiptare. Sipas raportit mbi gjendjen e krimit të organizuar dhe krimit ekonomik në Europën Juglindore, Strarsburg 2006 i cili analizon legjislacionin penal shqiptar vihet në pah se megjithëse Kodi Penal i Shqipërisë është në një linjë me Rekomandimin e Këshillit të Evropës Nr (81) 12 “Mbi krimin ekonomik” dhe ka parashikuar shumë prej aktiviteteve kriminale përse i përket llojeve të ndryshme të mashtrimeve, (duke përfshirë një dispozitë të veçantë mbi skemat financiare piramidale), falsifikimit dhe kontrabandës, evazionit fiskal, rregulloret mbi valutat, falimentin, shpërdorimin e postit dhe të kompetencave zyrtare dhe të tjera, ai (*kodi penal-shënim i autorit*) përsëri nuk operon më një koncept të qartë për krimin ekonomik, që ka lidhje me krimin e organizuar. Përveç kësaj, janë përdorur përkufizime të ndryshme dhe lloje të ndryshme krimi janë numëruar si “krim ekonomik”.

Praktika e dekadës së fundit sikurse vënë në pah raportet e organizmave ndërkombëtare monitoruese tregojnë për format e reja të krimit ekonomik që ndër të tjera njohin zgjerim dhe konsolidim të tyre falë rritjes së kapaciteteve financiare dhe të tjera, që krimi i organizuar ka fituar gjatë dhjetëvjeçarit të fundit, zgjeruar operacionet në sektorin ligjor, qoftë nëpërmjet depërtimit të strukturave shtetërore, qoftë me anë të diversifikimit të aktiviteteve në sektorin tregtar. Krimi ekonomik, si p.sh. mashtrimime TVSH-në, forma të tjera të evazionit fiskal dhe të detyrimeve tatimore si dhe falsifikimi i produkteve të ligjshme (pirateria) stimulohen nga dobësia e institucioneve tatimore dhe doganore shqiptare që veprojnë në fushën e kontrollit dhe të mbledhjes së të ardhurave publike. (CARPO, 2007)

Krimi ekonomik është një kërcënim madhor për shoqërinë shqiptare, por deri më sot nuk ka përllogaritje të saktë të dëmit të shkaktuar për buxhetin e shtetit.

Sikurse është theksuar edhe më parë, një prej pengesave kryesore për një kërkim të mirëfilltë mbi krimin ekonomik, është mungesa e të dhënave, ose natyra e ndryshme e të dhënave. Të dhënat statistikore të paraqitura janë të varfra dhe të fragmentarizuara. Pikërisht për këtë arsye është e vështirë të interpretohen këto të dhëna me shifra shumë të ndryshme nga Ministria e Brendshme dhe nga zyra e Prokurorisë së Përgjithshme në Tiranë. Prandaj, Shqipëria duhet të kërkojë sa më shpejt të jetë e mundur, të përmirësojë strukturat, metodat dhe mekanizmat e statistikave kriminale kombëtare.

Sikundër është raportuar, autorët e krimit ekonomik të cilët janë kryesisht meshkuj shqiptarë, janë të arsimuar, dhe kanë një të kaluar profesionale si menaxherë firmash. Ata ruajnë lidhje të ngushta me elementë të tjerë kriminale, të shteteve dhe kombësive të ndryshme. Ata blejnë ose marrin me anë të mashtrimit aktivitete të ndryshme ligjore si dhe rekrutojnë dhe punësojnë persona me formim ekonomik ose juridik që shërbejnë për të ruajtur fasadën e biznesit. Për arritjen e qëllimeve të tyre, ata nuk hezitojnë të përdorin dhunën ose frikësimin e konkurrenteve, duke organizuar ndonjëherë edhe vrasjen e tyre. Në shumë raste, këto grupe sigurojnë edhe rekrutimin dhe bashkëpunimin e zyrtarëve të zbatimit të ligjit, apo të administratës shtetërore (CARPO, 2006, pp. 76,77).

Krimi ekonomik shkakton humbje të të ardhurave publike, ka një ndikim negativ të drejtëpërdrejtë mbi ekonominë dhe financat publike, deformat ekonominë kombëtare dhe ndërkombëtare, si edhe cënon besimin tek sistemi ekonomik. Ai dëmton demokracinë, shtetin e së drejtës, të drejtat e njeriut si edhe progresin ekonomik dhe shoqëror.

Pavarësisht llojeve të shfaqjes së krimit ekonomik, rekomandimi i Komitetit të Ministrave të Keshillit të Europës R (81) 12, i vitit 1981, “Mbi krimin ekonomik rendit 16 vepra penale specifike dhe jo specifike të cilat konsiderohen krime ekonomike. Vepra të tilla si: shkeljet e Karteleve; praktikat mashtruese dhe abuzimi i situatës ekonomike nga kompanitë multinacionale; mashtrimi në prokurim ose keqpërdorimi i granteve shtetërore ose organizatave ndërkombëtare; krimi kompjuterik (p.sh. vjedhja e të dhënave, shkelje të sekreteve, manipulimi i të dhënave të kompjuterizuar); firma false; mashtrimet në bilancet e kompanisë dhe shkeljet e standarteve të mbajtjes së llogarive; mashtrimi në lidhje me situatën ekonomike dhe kapitalin e korporatave të kompanive; shkelje nga një kompani e standardeve të sigurisë dhe punonjësve të shëndetësisë; mashtrim në dëm të kreditorëve (p.sh. falimentimi, shkelja e të drejtave të pronësisë intelektuale dhe industriale); mashtrim i konsumit (në falsifikim të veçantë dhe të deklaratave mashtruese mbi mallrat, veprat penale kundër shëndetit publik, keqpërdorim të dobësisë të konsumatorëve); konkurrenca e pandershme (duke përfshirë ryshfetet nga ana e një punonjësi të një kompanie konkurrente) dhe reklamat mashtruese; veprat penale financiare dhe evazioni i kostove sociale nga ndërmarrjet; veprat penale në fushën doganore (p.sh. shmangie të detyrimeve doganore, shkelje e kufizimeve të kuotave); shkeljet në lidhje me paratë dhe rregullimet e këmbimit monetar; kundërvajtjet penale në bursë dhe bankë (p.sh. manipulim i bursës dhe shpërdorim të përvojës së publikut); veprat penale kundër mjedisit⁴⁰.

Ndryshimet legjislative në Kodin penal të Republikës së Shqipërisë, të viteve 2007, 2008 dhe 2012, kanë sjellë një përmirësim në dispozitat penale të krimit ekonomik. Pavarësisht

⁴⁰ Recommendation No. R (81) 12, of the Committee of Ministers to Member States on Economic Crime. (Adopted by the Committee of Ministers on 25 June 1981 at the 335th meeting of the Ministers' Deputies)

ndryshimeve, mospërfshirja në kod e veprave penale sipas standarteve të rekomanduar, sjell risi dhe disa vështirësi si më poshtë:

Së pari, ka përmirësim në disa dispozita, duke përfshirë dhe veprat penale të krimeve kompiuterike. *Së dyti*, problem mbetet zbatueshmëria e tyre, jo për faktin e moskuptimit të tyre, por për dobësitë që ekzistojnë në strukturat e luftës kundër krimit ekonomik mundësitë financiare, njerëzore dhe trajnimeve në këtë fushë të veçantë, *së treti*, nuk parashikohen vepra penale të krimit ekonomik të organizuar dhe të krimeve që lidhen me krimin e organizuar. Specifikimi i këtyre dispozitave do qartësonte zbatuesit e ligjit dhe do ta bënte të krahasueshme legjislacionin me vendet e tjera si dhe do të mundësonte identifikimin e faktorëve që duhet të ndryshojnë, me qëllim parandalimin e krimit. *Së katerti*, nuk ka një dallim mes krimit ekonomik dhe atij financiar.

Nevoja e parandalimit dhe luftimit të krimit ekonomik, përfshirë edhe krimin ekonomik të organizuar është e rekomandueshme të adresohet në procesin e reformës së sistemit të drejtësisë penaleqë tashmë ka nisur nga Kuvendi i Shqipërisë. (Analiza e sistemit të drejtësisë në Shqipëri⁴¹, 2015.

3.2.2 Krimi financiar

Në dokumentat ndërkombëtare dhe në të drejtën e brendshme nuk ka një ndarje, mes krimit ekonomik dhe atij financiar. Mendoj se një ndarje mes tyre do të jepte një përkufizim më të plotë të secilit lloj krimi. Nisur nga disa karakteristika dhe nga fushat në të cilat kryhen këto vepra penale mund të jepnim një panoramë të qartë për to.

⁴¹ <http://reformatdrejtesi.al/analiza-e-sistemit-te-drejtesise-ne-shqiperi-2015>

Për të dhënë një kuptim të saktë të këtyre lloje krimesh mendoj se termat krim ekonomik dhe krim financiar duhet të shihen ngushtë me termat “ekonomi” dhe “financë”. Në këtë kuptim veprat penale të cilat çënojnë marrdhënjet juridike në fushën e prodhimit, shpërndarjes dhe konsumit, do quheshin krime ekonomike, ndërsa veprat penale të cilat çënojnë marrdhëniet juridike në fushën e mbledhjes, ndarjes dhe shpenzimeve do quheshin krime financiare. Në këtë kuptim si krim financiar do të konsiderohen krimet të cilat kanë lidhje me financat, kanë lidhje me mbledhjen e të ardhurave, ndarjen e të ardhurave dhe shpenzimeve (publike dhe private).

Krahas nevojës për të dalluar krimet ekonomike nga ato financiare, një vështirësi tjetër qëndron në faktin se çfarë do të konsiderohet shkelje administrative, dhe çfarë do të konsiderohet shkelje penale. Pikërisht kjo vështirësi e ndarjes dhe qartësisë së këtyre koncepteve, sjell vështirësi në zbatimin e ligjeve. Duke i shtuar kësaj dhe faktin se cili organ është kompetent për zbatimin, të gjithë këta faktorë e ulin efektshmërinë e zbatimit të ligjit. Në kodin penal të Republikës së Shqipërisë nuk ka një ndarje të qartë të krimeve ekonomike dhe financiare.

Në Kodin Penal të Republikës së Shqipërisë parashikohen veprat penale kundër pasurisë dhe në sferën ekonomike, mashtrimet, veprat penale në fushën e doganave, taksave, shoqërive tregtare, falsifikimit të monedhave dhe letrave me vlere, falsifikimi i dokumenteve, zhvillimi i palejuar i lojrave të fatit dhe veprat penale kundër mjedisit parashikuara në pjesën e posaçme të kodit penal shqiptar. Të gjitha këto vepra kanë një qëllim, atë të përfitimeve të paligjshme. Sipas legjislacionit shqiptar, edhe për këto vepra mund të vendoset sekuestrimi dhe konfiskimi i produkteve të krimit, në kuptimin e dispozitave të Kodit Penal dhe Kodit të Procedurës Penale, por nuk bëhet fjalë për hetime financiare në kuptimin që po trajtojmë në

këtë punim. Nuk përdoren konceptet e hetimit të zgjeruar, apo barra e provës mbetet tek prokurori, dhe elementë të tjerë të cilat do të shpjegohen në kapitujt në vijim. Analiza e problematikës në këtë kapitull ka qëllim të tregojë se mundësitë për shtrirjen e hetimeve financiare edhe për këto vepra penale dhe gjetja e mekanizmave për konfiskimin e pasurisë së fituar në mënyrë të paligjshme për këto vepra, mbeten një sfidë e qeverive që marrin dhe kanë për detyrë luftën kundër krimit.

3.2.3 Krimi i organizuar

Kur shqyrtojmë përkufizimet e krimit të organizuar sipas konventave dhe kodeve penale të shteteve të ndryshme, si edhe rastet studimore dalin tre kategori kryesore të sjelljes së paligjshme, ofrimi i e shërbimeve të paligjshme, sigurimi i mallrave të paligjshme dhe infiltrimin në biznes të ligjshëm (Albanese, 2007, pp. 7,8).

Ofrimi i shërbimeve të paligjshme përfshin një përpjekje për të kënaqur kërkesat e publikut për para, seks dhe lojëra fati që shoqëria legjitime nuk i përmbush. Krimet specifike për plotësimin e këtyre nevojave shpesh përfshijnë: fajdet, prostitucionin dhe kumarin. Fajdet janë huadhënia e parave për individë me një normë interesi më të madhe se sa e lejon ligji. Prostitucioni ofron shërbim me pagesa në bazë sistematike. Kumari përfshin lojërat e fatit të cilat nuk janë të miratuara nga shteti. Secili nga këto krime ndodh si një ndërmarrje e vazhdueshme për shkak të dështimit të një pjese të publikut për të patur qasje në të holla, seks apo kumar në një mënyrë të ligjshme të tilla si: kredidhënia bankare, apo llotaritë shtetërore. Kategoria e dytë, sigurimi i mallrave të paligjshme është një kategori e krimit të organizuar që ofron produkte të veçanta që një pjesë e publikut nuk mund ti marrë përmes

kanaleve ligjore. Shitja dhe shpërndarja e lëndëve narkotike ose pasurisë së vjedhur janë shembuj të krimeve të veçanta në këtë kategori. Arsyeja e parë është se për këto produkte ka kërkesë nga publiku por që nuk lejohen nga ligji dhe arsyeja e dytë është nevoja për të blerë me çmime të ulta pa u interesuar për burimin. Si r shembull të tillë mund të përmendim rastet kur individët blejnë armë, pajisje të ndryshme elektronike, telefona celularë, programe ose produkte të tjera për të cilat ka një kërkesë të lartë. Kategoria e tretë e krimit të organizuar është infiltrimi në biznese të ligjshme nëpërmjet korrupsionit, kërcënimeve apo shantazheve të grupeve kriminale (Albanese, 2007).

Potter Stewart, anëtar i Gjykatës së Lartë të Drejtësisë në SHBA ka thënë se nuk e di saktësisht se çfarë është krimi i organizuar, por "Unë e di kur e shoh atë." Nga analizat e gjithë kërkimeve në 35 vitet e fundit, është bërë e mundur për të arritur në një konsensus për përkufizimin e krimit të organizuar. Analiza e kriminologut Frank Hagan ka tentuar të nxjerrë elementet e përbashkët në përshkrimet e ndryshme të krimit të organizuar.

Pavarësisht se ishte shkruar në shumë libra për krimin e organizuar nuk ishte arritur të sigurohej përkufizim i qartë për krimin e organizuar. Hagan gjeti se përkufizimet ishin ofruar me shkrim nga 13 autorë të ndryshëm në libra dhe raporte të qeverisë rreth krimit të organizuar gjatë 15 viteve të fundit (Hagan, 1993).

Autorë të ndryshëm kanë bërë analizën dhe krahasimin e përkufizimeve të ndryshme të krimit të organizuar duke nxjerrë çfarë është e përbashkët tek autorët e ndryshëm, dhe sa shpesh përsëritet ajo çfarë është e përbashkët tek përkufizimet mbi krimet e organizuar, në përpjekje për të qartësuar kuptimin e krimit të organizuar (Michael L. Perlin, 2008).

Lidhur me përkufizimin se çfarë është krimi i organizuar ka një konsensus në lidhje me atë që në fakt përbën krimin e organizuar. Janë dhënë 11 karakteristika të ndryshme si aspekte

të krimit të organizuar të cilat janë përfshirë në përkufizimet e ndryshme, ku autorët përfshihen në nivele të ndryshme të frekuencës. Pasqyra më poshtë përmbledh këto 11 atributet dhe sa autorë i kanë përfshirë ato në përkufizimin e tyre.

Përkufizimet e krimit të organizuar në literaturë⁴²

Karakteristika	Numri i autoreve
Organizatë hierarkike e vazhdueshme	16
<i>Fitim nëpërmjet krimit</i>	13
Përdorimi i forcës ose kërcënimit	12
<i>Korrupsioni</i>	11
Kërkesa publike për shërbime	7
Monopoli mbi tregun	6
Antarësim i kufizuar	4
Jo ideologjik	4
Specializim	3
Kode sekrete	3
Planifikim i gjerë	2

Nga përmbledhja e mësipërme, duket se një përkufizim i krimit të organizuar, bazuar në një konsensus të studiuesve gjatë rrjedhës së 35 viteteve të fundit, parashikon si më poshtë:

Krimi i organizuar është një ndërmarrje e vazhdueshme kriminale *që racionalisht punon për të përfituar nga aktivitetet e paligjshme* që janë shpesh në kërkesa të mëdha publike. Ekzistenca e tij e vazhdueshme është ruajtur nëpërmjet përdorimit të forcës, kërcënimeve, kontrollin monopol, dhe / ose korrupsionin e zyrtarëve publikë (Albanese, 2007, p. 4).

Përfitimi nga aktivitetet e paligjshme është dhe qëllimi kryesor i krimit të organizuar. Meqenëse fitimet janë një mundësi për aktivitet kriminale të krimit të organizuar, marrja e masave për konfiskimin e pasurisë së përfituar është domosdoshmëri për parandalimin dhe goditjen e këtij krimi.

⁴² Burimi është marrë nga Hagan F, (1993) Introduction to criminology, Chicago

3.2.4 Trafikimi i paligjshëm

Trafikimi i qenieve njerëzore shkel të drejtat e njeriut dhe ndikon negativisht në jetët e personave në Evropë dhe më gjerë. Gjithnjë e më tepër gra, burra dhe fëmijë po tregtohen si mallra, përtej kufijve, ose brenda shteteve të tyre, dhe bien në kurthin e shfrytëzimit dhe të abuzimit⁴³.

Konventa e përkufizon trafikimin e qenieve njerëzore mes kombinimit të tre elementëve:

- si veprim: rekrutim, transportim, transferim, strehim ose marrje të personave;
- si përdorim i mjeteve të caktuara: kërcënimin ose përdorimin e forcës, ose forma të tjera detyrimi, rrëmbim, mashtrim, gënjim, abuzim kompetencash ose të një pozicioni vulnerabiliteti, dhënie ose marrje të pagesave ose të përfitimeve për të marrë pëlqimin e një personi që ka kontroll mbi një person tjetër;
- për qëllimin e shfrytëzimit: minimalisht, shfrytëzimin e prostituimit të të tjerëve, ose forma të tjera të shfrytëzimit seksual, punë ose shërbime të detyruara, skllavëri ose praktika të ngjashme me skllavërinë, ose heqjen e organeve⁴⁴.

Qëllimi kryesor i trafikimit të çdo lloji është përfitimi. Prandaj një nga mënyrat efikase për parandalimin e tij është dhe marrja e masave të konfiskimit të pasurisë. Edhe ligji 10192, datë 3.12.2009, “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar dhe trafikimit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”, ka përfshirë në mënyrë specifike trafikimin. Referuar nenit 3 pika 1 gërma “ç” të ligjit 10192, datë 3.12.2009, veprat penale të parashikuara nga neni 110/a, 114/b, 128/b, 278/a, 282/a, 283, 283/a dhe 284 të Kodit

⁴³ Konventa e Këshillit të Evropës për Masa kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore, e cila ka hyrë në fuqi më 1 shkurt 2008.

⁴⁴ http://www.coe.int/t/dghl/monitoring/trafficking/Leaflets/Victims/ALB_victims.pdf (parë më 25 Maj 2015)

Penal, janë vepra penale ndaj të cilave, nëse ekziston dyshimi i arsyeshëm bazuar në indicje, aplikohen masat parandaluese kundër pasurisë⁴⁵.

Trafikimi i paligjshëm në kuptimin e trajtimit në këtë punim ka një kuptim të përgjithshëm ku përfshihen të gjitha llojet e trafikimit, jo vetëm ai i qenieve njerëzore, por edhe trafikimi i armëve, municioneve, automjeteve etj. Të gjitha këto vepra kryhen për qëllime përfitimi. Prandaj fokusimi dhe përdorimi i masave parandaluese do të godiste bazën financiare të organizatave, dhe do të dobësonte kryerjen e veprave të tjera.

3.2.5 Korrupsioni

Korrupsioni si fenomen ka marrë përmasa të mëdha jo vetëm në vendet në zhvillim dhe ato në tranzicion, por edhe në vendet më të zhvilluara të botës. Ryshfeti dhe korrupsioni janë të njohur si e keqja kryesore e shoqërisë. Shkalla e efekteve shkatërruese që korrupsioni sjell në botë është i madh. Banka Botërore vlerëson se 1trilion \$ në vit janë të paguar rryshfete në mbarë botën⁴⁶. Megjithatë, dëmi shkon përtej këtyre shifrave, korrupsioni çon në një çoroditje të vendimmarrjes ekonomike. Ai shtrembëron tregjet konkurruese, çon në mosndarje të burimeve, dhe shkatërron klimën e investimit. Përkufizimi, i korrupsionit është vështirë të përcaktohet, por nevoja për ta luftuar atë, për shkak të pasojave që sjell, ka bërë të mundur marrjen e inisiativave për hartimin e dokumenteve në nivel ndërkombëtar si: Konventa penale kundër korrupsionit e Këshillit të Europës, Protokolli shtesë i konventës penale, Konventa civile mbi korrupsionin dhe Konventa mbi luftën kundër mitmarrjes të zyrtarëve të huaj publikë në transaksionet e biznesit ndërkombëtar të OECD-së, në të cilat

⁴⁵ Me ligjin 24/2014, janë bërë ndryshime, duke përfshirë dhe veprën penale të korrupsionit

⁴⁶ <http://web.worldbank.org/WBSITE/EXTERNAL/NEWS/0,,contentMDK:20190295~menuPK:34457~pagePK:34370~piPK:34424~theSitePK:4607,00.html>

përkufizohet dhe rekomandohen masat juridike për minimizimin e tij. Vështirësia më e madhe e korrupsionit parandalimit dhe luftimit të korrupsionit është mungesa e treguesve matës të korrupsionit. Kjo është dhe arsyeja pse korrupsioni vlerësohet mbi bazën e perceptimeve që shoqëria mendon nivelin e korrupsionit, në institucionet e një shteti. Statistikat nuk janë të besueshme për nivelin e korrupsionit, për faktin se subjekti i veprës penale të korrupsionit pasiv është vetë personi zyrtar. Disa autorë e trajtojnë korrupsionin si çështje etike dhe morale, ndërsa nga ana juridike korrupsioni trajtohet si vepër penale, për të cilën duhet të ekzistojë ligji, të përcaktohen elementët e kësaj (objekti, subjekti, ana objektive dhe ana subjektive), si edhe sanksionet penale. Pavarësisht përkufizimeve dhe definicioneve të korrupsionit në thelbin e tij paraqitet si shpërdorim i detyrës zyrtare me qëllim përfitimin material ose moral, për vehte ose për të tjerë. Ky përfitim, produkt krimi, kërkon nevojën e legalizimit, i cili gjithnjë e më tepër po vështirësohet, për shkak të masave që merren për formalizimin e ekonomisë. Një sferë e mundshme e përfshirjes është ekonomia informale, e cila në vendet në tranzicion është në shifra shumë të larta, mbi 50 % në Shqipëri⁴⁷.


Korrupsioni gjithnjë e më shumë shtrin metaztazat e tij në të gjitha fushat e jetës, politike, ekonomike sociale, duke u bërë kështu pengues kryesor për ekonominë, mirëfunksionimin e sistemit, rrezikimin e demokracisë. Për arsye se pasojat që sjell korrupsioni janë shumë të mëdha dhe shkatërruese për demokracinë, masat e luftës ndaj tij janë gjithnjë e në rritje, por shpesh herë dhe të dështuara. Veprimet korruptive në sisteme të ndryshme shtete të ndryshme kohëra të ndryshme janë të ndryshme, për këtë arsye është e pamundur të përkufizohet korrupsioni, dhe për pasojë nuk mund të kemi një standard për kuptimin dhe

⁴⁷ <https://www.cia.gov/library/publications/the-world-factbook/geos/al.html>

shkaqet e shfaqjes së këtij fenomeni shkatërrues. Në thelbin e tij korrupsioni kuptohet si keqpërdorim i pozitës zyrtare për qëllime përfitimi. Ky kuptim mbi korrupsionin është shumë i përgjithshëm, nuk jep përgjigje për korrupsionin politik, korrupsionin privat, nuk ndan konceptin e përfitimit nëse është në vlera monetare, pasuri, interesa të tjera personale apo kolektive apo grupe të personit që kryen një veprim korruptiv. Fakti që përdoret termi keqpërdorim i pozitës zyrtare, perceptimi për nivelin e korrupsionit përqëndrohet tek zyrtari publik, në perceptimin për korrupsionin perceptuesi jep opinionin për nivelin e korrupsionit nisur nga disa interesa dhe faktorë si gjëndja ekonomike në të cilën ndodhet, nga opinionin i krijuar edhe për shkak të mediave, të cilat jo rrallë orientojnë opinione ose përkrahin grupe politike të caktuara në kohë të ndryshme, opinione këta që deformojnë dhe pozicionin e tyre të pavarur. Sipas një studimi mbi ndikimin e korrupsionit në qeverisje në vendet e Ballkanit Perëndimor⁴⁸ iu është dhënë përgjigje disa pyetjeve si: cila është lidhja ndërmjet ndërmjet perceptimit të korrupsionit dhe rritjes ekonomike, ndikimi i perceptimit të korrupsionit në rritjen ekonomike, si ndikon rënja ekonomike në qeverisje? Përgjigja e këtyre pyetjeve na jep disa konkluzione dhe rekomandime të cilat mendoj janë një kontribut dhe referencë për tu marrë parasysh në zbatimin e reformave antikorrupsion. Për të bërë një analizë me tregues statistikore dhe për të llogaritur efektin që sjell perceptimi i korrupsionit në rritjen ekonomike jam referuar treguesve të perceptimit në vendet e Ballkanit Perëndimor, Kroacisë, Malit të Zi, Bosnjë Hercegovinës, Serbisë, Maqedonisë, Kosovës dhe Shqipërisë, për periudhën 2003-2013, rezultate e të cilit gjenden në figurën e mëposhtme (figura nr.1).

⁴⁸ Petrit BUSHI (2015) Impact of Corruption in Governance of the Western Balkan Countries. IJHSSE 2(5), pp: 78-84.

Figura 1 Perceptimi i korrupsionit 2003-2013 në vendet e Ballkanit Perëndimor⁴⁹.




Burimi: Raportet vjetore të Transparency International 2004-2013

Për të bërë një krahasim ndërmjet nivelit të perceptimit të korrupsionit dhe rritjes ekonomike janë studiuar treguesit e rritjes ekonomike për periudhën në studim, për vendet e Ballkanit Perëndimor. Për Shqipërinë rezultatet e perceptimit të nivelit të korrupsionit dhe rezultatet e rritjes ekonomike gjenden në figurën nr.3 (Figura nr.3)

Rritja ekonomike për periudhën e studiuar, në vendet e Ballkanit Perëndimor pasqyrohet në figurën e mëposhtme (figura nr.2).

⁴⁹ Të dhënat janë marrë nga raportet e “Transparency International”, për periudhën 2004-2014

Figura 2: Rritja ekonomike 2004-2012, në vendet e Ballkanit Perendimor⁵⁰



Burimi: Raportet e Bankës Botërore




Figura 3: Korrupsioni dhe rritja ekonomike 2004-2012, në Shqipëri⁵¹

Qëllimi i analizës statistikore në vijim është matja e ndikimit të perceptimit të korrupsionit në rritjen ekonomike për shtetet e marra në analizë për periudhën e dhjetëvjeçarit të fundit. Të dhënat për perceptimin e korrupsionit janë marrë nga Transparency International. Pikët përfaqësojnë perceptimin e korrupsionit në një shtet të caktuar dhe në një vit të caktuar. Pikët janë të indeksuara dhe pikë më të mëdha nënkuptojnë një perceptim për korrupsion më të

⁵⁰ Të dhëna nga raportet e Bankës Botërore të viteve 2014-2012.

⁵¹ Të dhënat e tabelës janë marrë nga raportet e Transparency International dhe OECD, grafikët janë bërë nga autori i punimit

madh në kohën dhe vendin ku është matur ky indeks. Rritja ekonomike bazohet në studimet e kryera nga Banka Botërore. Këto të dhëna janë përqindje e rritjes së prodhimit të përgjithshëm bruto të një vendi, të llogaritura në terma real. Është lehtësisht i justifikuar ndjesia se rritja ekonomike ndikohet në një shkallë të gjërë nga perceptimi i korrupsionit në ekonomi dhe jetën shoqërore në tërësi. Veç të tjerave ia vlen të theksojmë se: *së pari*, korrupsioni ose perceptimi se ka korrupsion rrit kostot e transaksioneve. Kjo bën të mundur që të ulen fitimet dhe sipërmarrësit të dekurajohen për aktivitete fitimprurëse në atë periudhë dhe vend, *së dyti*, korrupsioni ul konkureshmërinë e cila në doktrinën ekonomike pranohet gjërësisht si gjeneratori i rritjes së performancës ekonomike, *së treti*, korrupsioni dekurajon sipërmarrjet që mbështeten në analiza dhe kanë në themel akumulimin e dijeve. Për aq kohë sa persona me aftësi për të penetruar në sistem duke përdorur metoda të tërthorta të "blerjes së aftësive", atëherë sipërmarrësit që mendojnë të ndërtojnë aktivitetin mbështetur tërësisht në metoda bashkëkohore, konkureshëse, dhe transparente janë të dekurajuar, për shembull pagesat për zyrat e konsulencës dhe *se katërti*, korrupsioni shkakton që institucionet e vendit të delegjetimohen dhe sipërmarrësit dhe aktoret ekonomike të drejtohen gjithnjë e më shumë tek "institucionet paralele ose të pasdites" që konkurojnë drejtpërsëdrejt shtetin.

Analiza statistikore e të dhënave mbi perceptimin e korrupsionit dhe rritjes ekonomike është kryer duke i trajtuar ato si të dhëna sektoriale kohore (*të dhëna për disa shtete dhe për disa vite- shënim i autorit*). Kjo nënkupton që për shtete dhe vite ku mungon qoftë edhe një e dhënë e vetme janë përjashtuar nga kampioni. Për shembull, nëse për Shqipërinë ne nuk disponojmë të dhëna për rritjen ekonomike për vitin 2013, ky vit përjashtohet nga kampioni edhe pse ne disponojmë të dhëna për percetimin e korrupsionit. Është marrë si e mirëqenë,

se mardhënia midis rritjes ekonomike dhe perceptimit të korrupsionit është në formën e mëposhtme:

$$Y = b + b_1X + e$$

Y = rritja ekonomike në përqindje,

b = pikëprerja e X me Y,

b₁ = efekti marginal i ndikimit të perceptimit të korrupsionit mbi rritjen ekonomike,

X = perceptimi i korrupsionit në pikë, dhe

e = gabimi (ose çfarë njihet në literaturë si residuals).

Nga analiza e të dhënave përfitohet ekuacioni i mëposhtëm:

$$Y = 11.82 - 3.7 X + e$$

Dy përfundime esenciale të pritshme përfitohen nga matja e bërë në ekuacionin e mësipërm.

Së pari, varësia mes rritjes ekonomike (Y) dhe perceptimit të korrupsionit (X) është negative (e zhdrejtë). Kjo nënkupton që rritja e perceptimit të korrupsionit ndikon negativisht në rritjen ekonomike. *Së dyti*, masa e këtij ndikimi vlerësohet të jetë i një madhësie të konsiderueshme (-3.7). Kjo do të thotë se rritja e perceptimit të korrupsionit me një pikë e ul rritjen ekonomike me 3.7 pikë përqindje. Ky përfundim është shumë i rëndësishëm dhe justifikon çdo përpjekje apo sakrificë që vendet duhet të bëjnë për të ulur korrupsionin në ekonominë e tyre. Ekonomia informale, sipas vendeve të ndryshme përkufizohet ndryshe, dhe mund të gjejmë disa përkufizime si “ekonomi jo formale”, “ekonomi sekondare”, “ekonomi hije”, “ekonomi dytësore”, “ekonomi e paraportuar”, “ekonomi nëntokësore” etj. Pavarësisht nga përkufizimi i ekonomisë informale, në përmbajtjen e saj, dhe për efekt të analizës së ekonomisë informale si mundësi për korrupsion, ekonomia informale përfshin të gjitha aktivitetet ekonomike të cilat sjellin të ardhura për vehte ose për të tretë, të fshehura

nga shteti, të parregjistruara ose që nuk mund të rregjistrohen dhe për pasojë nuk mund të auditohen. Në këtë çështje, ekonominë informale e konsiderojmë si një ekonomi e cila ka në përmbajtjen e saj dy grupe aktivitete ekonomike që sjellin të ardhura: *së pari*, ekonomia informale e cila përfshin aktivitete ekonomike të parregjistruara dhe *së dyti*, ekonomi hije, e cila sjell të ardhura nga aktivitete kriminale të tilla si shitja e drogës, kontrabanda, prostitucioni, trafikimi i qënjeve njerëzore, automjeteve, dhe e të gjithë atyre veprave kriminale që sjellin dobi pasurore të paligjshme, quajtur ndryshe dhe si ekonomi gri ose “ekonomi paralele”. Pjesa e parë e ekonomisë informale që përfshin aktivitetet ekonomike të parregjistruara, lidhet drejtëpërdrejt me punën dhe detyrën e punonjësve të sistemit tatimor dhe të strukturave të tjera që kanë për detyrë regjistrimin e këtyre aktiviteteve dhe ndëshkimin e tyre në rastet e konstatimit të aktiviteteve ekonomike të parregjistruara. Në të dy rastet kjo lidhet me punonjësit shtetërorë. Pjesa e dytë, është pjesa më e vështirë për tu kontrolluar, dhe kjo vështirësohet akoma më shumë në kushtet e tregtisë së lirë dhe integritetit ekonomik në të gjithë botën, duke lehtësuar aktivitetet ndërkombëtare të ekonomisë gri. Kjo ekonomi lidhet drejtëpërdrejtë me punën e punonjësve shtetërorë të strukturave që kanë për detyrë të luftojnë krimin. Duke e parë ekonominë e një vendi si shumë të dy pjesëve të saj formale dhe joformale, ndërmjet ekonomisë informale dhe asaj formale ka një relacion negativ.

Jan-Peter Olters, në artikullin “Ekonomia joformale në Shqipëri, një pengesë për zhvillimin ekonomik” në formë skematike paraqet lidhjen që ekziston ndërmjet ekonomisë informale dhe asaj formale dhe ryshfetin si pjesë të ekonomisë informale (Figura 4)



Figura 4: Ryshfeti pjese e ekonomise informale

Bazuar në analizën e mesipërme dalim në disa përfundime:

Së pari, korrupsioni ndikon drejtpërdrejt në ekonominë informale, ka një lidhje pozitive mes tyre, sa më i madh të jetë korrupsioni aq më e madhe është ekonomia informale, *së dyti*, rritja e ekonomisë informale pakëson të ardhurat nga tatimet e taksat, për pasojë pakëson të ardhurat në buxhetin e shtetit e për rrjedhojë pakësohen shërbimet dhe të mirat publike dhe *së treti*, korrupsioni është pjesë e ekonomisë informale.

Ky rreth vicioz i të ndikimit të korrupsionit në ekonominë informale dhe nëpërmjet saj në zvogëlimin e ekonomisë formale shpjegon dhe ndikimin negativ në qeverisje.

Korrupsioni si edhe perceptimi për korrupsion si pjesë e ekonomisë informale ndikon në madhësinë e sektorit informal, duke sjellë vështirësi në mbledhjen e taksave dhe tatimeve duke zvogëluar të ardhurat. Për pasojë kërkohet gjithnjë e më shumë ulje të shpenzimeve duke sjellë kështu shërbim publik të ulët dhe mosefiçencë në qeverisje.

Ky rreth vicioz i ndikimit negativ në të ardhura shpenzime dhe ineficencë, dobëson besimin e publikut në institucione, duke vënë në rrezik sistemin qeverisës e për pasojë dhe vetë demokracinë e një vendi. Korrupsioni ose perceptimi se ka korrupsion rrit kostot e transaksioneve. Kjo bën të mundur që të ulen fitimet dhe sipërmarrësit të dekurajohen për aktivitete fitimprurëse në atë periudhë dhe vend. Korrupsioni ul konkurueshmërinë e cila në doktrinën ekonomike pranohet gjërësisht si gjeneratori i rritjes së performancës ekonomike.

Korrupsioni dekurajon sipërmarrjet që mbështeten në analiza dhe kanë në themel akumulimin e dijeve. Perceptimi i rritjes së korrupsionit, është një opinion që njeriu e krijon për tjetrin, jo se e njih atë ose se ka mundësi të bëjë matjen reale të korrupsionit, por e bën këtë vlerësim nisur nga vetja, nga gjëndja e tij në një moment të caktuar duke u nisur nga mendimi meqënëse unë kam, tjetri i duhet të jetë i korruptuar që ka. Një rol të rëndësishëm në krijimin e këtij perceptimi luan media e cila jo shpesh i shmanget korrupsionit, duke u vënë në shërbim të partive dhe aleancave politike mazhoritare, ose konkurrentëve kundrejt përfitimeve nga kontratat qeveritare, duke u larguar nga pavarësia e tyre.

Politikat represive për minimizimin e korrupsionit, për sa kohë nuk ndërhyhet në analizën e shkaqeve politike ekonomike dhe sociale, si dhe të edukimit shoqëror, janë jo eficiente për të bërë të mundur fitoren ndaj këtij fenomeni shkatërrues për demokracinë dhe shoqërinë në tërësi, duke ngelur si sfidë dhe për shumë kohë. Ndryshimet në të drejtën materiale, procedurale dhe ekzekutive kërkojnë edhe efikasitet të strukturave të luftës, nëpërmjet të cilave realizohen goditja e rasteve të veçuara, vetëm rastet për të cilat fillohet një procedim penal. Masat parandaluese për sekuestrimin e të ardhurave nga korrupsioni si produkt krimi dhe me pas konfiskimin e tyre gjatë një procedure të rregullt gjyqësore, do të ishin masa të efektshme për të ndikuar në uljen e nivelit të korrupsionit dhe në rritjen e besimit të qytetarëve në institucionet e zbatimit të ligjit. Nevoja e bashkëpunimit institucional, ndërshtetëror dhe ndërkombëtar jo vetëm në planin formal, bashkëpunim i cili formalisht është i dukshëm, por edhe bashkëpunimi në nivel operacional të shkëmbimit të informacionit, të kryerjes së procedurave hetimore dhe evidentimin e konfiskimin e produkteve të krimit është domosdoshmëri.

3.2.6 Pastrimi i parave

Pastrimi i parave është procesi i fshehjes së origjinës kriminale të aktiviteteve dhe investimeve ose të natyrës së paligjshme të transaksioneve financiare. Terminologjia e saktë juridike e përcaktimit të pastrimit të parave është "fshehja ose maskimi i natyrës së vërtetë, burimit, vendndodhjes, disponimit, lëvizjes, të drejtave reale në lidhje me pronësinë, duke qenë në dijeni se prona të tilla rrjedhin nga një vepër penale⁵²". Ajo është një veprimtari kriminale, nëpërmjet së cilës, të ardhurat e krimit integrohen në veprimtari të ligjshme, duke e bërë më të lehtë përdorimin e tyre të mëtejshëm. "Pastrimi i parave është kthimi i të ardhurave të realizuara me mjete të paligjshme në pasuri të cilave është e vështirë t'u gjendet origjina e krimit"⁵³. Disa nga veprimet kriminale që shoqërohen me pastrim parash janë trafiku i drogës, financimi i terrorizmit dhe përvetësimi i fondeve publike. Paul Byron, përfaqësues i Departamentit të Drejtësisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës, shprehet se, "pastrimi i parave ka të bëjë me përfitimin e pasurisë nga aktivitetet ilegale dhe përpjekjet që këto përfitime të vendosen në sistemet bankare, në atë mënyrë që të fshihet origjina e parave apo edhe të vazhdohet aktiviteti kriminal, duke përdorur sistemin financiar". Nuk ka dallime të rëndësishme në përkufizimin e pastrimit të parave. Në thelb kjo veprimtari kriminale përfshin përpjekjet për t'iu shmangur konfiskimit të të ardhurave kriminale, të cilat mund të përdoren si provë në një ndjekje penale. Organizata Ndërkombëtare e Komisioneve të Letrave me Vlerë (IOSCO) e përkufizon pastrimin e parave si "... një gamë të gjerë të aktiviteteve dhe proceseve me qëllim errësimin e burimit të të hollave të fituara në mënyrë të paligjshme dhe për të

⁵² Cituar nga Mëçalla, N.(2007), Pastrimi i parave, kërcenim për sigurinë kombëtare, Tiranë, Dita 2000 f.12

⁵³ Po aty, f.12

krijuar pamjen se ato e kanë origjinën nga një burim legjitim”.Pra, pastrimi i parave është “transferimi i të hollave të nxjerra në rrugë të kundërligjshme ose investimi për të fshehur burimin e vërtetë”. Është një veprimtari e fshehtë, është procesi i maskimit të origjinës reale të përfitimeve kriminale, të transformimit të tyre në kapital legjitim.

Shumica e vendeve në përkufizimin e termit të pastrimit të parave, kanë përshtatur nenin 3 germa “b” të Konventës së Kombeve të Bashkuara “Kundër Drogave Narkotike dhe Substancave Psikotrope” të vitit 1988, e njohur si Konventa e Vjenës. Ajo e përkufizon pastrimin e parave si: (i) shkëmbim ose transferim të pasurive duke e ditur se këto pasuri kanë rrjedhur nga një veprimtari e kundërligjshme..., me qëllimin e fshehjes ose mbulimit të origjinës së paligjshme të pasurive ose me qëllimin e dhënies së ndihmës ndonjë personi që është përfshirë në kryerjen e një veprimtarie të kundërligjshme; (ii) fshehje ose mbulim të natyrës së vërtetë, të burimit, të vendndodhjes, të sistemit, të lëvizjes të të drejtave në lidhje me pasurinë ose pronësinë e pasurisë, duke ditur se një pasuri e tillë ka rrjedhur nga një veprimtari e kundërligjshme.

Konventa e Vjenës, pavarësisht se jep një nocion të pastrimit të parave, ajo kufizohet vetëm në pastrimin e parave të siguruara në fushën e trafikut të drogës, duke lënë pa përfshirë vepra të tjera të rëndësishme kriminale si për shembull, mashtrimet financiare, evazionin fiskal, kontrabandën, vjedhjen me dhunë, krimin e organizuar, financimin e terrorizmit, etj. Përkufizimi i termit pastrim parash plotësohet në akte të tjera ndërkombëtare si në Konventën Evropiane “Mbi pastrimin, kërkimin, marrjen dhe konfiskimin e produkteve të rrjedhura nga krimet”, e njohur si Konventa e Strasburgut, dhe në Konventën e Kombeve të Bashkuara Kundër Krimin të Organizuar, e njohur si Konventa e Palermos, duke bërë një

përkufizim të plotë të pastrimit të parave. Sipas këtyre konventave akti i pastrimit duhet të konsiderohet vepër penale nga sistemet penale të brendshme kur është kryer qëllimisht për:

(i) kthimin ose transferimin e pasurive, për të cilat, ai që i bën, e di që këto pasuri përbëjnë produkte me qëllim që të fshihet ose të maskohet origjina e paligjshme e tyre ose që ndihmon çdo person që është i ngatërruar në kryerjen e veprës penale kryesore për t'u shpëtuar pasojave juridike të akteve të tij;

(ii) fshehja ose maskimi i natyrës, origjinës, vendndodhjes, disponimit, zhvendosjes ose pronësisë reale të pasurive ose të drejtave të lidhur me to, për të cilat autori është në dijeni që këto pasuri përbëjnë produkte kriminale;

(iii) përfitimi, mbajtja ose përdorimi i pasurive, të cilat, ai që i fiton, i mban ose i përdor, është në dijeni, në kohën kur ai i merr, se ato përbëjnë produkte kriminale;

(iv) pjesëmarrja në njërin nga veprat penale të treguara sipas këtij neni ose çdo shoqërim, marrëveshje, tentativë ose bashkëpunim me anë të pranisë, të ndihmës ose të këshillave për kryerjen e tyre.

Pavarësisht nga përkufizimi i bërë në konventat ndërkombëtare, shtetet kanë përcaktime të ndryshme në lidhje me veprën penale të pastrimit të parave. Dallimet vijnë edhe për shkak të shumëllojshmërisë së burimit të origjinës të të ardhurave që legalizohen. Burime të tilla mund të jenë çdo lloj vepre penale e parashikuar në legjislacionin penal, tipik është krimi i organizuar, si dhe një numër shkeljesh të normave rregulluese financiare dhe penale, duke përfshirë raportimin e skemave për transaksionet dhe transferimet, kërkesat e regjistrimit për ndërmjetësit financiar dhe kryerjen e transaksioneve me produkte ose instrumente të krimit. Qarkullimi i parave është si një lum i turbullt, ku hap pas hapi shfaqen dhe mësojnë të notojnë keqbërës dhe afaristë të çfarë do lloji, sipërmarrës të paskrupullt, financierë dhe

personazhe publikë. Këta individë ose grupe individësh të organizuar ose të pa organizuar, ushtrojnë profesionin e tyre në funksion të këtij krimi. Janë mijëra degëzime që sjellin furnizime në lumin e parave të pista, duke përvijuar privilegje të paligjshme, intriga, rigrupime dhe veprimtari kriminale, trafike të paligjshme, kontrabandë, zhvatje parash, fajde, faturime false, etj.




Figura 5: Cikli i qarkullimit të parave të pista dhe riciklimi

Sipas figurës 5, “Cikli i qarkullimit të parave të pista dhe riciklimi”, qartësohet skema e plotë e ciklit që paratë e pista kalojnë për t’u fshehur paligjshmërisë së krijimit të tyre, pavarësisht nga burimi i tyre. Qëllimi i fshehjes së burimit të parave, për kryeresit e veprave penale është i dyfishtë. *Së pari*, i shmangen syrit të policisë dhe organeve të tjera të zbatimit të ligjit, për t’u ruajtur nga burgosja dhe dënimi i tij, *së dyti*, për t’u ruajtur pasurinë dhe fuqinë e tij ekonomike, pasuri e cila shërben si fuqia financiare për vazhdimin e aktivitetit kriminal dhe korrupsionin e punonjësve të zbatimit të ligjit. Në figurën 5 janë dhënë 5 faza në të cilat krijohen dhe kalojnë paratë e pista dhe rifinancimin e aktiviteteve kriminale dhe aktiviteteve të tjera ekonomike e tregëtare, duke krijuar një rreth vicioz, një rebus të lëvizjes së parave.

Prandaj dhe procesi i pastrimit të parave dhe provueshmëria e veprës penale të pastrimit është e vështirë. Rezultatet për raste të pastrimit të parave janë shumë të pakta, kjo jo se nuk ndodh, por për shkak të vështirësisë së hetimit të tyre. Nëpërmjet figurës së mësipërme kemi paraqitur fazat si më poshtë:

1- Shkeljet ligjore (penale dhe administrative). Shkeljet ligjore të cilat sjellin, krijojnë dobi pasurore të paligjshme janë evazoni fiskal, mashtrimet, fallsifikimet me cilësinë e mallrave, rimbursimet e TVSH-së, trafikku i drogës, korrupsioni, trafiket e paligjshme, prostitucioni, krimet kompjuterike, vjedhjet me karta krediti. Përdorimi i termit “shkelje ligjore”, është përdorur në përgjithësi, pasi jo të gjitha aktivitetet e mësipërme janë vepra penale. Për shembull evazoni fiskal, ndonëse është shmangie nga pagesa e tatimeve, jo në çdo rast është vepër penale. Pasuria e paligjshme në rastin e evazionit fiskal, shmangies është vetëm vlera që duhet të paguhet shtetit në formën e tatimit, por jo e gjithë vlera e shmangies. Sipas literaturës pastrimi i parave është i lidhur me veprat penale, dhe fillimisht me veprat penale të trafikut të drogës dhe trafikeve të tjera të paligjshme.

2- Subjektet të cilat marrin përsipër fshehjen e të ardhurave. Si subjekte mund të jenë edhe personat fizik edhe personat juridik. Me ndryshimet e bëra dhe në kodin penal të Republikës së Shqipërisë, në zbatim të konventave, edhe personat juridik mbajnë përgjegjësi penale.

3- Drejtimit e lëvizjes së të ardhurave të cilat kanë nevojë të fshihen. Fushat se ku drejtohen paratë për tu fshehur shkojnë në tre drejtime kryesore, *së pari*, lëvizje në CASH, *së dyti*, përfshirja në ekonomi ilegale, të paligjshme, *së treti*, përfshirja në ekonomi të ligjshme.

4- Veprimet që kryhen nga subjektet sipas drejtimeve. Sipas drejtimit të parë, lëvizjet bëhen nëpërmjet këmbimeve valutore, tregut të lirë, blerje të pasurive, blerje të letrave me vlerë. Në drejtimin e dytë, ekonomi ilegale, veprimet fokusohen në aktivitete kriminale, transferata

ndërkombëtare, në sektorët e prodhimit, shpërndarjes dhe tregëtisë, tregu i punës së zezë, korrupsion, fallsifikime, këshillime të ndryshme. Në drejtimin e tretë, është përfshirja në aktivitete të ligjshme në të gjithë fazat e tij si prodhim shpërndarje, tregëtia, kontrata pune, taksa, investime, depozita aksione sigurime.

5- Aktivitetet kriminale. Sasia e parave që kalon nëpërmjet dy fushave të para, CASH dhe ekonomi ilegale, shkon drejtpërdrejtë në financiaimin e aktiviteteve kriminale si trafik droge, trafiqe të paligjshme, financim terrorizmi dhe aktivitete të tjera kriminale.

Në përkufizimin e termit të pastrimit të parave, shtetet kanë përshtatur nenin 3 gërma “b” të Konventës së Kombeve të Bashkuara “Kundër Drogave Narkotike dhe Substancave Psikotrope” të vitit 1988, e njohur si *Konventa e Vjenës*⁵⁴. Konventa e Vjenës kufizohet vetëm në pastrimin e parave të siguruara në fushën e trafikut të drogës, duke lënë pa përfshirë vepra të tjera penale.

Përkufizimi i termit pastrim parash plotësohet në akte të tjera ndërkombëtare si në Konventën Evropiane “Mbi pastrimin, kërkimin, marrjen dhe konfiskimin e produkteve të rrjedhura nga krimet”, e njohur si *Konventa e Strasburgut*⁵⁵, 8 nëntor 1990 dhe në Konventën e Kombeve të Bashkuara Kundër Krimit të Organizuar, e njohur si *Konventa e Palermos*, 12 dhjetor 2000⁵⁶, duke bërë një përkufizim të plotë të pastrimit të parave.

⁵⁴ Konventa e Kombeve të Bashkuara kundër trafikut të paligjshëm të drogave narkotike dhe lëndëve psikotrope. Vjenë - Dhjetor 1988. Ratifikuar me Ligjin Nr.8723 dt.26.12.2000. Përmbledhje të Akteve Ndërkombëtare”, botim i Qendrës Publikimeve Zyrtare, Qershor 2010, faqe 188 - 194.

⁵⁵Ligji Nr. 8646, datë 17.05.2000 “Për Ratifikimin e Konventës Evropiane, për Pastrimin, Depistimin, Kapjen dhe Konfiskimin e Produkteve të Krimit”. Përmbledhje të Akteve Ndërkombëtare”, Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare, Qershor 2010, faqe 165-167

⁵⁶ Ligji Nr.8920 dt.11.07.2002 “Për Ratifikimin e Konventës së Kombeve të Bashkuara Kundër Krimit të Organizuar Ndërkombëtar”. Përmbledhje të Akteve Ndërkombëtare”, Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare. Qershor 2010, faqe 293-294.

Sipas nenit 287, “Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale” të Kodit

Penal të RSH-së, parashikon pastrimin e produkteve të vepres penale si:

- a) këmbim ose transferim të pasurisë, me qëllim fshehjen ose mbulimin e origjinës së paligjshme të saj, duke ditur se kjo pasuri është produkt i veprës penale ose i veprimtarisë kriminale;
- b) fshehjes ose mbulimit të natyrës së vërtetë, burimit, vendndodhjes, disponimit, zhvendosjes, pronësisë ose të drejtave në lidhje me pasurinë, duke ditur që kjo pasuri është produkt i veprës penale ose i veprimtarisë kriminale;
- c) fitimit të pronësisë, posedimit ose përdorimit të pasurisë, duke e ditur në çastin e marrjes në dorëzim të saj, që kjo pasuri është produkt i veprës penale ose i veprimtarisë kriminale;
- ç) kryerjes së veprimeve financiare ose transaksioneve të copëzuara për shmangien nga raportimi, sipas legjislacionit për parandalimin e pastrimit të parave;
- d) investimit në veprimtari ekonomike ose financiare të parave a sendeve, duke ditur se janë produkte të veprës penale ose veprimtarisë kriminale;
- dh) këshillimit, ndihmës, nxitjes ose thirrjes publike për kryerjen e secilës prej veprave të përcaktuara më sipër; dënohet me burgim nga pesë gjer në dhjetë vjet dhe me gjobë nga pesëqind mijë gjer në pesë milionë lekë.

Kodi penal shqiptar sipas përcaktimit në dispozitën e pastrimit të produkteve të krimit ka përfshirë elemente dhe rrethana të kryerjes së veprës penale nga të gjitha konventat e përmendura më sipër. Gjithashtu ndryshimi i bërë ka synuar zgjerimin e rrethit të produkteve jo vetëm nga vepra penale por dhe nga veprimtaritë kriminale.

Kodi penal në nenin 287 të tij përcakton rrethin e personave ndaj të cilëve zbatohet kjo dispozitë. Konkretisht parashikon se dispozitat e këtij neni zbatohen edhe kur: a) vepra penale, produktet e së cilës pastrohen, është kryer nga një person që nuk mund të merret si i pandehur ose që nuk mund të dënohet, b) ndjekja penale për veprën, produktet e së cilës pastrohen, është parashkruar ose amnistuar, c) personi që kryen pastrimin e produkteve është i njëjtë me personin që ka kryer veprën, nga e cila kanë rrjedhur produktet, ç) për veprën penale, nga e cila kanë ardhur produktet, nuk është filluar asnjëherë çështja penale apo nuk është dhënë një dënim me vendim penal të formës së prerë, d) vepra penale, produktet e së cilës pastrohen, është kryer nga një person, pavarësisht shtetësisë së tij, jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë dhe është njëkohësisht e dënueshme, si në shtetin e huaj, ashtu edhe në

Republikën e Shqipërisë. Dijenja dhe qëllimi, sipas paragrafit të parë të këtij neni, nxirren nga rrethana fakti, objektive. Hetimet financiare bëhen paralel me hetimet penale. E përbashkëta ndërmjet hetimeve financiare dhe pastrimit të parave është qëllimi i tyre, goditja e produkteve të krimit. Por midis tyre ka disa dallime esenciale. Qëllimi i hetimit financiar është që të identifikojë, gjurmojë, sekuestrojë dhe konfiskojë të ardhurat nga krimi, paralelisht me hetimin penal të një vepre kriminale e cila ka sjellë përfitime financiare, ose të ardhura nga krimi. Ndërsa qëllimi i masave për parandalimin dhe pastrimin e parave, të cilat merren nga njësi të specializuara të inteligjencës financiare, (FIU) është të monitorojë dhe analizojë transaksionet financiare dhe të zbulojë ekzistencën e tipologjive të pastrimit të parave. Ndryshimet ndërmjet pastrimit të parave dhe hetimit financiar janë së pari në mënyrën se si arrijnë qëllimin, së dyti në organet që merren me ndjekjen e tyre, me pastrimin e parave merren njësi të inteligjencës financiare, ndërsa me hetimet financiare merret policia dhe prokuroria, Lidhja midis tyre qëndron në faktin se ata shërbejnë njëra tjetrës, në kuptimin që evidentimi dhe monitorimi i një transaksioni të dyshimtë mund të çojë në rast të veprës penale të pastrimit, e cila kërkon hetim financiar për të identifikuar, sekuestruar dhe konfiskuar produktet e krimit, dhe e kundërta nga një rast i hetimit financiar mund të kalojë në një rast të dyshuar për pastrim parash, rast i cili ka nevojë të plotësohet me monitorim të transaksioneve financiare. Në formë të përmbledhur lidhja dhe dallimi ndërmjet hetimit financiar dhe pastrimit të parave mund të paraqiten nëpërmjet skemes së mëposhtme:




Figura 6: Dallimi i hetimit financiar me pastrimin e parave⁵⁷

Hetimi financiar është procedura për zbulimin, identifikimin, ngrirjen dhe sekuestrimin me qëllim konfiskimin e produkteve të krimit, ndërsa pastrimi i parave, në format dhe rrethanat e mësipërme është vepër penale, e parashikuar në kodin penal dhe për të cilën kërkohet hetim financiar, sipas ligjit Antimafia⁵⁸

3.2.7 Krimi kibernetik

Kriminaliteti si dukuri e dëmshme dhe e rrezikshme shoqërore, që nga kohrat e lashta ka zgjuar interesim ndër qarqet e ndryshme shoqërore. Lidhur me këtë dukuri, janë bërë përpjekje të vazhdueshme për të gjetur dhe shpjeguar shkaqet dhe natyrën e tij. Ka pikpamje të ndryshme lidhur me kriminalitetin, shpesh here dhe të gabuara, në kohra të ndryshme. Sipas autorit Halili, me nocionin kriminalitet kuptohet: (...) “tërësia e të gjitha krimeve të kryera në një kohë, hapsirë dhe periudhë të caktuar” (Halili, 2008, p. 69). Nga ky përkufizim mbi kriminalitetin del qartë ndryshueshmëria e formave të kriminalitetit në kohra të ndryshme, për shkaqe të zhvillimit dhe transformime të shoqërive dhe sisteme të caktuara.

⁵⁷ Manuali mbi hetimet financiare, 2006

⁵⁸ Neni 3 i ligjit nr. 10192, datë 3.12.2009, “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar dhe trafikimit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”

Vëllimi, format e krimeve dhe sjelljeve kriminale, kanë qënë të lidhura ngushtë me zhvillimin dhe transformimin e shoqërive dhe sistemeve të caktuara ekonomiko-shoqërore (Halili, 2008, p. 116). Ky proces i varësisë së formave të kriminalitetit nga transformimet e veçanta shoqërore, veçmas vërehet në shoqëritë bashkëkohore, ku brenda afateve të shkurtëra kohore në vendet e ndryshme, ose në të njëjtin vend, vërehen forma dhe lloje të reja të manifestimit të kriminalitetit. Bazuar në literaturë e cila trajton format e ndryshme të kriminalitetit të organizuar, hasim në një formë të re të manifestimit të kriminalitetit në botën bashkëkohore, fjala është për veprat penale nga fusha e krimit kompjuterik (G.Vula, 2010, p. 26). Trajtimi i krimit kompjuterik bëhet për disa arsye si: *së pari* qëllimi i krimit kompjuterik është përfitimi për vehte dhe persona të tjerë *së dyti*, lidhja e krimit kompjuterik me krimin e organizuar dhe *së treti* nevoja e marrjes së masave ligjore, institucionale dhe operacionale në goditjen dhe parandalimin e këtij krimi. Krimi kompjuterik është një formë e veçantë e krimit, në të cilën, kompjuteri paraqitet si mjet për kryerjen e veprimit ilegal (*modus operandi*) apo si objekt sulmi, i drejtuar nga personat të cilët posedojnë njohuri dhe prirje të veçanta për sistemet kompjuterike, me qëllim që vehtes apo të tjerëve tju sjellë fitime (G.Vula, 2010, p. 31).

Prioritetet strategjike në bashkëpunimin kundër krimit kompjuterik, miratuar nga Takimi i Ministrave dhe Zyrtarëve të Lartë të Ministrive të Brendshme dhe të Sigurisë, të Ministrive të Drejtësisë dhe Shërbimeve të Prokurorisë të vendeve dhe rajoneve pjesëmarrëse në Projektin CyberCrime@IPA1, Dubrovnik, Kroaci, 15 shkurt 2013, lidhur me hetimet financiare, mashtrimet dhe pastrimin e parave, përcaktoi si prioritet strategjik hetimet financiare, parandalimin dhe kontrollin e mashtrimit dhe pastrimit të parave në internet.

Shumica e krimeve që përfshijnë internetin dhe teknologji të tjera informacioni synojnë

nxjerrjen e përfitimeve ekonomike nëpërmjet llojeve të ndryshme të mashtrimit dhe formave të tjera të krimit ekonomik dhe të rëndë. Kështu, sasi të mëdha të të ardhurave nga krimet, gjenerohen dhe qarkullojnë në internet. Rrjedhimisht, hetimet financiare që synojnë kërkimin, sekuestrimin dhe konfiskimin e të ardhurave nga krimet dhe masat për parandalimin e mashtrimit dhe për parandalimin dhe kontrollin e pastrimit të parave në Internet, duhet të bëhen prioritet strategjik. Në takim u përcaktuan disa masa që synjnë krijimin e një platforme online për raportim publik. Duke vlerësuar rëndësinë e raportimit të krimit, rëndësi i është kushtuar përdorimit të modeleve të standartizuara të raportimit si:

-Të krijojnë një platformë online për raportim publik mbi mashtrimin në Internet dhe për krimin kompjuterik në përgjithësi. Përdorimi i modeleve të standardizuara të raportimit do të mundësojë një analizë më të mirë të kërcënimeve dhe tendencave, të operacioneve dhe organizatave kriminale, dhe të modeleve të qarkullimit dhe pastrimit të parave. Kjo do të lehtësojë masat nga autoritetet e drejtësisë penale dhe njësitë e zbulimit financiar për ndjekjen penale të autorëve të veprave dhe për sekuestrimin dhe konfiskimin e të ardhurave nga krimi. Gjithashtu, platforma duhet t'i shërbejë funksioneve parandaluese si ndërgjegjësimi dhe edukimi publik, sinjalizimet e rreziqeve, instrumentet dhe informacionet. Sa më të harmonizuara të jenë platformat kombëtare me ato të vendeve dhe rajoneve të tjera, aq më shumë do të lehtësojnë analizat dhe masat rajonale dhe ndërkombëtare.

Hetimi i krimeve kompjuterike nuk mund të bazohet në çdo rast në denoncimet e bëra nga individë ose institucione. Për shkak të specifikave dhe sofistikimit të tij dhe nevojës së pasjes së dijeve në këtë fushë jo gjithnjë është e mundur raportimi i tij. Në këtë aspekt ka rëndësi promovimi i hetimeve proaktive paralele financiare gjatë hetimit të krimeve kompjuterike ose veprave penale që përfshijnë teknologji të informacionit, internetin. Kjo kërkon

bashkëpunim më të madh ndërmjet agjencive midis autoriteteve përgjegjëse për krimet kompjuterike dhe për hetimet financiare, si dhe për njësitë e zbulimit financiar. Trajnimi i përbashkët mund të lehtësojë këtë bashkëpunim ndërmjet agjencive.

Duke qenë se krimi kompiuterik nuk ka kufi, rëndësi i kushtohet krijimit të forumeve të besuara (kombëtare dhe rajonale) për ndarjen e informacionit publik/ privat mbi kërcënimet kompjuterike në lidhje me sektorin financiar. Forumet kombëtare duhet t'i vihen në dispozicion aktorëve kyçë (për shembull, përfaqësues të sektorit financiar, ofrues të shërbimit të internetit, njësitë e krimit kompjuterik, njësitë e zbulimit financiar, ekipet e reagimit ndaj incidenteve dhe sigurisë së kompjuterëve). Qëllimi i tyre është identifikimi i rreziqeve, tendencave, instrumenteve dhe zgjidhjeve për mbrojtjen e sektorit financiar nga krimi kompjuterik. Forumi rajonal duhet të përbëhet nga forume të krijuara në nivele të brendshme. Megjithë progresin e bërë në legjislacionet kombëtare dhe në nivel ndërkombëtar, kuadri ligjor për sekuestrimin dhe konfiskimin e të ardhurave nga krimi dhe asetet dixhitale, si dhe për parandalimin e pastrimit të parave në internet ka ende mangësi.

Format e reja të komunikimit elektronik mundësojnë shfaqjen e formave të reja të krimit kompjuterik. Në këtë kuadër, krijimi ose përmirësimi i kuadrit të ri ligjor duhet të përfshijë asetet dixhitale, si për shembull monedhat virtuale dhe paratë e ruajtura elektronikisht. Rregullat, rregulloret dhe procedurat kundër pastrimit të parave duhet të zbatohen edhe për sisteme pagesash të bazuara në internet. Karakteri ndërkombëtar i krimit kompjuterik ose mundësia e lëvizjes së shpejtë dhe në distanca të mëdha të shërbimeve kompjuterike diktojnë nevojën e rritjes së mundësive për bashkëpunim ndërkombëtar më efikas. Lidhja e masave kundër pastrimit të parave dhe hetimeve financiare me ekspertizën e krimit kompjuterik dhe provat ligjore kompjuterike, ofron mundësi shtesë për bashkëpunim ndërkombëtar. Qeveritë

duhet të shfrytëzojnë mundësitë e Deklaratë për prioritetet strategjike kundër krimit kompjuterik disponueshme sipas Konventës së Budapestit për Krimin Kompjuterik, Konventës së Këshillit të Europës për Pastrimin, Kërkimin, Sekuestrimin dhe Konfiskimin e të Ardhurave nga Krimi dhe Financimin e Terrorizmit (CETS 198) dhe 40 Rekomandimet e rishikuara të Task Force të Veprimit Financiar (FATF). Për më tepër, duhet t'i kushtohet rëndësi rezultateve të studimit të tipologjisë MONEYVAL të muajit mars 2012 në lidhje me qarkullimin e parave nga krimi në internet. Arritja e një bashkëpunimi më efikas ndërkombëtar për krimin kompjuterik dhe provat elektronike duhet të jetë prioritet strategjik për shfrytëzimin e mundësive të Konventës së Budapestit për Krimin Kompjuterik dhe marrëveshje të tjera dypalëshe, rajonale dhe ndërkombëtare për bashkëpunim në çështjet penale. Kjo përfshin shfrytëzimin e plotë të neneve 23-25 të Konventës së Budapestit në lidhje me bashkëpunimin gjyqësor dhe ndërpoligor, duke përfshirë rregullimet legislative dhe përmirësimin e procedurave.

Konventa parashikon marrjen e masave për trajnimin kombëtar, rajonal dhe ndërkombëtar dhe ndarjen e praktikave të mira, vlerësimin e efektivitetin e bashkëpunimit ndërkombëtar, forcimin e efektivitet të pikave të kontaktit mbi baza 24 orëshe në 7 ditë. Këto pika kontakti janë krijuar në të gjitha vendet dhe rajonet, në përputhje me nenin 35 të Konventës së Budapestit por roli i tyre duhet të përmirësohet dhe duhet të bëhen më proaktive dhe tërësisht funksionale. Rëndësi kanë dhe statistikave për rishikimin e efektivitetit të pikave të kontaktit mbi baza 24 orëshe në 7 ditë dhe forma të tjera të bashkëpunimit të rregullt ndërkombëtar⁵⁹.

⁵⁹ www.coe.int/cybercrime

Krimi ekonomik, financiar, korrupsioni, pastrimi i parave dhe krimet kopiutere, trajtohen si krime të lidhura me krimin e organizuar dhe trafikimin. Këto krime, përveç se janë penalizuar sipas legjislacioneve ndërkombëtare dhe kombëtare, pra për të cilat aplikohen sanksione penale për kryesit e këtyre veprave penale, për shkak të impaktit që japin me të ardhurat e tyre në krimin e organizuar, janë dhe krimet për të cilat duhet të aplikohen masat parandaluese të konfiskimit të pasurisë. Sidomos korrupsioni, i cili sjell fitime në shifra të pallogaritshme, dobëson efikasitetin e zyrtarëve të zbatimit të ligjit. Për këto arsye, ndërmarra e hetimeve financiare me qëllim konfiskimin e produkteve të krimit për këto vepra është shumë e rëndësishme.

3.3 Vështrim historik i hetimeve financiare dhe konfiskimit të produkteve të krimit

Globalizimi i krimit, rritja e fuqisë së “mafias botërore”, përhapja e rrjeteve të mëdha transnacionale të krimit të organizuar si trafiku i drogës, armëve, automjeteve, njerëzve, si dhe kontrabanda e mallrave, janë një nga kërcënimet kryesore për rendin ekonomik dhe politik botëror. Shumë vëzhgues, kryesisht nga media, shprehën shqetësimin se kishte lindur një “perandori e mafias”, se korrupsioni i tregjeve dhe i institucioneve qeveritare po zgjerohej, duke minuar themelet materiale dhe morale të demokracisë liberale (Jean Louis Briquet, Gilles Favareli Garrigues, 2010). Ekspertët, zyrtarët e policisë, prokurorët, gjyqtarët, gazetarët, udhëheqësit politikë dhe akademikët alarmuan publikun për këtë kërcënim që ishte zgjeruar nën hijen e globalizimit dhe “tërheqjen e shtetit”. Organizatat Ndërkombëtare bënë përpjekje për të parandaluar dhe luftuar krimin e organizuar më me zell se në të kaluarën. Promovimi i bashkëpunimit ndërshtetëror policor dhe gjyqësor, kanë inkurajuar qeveritë të miratojnë legjislacione të veçanta kundër krimit të organizuar, për ta

parashikuar në legjislacionet e brendshme, përforcimin e sistemit institucional, ngritjen e njësive të inteligjencës dhe njësive të specializuara për të luftuar krimin. Marrja e masave të brendshme në shtete të ndryshme, nuk i përgjigjej lëvizjes së krimit dhe kriminelëve, të cilët i kaluan kufijtë shtetëror, duke sjellë regjionalizimin dhe ndërkombëtarizimin e krimit, sidomos të atij të organizuar, si dhe korrupsionin e njësive të luftës kundër krimit. Nevoja për të gjetur forma dhe masa të reja të luftës kundër krimit, sidomos masa parandaluese, bëhej gjithnjë e më e domosdoshme. Kjo kërkonte përfshirjen e disa strukturave dhe institucioneve shtetërore, dhe ndërshtetërore, duke kërkuar forma të tjera për mobilizimin e tyre në marrjen e masave parandaluese dhe luftës kundër krimit në përgjithësi dhe atij të organizuar, pastrimit të parave dhe korrupsionit në vecanti.

Ky mobilizim çoi në miratimin e disa Konventave Ndërkombëtare, të cilat detyronin dhe rekomandonin shteteve palë për marrjen e masave konkrete, legjislative, operacionale, institucionale, dhe rritjen e bashkëpunimit, kombëtar dhe ndërkombëtar, në luftën dhe parandalimin e krimit të organizuar, trafikeve, pastrimit të parave e korrupsionit.

Edhe Shqipëria ka ratifikuar dhe aderuar në të gjitha konventat ndërkombëtare të Kombeve të Bashkuara dhe të Këshillit të Europës, në kuadër të këtij pinimi me interes janë, ligji nr.8722, datë 26.12.2000, Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në “Konventën e Kombeve të Bashkuara kundër trafikut të paligjshëm të drogave narkotike dhe të lëndëve psikotrope” (Konventa e Vjenës), ligji nr.8646, datë 20.7.2000, Për ratifikimin e Konventës Europiane “Për pastrimin, depistimin, kapjen dhe konfiskimin e produkteve të krimit” (Konventa e Strasburgut), ligji nr.8920, datë 11.7.2002, Për ratifikimin e Konventës së Kombeve të Bashkuara kundër krimit të organizuar ndërkombëtar” dhe dy protokolleve shtesë të saj. (Konventa e Palermos), ligji nr.9646, datë 27.11.2006, Për ratifikimin e

Konventës Europiane “Për pastrimin, depistimin, kapjen dhe konfiskimin e produkteve të krimit dhe financimin e terrorizmit” (Konventa e Varshavës)

3.3.1 Hetimet financiare dhe konfiskimi i produkteve të krimit para hyrjes në fuqi të ligjit për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar

Lidhur me hetimet financiare përpara hyrjes në fuqi të ligjit “për parandalimin e krimit të organizuar”, ose siç thirret ndryshe ligji antimafia, në literaturë nuk gjenden drejtpërdrejt koncepte apo përkufizime lidhur me hetimet financiare. Gjithsesi në të drejtën e brendshme penale kishte dispozita lidhur me konfiskimin, si dënim plotësues, parashikuar në Kodin Penal të RSH, Kreu V, neni 30, pika 2 ku thuhej: Për personat që kanë kryer krime ose kundërvajtje penale, bashkë me dënimin kryesor, mund të jepen edhe një ose disa nga këto dënime plotësuese: (...), 2. Konfiskimi i mjeteve të kryerjes së veprës penale dhe përfitimeve prej saj⁶⁰. Nisur nga vendi që është përfshirë konfiskimi në krerët e kodit penal gjykojmë se: së pari, konfiskimi nuk ishte masë për luftën dhe parandalimin, por ishte e përcaktuar si dënim, në kapitullin e dënimeve, si dënim plotësues dhe aplikimi i këtij dënimi mbetej në diskrecionin e gjykatësve, ku dhe në dispozitë thuhet shprehimisht, “... mund të jepen...”, së dyti, konfiskimi si dënim plotësues aplikohet ndaj personave, të cilët “... kanë kryer krime ose kundërvajtje penale”, ku standarti i të provuarit është shumë i lartë, kërkohej patjetër që të deklarohet fajtor, dhe së treti, edhe nëse deklarohet fajtor, dhe mund të jepej dënim plotësues konfiskim, konfiskimi jepej vetëm për “...mjeteve të kryerjes së veprës penale dhe përfitimeve prej saj.” Edhe vete termi “përfitim prej saj”, ka patur një moskuptshmëri së

⁶⁰ Ligj nr.7895, datë 27.1.1995 Kodi penal i Republikës së Shqipërisë

çfarë do të konsiderohet përfitim, dhe cili është përfitimi nga vepra e kryer. Paqartësia në terminologjinë e përdorur dhe fakti që edhe kjo është lënë në diskrecion të gjykatësve, nuk ka rezultate konkrete, dhe nuk është kryer funksioni parandalues apo goditës mes përdorimit të këtij mjeti të politikës penale. Mungesa e rezultateve është argument për vështirësitë në praktikë të përdorimit të këtij mjeti. Në nenin 36, “Konfiskimi i mjeteve të kryerjes së veprës penale” të Kodit Penal, thuhet se konfiskimi jepet detyrimisht nga gjykata ndaj personave që kryejnë vepër penale dhe konsiston në marrjen dhe kalimin në favor të shtetit të sendeve që kanë shërbyer ose ishin caktuar si mjet për kryerjen e veprës penale, si dhe objektet, të hollat dhe çdo pasuri tjetër që rrjedh nga vepra penale apo i shpërblimit të dhënë apo të premtuar për kryerjen e saj. Pas ratifikimit të Konventave të Vjenës⁶¹, 1998, Konventa e Strasburgut⁶², 1990 dhe Konventa e Palermos⁶³, 2000, sipas ligjit Nr. 9086, datë 19.6.2003, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.7895, datë 27.1.1995 "Kodi penal i Republikës së Shqipërisë" ndryshohet neni 30, pika 2 termi “përfitim prej tyre” me termin “produkte të veprës penale”, dhe neni 36 ndryshohet, duke zgjeruar mundësitë e institucioneve të ndjekjes penale për zbatimin e konfiskimit të zgjeruar dhe konfiskimit në vlerë, parashikuar në pikën 3 dhe 4 të nenit 36 të kodit penal i cili shprehet se, nëse produktet e veprës penale janë bashkuar me pasuri të fituara në rrugë të ligjshme, këto të fundit konfiskohen deri në vlerën e produkteve të veprës penale dhe Konfiskimit i nënshtrohen edhe të ardhurat ose përfitimet e tjera nga produktet e veprës penale, nga pasuritë në të cilat janë transformuar

⁶¹ Ligj 8722 date 26.12.2000, Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në "Konventën e Kombeve të Bashkuara kundër trafikut të paligjshëm të drogave narkotike dhe të lëndëve psikotrope"

⁶² Ligj 8646 date 20.7.2000, Për ratifikimin e “Konventës europiane “Për pastrimin, depistimin, kapjen dhe konfiskimin e produkteve të krimit”

⁶³ Ligj 8920 date 11.7.2002, Për ratifikimin e “Konventës së Kombeve të Bashkuara kundër krimit të organizuar ndërkombëtar” dhe dy protokolleve shtesë të saj

ose shndërruar produktet e veprës penale ose nga pasuritë me të cilat janë përzier këto produkte, në të njëjtën masë dhe mënyrë sikurse produktet e veprës penale”⁶⁴.

Ndryshimet në legjislacionin e brendshëm siç u analizuan më sipër, sollën një risi në kuptueshmerinë e përmbajtjes së termit konfiskim dhe zgjerimin e konceptit produkte të veprës penale. Për herë të parë parashikohet mundësia e konfiskimit dhe të pasurive të tjera, deri në vlerën e produkteve të veprës penale, ndryshe quhet “konfiskimi në vlerë”, e përdorur në terminologjinë juridike. Pavaresisht ndryshimeve pozitive, nën frymën e konventave të cilat shteti shqiptar tashmë i ka miratuar, neni 30 dhe 36 të Kodit penal, e lidhin konfiskimin me personin që ka kryer vepër penale, pra sipas veprimit “*in personam*”. Gjithashtu këta dispozita përfshihen në kreun e dënimeve plotësuese, ku përsëri edhe ky dënim mbetet nën diskrecionin e gjykatësve. Efektet e ndryshimeve në dispozitat e së drejtës penale të brendshme nuk kanë reflektuar në rezultate, pikërisht për arësyet e mësipërme. Konfiskimi është parë si sanksion penal dhe jo si masë parandaluese, ashtu siç dhe parashikohej.

Në kuptimin procedural penal, në Kreun VI, të Kodit të Procedures Penale, parashikohen masat e sigurimit pasuror ku parashikohen a) sekuestroja konservative⁶⁵ dhe b) sekuestroja preventive⁶⁶. Ndryshimet ndërmjet sekuestros konservative dhe sekuestros preventive, jepen respektivisht në nenin 270, në pikën 1, të këtij kodi, ku jepen kushtet e sekuestros konservative në të cilën thuhet: “Kur ka arsye të bazuara për të menduar se nuk ka garanci për pagimin e dënimit me gjobë, të shpenzimeve të procedimit dhe të çdo detyrimi ndaj pasurisë së shtetit, prokurori kërkon sekuestron konservative të pasurisë së luajtshme ose të

⁶⁴ Ligj nr. 9086, datë 19.6.2003 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.7895, datë 27.1.1995, kodi penal i Republikës së Shqipërisë”

⁶⁵ Neni 270, 271, 272, 273 të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Shqipërisë.

⁶⁶ Neni 274, 275 të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Shqipërisë.

paluajtshme të të pandehurit ose të shumave a sendeve që të tjerët i detyrohen atij, në caqet që ligji lejon sekuestrimin e tyre”, kurse në nenin 274, pika 1, parashikon sekuestrimin kur ka rrezik që disponimi i lirë i një sendi që lidhet me veprën penale mund të rëndojë ose të zgjasë pasojat e saj ose të lehtësojë kryerjen e veprave penale të tjera, me kërkesën e prokurorit, gjykata kompetente urdhëron sekuestrimin e tij me vendim të arsyetuar. Sekuestroja mund të vendoset edhe për sendet, produktet e veprës penale dhe çdo lloj pasurie tjetër që lejohet të konfiskohet, sipas nenit 36 të Kodit Penal⁶⁷, Kur ndryshojnë kushtet e zbatimit, gjykata, me kërkesën e prokurorit ose të të interesuarit, e heq sekuestron.

Sekuestroja konservative ka të bëjë me marrjen e masave për të garantuar pagimin e dënimit me gjobë ose shpenzime të tjera gjatë procesit penal, ndërsa sekuestroja preventive, ka të bëjë me masat që merren në rast se ka rrezik që disponimi i lirë i një sendi që lidhet me veprën penale mund të: rëndojë ose zgjasë pasojat, lehtëson kryerjen e veprës penale.

Në pikën 2 të nenit 274 dispozita përshkruan mundësinë e sekuestros preventive edhe për sendet, produktet e veprës penale dhe çdo lloj pasurie tjetër që lejohet të konfiskohet, sipas nenit 36 të Kodit Penal. Pra në çdo rast, i referohet kushteve të nenit 36 të Kodit Penal, për konfiskimin e mjeteve të kryerjes së veprës penale dhe produkteve të veprës penale. Sa më sipër, zbatimi i masave të konfiskimit lidhet domosdoshmërisht me ekzistencën e veprës penale dhe provueshmërinë e saj, si edhe në kuptim të zbatimit si dënim plotësues sipas nenit 30 të Kodit penal, lihet në diskrecion të gjykatësve. Nga njëra anë kërkohet një standart i lartë i të provuarit, pasi lidhet me fajësinë, dhe nga ana tjetër mbetet në diskrecionin e

⁶⁷ Ndryshuar pika 2 me ligjin nr.9085, datë 19.6.2003, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.7905, datë 21.3.1995.

gjyqtarëve. Vështirësitë e aplikimit të këtyre dispozitave, kanë ndikuar dhe në pritshmëritë dhe rezultate konkrete, për konfiskimin e produkteve të krimit, deri në këtë periudhë.

Në Janar të vitit 2003 u lançuan zyrtarisht negociatat për një Marrveshje Stabilizim Asocimi (MSA). Sipas raportit të stabilizim asocimit⁶⁸ të vitit 2003 thuhet:

Disa përmirësime janë vërejtur në kontrollin e migracionit të paligjshëm drejt BE-së, por trafikimi i qenieve njerëzore, drogave dhe formave të tjera të krimit të organizuar si dhe korrupsionit në fusha kyçe si sistemi gjyqësor, doganat dhe policia mbeten çështje tepër shqetësuese. Përmirësimet në pushtetin gjyqësor kanë qënë të kufizuara dhe hetimi i krimeve i pamjaftueshëm, me përjashtim të një numri në rritje të ndaluarve. Shqipëria do të jetë në gjendje t'i adresojë këto çështje të vështira në qoftë se do të ketë një angazhim të vërtetë nga Qeveria, forcat politike shqiptare dhe strukturat e zbatimit të ligjit (përfshirë prokurorinë dhe gjyqësorin), dhe një vendosmëri për të kthyer këtë angazhim në veprim (Komisioni Europian, 2003).

Raporti vë theksin në çështjet e zbatimit të ligjit, të reformave ligjore, institucionale, operacionale dhe bashkëpunimit institucional, rajonal dhe ndërkombëtar, duke evidentuar me shqetësim problemet e krimit të organizuar dhe korrupsionit duke theksuar se: “Ndonëse ka progrese mbi zhvillimin e bashkëpunimit rajonal, zbatimi i shtetit të së drejtës mbetet i mangët sidomos nga zbatimi i dobët i ligjit nga institucionet përgjegjëse, nga kapacitetet e pamjaftueshme të administratës, korrupsioni dhe krimi i organizuar. Liritë individuale dhe të drejtat e njeriut garantohen nga legjislacioni shqiptar por ka ende vend për përmirësim përse i përket zbatimit të tij” (Komisioni Europian, 2003).

Gjatë vitit 2002 Shqipëria ratifikoi një numër të instrumentave ndërkombëtare dhe pikërisht Statutin e Romës mbi Gjykatën Ndërkombëtare Penale, Konventën e Këshillit të Europës mbi Krimet kibernetike dhe protokollet shtesë mbi asistencën e ndërsjellë në fushën juridike. Do të duhet të sigurohet tani zbatimi dhe imponimi i këtij legjislacioni (Komisioni Europian, 2003, p. 6). Sipas së drejtës penale shqiptare, penale dhe proceduriale penale,

⁶⁸ SEC (2003) 339 Bruksel, 26.3.2003

trajtoheshin çështje të rëndësishme lidhur me hetimet financiare dhe konfiskimin e produkteve të krimit, pasi gjendeshin dispozita që kanë të bëjnë me konfiskimin në përgjithësi, neni 36 pika 1 gërma c e KP, neni 275 të KPP, konfiskimin e përkohshëm, ose sekuestrimin konservativ, parashikuar nga neni 270 – 273 të KPP dhe sekuestrimin preventiv, parashikuar nga nenet 274 – 276 të KPP. Mangësitë në legjislacionin e brendshëm qëndronin lidhur me disa çështje si: konfiskimi i shtrirë, konfiskimi vlerës së produkteve të ligjshme në vlerën e produkteve të krimit, barra e provës, të cilat rekomandoshin nga Konventat ndërkombëtare, të ratifikuara nga Shqipëria, por që nuk gjenin zbatimin e pritur për shkak të mos ndryshimit dhe pengesave që sillte e drejta e brendshme penale dhe procedurale penale. Në përballjen me gjendjen e krimit të organizuar dhe korrupsionit, kërkohej gjetja e mjeteve të tjera juridike dhe ngritjen e fuqizimin e institucioneve të zbatimit të ligjit. Ligji antimafia, për herë të parë parashikoi konceptet për hetimet financiare, dhe përpjekjet në parandalimin e goditjen e krimit të organizuar u fokusuan në hetimet për mjetet financiare, pasuritë, veprimtaritë ekonomike, mënyrën e jetesës si dhe burimet e të ardhurave të tyre. Ligji 9284, datë 30.9.2004, “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar”, ishte risi në mënyrën se si, dhe mjetet për parandalimin dhe luftën kundër krimit. Për herë të parë u praktikuan veprimet “*in rem*”, ku fokus ishte pasuria e vënë në mënyrë të paligjshme.

3.3.2 Hetimet financiare dhe konfiskimi i produkteve të krimit pas hyrjes në fuqi të ligjit për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar dhe trafikimit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë

Një rol të rëndësishëm në parandalimin dhe luftën kundër krimit të organizuar në përgjithësi dhe hetimeve financiare në veçanti kanë luajtur ratifikimi i instrumenteve ndërkombëtare,

si dhe ndryshimet legislative në të drejtën e brendshme, miratimi i paketës antimafia, e cila përfshin ndryshime në ligjin penal dhe procedural penal si dhe krijon një ligj specifik, i cili ka për qëllim parandalimin dhe goditjen ndaj krimit të organizuar dhe trafikimit përmes konfiskimit të pasurisë së personave, të cilët kanë një nivel të pajustificuar ekonomik, si rezultat i veprimtarisë së dyshuar kriminale. Reformat e ndërmarra nga Shqipëria, sollën ndryshime në tre aspekte kryesore ligjore, institucionale dhe operationale:

Në aspektin ligjor, Shqipëria ratifikoi ose aderoi në konventat ndërkombëtare të OKB-së dhe Këshillit të Europës, hartoi dhe miratoi instrumentet juridike të brendshme siç thirret ndryshe paketa antimafia. Në zbatim të rekomandimeve që konventat e mësipërme u jepnin shteteve, Shqipëria miratoi ndryshime në ligjin material penal⁶⁹, dhe procedural penal⁷⁰ dhe ligjin specifik për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar⁷¹. Ndryshimet në Kodin penal, dhe procedural penal, qartësuan konceptet dhe përkufizimet për krimin e organizuar, krimin e rëndë dhe atë serioz⁷², pastrimin e parave⁷³, dhe penalizimin si vepër penale, korrupsionin, si dhe procedurat për ngrirjen, sekuestrimin, konfiskimin, bashkëpunimin ndërkombëtar. Nga përmbajtja e këtij nenit 4 të , ligjit Nr. 9284, datë 30.9.2004, “ Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar” i jepet përgjigje tre pyetjeve kryesore në hetimet financiare si: a) ndaj kujt bëhen hetimet, b) si bëhen dhe c) ku bazohen. Pika 3 e nenit 4 jep sistemin e hetimeve financiare, penale, civile. Gjithashtu miratimi i këtij ligji solli

⁶⁹ Ligji Nr.9275, datë 16.9.2004, Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin Nr.7895, datë 27.1.1995 “Kodi penal i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar

⁷⁰ ligjin Nr. 9276, Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin 7905, datë 27.1.1995, “Kodi i procedurës penale i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar

⁷¹ Ligji Nr. 9284, datë 30.9.2004, “ Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar”, ndryshuar më vonë me ligjin Nr.10192, datë 3.12.2009, “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar dhe trafikimit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”.

⁷² Konventa e Palermos

⁷³ Konventa e Strasburgut

disa risi, në parandalimin e krimit, së pari përcaktoi rrethin e personave si pjesëmarrës në krim të organizuar, kompetencat institucionale, dhe kriteret e sekuestrimit dhe konfiskimit të pasurisë, së dyti përfshiu një koncept tjetër të sekuestrimit, atë të sekuestros paraprake⁷⁴, së treti trajtoi kalimin e barrës së proves⁷⁵, si edhe trajtoi përdorimin e aseteve kriminale duke u krijuar dhe një institucion i posaçëm që do të merrej me administrimin e aseteve kriminale dhe mënyrën e shpërndarjes së tyre. E parë në tërësi, sipas këtij ligji dhe ndryshimeve të bëra në kodin penal dhe atë procedural penal, hetimet financiare përfshijne tre faza si: *a) fazën hetuese, b) fazën gjyqësore dhe c) fazën e administrimit dhe përdorimit të aseteve kriminale*. Vështirësitë që u shfaqën në implementimin e ligjit përparandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, u shfaqën në disa drejtime: *Së pari* në kuptueshmërinë e termave të përdorura në këtë ligj, *së dyti*, në praktikën e hetimit dhe atë gjyqësore. Problemet e moskuptueshmërisë së termave, u bënë dhe objekt i shqyrtimit gjyqësor, (Çështja Troplini), ku Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, sipas vendimit Nr. 1, datë 25.1.2007, unifikoi dhe praktikën lidhur me disa çështje dhe konkretisht:

Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, në seancën gjyqësore të datës 25.10.2006, vendosi ta kalojë çështjen për gjykim në Kolegjet e Bashkuara, për të unifikuar praktikën gjyqësore lidhur me sqarimin dhe interpretimin e kuptimit të nenit 4, pika 3 dhe nenit 28, pika 1 të ligjit për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, si dhe iu dha përgjigje disa pyetjeve lidhur me procedurat dhe kompetencat e gjykatës, kuptimi dhe interpretimi i neneve 7 e 10 të këtij ligji, lidhur me sekuestrimin paraprak dhe sekuestrimin nese jane masa që duhet të zbatohen përpara konfiskimit ose mund të veprohet pavarësisht nga njëra tjetra.

⁷⁴ Neni 7 i ligjit Nr. 9284, datë 30.9.2004, “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar”

⁷⁵ Po aty: pika 2 e nenit 13

Vlen për tu theksuar se qendrimet e anëtarëve të Kolegjit, lidhur me interpretimin, u ndanë. Në këtë vendim u bashkëngjit dhe qëndrimi kundër, si mendim pakice. Nga ana tjetër, disa vendime gjyqësore të Gjykatës së Shkallës së Parë, për Krime të Rënda, u prishën nga Gjykata e Apelit. Sipas raportit vjetor 2008, të Gjykatës së krimeve të rënda thuhet se “lidhur me gjykimin e çështjeve me objekt “ Parandalimin e goditjen e krimit të organizuar“, ndihmesë të vecantë ka dhënë Vendimi Unifikues, nr. 1 datë 25.01.2007 i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, në të cilin jepen orientime të vlefshme kryesisht për unifikimin e praktikës gjyqësore që kanë të bëjnë me fazën e sekuestrimit të pasurive. Pra, në këtë vendim nuk janë trajtuar problemet e fazës së konfiskimit të ketyre pasurive të sekuestruara. Rastet e prishjes së vendimeve konsistojnë në procedurën e ndjekur për njoftimin e personit të paditur apo për thirrjen e personave të tretë në gjykim si palë që kanë interes për çështjen sipas nenit 193 të KPrC. Nga ana e gjykatës së Apelit disa vendime janë prishur dhe pasuria e konfiskuar sipas vendimit të Gjykatës së shkallës së parë është kthyer personit të dyshuar, me arsyetimin se ka kërkesa e organit të akuzës për konfiskim që janë paraqitur tej afatit 6 mujor që parashikon neni 7 pika 4 i ligjit 9284 datë 30.09.2004 “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar”. Ndonëse ende nuk kemi një qëndrim nga ana e Gjykatës së Lartë, mendojmë se Gjykata e Apelit ka vepruar në kundërshtim me frymën e ligjit të sipërcituar duke kuptuar afatet kohore të sekuestros paraprake, sipas nenit 7 të ligjit, si afate të sekuestros përfundimtare të pasurisë (GJKR, Raport vjetor , 2008).

Për këto arsye, ligji për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, tregoi se nuk ishte efikas. Praktika gjyqësore tregoi raste të revokimit, shurje të masave të përkohshme ndaj pasurisë dhe përfundimisht mos miratimin e pasave përfundimtare, konfiskimin e pasurisë. Një tjetër pengesë e zbatimit të këtij ligji ishte dhe standarti i provës. Shprehja “dyshim i

arsyeshëm i bazuar në prova”, ishte standart i lart i të provuarit. Ky standart e bën jo eficient zbatimin e ligjit, jo vetëm ndaj personit nën hetim apo të pandehurit, sidomos dhe ndaj personave a) personave të afërm (bashkëshorti, fëmijët, të paralindurit, të paslindurit, vëllezërit, motrat, ungjërit, emta, nipërit, mbesat, fëmijët e vëllezërve dhe të motrave, vjehrra, vjehrra, dhëndri, nusja, kunata, kunati, bashkëjetuesi, thjeshtri, thjeshtra, njerku dhe njerka) të subjekteve të pikës 1 të këtij neni; b) personave fizikë ose juridikë, për të cilët ka të dhëna të mjaftueshme se pasuritë ose veprimtaritë e tyre zotërohen, pjesërisht ose plotësisht, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, a janë përdorur, kanë lehtësuar apo në një formë kanë ndikuar në kryerjen e veprimtarive të jashtëligjshme nga personat e parashikuar në pikën 1 të këtij neni. ndaj trashëgimtarëve të personit, subjekt i zbatimit të këtij ligji, por, në çdo rast, jo më vonë se 5 vjet nga data e vdekjes. të përcaktuar në pikën 2 të nenit 3 të ligjit, si rrethi i personave të dyshuar, duke sjellë dhe një problem tjetër, pasi nëse gjenden prova, statusi procedural penal i tyre do të ndryshonte.

Ky konfliktualitet në qëndrimet që mbaheshin nga prokurorët si dhe praktika gjyqësore, solli domosdoshmërinë e rishikimit të ligjit. Për këtë arsye, edhe me konsulencën e ekspertëve të BE-së dhe KE-së, u përgatit dhe miratua nga legjislativi, ligji Nr.10192, datë 3.12.2009, “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar dhe trafikimit nëpërmjet masave parandaluese kundër konfiskimit”, i cili solli disa ndryshime:

Në fushën e zbatimit të këtij ligji u përfshinë dhe tre vepra të tjera penale, prodhimi dhe shitja e narkotikëve parashikuar nga 283, shfrytëzimi i prostitucionit në rrethana rënduese, parashikuar nga 114/a dhe pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale, parashikuar nga neni 287 të Kodit Penal, të cilat nuk përfshiheshin në ligjin e mëparshëm, u dha kuptimi i konceptit “masë parandaluese” (neni 4 i ligjit), u përcaktua marrdhënja me

procedimin penal (neni 5 i ligjit), u përcaktua kompetenca dhe përbërja e gjykatës (neni 7 i ligjit), përcaktoi procedurat dhe afatet e sekuestrimit të pasurisë (neni 12 i ligjit dhe ndryshoi standartin e provës duke e ulur atë nga *“dyshim i arsyeshëm i bazuar në prova”*, në *“dyshim i arsyeshëm i bazuar në indicje”*.

Nevoja e rritjes së efencës ndaj krimit ekonomik dhe financiar diktoi nevojën e ndryshimeve ligjore dhe institucionale. Në aspektin institucional, gjatë vitit 2003, u miratua ligji nr.9110, datë 24.7.2003, *“Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave për krime të rënda”*. Ky ligj ka për qëllim organizimin dhe funksionimin e gjykatave për krimet e rënda, me synim rritjen e efektivitetit të luftës kundër krimit të organizuar dhe krimeve të rënda, si dhe përmirësimin e cilësisë së gjykimit të tyre⁷⁶. Me 1 tetor 2004, në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë, u krijua Drejtoria e Luftës Kundër Krimit të Organizuar, e cila në përbërjen e saj kishte sektorët e luftës kundër drogës, sektorin e luftës kundër trafikëve të paligjshme, dhe sektorin e luftës kundër krimit ekonomik financiar, korrupsionit dhe pastrimit të parave.

Krijimi i bazës ligjore, ndryshimet në Kodin Penal dhe Kodin e Procedurës Penale, miratimi i ligjeve specifike, siç ishte ligji Antimafia, për marrjen e masave kundër pasurisë, krijimi i disa institucioneve si Gjykata e Krimeve të Rënda, Prokuroria e Krimeve të Rënda, Drejtoria për Parandalimin e Pastrimit të Parave, Agjensia e Menaxhimit të Aseteve të Sekuestruara dhe të Konfiskuara, krijuan dhe një qasje të re në luftën kundër krimit dhe parandalimit. Megjithatë pritshmëritë e rezultateve, referuar raporteve vjetore dhe statistikave të Prokurorisë, Gjykatës dhe Agjensisë së menaxhimit të asetëve, nuk ishin rezultative. Kjo për disa arsye, *së pari*, legjislacioni ishte i marrë nga konventat dhe shumë terma nuk

⁷⁶ Neni 1, i ligjit nr.9110, datë 24.7.2003, *“Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave për krime të rënda”*

kuptoheshin, dhe në disa raste kanë qenë dhe objekt i shqyrtimit nga gjykatat, *së dyti*, trajnimi i prokurorëve dhe gjyqtarëve ishte në fillimet e tij, dhe nevoja për trajnim ishte e nevojshme, *së treti*, nevoja për burime njerëzore dhe materiale, si dhe lëvizjet pa kriter të punonjesve, mbetet sfidë e qeverive. Mosekzistenca e një banke të dhënash kombëtare, e vështirëson hetimin financiar dhe mundësinë e konfiskimit të pasurive kriminale. Ekonomia informale dhe korrupsioni, vlerësohen si pengesat kryesore për hetimet financiare dhe konfiskimin.

3.4 Përmbledhje e kapitullit

Në këtë kapitull trajtohen tre çështje kryesore, kuptimi i hetimit financiar, nocioni i krimeve që sjellin dobi pasurore dhe ndryshimet ligjore e institucionale që ka sjellë ligji për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, pas vitit 2004 në Shqipëri. Përpara hyrjes në fuqi të këtij ligji, nuk kryheshin veprime për hetime financiare por ka patur raste të sekuestrimit dhe konfiskimit të mjeteve të kryerjes së veprës penale dhe produkteve të tyre në mbështetje të dispozitave të Kodit penal dhe procedural penal shqiptar. Konfiskimi i produkteve bëhej vetëm si dënim plotesues dhe jo si masë për parandalimin dhe goditjen e krimit në kuptimin që solli ligji për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar. Hyrja në fuqi e ligjit për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar ndryshoi qasjen ndaj luftës kundër krimit nga *in personam*, në *in rem*. Ndryshimi i qasjes solli dhe krijimin e institucioneve të reja në luftën kundër krimit të organizuar, duke u krijuar Gjykata e Krimeve të Rënda⁷⁷, Prokuroria e Krimeve të Rënda dhe Agjencia e Menaxhimit të Aseteve të

⁷⁷ Ligji nr. 9110 datë 24.07.2003 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatave për Krimet e Rënda"

Sekuestruara dhe të Konfiskuara⁷⁸. Lufta kundër krimit të rëndë e atij të organizuar, përbën tashmë një fazë të rëndësishme të zhvillimit shoqëror të shoqërisë shqiptare e sistemit të drejtësisë në veçanti. Në këtë kontekst, viti 2004 solli një ndryshim të rëndësishëm në sistemin tonë gjyqësor, krijimin dhe funksionimin e një hallke të re brënda këtij sistemi siç është Gjykata për Krime të Rënda. Kjo është dhe arsyeja pse periudha e studimit fillon prej vitit 2004 deri në vitin 2014. Në këtë këndvështrim ky kapitull studion zhvillimin e tre çështjeve të mësipërme, kuptimit të hetimit financiar, nocioneve të krimeve që sjellin dobi pasurore dhe efektet që solli zbatimi i këtij ligji në praktikë.

Hetim financiar janë procedurat që kryhen për identifikimin, gjurmimin, zbulimin me qëllim sekuestrimin e më pas konfiskimin të produkteve që rrjedhin nga veprimtaria kriminale. Për të dhënë një kuptim të plotë të hetimit financiar në këtë kapitull janë trajtuar çështje të rëndësishme si ndaj kujt behen hetimet financiare, për çfarë behen, lidhur me se bëhen hetimet financiare, si edhe çfarë kuptojme, ku gjenden, si merret informacioni, dhe cila është baza ligjore për kategoritë si mjete financiare, pasuri, veprimtari ekonomike, mënyra e jetesës, niveli ekonomik dhe burimet e të ardhurave. Trajtimi në këtë mënyrë i kategorive të mësipërme jep një kuptim të plotë për masat që duhet të merren për hetimet financiare, vështirësitë ligjore, institucionale dhe operacionale, të cilat trajtohen si konkluzione në fund të punimit duke dhënë dhe rekomandime konkrete për ndryshimin e tyre.

Në aspektin ligjor, ligji për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, solli një risi në parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar. Por nëse i referohemi ndryshimeve që pësoi

⁷⁸ Ligji nr. 9284, datë 30.09.2004 “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar”, Kap.IV, Administrimi i pasurive të sekuestruara.

ky ligj në vitin 2009⁷⁹ dhe në vitin 2014⁸⁰, kuptimi i termave kishte nevojë për interpretim, interpretim ky që u bë dhe objekt i shqyrtimit nga Gjykata Kushtetuese dhe Gjykata e Lartë⁸¹. Objekti i ligjit ndryshoi jo vetëm për personat të përfshirë në krim të organizuar, por edhe për personat e dyshuar për trafikim dhe korrupsion. Zgjerimi i veprave penale, si edhe zgjerimi më vonë dhe përfshirja e të gjithë veprave që sjellin dobi pasurore të paligjshme të trajtuara në këtë kapitull e vështirëson punën e organeve dhe strukturave që merrn me hetimet financiare, duke sjellë si domosdoshmëri rishikimin e krijimit ose ristrukturimit të strukturave, agjencive ligjzbatuese, me qëllim rritjen e efektivitetit të tyre në parandalimin dhe luftën kundër krimit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë.

Gjithashtu, kryerja e hetimeve në veçanti për çdo person i përcaktuar në rrethin e personave, subjekte të ligjit⁸², është një vështirësi tjetër e evidentuar në këtë studim.

⁷⁹ Ligj nr. 10192, date 3.12.2009, “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar dhe trafikimit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”

⁸⁰ Ligj nr. 24/2014, “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.10192, date 3.12.2009, “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar dhe trafikimit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”

⁸¹ Vendimi Nr. 1, datë 25.1.2007, Gjykata e Lartë, Tiranë.

⁸² Neni 3 i ligjit nr. 10192, date 3.12.2009, “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar dhe trafikimit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”, ndryshuar me ligjin 24/2014

KAPITULLI IV: TEORITË DHE INSTRUMENTET JURIDIKË MBI HETIMET FINANCIARE DHE KONFISKIMIN E PRODUKTEVE TË KRIMIT

4.1 Pikëpamjet mbi hetimet financiare dhe konfiskimin

Në artikullin e Tij, “*Perspektiva mbi konfiskimin civil*”, Jeffrey Simser argumenton se konfiskimi i aseteve është një mjet i projektuar për të rimarrë të ardhurat nga veprimtari të paligjshme, dhe se perspektiva e tyre është konfiskim civil. Lexo argumentin e Tij si më poshtë:

Ekzistojnë dy shkaqe të politikave për konfiskimin civil. *Së pari*, fitimet nga veprimtari të paligjshme nuk duhet të rriten dhe të grumbullohen në duart e atyre që kryejnë veprimtari të paligjshme. Në rastet e mashtrimit dhe vjedhjes, të ardhurat duhet të shpërndahen përsëri për viktimat. *Së dyti*, shteti si një çështje e politikës dëshiron për të shtypur kushtet që çojnë në aktivitete të paligjshme. Fitimet e drogës gjithashtu paraqesin kapitalin për më shumë transaksione të drogës, të cilat mund të sjellin dëm të mëtejshëm shoqërisë. (Simon N.M.Young, 2009, p. 13).

Konfiskimi i aseteve është një mjet korrigjues i krijuar për të rimarrë të ardhurat nga veprimtari të paligjshme, si dhe prona që përdoren për të lehtësuar veprimtarinë e paligjshme. Në përgjithësi, shteti sjell një procedurë kundër pasurisë (*in rem*) se sa kundër individëve. Në rastin e të ardhurave nga veprimtari të paligjshme, gjykata është e ftuar për të pyetur për origjinën e pasurisë⁸³. Në qoftë se prejardhja e titullit qëndron në veprimtari të paligjshme, dhe shteti provon këtë, atëherë gjykata ka të drejtë të transferojë titullin për shtetin. Në rastin e pronave të përdorura për të lehtësuar veprimtarinë e paligjshme, gjykates

⁸³ Neni 10 i ligjit nr. 10192, date 3.12.2009, “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar dhe trafikimit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”, ndryshuar me ligjin 24/2014

i kërkohet të hetojë në përdorimin e pronës, nëse kjo pronë duhet të konfiskohet për të parandaluar lehtësimin e mëtejshëm të aktivitetit të paligjshëm?

Ka shumë arsye për të përfshirë konfiskimin e aseteve si pjesë e një çështjeje penale. *Së pari*, agjentët e zbatimit të ligjit dhe prokurorët duan jo vetëm për të arrestuar keqbërësin dhe të futin në burg për një periudhë kohe, por edhe për të hequr mjetet e krimit nga qarkullimi në mënyrë që ata nuk mund të përdoren përsëri, qoftë nga keqbërësi vetë, dikur ai fiton lirimin e tij, ose anëtarët e organizates së tij. Kështu, organeve të zbatimit të ligjit do t'u duhen për të kapur armë, aeroplanë dhe makina të fshehura që janë përdorur për trafik droge, ose për të marrë kompjutera, printera dhe pajisje të tjera elektronike që përdoren në pornografinë e fëmijëve, falsifikimit dhe mashtrimit, shtëpitë ku droga shpërndahet për fëmijët, për konfiskimin e fermës e cila është përdorur për rritjen e marihuanës dhe për të mbyllur biznesin e përdorur për të kryer mashtrim të sigurimit, mashtrim marketingu ose për të drejtuar një skeme Ponzi. *Së dyti*, në çdo rast kur krimi përfshin viktimat e pafajshme, të tilla si vepra të pronës dhe mashtrimit, konfiskimin e aseteve rezulton të jetë mjeti më efektiv të kthimin e pronave që mund të përdoren për të kompensuar viktimat. Në të vërtetë, restaurimi i pasurisë së viktimave në rastin e jakave të bardha është cilësuar si parësor në zbatimin e ligjit, kur është fjala për disbursim pasuritë e konfiskuara. *Së treti*, konfiskimin e aseteve përfshin dhe fitimin nga krimi. Natyrisht, nuk është një element i drejtësisë të thjeshtë për të siguruar që një keqbërës është i privuar nga frutat e veprave të tij të paligjshme. Por ka edhe një element i parandalimit të përgjithshëm. Me siguri nxitja për t'u angazhuar në krimin ekonomik zvogëlohet, në qoftë se njerëzit kuptojnë se ka një mundësi të lartë që ata nuk do të lejohen të mbajnë çdo fitim që mund të rrjedhin nga suksesi i tyre i përkohshëm. Në anën tjetër, dënimi i të pandehur, por duke e lënë atë në posedim të

pasurisë së përfituar në mënyrë të paligjshme, jep një mesazh negativ tek të tjerët, përderisa ai jeton në formë lluksoze. Është edhe çështja e mesazhit që është dërguar për komunitetin e qytetarëve⁸⁴.

Siç shihet, konfiskimi i produkteve të krimit gjithnjë e më shumë po bëhet si formë e rëndësishme e luftës dhe parandalimit të krimit. E ardhmja e regjimit të konfiskimit që duhet të përdoret është konfiskimi civil dhe konfiskimi penal.

4.2 Instrumentet juridikë mbi hetimet financiare

Aktet juridike ndërkombëtare janë të shumta në luftën kundër kriminalitetit. Ky nënkapitull do të fokusohet në aktet juridikë ndërkombëtarë që kanë të bëjnë vetëm me masat repressive dhe preventive lidhur me hetimet financiare. Hetimi financiar nuk ka një përkufizim definitiv, dhe një nga arsyet e mosëficencës është dhe moskuptimi i drejtë i kësaj procedure. Referuar literaturës dhe autorëve të ndryshëm për këtë fushë, mund të arrijmë në një përkufizim për hetimet financiare si procedura për identifikimin e ekzistencës së veprave penale që krijojnë produkte krimi, identifikimi i produktit të krimit, përcaktimi i pasurive të autorëve të krimeve apo të afërmeve të tyre, mjetet e jetesës, aktivitetet ekonomike, tregtare e profesionale, burimet e të ardhurave, me qëllim sekuestrimin dhe konfiskimin e pasurisë si produkt të veprës penale. Instrumentet juridikë në luftën kundër krimit të organizuar dhe atij transnacional, dhe në veçanti për hetimet financiare vijnë nga disa burime kryesore si:

a) burime ndërkombëtare në të cilat përfshihen 1) Konventat e Vjenës, 2) Konventa e Strasburgut, 3) Konventa e Palermos, 4) Konventa e Varshavës, të cilat do të trajtohen në

⁸⁴ Simon N.M.Young, 2009, An overview on assets seized in US, fq. 33

këtë nënçështje, b) burime regjionale, si marrveshje multilaterale dhe bilaterale ndërmjet shteteve dhe c) e drejta e brendshme, Kodi penal, Kodi i procedurës penale, Kodi civil, Kodi i procedurës civile, si dhe ligjet e veçanta siç është i ashtuquajturi ligji Antimafia, të cilat do të trajtohen në vijim. Këta instrumente ndërkombëtare dhe kombëtare janë analizuar në fushën e konfiskimit të pasurisë që rrjedh nga krimi, duke u fokusuar dhe në efikasitetin e zbatimit të tyre në Shqipëri, për periudhën 2004-2012. Ratifikimi apo aderimi në Konventa ndërkombëtare, bazuar në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, nenet 5, 116 pika 1 gërma b dhe 122 pika 1, ku thuhet: Çdo marrëveshje ndërkombëtare e ratifikuar përbën pjesë të sistemit të brendshëm juridik pasi botohet në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë. Ajo zbatohet në mënyrë të drejtpërdrejtë, përveç rasteve kur nuk është e vetëzbatueshme dhe zbatimi i saj kërkon nxjerrjen e një ligji⁸⁵.

4.2.1 Instrumentet juridikë ndërkombëtarë

Instrumentet më të rëndësishme juridike ndërkombëtare, të cilat kanë shërbyer edhe për ndryshimet në të drejtën e brendshme penale dhe civile të shteteve janë: konventa e Kombeve të Bashkuara kundër trafikut të paligjshëm të drogave narkotike dhe lëndëve psikotrope⁸⁶, konventa mbi pastrimin, depistimin, kapjen dhe konfiskimin e produkteve të krimit⁸⁷, konventa e Kombeve të Bashkuara kundër krimit të organizuar ndërkombëtar⁸⁸, konventa e Këshillit të Europës për pastrimin, kërkimin, kapjen dhe konfiskimin e produkteve të krimit dhe financimin e terrorizmit⁸⁹. Kontributi i këtyre konventave në parandalimin dhe luftën

⁸⁵ Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë

⁸⁶ Konventa e Vjenës, 1988

⁸⁷ Konventa e Strasburgut, 1990

⁸⁸ Konventa e Palermos, 2000

⁸⁹ Konventa e Varshavës, 2006

kundër krimit në përgjithësi dhe krimit të organizuar, trafikimit, terrorizmit dhe pastrimit të parave në veçanti fokusohet në përkufizimet, masat, mjetet, sanksionet dhe bashkëpunimin institucional dhe ndërkombëtar. Një kontribut të veçantë japin për përdorimin e metodave të reja në parandalimin dhe luftën kundër krimit duke përdorur metoda indirekte të të provuarit nëpërmjet hetimeve financiare dhe duke kaluar barrën e provës tek i dyshuari. Një analizë më të thellë bëhet në nënçështjet e këtij kapitulli.

4.2.1.1 Konventa e Vjenës

Republika e Shqipërisë me ligjin Nr.8722, datë 26.12.2000, ka aderuar në “Konventen e Kombeve të Bashkuara kundër trafikut të paligjshëm të drogave narkotike dhe lëndëve psikotrope”, Konventa e Vjenës⁹⁰.

Konferenca e Kombeve të Bashkuara, më 20 Dhjetor 1988 miratoi tre rezoluta si: shkembimi i informacionit⁹¹, zbatimi i përkohshëm i konventës së Kombeve të Bashkuara kundër trafikut të paligjshëm të drogave narkotike dhe lëndëve psikotrope⁹², sigurimi i burimeve të nevojshme për seksionin e drogave narkotike dhe për sekretariatin e bordit ndërkombëtar të kontrollit të narkotikëve me qëllim që ata të mundësohen të kryejnë detyrat që u janë besuar në bazë të traktateve ndërkombëtare të kontrollit të drogës⁹³.

Konventa vlerëson se përmasat dhe tendenca në rritje e prodhimit të paligjshëm të drogave narkotike dhe lëndëve psikotrope, të kërkesave për to dhe të trafikut të tyre, përbëjnë një kërcënim serioz për shëndetin dhe mirëqenien e qenieve njerëzore dhe ka ndikim të pafavorshëm ndaj themeleve ekonomike, kulturore dhe politike të shoqërisë. Lidhjet midis

⁹⁰ FZ 50/ 2001 marre nga permbledhesja e legjislacionit fq. 2156

⁹¹ Rezoluta 1

⁹² Rezoluta 2

⁹³ Rezoluta 3

trafikut të paligjshëm dhe veprimtarive të tjera të krimit të organizuar minojnë ekonominë legjitime dhe kërcënojnë stabilitetin, sigurinë dhe sovranitetin e shteteve. Trafiku i paligjshëm është një veprimtari ndërkombëtare kriminale, ndalimi i së cilës kërkon vëmendje urgjente dhe përparësinë më të lartë. Trafiku i paligjshëm sjell përfitime të mëdha financiare dhe pasuri që i mundësojnë organizatat kriminale midis shteteve të depertojnë, të ndotin dhe të korruptojnë struktura të qeverisë, biznesin e ligjshëm tregtar dhe financiar dhe shoqërinë në të gjitha nivelet e saj, kërkojnë marrjen e masave për t'i privuar personat që merren me trafik të paligjshëm nga fitimet që sjellin veprimtaritë të tyre kriminale duke eliminuar kështu stimulën e tyre kryesor që i nxit në këto veprimtari. Konventa pranon se zhdukja e trafikut të paligjshëm është një përgjegjësi kolektive e të gjitha Shteteve dhe se, për këtë qëllim, nevojitet një veprim i bashkërenduar në kuadrin e bashkëpunimit ndërkombëtar si forcimin dhe rritjen e mjeteve efektive ligjore për bashkëpunimin ndërkombëtar në çështje kriminale për të ndaluar veprimtaritë kriminale ndërkombëtare të trafikut të paligjshëm⁹⁴.

Konventa shpreh lidhjet e trafikut me krimin e organizuar, trafiku i paligjshëm sjell përfitime të mëdha financiare dhe pasuri që i mundësojnë organizatat kriminale midis shteteve të depertojnë, të ndotin dhe të korruptojnë struktura të qeverisë, biznesin e ligjshëm tregtar dhe financiar dhe shoqërinë në të gjitha nivelet e saj, si dhe nevojën për bashkëpunim ndërkombëtar, për perballimin e krimit. Në nenin 1 gërma: (f) përkufizohet "*Konfiskimi*", që përfshin gjobën atje ku është e zbatueshme, nënkupton marrjen e përhershme të pasurisë me urdhër të gjykatës ose të një autoriteti tjetër kompetent; "*Ngrirje*" ose "*kapje*"

⁹⁴ Konventa e Vjenës, 1998

nënkupton ndalimin e përkohshëm të transferimit, shkëmbimit, sistemimit ose lëvizjes së pasurisë ose marrjen përkohësisht nën kujdestari ose nën kontroll të pasurisë në bazë të një urdhri të lëshuar nga gjykata ose një autoritet kompetent; "*Fitime*" nënkupton çdo lloj pasurie që rrjedh ose përfitohet, drejtpërsëdrejti ose tërthorazi, nga kryerja e një veprimtarie të kundërligjshme e parashikuar në përputhje me nenin 3, paragrafi 1; "*Pasuri*" nënkupton pasuri të çdo lloji, fizike ose jo, të tundshme ose të patundshme, të prekshme ose jo, dhe dokumentet ligjore ose dokumentet që vërtetojnë të drejtën ndaj këtyre pasurive ose interesin në to. Qëllimi i konvëntës është në dy drejtime kryesore:

Së pari, nxitja e bashkëpunimit ndërkombëtar, në mënyrë që ato të mund t'i trajtojnë në mënyrë më të efektshme aspektet e ndryshme të trafikut të paligjshëm të drogave narkotike dhe lëndëve psikotrope që ka marrë përmasa ndërkombëtare dhe *Së dyti*, për të marrë masat e nevojshme, duke përfshirë masa legislative dhe administrative, në përputhje me dispozitat themelore të sistemeve ligjore respektive të vendeve të tyre.

Rekomandoi penalizimin e veprimtarive që kanë të bëjnë me përpjekjet për fshehjen e burimeve të paligjshme të pasurisë. Në nenin 3, parashikohet penalizimi i veprimtarive si:

- (i) shkëmbimin ose transferimin e pasurive duke ditur se këto pasuri kanë rrjedhur nga një veprimtari të kundërligjshme ose veprimtari të kundërligjshme të parashikuara në përputhje me nënparagrafin (a) të këtij paragrafi ose nga akti i pjesëmarrjes në një veprimtari të kundërligjshme ose veprimtari të kundërligjshme të tilla, me qëllimin e fshehjes ose mbulimit të origjinës së paligjshme të pasurive ose me qëllimin e dhënies së ndihmës ndonjë personi që është përfshirë në kryerjen e një veprimtarie të kundërligjshme ose veprimtarive të kundërligjshme të tilla, për t'iu shmangur pasojave ligjore të veprimeve të tij;
- (ii) fshehjen ose mbulimin e natyrës së vërtetë, burimit, vendndodhjes, sistemimit, lëvizjes, të të drejtave në lidhje me pasurinë ose pronësinë e pasurisë, duke ditur se një pasuri e tillë ka rrjedhur nga një veprimtari e kundërligjshme ose veprimtari të kundërligjshme të parashikuara në përputhje me nënparagrafin (a) të këtij paragrafi ose nga akti i pjesëmarrjes në një veprimtari të kundërligjshme ose veprimtari të kundërligjshme të tilla.

Gjithashtu konventa parashikon se kryerja e veprimtarive të kundërligjshme të parashikuara në përputhje me paragrafin 1 të këtij neni, t'i nënshtrohet sanksioneve që llogarisin natyrën e

rëndë të këtyre veprimtarive të kundërligjshme, siç janë burgimi ose forma e tjera të heqjes së lirisë, sanksione financiare dhe konfiskimi. Në nenin 5, parashikohen masat që secili shtet duhet të marrë për të mundësuar konfiskimin: a) fitimeve që rrjedhin nga veprimtari të kundërligjshme të parashikuara në përputhje me nenin 3 paragrafi 1, ose të pasurive, vlera e të cilave korrespondon me vlerën e këtyre fitimeve; b) drogave narkotike dhe lëndëve psikotrope, materialeve dhe pajisjeve ose mjeteve të tjera që janë përdorur ose që synojnë të përdoren në çfarëdo mënyre në veprimtaritë e kundërligjshme të parashikuara në përputhje me nenin 3 paragrafi 1. Në pikën 2 të nenit 5 të konventës jepet koncepti për hetimin financiar si procesi i identifikimit, gjurmimit, ngrirjes së fitimeve, pasurive, mjeteve ose çdo gjë tjetër që i referohet pikës 1 të këtij neni me qëllimin e një konfiskimi të mundshëm. Gjithashtu adreson çështjen e dhënjes fuqi të plotë gjykatave ose autoriteteve të tjera kompetente që të urdhërojnë që dokumentacioni bankar, financiar se tregtar të vihet në dispozicion ose të shtihet në dorë. Pala nuk duhet të refuzojë që të veprojë në bazë të dispozitave të këtij paragrafi për arsye të sekretit bankar. Mënyra e përdorimit të pasurive të sekuestruara përcaktohen në pikën 5, gërma b, të këtij neni ku thuhet se kur vepron me kërkesën e një pale tjetër në përputhje me këtë nen, pala mund t'i kushtojë vëmendje të veçantë lidhjes së marrëveshjeve për:

- (i) dhënien e vlerës së këtyre fitimeve dhe pasurive, ose fondeve, që rrjedhin nga shitja e këtyre fitimeve ose pasurive, ose një pjese të rëndësishme të tyre, organeve ndërqeveritare që specializohen në luftën kundër trafikut dhe përdorimit të paligjshëm të drogave narkotike dhe lëndëve psikotrope;
- (ii) ndarjen me palët e tjera, në baza të rregullta ose rast pas rasti, të këtyre fitimeve, pasurive ose fondeve që rrjedhin nga shitja e këtyre fitimeve ose pasurive, në përputhje me ligjin e saj vendas, procedurat administrative, marrëveshjeve dypalëshe ose shumëpalëshe të lidhura për këtë qëllim.

Konfiskimi i vlerës së njëjte me vlerën e fitimeve të transferuara, shndërruara ose përyerë me pasuri të tjera parashikohet në përmbajtjen e pikës 6 të nenit 5 të konventës e cila

përcakton se: (a) kur fitimet janë transformuar ose shndërruar në pasuri të tjera, këto pasuri duhet t'u nënshtrohen masave të cilave iu referohet në këtë nen në vend të fitimeve, (b) kur fitimet janë përzier me pasuri të përftuara nga burime të ligjshme, këto pasuri duhet, pa marrë parasysh asnjë lloj vendimi tjetër në lidhje me kapjen ose ngrirjen, t'i nënshtrohen konfiskimit deri në vlerësimin e vlerës së fitimeve të përziera me to. Një çështje me rëndësi është përmbysja e barrës së provës. Në pikën 7 të nenit 5 parashikohet se: secila palë duhet të ketë parasysh se mund të ndodhë një përmbysje e vlerësimit të provave në lidhje me origjinën e ligjshme të fitimeve ose pasurive të tjera të deklaruara që i nënshtrohen konfiskimit, në atë masë që ky veprim të jetë në përputhje me parimet e ligjit të vendit të vet dhe me natyrën e procedurave gjyqësore dhe procedurave të tjera.

Kontributi i Konventës së Vjenës, lidhur me hetimet financiare dhe konfiskimin e produkteve të krimit, mund ti përmbledhim në disa drejtime si: përkufizimin e termave, konfiskim, ngrirje ose kapje, fitim dhe pasuri; përkufizimin e veprës penale të pastrimit të produkteve të veprës penale; konfiskimi në vlerë; përmbysja e barrës së provës; çështjen e sekretit bankar, si pengesë për informacionet lidhur me mjetet financiare; koncepti mbi hetimet financiare, si procedurë për identifikimin, zbulimin, kapjen, ngrirjen, sekuestrimin dhe konfiskimin, duke dhënë në formë të plotë elementet e hetimit financiar në të gjitha fazat e tij. Lidhur me hetimet financiare, Konventa e Vjenës, qartësoi çështje të rëndësishme, lidhur me përkufizimin e termave, pastrimin e produkteve të veprës penale dhe mënyrën e shpërndarjes ndërmjet palëve të përfshira në krim transnacional. Rekomandimet e kësaj konvente shërbyen për ndryshimin e të drejtave të brendshme të shteteve palë, lidhur me penalizimin e veprës penale të pastrimit të parave, por dhe për ndryshimin e procedurave për çështje të rëndësishme si konfiskimi në vlerë, përmbysja e barrës së provës, masat për heqjen

e sekretit bankar si pengesë në identifikimin dhe kapjen e mjeteve financiare, si edhe ka dhënë elementet dhe fazat e hetimit financiar që nga zbulimi i pasurive kriminale deri në konfiskimin e tyre. Konventa e Vjenës, kufizohet në pastrimin e produkteve të veprës penale, të siguruara në fushën e trafikut të drogës, duke mos përfshire vepra të tjera penale të cilat sigurojnë dobi pasurore të paligjshme, si evazioni, korrupsioni, mashtrimet financiare, etj.

4.2.1.2 Konventa e Strasburgut

Me ligjin nr. 8646, datë 20.7.2000, Republika e Shqipërisë, ratifikoi Konventën Europiane “Për pastrimin, depistimin, kapjen dhe konfiskimin e produkteve të krimit”.

Konventa e Strasburgut çmon se një nga metodat moderne dhe efikase në shkallë ndërkombëtare, kundër kriminalitetit të rëndë, i cili është bërë gjithnjë e më shumë problem ndërkombëtar, konsiston në privimin e krimineleve nga produktet e krimit.

Konventa qartëson definicionet e termave kryesore të metodës së privimit të krimineleve nga produktet e krimit. Neni 1 i Konventës jep kuptimin e termave si:

- a. “*produkt*”, tregon çdo avantazh ekonomik të nxjerrë nga veprat penale. Ky avantazh mund të konsistojë në çdo pasuri ashtu siç përcaktohet në nënparagrafin b të këtij neni;
- b. “*pasuri*”, do të thotë pasuri të çdo natyre, qoftë trupore ose jotrupore, e luajtshme ose e paluajtshme, si dhe aktet juridike ose dokumentet që vërtetojnë një titull ose një të drejtë mbi këtë pasuri;
- c. “*instrument*”, do të thotë të gjitha objektet e përdorura ose të destinuara për t’u përdorur me çfarëdo mënyre qoftë, plotësisht ose pjesërisht, për të kryer një ose disa vepra penale;

d. “*konfiskim*”, do të thotë dënim ose masë e urdhëruar nga një gjykatë pas një procedimi lidhur me një ose disa vepra penale, dënim ose masë që përfundon me privimin e përhershëm të pasurisë;

e. “*vepër penale kryesore*”, do të thotë çdo vepër penale në vijim të së cilës janë krijuar produkte dhe që mund të bëhen objekt i një vepre penale sipas nenit 6 të kësaj Konvente.

Konventa rekomandon marrjen e masave hetimore dhe masat e perkohshme, dhe kompetencat dhe teknikat e hetimit. Sipas nenit 4 pika 2 e Konventes, parashikohet që çdo palë merr parasysh të përshtasë masat ligjore dhe masat e tjera për t’i lejuar asaj përdorimin e teknikave speciale të hetimit që lehtësojnë identifikimin dhe kërkimin e produktit si dhe grumbullimin e provave që kanë të bëjnë me të. Ndër këto teknika, mund të përmenden urdhërat për mbikqyrjen e llogarive bankare, vrojtimi, kapja e telekomunikimeve, hyrja në sistemet informatike dhe urdhërat për të lëshuar dokumente specifike⁹⁵.

E rëndësishme në këtë konventë është fakti që është kërkuar kriminalizimi dhe është dhënë përkufizimi i veprës penale të pastrimit të parave, përdorimi i mjeteve speciale të hetimit, dhënja e kompetencave organeve të zbatimit të ligjit për sekretin bankar, si edhe zgjerimi i veprave penale për të cilat mund të bëhet konfiskimi i produkteve të krimit, ose i pasurive, vlera e të cilave u përket këtyre produkteve, duke kaluar kështu nga konfiskim i ngushtë në konfiskim të zgjeruar, duke u shtuar kështu rrethi i personave të dyshuar si dhe numri i veprave penale, për të cilat mund të përdoret masa e konfiskimit. Vepra penale e pastrimit parashikohet në nenin 6 të Konventës, qartëson përkufizimin e veprës penale të pastrimit të parave, si edhe duke rekomanduar dhe masat për realizimin dhe zbatimin e këtij neni

⁹⁵ Neni 4 pika 2 Konventa e Strasburgut, 1990

nëpermjet rrethanave objektive të zbulohet qëllimi dhe pasja dijeni, dashja, elemente thelbësor i kësaj vepre penale. Në paragrafin 1, të nenit 6 të konventës kërkohet përshtatja e masave ligjore dhe masave të tjera që rezultojnë të nevojshme për t'i atribuar aktit karakterin e veprës penale konform të drejtës së brendshme kur akti është kryer qëllimisht⁹⁶ për: a) kthimin ose transferimin e pasurive, për të cilat, ai që i bën, e di që këto pasuri përbëjnë produkte me qëllim që të fshihet ose të maskohet origjina e paligjshme e pasurive të tilla ose që ndihmon çdo person që është i ngatërruar në kryerjen e veprës penale kryesore për t'u shpëtuar pasojave juridike të akteve të tij; b) fshehja ose maskimi i natyrës, origjinës, vendndodhjes, disponimit, zhvendosjes ose pronësisë reale të pasurive ose të drejtave të lidhur me to, për të cilat autori është në dijeni që këto pasuri përbëjnë produkte; dhe, me rezervën e parimeve kushtetuese të saj dhe të koncepteve themelore të sistemit juridik; c) të fituarit, mbajtja ose përdorimi i pasurive, të cilat, ai që i fiton, i mban ose i përdor, është në dijeni, në kohën kur ai i merr, se ato përbëjnë produkte; d) pjesëmarrja në njërën nga veprat penale të treguara konform këtij neni ose çdo shoqërim, marrëveshje, tentativë ose bashkëpunim me anë të dhënies të pranisë, të ndihmës ose të këshillave për kryerjen. Konventa Europiane, Strasburg, 08.11.1990, “Mbi pastrimin, depistimin, kapjen dhe konfiskimin e produkteve të krimin”, përfaqëson një hap të rëndësishëm për kriminalizimin si vepër penale më vete në të drejtën e brendshme, pastrimin e parave. Ndryshe nga Konventa e Vjenës, e cila e trajtonte pastrimin e parave të lidhur vetëm me trafikun e drogës, Konventa Europiane e trajton pastrimin e parave si një vepeër kryesore, si

⁹⁶ Neni 6, pika 1 e Konventës së Strasburgut, 1990

një krim më vehte. Konventa Europiane, objekt te veprës penale të pastrimit, konsideron të ardhurat që vijnë nga një grup i gjerë shkeljesh penale⁹⁷.

Vepra bazë e aktit është kthimin ose transferimin e pasurive⁹⁸, fshehja ose maskimi i natyrës, origjinës, vendndodhjes, disponimit, zhvendosjes ose pronësisë reale të pasurive ose të drejtave të lidhur me to⁹⁹, të fituarit, mbajtja ose përdorimi i pasurive, të cilat, ai që i fiton, i mban ose i përdor¹⁰⁰, pjesëmarrja në njërën nga veprat penale të treguara konform këtij neni ose çdo shoqërim, marrëveshje, tentativë ose bashkëpunim me anë të dhënies të pranisë, të ndihmës ose të këshillave për kryerjen¹⁰¹.

Vështirësia e të provuarit të veprës penale të pastrimit qëndron në anën subjektive, dhe provueshmërinë e fajit, pasjes dijeni që në fillim, qëllimin dhe motivin si elementë të veprës penale. Kontributin e jep Konventa Europiane, sipas pikës 2, germa c të nenit 6 ku shprehet se pasja dijeni, qëllimi ose motivimi, të nevojshëm si elementë të veprave penale të shpallura nga ky paragraf, mund të nxirren nga rrethanat faktike objektive.

Rëndësia e këtij rekomandimi qëndron në faktin se anën subjektive si element të veprës penale duhet ta provojme nëpërmjet rrethanave objektive.

Në formë të përmbledhur kontributi i Konventës Europiane adresohet në drejtim të kriminalizimit të veprës penale të pastrimit si vepër penale më vehte, objekt i veprës penale janë të ardhurat nga një fushë e pakufizuar veprash që sjellin fitime, pa u kufizuar vetëm në veprën e trafikimit të drogës në të cilën kufizohej Konventa e Vjenës. Gjithashtu një

⁹⁷ Konventa Europiane, Strasburg 1990, miratuar me ligjin 8646, datë 20.7.2000, “Për ratifikimin e Konventës Europiane “Për pastrimin, depistimin, kapjen dhe konfiskimin e produkteve të krimit”, neni 1 (e)

⁹⁸ Po aty, neni 6 (1) a

⁹⁹ Po aty, neni 6 (1) b

¹⁰⁰ Po aty, neni 6 (1) c

¹⁰¹ Po aty, neni 6 (1) d

kontribut të rëndësishëm ka dhënë dhe për masat që duhet të merren në të gjithë fazat e procesit për pastrimin, depistimin, kapjen me qëllim konfiskimin e produkteve të veprave penale, duke hedhur bazat e hetimit financiar. Në nenin 6 (2) (b) parashikon se shtetet mund të sigurojnë se vepra penale e pastrimit të parave nuk zbatohen për personin që ka kryer veprën penale kryesore¹⁰². Kjo dispozitë pranon se sistemet penale të shteteve mund të sigurojnë se nëqoftëse një person ka kryer një vepër e cila si elementë të saj kryesor përfitimin, ai nuk mund të gjykohet për një vepër shtesë të pastrimit të të ardhurave të asaj vepre. Dijenia, qëllimi ose motivi, si elementë të nevojshëm të veprës penale të pastrimit, mund të nxirren nga rrethanat objektive të faktit.

4.2.1.3 Konventa e Palermos

Në mbledhjen e saj të Mijëvjeçarit, në Palermo, Dhjetor 2002, Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara miratoi Konventën e Kombeve të Bashkuara Kundër krimit të organizuar ndërkombëtar. Konventa u nënshkrua nga 184 vende anëtare të OKB-së. Nënshkruesit janë të detyruar që brenda sistemeve të tyre të brendshëm penal të percaktojnë katër vepra të dallueshme si: pjesëmarrja në një grup të organizuar kriminal, pastrimin e parave, korrupsionin dhe pengimin e drejtësisë. Konventa e Kombeve të Bashkuara kundër krimit të organizuar ndërkombëtar¹⁰³, përcakton si pikësynim kryesor përkrahjen e bashkëpunimit për parandalimin dhe luftimin e krimit të organizuar ndërkombëtar, në mënyren më efektive. Konventa përmban norma me karakter material dhe procedural duke parashikuar edhe mjetet konkrete në luftën kundër këtij fenomeni i cili është bërë shqetësues

¹⁰² Po aty, neni 6 (2) b

¹⁰³ FZ 41, 2002 fq.1195

për të gjithë popujt. Konventa, përvec masave të tjera, parashikon si masë kundër krimit të organizuar ndërkombëtar edhe sekuestrimin, ngrirjen, pezullimin dhe konfiskimin e produkteve të këtyre aktiviteteve kriminale. Gjithashtu jep edhe përkufizime lidhur me disa nocione të rëndësishme lidhur me konceptet krim serioz, grup i strukturuar, pronë, të ardhura nga krimi, ngrirje apo bllokim, konfiskim. Konventa detyron shtetet palë, që në të drejtën e tyre të brendshme të parashikojnë masa për kriminalizimin dhe penalizimin e pastrimit të parave dhe korrupsionit. Konventa parashikon penalizimin e pjesëmarrjes në një grup kriminal të organizuar, penalizimin e pastrimit të të ardhurave nga krimi, masat për të luftuar pastrimin e parave, penalizimin e korrupsionit dhe masat kundër tij, konfiskimi dhe marrja e sendeve, bashkëpunimi ndërkombëtar në lidhje me konfiskimin, çështje të juridiksionit dhe të ekstradimit. Penalizimi dhe masat kundër pastrimit të parave, përcaktohen në kërkesat e nenit 6 dhe 7 të Konventës së Palermos.

Konventa e Palermos parashikon penalizimin si vepër penale të pastrimit të produkteve të veprës kryerjen në disa forma si: shkëmbimin ose transferimin e pasurisë¹⁰⁴, fshehjen ose mbulimin e natyrës së vërtetë, burimit, vendndodhjes, disponimit, zhvendosjes, pronësisë ose të drejtave në lidhje me pronësinë¹⁰⁵, fitimin, posedimin ose përdorimin i pasurisë, pjesëmarrjen¹⁰⁶, shoqërimin ose komplotimin për të kryer, tentativat për të kryer dhe dhënien e ndihmës, përkrahjen, lehtësimin dhe dhënien e këshillave për kryerjen e çdonjëres prej veprave penale të cilësuar si të tilla¹⁰⁷ duke ditur që një pasuri e tillë është e ardhur nga krimi. Për qëllimet e zbatimit ose aplikimit të paragrafit 1 të këtij neni: (a) secili shtet palë

¹⁰⁴ Konventa e Palermos, neni 6 (a) (i)

¹⁰⁵ Po aty, neni 6 (a) (ii)

¹⁰⁶ Po aty, neni 6 (b) (i)

¹⁰⁷ Po aty, neni 6 (b) (ii)

duhet të përpiqet të aplikojë paragrafin 1 të këtij neni në shtrirjen më të gjerë të veprave penale bazë; (b) duhet të përfshijë si vepra penale bazë të gjitha krimet serioze të cilësuar si të tilla në përputhje me nenet 5, 8 dhe 23 të kësaj Konvente; (c) për qëllimet e nënparagrafit (b), veprat penale bazë përfshijnë veprat penale të kryera si brenda dhe jashtë juridiksionit të shtetit palë në fjalë, (d) t'i dorëzojë Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara kopjet e ligjeve të tij të brendshme, që lidhen me zbatimin e këtij neni, ndryshimet vijuese të këtyre ligjeve ose një përmbledhje e tyre, (e) në qoftë se e kërkojnë parimet themelore të legjislacionit të brendshëm, mund të parashikohet që veprat penale të përmendura në paragrafin 1 të këtij neni të mos aplikohen ndaj personave që kanë kryer veprën penale bazë; (f) dijenia, qëllimi ose synimi të kërkuara si elemente të një vepre penale, të parashikuara në paragrafin 1 të këtij neni, mund të nxirren nga rrethanat objektive faktike. Megjithatë, veprat penale të kryera jashtë juridiksionit të një Shteti Palë do të përbëjnë vepra penale bazë vetëm në rastet kur veprimi përkatës është një vepër penale në bazë të ligjit të brendshëm të Shtetit ku është kryer dhe do të ishte një vepër penale në bazë të legjislacionit të brendshëm të Shtetit Palë që zbaton ose aplikon këtë nen, në qoftë se vepra penale do të ishte kryer në këtë Shtet¹⁰⁸. Konventa e Palermos rekomandon dhe masat për të luftuar pastrimin e parave si: krijimin e një regjim të brendshëm të gjithanshëm, rregullator dhe mbikëqyrës për bankat dhe institucionet financiare jobankare, brenda kompetencës së tij, me qëllim që të pengojnë dhe zbulojnë të gjitha format e pastrimit të parave, regjim i cili duhet t'i vërë theksin kërkesave për identifikimin e klientit, ruajtjen e dokumenteve dhe raportimin e transaksioneve të dyshimta, të sigurojë që autoritetet administrative, rregullatore, të

¹⁰⁸ Po aty, neni 6 (2) (a) (b) (c) (d) (e) (f)

zbatimit të ligjit dhe autoritetet e tjera që i janë kushtuar luftës kundër pastrimit të parave, përfshirë autoritetet gjyqësore, të kenë aftësinë për të bashkëpunuar dhe shkëmbyer informacion në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar, brenda kushteve të parashikuara nga legjislacioni i tij i brendshëm. Për këtë qëllim, duhet të marrin parasysh krijimin e një njësie zbulimi në fushën e financave që do të shërbejë si një qendër kombëtare për *mbledhjen, analizimin dhe shpërndarjen e informacionit* që lidhet me pastrimin e mundshëm të parave¹⁰⁹.

Një kontribut të veçantë Konventa e Palermos jep lidhur me figurën e krimit të korrupsionit. Korrupsioni është një pengesë kryesore për të realizuar hetimet financiare me qëllim identifikimin, kapjen, ngrirjen sekuestrimin dhe më pas konfiskimin e produkteve të vepres penale. Kontributi që sjell Konventa e Palermos lidhur me korrupsionin fokusohet në përmbajtjen e vepres penale të korrupsionit dhe masat që shtetet duhet të marrin për ndryshimet në të drejtën e brendshme. Korrupsioni përkufizohet si: (a) premtimin, propozimin ose dhënien ndaj një zyrtari publik, direkt ose jodirekt, të një përfitimi të padrejtë, për vetë zyrtarin/zyrtaren, një person ose dikë tjetër, me qëllim që zyrtari të veprojë ose të mos veprojë gjatë ushtrimit të detyrave të tij/saj zyrtare, (b) kërkesën ose pranimin nga një zyrtar publik, direkt ose jodirekt, të një përfitimi të padrejtë, për atë vetë ose për një person apo dikë tjetër, me qëllim që zyrtari të veprojë ose të mos veprojë gjatë ushtrimit të detyrave të tij/saj zyrtare¹¹⁰.

Një objektiv tjetër i Konventës së Palermos ishte dhe lidhur me subjektin e veprës penale të korrupsionit duke përfshirë dhe zyrtar të huaj ose nëpunës civil ndërkombëtar, duke dhënë

¹⁰⁹ Konventa e Palermos, neni 7 (a) (b) (c)

¹¹⁰ Po aty, neni 8 (1) (a) (b)

dhe përkufyimin e “zyrtarit publik” që nënkupton një zyrtar publik ose një person i cili kryen një shërbim publik në mënyrën e parashikuar nga legjislacioni i brendshëm dhe në mënyrën që aplikohet nga legjislacioni penal i Shtetit Palë, në të cilin personi në fjalë kryen atë funksion¹¹¹. Gjithashtu Konventa e Palermos parashikon marrjen e masave për përgjegjësinë penale të personave juridikë duke u shprehur se: secili shtet palë duhet të adaptojë masat e nevojshme, që janë në pajtim me parimet e tij ligjore, për të përcaktuar përgjegjësinë e personave juridikë që marrin pjesë në krime serioze që përfshijnë një grup të organizuar kriminal dhe për veprat penale të cilësuar si të tilla, në përputhje me nenet 5, 6, 8 dhe 23 të kësaj Konvente, përgjegjësia e personave juridikë mund të jetë penale, civile ose administrative si dhe një përgjegjësi e tillë nuk duhet të cenojë përgjegjësinë penale të personave fizikë që kanë kryer veprat penale, duhet të sigurojë, veçanërisht, që personat juridikë që konsiderohen përgjegjës në përputhje me këtë nen t'i nënshtrohen sanksioneve efektive, proporcionale, bindëse penale ose jopenale, përfshirë sanksionet financiare¹¹². Shqipëria ka ratifikuar Konventën e Palermos me ligjin Nr.8920¹¹³, datë 11.7.2002 duke bërë dhe ndryshime në të drejtën e brendshme dhe miratuar ligjin për përgjegjësinë penale të personave juridikë.

4.2.1.4 Konventa e Varshavës

Shtetet anëtare të Këshillit të Europës dhe shtete të tjera nënshkruese janë të bindur për nevojën e një politike penale të përbashkët, duke patur parasysh se se lufta kundër krimeve të rënda kërkon përdorimin e metodave moderne dhe efektive në shkallë ndërkombëtare

¹¹¹ Po aty, neni 8 (4)

¹¹² Konventa e Palermos, neni 10 (1) (2) (3) (4)

¹¹³ Gazeta Zyrtare Nr.41, datë 25.07.2002

duke u shprehur se: njëra prej këtyre metodave konsiston në privimin e kriminelëve nga produktet e krimit dhe instrumenteve për kryerjen e saj dhe se për arritjen e këtij objektiv i duhet të ngrihet një sistem funksional bashkëpunimi ndërkombëtar¹¹⁴.

Konventa e Këshillit të Europës për pastrimin, kërkimin, kapjen dhe konfiskimin e produkteve të krimit dhe për financimin e terrorizmit, (Konventa e Varshavës), është një plotësim dhe rregullim më i saktë i institutive të sekuestrimit dhe konfiskimit të produkteve të veprave penale në të gjitha aspektet, në vazhdim të Konventës së Strasburgut. Kjo konvente jep perkufizime për nocionin konfiskim i zgjeruar dhe konfiskim i ngushtë, duke ju lënë në diskrecion të shteteve palë të zgjedhin cilin nga këto dy lloje konfiskimi mund të aplikojnë, duke marrë parasysh kushtet ligjore dhe ekonomike të secilit shtet. Një vend të veçantë Konventa e Varshavës i kushton përkufizimit të termave si: produkt, pasuri, instrument, konfiskim, vepër penale kryesore, njësi e informacionit financiar, ngrirje ose bllokim dhe financim terrorizmi.

Në nenin 1, gërma (e) thuhet: “vepër penale kryesore” nënkupton çdo vepër penale në vijim të së cilës janë krijuar produkte dhe që mund të bëhen objekt i një veprë penale sipas nenit 9 të kësaj konvente. Sipas konventës veprat penale kryesore paraqiten në shtojcë ku parashikohen 20 vepra penale, si edhe le ta hapur mundësinë që masat mund të aplikohen edhe a) ndaj veprave penale të dënueshme me heqje lirie mbi një vit, ose gjashtë muaj, b) vetëm për një listë të specifikuar veprash penale dhe c) për një kategori veprash penale të rënda, të specifikuar në legjislacionin e brendshëm¹¹⁵. Këta konventa janë ratifikuar nga

¹¹⁴ Konventa e Këshillit të Europës “Per pastrimin, depistimin, sekuestrimin dhe konfiskimin e produkteve të krimit dhe financimit të terrorizmit”, (Konventa e Varshavës), ratifikuar me Ligjin Nr. 9646, datë 27.11.2006, botuar në GZ.134 datë 22.12.2006

¹¹⁵ Konventa e Varshavës, neni 9 (4) (a) (b) (c)


Shqipëria, dhe janë pjesë të së drejtës së brendshme duke u shoqëruar dhe me instrumente të tjera ligjore, sic është ligji për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, i quajtur ndryshe dhe si ligji antimafia, i cili ka hyrë në fuqi në vitin 2004. Në nën çështjet në vijim do të jepen rezultate të efikasitetit të zbatueshmërisë së këtij ligji dhe ligjeve të tjera pjesë të së drejtës së brendshme në Shqipëri.

4.2.2 Instrumentet juridik regjional

Për vendet e Europës Jug-Lindore nga Këshilli i Europës, Komisioni European dhe Organizata Ndërkombëtare për Migrim, (IOM), në vitet 2004-2007, janë ofruar dhe realizuar projekte konkrete për mundjen e krimit të organizuar, trafikimin e qenjeve njerzore dhe krimin ekonomik. Projektet mbështesin vendet e Europës Jug-Lindore, për të zbatuar zotimet e marra në tre dokumente të rëndësishme si: Deklarata e Londrës, “Për mundjen e krimit të organizuar në Europën Jug-Lindore”, (Nëntor 2002), Deklaratës së Brukselit, “Mbi trafikimin e qenjeve njerëzore”, (Prill 2003), Procesi i Stabilizim Associmit.

Synimi i projektit ishte zhvillimi i sistemeve të besueshme dhe funksionale të policive, si dhe nxitja e luftës kundër aktiviteteve kryesore kriminale dhe i bashkëpunimit policor. Financimi i projektit në shumën 5.144.000 Euro, është financuar nga Komisioni European në masën 90 përqind dhe Këshilli i Europës në masën 10 përqind. Zbatimi i projektit është realizuar nga Këshilli i Europës për modulën 1, “Mjetet kundër krimit ekonomik dhe atij të organizuar”, dhe nga IOM për modulën 2, “Trajnime kundër trafikimit të qenjeve njerëzore, kontrabandës dhe migrimit ilegal”. Rezultatet e nxjerra nga modulet, kanë shërbyer dhe për hartimin e strategjive rajonale, lidhur me synimet e projektit. Moduli 1, u finalizua me

strategjinë rajonale “Mbi instrumentet e krimit të organizuar dhe krimit ekonomik”, të miratuar në takimin e nivelit të lartë të Ministrave të Brendshëm dhe Zyrtarëve të Lartë, më 23 Shtator 2005, në Brijuni, Kroaci. Në këtë takim morën pjesë përfaqësuesit e lartë të të gjitha shteteve të rajonit si Kroacia, Serbia, Bosnje-Hercegovina, Mali i Zi, Shqipëria, Kosova dhe Maqedonia. Në formë të përmbledhur, rezultatet e këtij projekti jepen në skemën më poshtë:



Strategjia rajonale për hetimet financiare dhe konfiskimin e produkteve të krimit, (Moduli 1, Rezultati 1.2) përcaktoi synimet, masat dhe objektivat specifike afat shkurtëra dhe afat mesme, për secilin shtet, që duhej të merreshin nga vendet e rajonit. U përcaktuan 5 synime kryesore si: forcimit të kuadrit ligjor që rregullon identifikimin, gjurmimin, ngrirjen, kapjen dhe konfiskimin e produkteve të krimit, hartimin e strategjive të hetimit financiar, të cilat vënë në shënjestër pasuritë e grupeve të krimit të organizuar, nëpërmjet integritetit të hetimeve financiare tek hetimet penale, forcimit të bashkëpunimit ndërmjet organeve të zbatimit të ligjit, të garantohet specializimi i personave, apo organeve, autoriteteve

kompetentë të zbatimit të ligjit, prokurorëve, në hetimet financiare dhe të zhvillohet maksimalisht bashkëpunimi ndërkombëtar dhe bashkëpunimi i ndërsjellë në këtë fushë.

Si objektiva afat shkurtëra për Shqipërinë u përcaktuan: a) të rritet ndërgjegjësimi i mëtejshëm mbi konceptin e hetimeve financiare ndërmjet policeve, prokuroreve dhe gjyqtarëve, b) të rritet bashkëpunimi dhe shkëmbimi i informacionit ndërmjet policisë dhe prokurorisë nëpërmjet nënshkrimit të marrveshjeve dypalëshe ndërmjet këtyre institucioneve, të cilat duhet të specifikojnë hollësisht mënyrat në të cilat policia dhe prokuroria funksionojnë dhe operojnë në fushën e hetimeve financiare, c) të kryhen trajnime të përbashkëta për oficerë të policisë gjyqësore dhe prokurorët të cilët duhet të përqëndrohen në njohjen më të mirë të konceptit të hetimit financiar si dhe në kuadrin ligjor që ekziston në këtë fushë në Shqipëri dhe mbi instrumentet ligjore europiane dhe ndërkombëtare, d) të krijohet Njësia e Policisë Gjyqësore në kuadër të Administratës së Taksave. Si objektiva afatgjata u përcaktuan: 1) të zgjerohen kompetencat e Agjencisë për Adminsitrimin e Pasurive të Konfiskuara dhe të Sekuestruara, që duhet të përfshijë jo vetëm pasuritë e krimit të organizuar, por edhe pasuritë e formave të tjera të krimit, 2) të bëhen shtesa në Kodin e Procedurës Penale duke mundësuar monitorimin e fshehtë të transaksioneve bankare, 3) të ndryshohet Kodi i Procedures Penale ku të përfshihet detyrimi për Policinë Gjyqësore që të nisë bashkë me hetimin penal për vepra të rënda penale, edhe hetimin financiar, që synon identifikimin dhe sekuestrimin e produkteve të krimit, 4) të krijohet një rrjet rajonal i shkëmbimit të informacionit në lidhje me hetimin financiar, ndërmjet agjensive të ndjekjes penale në rajon që do të nxisë bashkëpunimin rajonal në këtë fushë, 5) të mbështeten kontaktet e drejtepërdrejta ndërmjet institucioneve hetimore dhe të prokurorisë si dhe

ndërmjet ekspertëve nga vende të ndryshme, sidomos për çështje që lidhen me krimet në fushën e doganave, krimin e organizuar pastrimin e parave etj.

Nga një analizë e përgjithshme, referuar ndryshimeve legislative, raport progreseve, analizave vjetore të Prokurorisë e Gjykatës për Krime të Rënda, dhe nga testimi nëpërmjet pyetsoreve rezulton se nuk janë kryer në masën e duhur objektivat specifike. Mangësitë konstatohen qoftë në realizimin e objektivave afat shkurtëra dhe në ato afat gjata. Në Shqipëri janë nënshkruar marrveshje e memorandume, por janë vetëm të shkruara, janë bërë trajnime, por lëvizjet pa kriter të punonjësve të cilët kanë marrë trajnimet specifike, mbetet një problem të cilin e evidentojnë dhe raportet e progresit për Shqipërinë. Mendoj se kultura e zbatimit të ligjit në Shqipëri, vazhdon të mbetet një problem serioz.

Shqipëria ka nënshkruar marrveshje me të gjitha vendet e rajonit për bashkëpunimin në luftën kundër krimit.

4.2.3 Instrumentet juridik kombëtar

Në Shqipëri janë ratifikuar të gjitha konventat ndërkombëtare që përmendëm më sipër dhe sipas nenit 5 dhe 122 të Kushtetutës së RSH-së janë pjesë e së drejtës së brendshme. Gjithashtu në të drejtën penale shqiptare, sekuestrimi dhe konfiskimi është pjesë e së drejtës materiale dhe procedurale. Instrumentet kryesore janë Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, e cila mundëson përfshirjen e konventave si pjesë e së drejtës së brendshme pas ratifikimit, Kodi penal, i cili e parashikon konfiskimin si masë dhe si dënim, si edhe penalizon krimin e organizuar, pastrimin e parave, terrorizmin, korrupsionin, sipas konventave ndërkombëtare, si edhe ka një ligj të posaçëm për parandalimin e goditjen e krimit të organizuar, i quajtur ndryshe dhe si ligji antimafia, i cili ka hyrë në fuqi në vitin

2004 dhe është ndryshuar në vitin 2009, për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar dhe trafikimit, nëpërmjet masave parandaluese të konfiskimit të pasurisë. Konfiskimi i produkteve të krimit është një mjet efikas në luftën kundër krimit të organizuar dhe atij të rëndë. Megjithatë aplikimi në praktikë i standarteve ndërkombëtare e dispozitave ligjore egzistuese në të drejtën e brendshme vazhdon të jetë një sfidë për shumë vende të Europës. Artikulli është fokusuar në efencën e dispozitave eksistuese për hetimin financiar me qëllim konfiskimin e produkteve të krimit duke e parë në këndvështrimin sipas fazave investiguese, gjyqësore dhe administrimit të pasurisë së konfiskuar. Në Shqipëri konfiskimi parashikohet në nenin 30 dhe 36 të Kodit Penal. Ky konfiskim bëhet për mjetet e kryerjes së veprës penale, që kanë shërbyer ose ishin caktuar për të realizuar veprën penale, si edhe objektet, mjetet monetare, si dhe çdo pasuri tjetër që rrjedh nga vepra penale apo i shpërblimit të dhënë apo të premtuar për kryerjen e veprës penale. Kjo dispozitë e Kodit Penal përcaktonte që konfiskimi jepej detyrimisht nga gjykata ndaj personave që kryejnë veprë penale. Në këtë kuptim, standarti i provës ishte shumë i lartë, pasi kërkohet domosdoshmerisht që të provohet fajësia, dhe vetëm pasi jepet vendimi i fajësisë, gjykata shprehet në vendim për konfiskimin e mjeteve dhe pasurisë, si masë dënimi. Nisur nga fakti se kërkohet patjetër provueshmëria e fajësisë së kryesit të veprës penale, rastet e konfiskimit ishin shumë të rralla. Por sekuestrimet dhe konfiskimet të parashikuara nga kuadri ligjor Shqiptar duke pasur parasysh qëllimet që ato ndjekin ishin instrument ligjor të pamjaftueshëm në luftën kundër krimit të organizuar, pasi ato ishin të lidhura me procedimin penal, me mënyrën e përfundimit të tij dhe vendoseshin vetëm kur personi deklarohet fajtor jashtë çdo dyshimi të arsyeshëm. Kështu procedimi parandalues ishte më efikas në luftën kundër KO-së trafikimeve dhe akteve terroriste, pasi konfiskimi i detyrueshëm sipas nenit

36 të Kodit Penal, ishte pothuajse i pazbatueshëm për vepra të tilla penale si krimi i organizuar, trafikime, pastrim parash, pasi autorët e këtyre veprave ishin të specializuar për të fshehur produktet e këtyre veprave penale. Nga njëra anë kemi organet e drejtësisë, të cilët standardin e të provuarit në konfiskimet e detyrueshme e kanë shumë të lartë, tej çdo dyshimi të arsyeshëm, ndërkohë nga ana tjetër qëndrojnë autorët e këtyre veprave penale të cilët janë shumë të aftë të fshehin lidhjen midis krimit dhe produkteve. Në këtë procedim gjykata e ka të pamundur të aplikojë një standard më të ulët të barrës së provës atë “jashtë çdo dyshimi të arsyeshëm” sepse Kodi i procedurës penale, e ndalon. Në këto kushte lindi nevoja e një sistemi të përzier sekuestrimi dhe konfiskimi, i cili duhet të ishte në përputhje me standardet e vendosura nga aktet ndërkombëtare. Bazuar në këto argumente, Kuvendi i Shqipërisë miratoi ligjin Nr.9284, datë 30.9.2004, “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar”, zëvendësuar me ligjin Nr. 10192, datë 3.12.2009, “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar dhe trafikimit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”.

4.2.3.1 Ligji për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar në këndvështrim të

Vendimit Unifikues të Gjykatës së Lartë

Ligji 9284, datë 30.9 2004, “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar”, ishte një mundësi e shtuar në duart e organeve të zbatimit të ligjit, për goditjen e krimit të organizuar dhe parandalimin e krimit, për shkak se solli risi dhe një qasje të re në luftën dhe parandalimin e krimit. Efikasiteti në zbatimin e këtij ligji ka hasur shpesh në pengesa së pari në kuptueshmërinë e termave të përdorura në këtë ligj. Kjo del qartë dhe në qëndrimet e Gjykatës së Apelit për krime të Rënda, lidhur me vendimet gjyqësore të Gjykatës së Shkallës

së Parë për Krime të Rënda, si dhe vendimet e Kolegjit Penal në Gjykatën e Lartë, i cili për disa çështje interpretimi të dispozitave të këtij ligji i është drejtuar Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë. Në raportin vjetor të vitit 2008 të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda thuhet: “Rastet e prishjes së vendimeve konsistojnë në :

1. Procedurën e ndjekur për njoftimin e personit të paditur apo për thirrjen e personave të tretë në gjykim si palë që kanë interes për çështjen sipas nenit 193 të KPrC.
2. Nga ana e gjykatës së Apelit disa vendime janë prishur dhe pasuria e konfiskuar sipas vendimit të Gjykatës së shkallës së parë është kthyer personit të dyshuar, me arsyetimin se ka kërkesa e organit të akuzës për konfiskim është paraqitur tej afatit 6 mujor që parashikon neni 7 pika 4 i ligjit 9284 datë 30.09.2004 “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar” (GJKR, Raport vjetor , 2008, p. 26). Për argumentimin e fakteve dhe vështirësive të zbatimit të këtij ligji shprehet dhe Vendimi Nr. 1, datë 25.1.2007, i Gjykatës së Lartë, ku Kolegjet e Bashkuara shqyrtuan dhe unifikuan praktikën gjyqësore, (Çështja Troplini), lidhur me interpretimin e disa dispozitave të këtij ligji në të cilin thuhet:

Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, në seancën gjyqësore të datës 25.10.2006, vendosi ta kalojë çështjen për gjykim në Kolegjet e Bashkuara, për të unifikuar praktikën gjyqësore lidhur me sa poshtë:

1. Të sqarohet dhe të interpretohet kuptimi i nenit 4, pika 3 dhe nenit 28, pika 1 të Ligjit nr.9284, datë 30.09.2004 “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar”. Sipas këtij ligji dhe, më posacërisht, në kuptim e zbatim të dispozitave të mësipërme, cila do të jetë gjykata kompetente për hetimin e gjykimin e masave parandaluese pasurore të sekuestrimit dhe konfiskimit të pasurive: gjykata penale për krime të rënda, duke hetuar e gjykuar çështjen sipas rregullave të procedurës civile, apo është gjykata civile. Nëse është Gjykata e

Krimeve të Rënda, a mund të veprojë si gjykate civile? Po kështu, nëse ky gjykim do të jetë në kompetencë të Gjykatës për Krime të Rënda, a do të gjykohet çështja me një gjyqtar, në bazë të nenit 13 pika 3 paragrafi "2" të K.Pr.Penale, si një kërkesë e prokurorit e bërë në fazën e hetimit paraprak, apo do të gjykohet në bazë të kritereve ligjore të përcaktuara nga neni 35/2 të K.Pr.Civile.

2. Cili është kuptimi dhe interpretimi i neneve 7 e 10 të këtij ligji, nëse sekuestrimi paraprak (neni 7) dhe sekuestrimi (neni 10) janë faza të domosdoshme të një procesi që i paraprin konfiskimit, apo janë masa të shkëputura nga njëra tjetra dhe si të tilla veprojnë në mënyrë të pavarur.

3. Nëse konfiskimi bëhet vetëm në rastet pasi më parë është vendosur pezullimi dhe sekuestro (neni 9 e 10), apo edhe në rastet kur më parë është vendosur vetëm sekuestro paraprake, neni 7.

4. Cili është kuptimi i "pezullimit të përkohshëm të administrimit dhe disponimit të pasurive" (neni 9) dhe lidhja e tij me sekuestrimin (neni 10). Nëse janë hallka të një procesi që duhen zbatuar patjetër për të arritur tek konfiskimi, apo mund të veprojnë pavarësisht nga njëra tjetra (Gjykata e Lartë, 2007).

Duhet theksuar se ky vendim unifikues trajtoi dhe bëri interpretim dhe për çështje të tjera, pavarësisht qartësimeve lidhur me kuptueshmërinë e termave dhe unifikimin në praktikën gjyqësore, një numër prej 6 anëtarëve kanë dhënë mendim kundër për çështjen konkrete, duke dhënë dhe qëndrimin e tyre për mendimet e shumicës, dhe argumentimin kundër. Mendoj se është e rëndësishme të trajtoj disa çështje lidhur me qëndrimet dhe argumentet e anëtarëve të Kolegjeve të Bashkuara Penale, dhe efektin që solli ky vendim unifikues në zbatueshmërinë e tij në praktikë. Mendimi pakicë adresohet në disa çështje si:

Si aplikohet ligji kundër krimit të organizuar në rastin kur ndaj personit të dyshuar ka filluar procedimi penal? Cili duhet të aplikohet, ligji kundër krimit të organizuar apo Kodi i Procedurës Penale si ligj me votë të cilësuar?

Mendoj se ekzistenca e dispozitave për sekuestrimin dhe konfiskimin edhe në Kodin Penal, neni 30, neni 36, dhe Kodin e Procedurës penale, nenet 270 – 273, sekuestroja konservative, dhe nenet 274 – 276, sekuestroja preventive dhe konfiskimin të cilat janë ende në fuqi, si edhe parashikimi i dispozitave të sekuestrimit dhe konfiskimit në ligjin kundër krimit të organizuar (Ligj. 9284), ka sjellë dhe moseficencën e këtij ligji në praktikë. Kolegjet e Bashkuara, procedimin sipas ligjit për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar e konsiderojnë si *procedim parandalues* dhe *autonom* me *procedimin penal* dhe *civil*. Gjyqtarët pakicë, në vendimin Nr. 1, datë 25.1.2007 shprehen se ky qëndrim shkel parimin themelor mbi të cilin ngrihet procedimi penal, të sanksionuar në nenin 1 të K.Pr.Penale. Lënia në vlerësim të organit të akuzës që në rastet analoge, për të cilat ka filluar një çështje penale, të kërkojë sekuestrimin e pasurisë së të pandehurit apo personit nën hetim që të aplikojë dispozitat e K.Pr.Penale apo dispozitat e ligjit nr.9284, datë 30.09.2004, mëndojmë së është shumë e rrezikshme dhe i hap rrugën një subjektivizmi më pasojë të drejtpërdrejtë diskriminimi dhe vendosje në pozita të pabarabarta të subjekteve të njëjta procedurale, duke shkelur parimin themelor të ndjekjes penale dhe të drejtat dhe liritë procedurale e Kushtetuese, për personat që dyshohen të kenë kryer vepra penale¹¹⁶. Sikurse lehtësisht konstatohet në nenin 3 të ligjit, ku përcaktohet “rrethi i personave të dyshuar”, sekuestrimi i pasurisë shtrihet edhe ndaj personave dhe subjekteve të cilët nuk kanë kryer vepra që lidhen

¹¹⁶ Gjykata e Lartë, Vendim nr. 1, datë 25.1.2007

me krimin e organizuar, duke treguar kështu se aplikimi i këtij ligji nuk lidhet me vetë procedimin penal, por është jashtë tij. Këtë qëndrim me të drejtë mbajnë edhe Kolegjet e Bashkuara në unifikim të praktikës gjyqësore, duke e konsideruar *procedim parandalues dhe autonom* me procedimin penal dhe atë civil.

Ky ligj, duke qenë me karakter të fortë represiv dhe që është bazuar në nevojën për të parandaluar dhe luftuar më mirë krimin e organizuar, ka efekte të kufizuara në kohë duke përcaktuar afate më të shkurtra sesa ato të KPP për kohën e vënies së sekuestros mbi pasurinë, por nga ana tjetër, ka lehtësuar mundësinë e vënies së saj në raport me dispozitat e Kodit të Procedurës Penale. Mendojmë së ky është edhe shkak që ligjvënisi ka kufizuar kohën gjatë të cilës pasuria mbahet në sekuestro. Që ky ligj nuk lidhet me rastet kur ka një procedim penal, e tregon qartë, ndryshe nga sa pranon shumica, neni 27 i tij ku në paragrafin e parë përcaktohet se, *masa e sekuestrimit ose konfiskimit mund të vendoset edhe ndaj pasurive të sekuestruara në një procedim penal*. Akontrario, duhet kuptuar se në një procedim penal aplikohen dispozita të tjera, K.Pr.Penale dhe vetëm në një rast ky ligj bën lidhjen me procedimin penal kur i jep të drejtë gjykatës që të vendosë sekuestro apo të konfiskojë pasuri mbi të cilat ajo ka disponuar më parë në procedimin penal, duke bërë kështu të mundur zbatimin e normave të këtij ligji të lidhura me ato të K.P.Penale. Sipas mendimit të pakicës, ky është i vetmi rast kur këto dy ligje mund aplikohen së bashku në një procedim penal. Pra në thelb ai është një ligj parandalues, ashtu sikurse ka edhe titullin dhe nuk është një ligj që shtrihet gjatë procedimit penal (VGJL Nr. 1, date 25.1.2007, fq. 18).

Lidhur me rastin e zbatimit të dispozitave të Kodit të Procedurës Penale apo dispozitave të ligjit për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, mendoj se gjyqtarët pakicë, kanë të drejtë kur thonë: “ky është i vetmi rast kur këto dy ligje mund aplikohen së bashku në një procedim penal. Pra në thelb ai është një ligj parandalues, ashtu sikurse ka edhe titullin dhe nuk është një ligj që shtrihet gjatë procedimit penal, (VGJL Nr. 1, date 25.1.2007, fq. 18).

Ligji për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, pavarësisht unifikimit të praktikës për disa çështje që lidheshin me kompetencën e gjykatës, penale apo civile, sqarimin e termave sekuestrim paraprak dhe sekuestrim, nëse konfiskimi kërkon ose jo domosdoshmërisht marrjen e sekuestrimit apo pezullimit të përkohshëm më përpara, apo janë procese të ndara, nuk solli rezultatet konkrete në zbatim. Mendoj se paqartësia në kuptimin e termave, si dhe standarti i lartë i të provuarit, ku sipas nenit 3 pika 1 e ligjit kërkohet “ekzistenca e një dyshimi të arsyeshëm, i bazuar në prova”, si dhe paqartësia se cilat dispozita duhej të aplikoheshin ndaj të pandehurit apo personin nën hetim, ata të Kodit të Procedurës Penale apo ata të ligjit për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, e bën më të vështirë zbatimin e ligjit. Ligjvënësi në Dhjetor të vitit 2009, miratoi një ligj tjetër, Ligjin Nr. 10192, datë 3.12.2009, “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar dhe trafikimit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”, i cili shfuqizoi ligjin eksistues “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar”. Ligji i ri solli disa qartësime dhe risi si:

- 1) në fushën e zbatimit të këtij ligji u përfshinë dhe tre vepra të tjera penale, prodhimi dhe shitja e narkotikëve parashikuar nga 283, shfrytëzimi i prostitucionit në rrethana rënduese, parashikuar nga 114/a dhe pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale, parashikuar nga neni 287 të Kodit Penal, të cilat nuk përfshiheshin në ligjin e mëparshëm.

2) u dha kuptimi i konceptit “masë parandaluese” (neni 4 i ligjit), 3) u përcaktua marrëdhënia me procedimin penal (neni 5 i ligjit), 4) u përcaktua kompetenca dhe përbërja e gjykatës (neni 7 i ligjit), 5) përcaktoi procedurat dhe afatet e sekuestrimit të pasurisë (neni 12 i ligjit dhe 6) shumë e rëndësishme, ndryshoi standartin e provës duke e ulur atë nga “dyshim i arsyeshëm i bazuar në prova”, në “dyshim i arsueshëm i bazuar në indicje”.

Mendoj se një vëmendje të vecantë duhet ti kushtohet nenit 5 të ligjit Nr.10192, datë 3.12.2009, “Marrëdhënia me procedimin penal”, ku thuhet se procedura e caktimit dhe e zbatimit të masave parandaluese, sipas këtij ligji, është *autonome nga gjendja, shkalla apo përfundimi i procedimit penal* që zhvillohet në ngarkim të personave, subjekte të këtij ligji. *Verifikimet, hetimet dhe gjykimi, sipas këtij ligji, mbështeten në rregullat procedurale të këtij ligji dhe plotësohen nga rregulla të përcaktuara në Kodin e Procedurës Civile. Në rastet kur pasuritë e sekuestruara apo të konfiskuara, sipas këtij ligji, i nënshtrohen, gjithashtu, sekuestrimit apo konfiskimit, sipas Kodit Penal dhe Kodit të Procedurës Penale, gjykata urdhëron pezullimin e pasojave të zbatimit të masave të sekuestrimit dhe konfiskimit, sipas këtij ligji. Pezullimi përfundon me dhënien e një vendimi gjyqësor penal për revokimin apo shuarjen e këtyre masave*¹¹⁷.

Kjo dispozitë qartëson se ky lloj procedimi është autonom, pra i pavarur nga gjendja, shkalla apo përfundimi i procedimit penal. Qartëson se procedurat për verifikim, hetim dhe gjykim kryhen sipas këtij ligji plotësohen nga rregulla të përcaktuara në kodin civil e konkretisht nga nenet 130 e vijues të KPC. Sipas pikës 3 të nenit 5, bëhet ndarja e qartë se kur zbatohen

¹¹⁷ Neni 5 i ligjit nr.10192, datë 3.12.2009, “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar dhe trafikimit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”

dispozitat e Kodi Penal dhe Kodi i Procedurës Penale, procedurat për sekuestrimin dhe konfiskimin, pezullohen deri në dhënjen e një vendimi gjyqësor penal. Këtë mendim kanë dhënë dhe gjyqtarët pakicë në vendimin unifikues të cilin e trajtuam më sipër.

Komiteti Shqiptar i Helsinkit, ka paraqitur në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë kërkesën me objekt: 1. Shfuqizimi si i papajtueshëm me Kushtetutën dhe Konventën Europiane të të Drejtave të Njeriut (KEDNJ) të ligjit nr. 10192 datë 03.12.2009, “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar dhe trafikimit, nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”; 2. Pezullimi i zbatimit të ligjit deri në përfundim të shqyrtimit të kërkesës nga Gjykata Kushtetuese, (V-4/11). Papajtueshmëria me Kushtetutën dhe Konventën Europiane të të drejtave të Njeriut (KEDNJ) dhe qëndrimi i Gjykatës Kushtetuese, dhe praktika ndërkombëtare, do të trajtohen me hollësisht në nënçështjet 4.2.3.2 dhe 4.2.3.3.

4.2.3.2 Ligji për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar në këndvështrim të

Vendimit të Gjykatës Kushtetuese

Gjykata Kushtetuese më datë 01.07.2010, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen Nr. 4/11. Gjykata Kushtetuese pas shqyrtimit të kërkesës, sipas Vendimit Nr.4, datë 23.02.2011 vendosi: “ Rrëzohet kërkesa për shfuqizimin, si të papajtueshëm me Kushtetutën dhe KEDNJ, të ligjin nr. 10192, datë 03.12.2009 “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar dhe trafikimit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë” (VGJK Nr.4, date 23.2.2011, fq. 26). Me interes është analizimi i vendimit për pikën 1. Shfuqizimi si i papajtueshëm me Kushtetutën dhe Konventën Europiane të të Drejtave të Njeriut (KEDNJ) të ligjit nr. 10192 datë 03.12.2009, “Për parandalimin dhe goditjen e krimit

të organizuar dhe trafikimit, nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”; pasi lidhur me piken 2. Pezullimi i zbatimit të ligjit deri në përfundim të shqyrtimit të kërkesës nga Gjykata Kushtetuese, (V-4/11), Gjykata kushtetuese është shprehur në Kreun II, gërma B, paragrafi 12. Gjykata mori paraprakisht në shqyrtim kërkesën për pezullimin e zbatimit të ligjit nr. 10192, datë 03.12.2009 “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar dhe trafikimit, nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”. Në mbështetje të nenit 45 të ligjit nr.8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, u vendos rrëzimi i kërkesës. Gjykata nuk gjeti argumente bindëse për mundësinë e cenimit të interesave shtetërorë e shoqërorë ose të individëve, si rrjedhojë e zbatimit të menjëhershëm të këtij ligji, në kuptim të kërkesave normative të ligjit”, (VGJK Nr.4, datë 23.2.2011, fq. 9-10). Çështje me interes dhe për punimin, të trajtuara në VGJK Nr. 4, datë 23.2.2011 janë:

A. Për pretendimin se shprehja “dyshim i arsyeshëm bazuar në indicie”, parashikuar në nenin 3 paragrafi 1 i ligjit nuk është në përputhje me standardin “dyshim i arsyeshëm”, parashikuar në nenin 27 paragrafi 2 shkronja “c” të Kushtetutës dhe në nenit 5 paragrafi 1 të KEDNJ-së dhe në nenin 228 paragrafi 1 të KPP-së.

B. Për pretendimin se ligji objekt shqyrtimi cënon të drejtën e pronës, të sanksionuar nga neni 41 i Kushtetutës dhe neni 1, Protokoli 1 i KEDNJ-së.

C. Për pretendimet se ligji objekt shqyrtimi shkel disa elemente të procesit të rregullt ligjor të garantuar nga neni 42 i Kushtetutës dhe neni 6 i KEDNJ-së.

C.1 Për pretendimin se ligji objekt shqyrtimi cënon të drejtën për t’iu drejtuar gjykatës (e drejta e aksesit)

C.2 Për pretendimin se cënohet prezumimi i pafajësisë

C.3 Për pretendimin se ligji cënon parimin e gjykatës të caktuar me ligj

Ç. Për pretendimin se cënohet e drejta e ruajtjes së jetës private, garantuar nga nenet 35, 36 dhe 37 të Kushtetutës dhe neni 8 i KEDNJ-së

D. Për pretendimin se ligji shkel hierarkinë e akteve normative dhe se është miratuar jo sipas kërkesave të nenin 81 të Kushtetutës

Në këtë vendim të Gjykatës Kushtetuese, ka patur dhe mendim paralel nga një gjyqtar dhe një mendim pakicë, ku në tërësi pajtohen me shumicën, por kanë qëndrime të ndryshme dhe të kundërta në disa çështje. Analiza fokusohet për çështje të rëndësishme që kanë të bëjnë me interpretimin dhe kuptueshmërinë e termave si “dyshim i arsyeshëm bazuar në indicje”, “cënimi i së drejtës së pronës”, “e drejta e aksesit”, “prezumimi i pafajsisë”, “e drejta për gjykim nga gjykatë të caktuar me ligj”, “e drejta e ruajtjes së jetës private”, “hierarkinë e akteve normative”. Këto çështje janë të debatuar dhe shpesh kanë qënë dhe objekt i shqyrtimit gjyqësor në Gjykatën Europiane të të Drejtave të Njeriut, praktika e të cilave do të trajtohet në nënçështjet në vijim.

Një nga ndryshimet që solli ligji nr.10192, është ndryshimi i standartit nga “*dyshim i arsyeshëm bazuar në prova*” në “*dyshim i arsyeshëm bazuar në indicje*”. Ky ndryshim ju jepte mundësi dhe krijoi lehtësira prokurorëve për të mundësuar hetimin financiar me qëllim konfiskimin, pasi standarti “bazuar në prova”, (sipas neni 3, pika 1 e ligjit 9284), ishte shumë i lartë. Objekt i shqyrtimit nga Gjykata Kushtetuese ishte standarti “dyshim i arsyeshëm bazuar në indicje”, parashikuar në nenin 3, pika 1 e ligjit Nr.10192, viti 2009, dhe standartit “dyshim i arsyeshëm”, parashikuar në nenin 27 paragrafi 2 shkronja “c” të Kushtetutës, në nenin 5 paragrafi 1 të KEDNJ-së dhe nenin 228 paragrafi 1 të KPP-së. Gjykata Kushtetuese arsyeton dhe vlerëson se:

“neni 27 paragrafi 2 i Kushtetutës mbi kriterin e dyshimit të arsyeshëm lidhet me garancitë kushtetuese *për privimin e lirisë*. Ndërsa ligji objekt shqyrtimi, në nenin 1 për objektin e ligjit, parashikon se “Ky ligj përcakton procedurat, kompetencat dhe kriteret për *zbatimin e masave parandaluese kundër pasurisë së personave*, që janë subjekt i këtij ligji, si të dyshuar për pjesëmarrje në krimin e organizuar dhe trafikim”. Neni 4 i ligjit saktëson se masë parandaluese është çdo masë me karakter pasuror, që gjykata vendos në një procedim gjyqësor, nëpërmjet sekuestrimit të pasurive, veprimtarisë ekonomike, tregtare dhe profesionale të personave, si dhe nëpërmjet konfiskimit të tyre. Ndaj garancia e cituar kushtetuese nuk ka lidhje me objektin e ligjit dhe, për këtë arsye, Gjykata arrin në përfundimin se ligji nuk shkel nenin 27, paragrafi 2 shkronja “c” të Kushtetutës dhe pretendimi i kërkuar është i pabazuar” (VGJK Nr. 4/11, date 23.2.2011, paragrafi 16, fq. 11).

Në argumentimin e Gjykatës, del qartë se standarti “dyshim i bazuar bazuar në indicje”, i referohet parimit “*in rem*”, ndërsa standarti “dyshim i arsyeshëm”, parashikuar nga neni 27 paragrafi 2 i Kushtetutës, i referohet parimit “*in personam*”. Kërkuar në kërkesën e tij lidhur me pretendimin e “cënimit të së drejtës së pronës”, i referohet nenit 41 të Kushtetutës dhe nenit 1 të Protokollit të KEDNJ –së. Në arsyetimin e saj, Gjykata vlerëson se masat parandaluese, të parashikuara në ligj, cënojnë të drejtën e pronës, por çështja që shtrohet është nëse kufizimet janë të nevojshme, pra behen për një interes publik dhe janë në përpjestim me gjendjen që ka diktuar marrjen e ketyre masave. Në nenin 17/1 i Kushtetutës, kërkesat e të cilit shtrihet ndaj të gjitha të drejtave dhe lirive të parashikuara në Kushtetutë, parashikon se “kufizime të të drejtave dhe lirive të parashikuara në këtë Kushtetutë mund të vendosen vetëm me ligj, për një interes publik ose për mbrojtjen e të drejtave të të tjerëve. Kufizimi duhet të jetë në përpjesëtim me gjendjen që e ka diktuar atë”. Nga ky arsyetim dhe referenca në dispozitat kushtetuese del qartë se kufizimi i të drejtave, duke përfshirë edhe atë mbi pronësinë, kërkon plotësimin e dy kushteve: të ketë interes publik dhe të zbatohet parimi i proporcionalitetit. Gjykata në arsyetimin e saj vlerëson:

“Në zbatim të kriterëve të mësipërme kushtetuese dhe jurisprudencës së saj, Gjykata Kushtetuese vlerëson se kufizimet e të drejtës së pronës dhe të veprimtarisë ekonomike janë vendosur për t’i shërbyer një interesi publik që është parandalimi dhe goditja e krimit të organizuar dhe trafikimit përmes sekuestrimit dhe konfiskimit të pasurive të personave të dyshuar për pjesëmarrje në organizata kriminale, pjesëmarrje në organizata terroriste e banda

të armatosura e trafikime. Nëpërmjet ngrirjes dhe konfiskimit të pasurive, ligji synon parandalimin e kryerjes së veprimtarive kriminale” (VGJK Nr. 4/11, date 23.2.2011, paragrafi 20, fq. 14).

Ndërsa për respektimin e proporcionalitetit:

“Gjykata vlerëson se edhe parashikimi në nenin 29/3, për zhdëmtimin respekton parimin e proporcionalitetit të kufizimit. Kështu, ky nen parashikon se zotëruesi i pasurisë ka të drejtë të kërkojë zhdëmtim të drejtë, nëse në vijim provohet paligjshmëria ose pabazueshmëria e konfiskimit. Pra, Gjykata arrin në përfundimin se masat parandaluese, të parashikuara në ligj, i shërbejnë një interesi publik dhe janë në përpjesëtim me gjendjen që e kanë diktuar atë. Ligji parashikon garanci të tilla procedurale në mënyrë që të arrihet një balancë e drejtë ndërmjet kërkesave të interesit të përgjithshëm dhe interesave të individit ose individëve në fjalë, (VGJK Nr. 4/11, date 23.2.2011, paragrafi 25, fq. 15).

Kërkuesi pretendon se ligji cenon një sërë elementesh të procesit të rregullt ligjor. Më konkretisht kërkuesi pretendon: neni 12, paragrafi 1 i ligjit mohon të drejtën e aksesit efektiv në gjykatë, bazuar mbi parimin e kontradiktoritetit, barazinë e armëve dhe *të drejtën për t’u gjykuar*, pasi parashikon se kërkesa për vendosjen e *sekuestros* shqyrtohet nga gjykata në praninë e prokurorit, në bazë të dokumenteve të paraqitura prej tij; ky ligj nuk parashikon asnjë kriter ose kusht ligjor që duhet të plotësojë kërkesa e prokurorit për *konfiskimin* e pasurisë, me qëllim që kjo kërkesë të jetë e vlerësueshme dhe pranueshme prej gjykatës; neni 21 paragrafi 3 shkel të drejtën e procesit të rregullt ligjor, pasi ndryshon marrëdhënien procedurale dhe sjelljen e palëve në procesin gjyqësor civil, si dhe shkel *prezumimin e pafajësisë* dhe se kështu bëhet kalimi i *barrës së provës* nga organi i Prokurorisë te personi ndaj të cilit do të zbatohet masa e konfiskimit; neni 10 paragrafi 1, neni 13 dhe 23 paragrafi 2 të ligjit, ku parashikohet roli aktiv i gjykatës në proces, vijnë në kundërshtim me thelbin e procesit të rregullt ligjor, duke shkelur kështu parimin e paanshmërisë së gjykatës; ligji shkel parimin e juridiksionit gjyqësor, pasi në kundërshtim me ndarjen e juridiksionit gjyqësor në gjykata penale dhe civile, cakton një gjykatë penale të gjykojë një proces civil. Kështu

shkelet e drejta e çdo individi që të gjykohet nga një gjykatë kompetente e caktuar me ligj, si element i procesit të rregullt ligjor. Subjektet e interesuara i prapësojnë këto pretendime duke pretenduar se ndonëse ligji kufizon të drejtat dhe liritë themelore të shtetasve, ai është në përputhje me Kushtetutën se bëhet për një qëllim të ligjshëm dhe ky kufizim është bërë duke respektuar kërkesat e nenit 17 të Kushtetutës¹¹⁸. Gjykata arsyeton dhe vlerëson me të drejtë kur ndan konceptet “sekestrim” dhe “konfiskim”. Edhe neni 12, paragrafi 1 i ligjit parashikon procedura dhe afatin kohor referuar *sekestrimit*, ndërsa “barra e provës, për të vërtetuar se pasuritë janë fituar në mënyrë të ligjshme, i përket personit, kundër pasurive të të cilit kërkohet *konfiskimi*”¹¹⁹. Arsyetimi dhe vlerësimi i plotë duke sqaruar dhe elementë të tjerë si barra e provës, proces i rregullt gjyqësor, formën e kërkesës, dhe rolin aktiv të gjykatës, të arsyetuar në formë të përmbledhur dhe në paragrafin 34 të vendimit ku thuhet: Për pretendimin e kërkuesit se ligji nuk parashikon asnjë kriter apo kusht ligjor që duhet të plotësojë kërkesa e prokurorit për konfiskimin e pasurisë, me qëllim që ajo të jetë e pranueshme dhe e vlerësueshme prej gjykatës, Gjykata, së pari vlerëson se kërkuesi nuk ka argumentuar para saj në mënyrë të qartë se me cilin element të procesit të rregullt lidhet ky pretendim. Megjithatë, Gjykata e analizon këtë pretendim, që lidhet me nenin 21 të ligjit, në dritën e parimit të kontradiktoritetit. Gjykata vëren se neni 21 për kriteret për konfiskim të pasurisë dhe barrën e provës shprehet se masa e konfiskimit vendoset me kërkesë të prokurorit, i cili i paraqet gjykatës arsyet ku bazohet kërkesa. Barra e provës më pas i kalon personit, i cili duhet të vërtetojë që pasuria është fituar në mënyrë të ligjshme. Neni 22 sqaron

¹¹⁸ VGJK Nr. 4/11, date 23.2.2011, paragrafi 28, fq. 17.

¹¹⁹ Neni 21 paragrafi 3 i ligjit nr. 10192, datë 3.12.2009, “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit dhe korrupsionit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë, ndryshuar me ligjin 24/2014

me hollësi procedurën e konfiskimit. Pra, është mëse e qartë që para gjykatës zhvillohet një proces gjyqësor, ku palët shprehin argumentet e tyre dhe kanë mundësi të debatojnë, për të ndikuar vendimmarrjen gjyqësore. Vendimi i gjykatës, përveç elementeve të parashikuara në nenin 310 të KPC-së, sipas të cilit vendimi duhet të përmbajë hyrjen, pjesën arsyetuese dhe pjesën urdhëruese, ku pjesa arsyetuese duhet të përmendë rrethanat e çështjes ashtu siç janë vërejtur nga gjykata gjatë gjykimit, provat dhe arsyet në të cilat mbështetet vendimi, duhet të përmbajë edhe a) llojin e masës parandaluese dhe kohëzgjatjen e saj, nëse masa është caktuar me afat; b) llojin e pasurisë me të gjitha të dhënat që shërbejnë për identifikimin e saj, përfshirë edhe vendndodhjen ose çdo gjë tjetër që vlen për ta identifikuar atë; c) parashtrimin e përmbledhur të faktit dhe shkakun ligjor të masës parandaluese; ç) masën e shpenzimeve procedurale, llojin e tyre, si dhe të dhëna për personin, të cilit i ngarkohen ato. Gjykata çmon se këtë vendimmarrje gjykatat e zakonshme nuk mund ta arrijnë pa kryer një hetim gjyqësor të plotë dhe të gjithanshëm në përputhje me ligjin dhe duke lejuar një debat të plotë gjyqësor. Prandaj Gjykata arrin në përfundimin se edhe ky pretendim i kërkuarit është i pambështetur¹²⁰.

Lidhur me pretendimin se çënohet parimi prezumimit të pafajësisë, bëhet interpretimi i përmbajtjes së prezumimit të pafajësisë referuar nenit 30 të Kushtetutës dhe shprehet se ky interpretim lidhet ngushtësisht me proceset penale. Ndërsa ligji për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar dhe trafikimit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë, është një proces autonom nga procesi penal, ndaj “garancitë e procesit penal nuk

¹²⁰ VGJK Nr. 4/11, date 23.2.2011, paragrafi 34, fq. 20-21.

mund të gjejnë zbatim në këtë proces të rregulluar nga ligji objekt shqyrtimi. Siç e konfirmon edhe neni 5, paragrafi 1, ky ligj rregullon marrëdhënien ndërmjet procedurës së caktimit të masave parandaluese dhe procedimit penal, duke vendosur se “procedura e caktimit dhe e zbatimit të masave parandaluese, sipas këtij ligji, është autonome nga gjendja, shkalla apo përfundimi i procedimit penal që zhvillohet në ngarkim të personave, subjekt të këtij ligji¹²¹. Referuar dhe praktikës italiane, nga ku dhe është marrë ky ligj parandalues Gjykata shprehet: “Në vijim të këtyre arsyetimeve dhe argumenteve për nevojën e dallimit ndërmjet procesit penal dhe procesit parandalues, garancitë e procesit penal për prezumimin e pafajësisë nuk janë të zbatueshme në procesin parandalues, të sanksionuar nga ligji objekt shqyrtimi. Gjykata vëren se këtë dallim ndërmjet procesit penal dhe procesit të masave parandaluese dhe zbatimin e garancive të procesit penal në procedimin e masave parandaluese e vë në dukje edhe Gjykata Kushtetuese Italiane, kur shprehet për kushtetueshmërinë e ligjit italian të vitit 1956 (për masat parandaluese ndaj pasurive të krimit të organizuar). Gjykata Kushtetuese Italiane, me vendimin nr. 27 të vitit 1959 dhe vendimin nr. 23 të vitit 1964 ka mbajtur këtë qëndrim: “...në sistemin ligjor italian ka një dallim thelbësor ndërmjet dënimeve penale dhe masave parandaluese. Të parat përbëjnë një përgjigje ndaj akteve të paligjshme dhe pasojat që sjell ai veprim; të dytat janë mjet për parandalimin e kryerjes së një veprimi të tillë. Me fjalë të tjera një dënim penal lidhet me një vepër penale të kryer, ndërsa masat parandaluese synojnë të reduktojnë rrezikun e veprave të ardhshme.

¹²¹ VGJK Nr. 4/11, date 23.2.2011, paragrafi 37, fq. 21-22.

Meqenëse sanksionet penale dhe masat parandaluese janë në thelb të ndryshme, jo gjithë parimet kushtetuese që qëndrojnë në themel të sistemit penal, zbatohen ndaj tjetrit. Për shembull, prezumimi i pafajësisë nuk lidhet me masat parandaluese, pasi ato nuk bazohen në përgjegjësinë penale ose në fajin e personit¹²².

Siç del dhe nga arsyetimi i vendimit, barra e provës është e ndarë ndërmjet prokurorit dhe personit të cilit do t'i sekuestrohet ose konfiskohet pasuria. Që do të thotë se fillimisht barrën e provës për të krijuar bindjen e gjyqtarit lidhur me dyshimin e arsyeshëm bazuar në indicje e ka prokurori, i cili i paraqet gjykates kërkesën për konfiskimin, dhe me pas barrën e provës për të vërtetuar ligjshmërinë e burimeve të pasurisë objekt konfiskimi e ka personi të cilit i është sekuestruar pasuria, për të bindur gjykatën për ligjshmërinë.

Referuar nenit 6 të ligjit, Gjykata pranon se ka një ndërhyrje në të drejtën e mbrojtur nga neni 37 i Kushtetutës dhe neni 8 i KEDNJ-së. Por çështja është nëse kjo ndërhyrje është “e justifikueshme”, “në përputhje me ligjin” ose “e nevojshme në një shoqëri demokratike”.

Me të drejtë gjykata arsyeton dhe vlerëson:

Çështja që shtrohet është nëse kjo ndërhyrje është e justifikueshme sipas nenit 17 të Kushtetutës dhe nenit 8, paragrafi 2 i KEDNJ-së, pra nëse ajo është “në përputhje me ligjin” ose “e nevojshme në një shoqëri demokratike” për një nga qëllimet e parashikuara. Ligji, këtë proces verifikimi, e lidh me ata persona që bien në fushën e veprimit të nenit 3, pra për të cilët ka një dyshim të arsyeshëm bazuar në indicje për pjesëmarrje në organizata kriminale, terroriste etj. Ligji ka përcaktuar në mënyrë të qartë fushën e zbatimit, si dhe

¹²² Shih Vendimi i Gjykatës Kushtetuese Italiane të vitit 1964, VGJK Nr.4/11, fq. 22-23. (Përkthim i GjK)

personat që janë subjekt të dispozitave të tij. Fusha e zbatimit të ligjit është e kufizuar vetëm për personat për të cilët ekziston dyshimi i arsyeshëm për pjesëmarrjen e tyre në veprimtari kriminale me rrezikshmëri të lartë shoqërore. Për rrjedhojë, jo çdo subjekt në Shqipëri është i ekspozuar në verifikimet e organit të akuzës. Në rastin e verifikimit, sipas dispozitave të ligjit objekt shqyrtimi, është prokurori që, pas marrjes dijeni për pasuritë që duhen verifikuar, kryen hetimet përkatëse.

47. Gjykata Kushtetuese thekson se parandalimi dhe goditja e krimit të organizuar është një nga detyrat themelore të shtetit, me qëllim mbrojtjen e interesit publik dhe të drejtave e lirive themelore të njeriut. Për pasojë është e domosdoshme që të merren masa për verifikimin e të dhënave edhe pa pëlqimin e personit, për subjekte për të cilët ekziston dyshimi i arsyeshëm, bazuar në indicie për kryerjen e veprimeve kriminale, me qëllim parandalimin e krimit të organizuar dhe goditjen e një prej mjeteve kryesore që e mbështet këtë veprimtari.

48. Neni 8 i KEDNJ-së sanksionon të drejtën e çdokujt që t'i respektohet jeta private, përveç në shkallën e parashikuar nga ligji dhe kur, në një shoqëri demokratike, ndërhyrja në ushtrimin e kësaj të drejte është e domosdoshme për sigurimin kombëtar, për sigurinë publike, për mirëqenien ekonomike të vendit, për mbrojtjen e rendit ose për parandalimin e veprave penale, për mbrojtjen e shëndetit ose të moralit, ose për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të të tjerëve. Pra, siguria publike, parandalimi i veprave penale, si dhe mbrojtja e të drejtave të të tjerëve shërbejnë si premisa për të konsideruar, në përputhje me këtë Konventë, një ndërhyrje në të drejtën për jetë private. Pra, në bazë të argumenteve dhe

interpretimit të mësipërm, Gjykata vlerëson se edhe ky pretendim i kërkuesit nuk është i mbështetur¹²³.

Lidhur me pretendimin se ligji shkel “hierarkinë e akteve normative”, gjykata vlerëson se përderisa nuk konstatohen shkelje të të drejtave në gjithë vlerësimin e bërë, nuk mund të vijojë me tej analizën e vlerësimit të pretendimeve për cënimin e hierarkisë së akteve normative.

Në tërësi, arsyetimi dhe vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese në këtë vendim, ka qartësuar me interpretimin e saj, shumë elementë të domosdoshëm, dhe referuar vendimit dhe argumenteve jepen qarte elementet e procesit të hetimit financiar me qëllim sekuestrimin dhe procedurat që duhet të ndiqen nga ana e organeve të ndjekjes penale dhe gjykata, duke dhënë një kontribut konkret në jurisprudencën shqiptare, për të kuptuar dhe zbatuar këtë ligj mjaft të rëndësishëm, ligj i cili sjell një mjet tjetër në duart e prokurorëve për efikasitetin e goditjes së krimit të organizuar dhe trafikeve dhe parandalimin e kryerjes së veprave të tjera penale.

4.2.3.3 Praktika e Gjykatës Europiane e të Drejtave të Njeriut

Hetimet financiare dhe konfiskimi i produkteve të krimit, si një mjet i ri në luftën dhe parandalimin e krimit të organizuar, trafikeve, terrorizmit, pastrimit të parave dhe korrupsionit, kanë gjetur kundërshtimin e tyre dhe në jurisprudencën ndërkombëtare. Me interes në këtë punim është analiza e disa rasteve objekt gjykimi në Gjykatën Europiane të

¹²³ VGJK Nr. 4/11, date 23.2.2011, paragrafi 46, 47, 48, fq. 25.

të Drejtave të Njeriut, sidomos kundërshtimet lidhur me nenin 6, 8 të KEDNJ-së dhe nenit 1 të Protokollit shtesë të KEDNJ-së. Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut (ECHR) testoi pajtueshmërinë e legjislacioneve kombëtare me ECHR-në. në disa raste duke arsyetuar se:

- Presumimi i pafajësisë¹²⁴ zbatohet për procesin penal në tërësi , duke përfshirë dhe lëshimin e një urdhëri për konfiskim, si pjesë të tij, dhe respektimi i këtij prezumimi duhet të aplikohet gjatë gjithë procesit gjyqësor dhe jo ndarazi për secilën fazë;

- Përdorimi i supozimeve mbi faktet ose ligjin është i pranueshëm brenda kufijve të arsyeshëm dhe duhet të jetë në përpjestim me rrethanat e çështjes (parimi i proporcionalitetit) si dhe duhet respektojë të drejtën e mbrojtjes (parimi i barazisë së armëve¹²⁵). Supozimet nuk mund të jenë kurrë të pakundërshtueshme dhe gjykata duhet të ketë një marzh vlerësimi. Prandaj, përmbysja totale e barrës së provës, apo konfiskimi i përgjithshëm janë të palejueshme;

- E drejta për të mos u vetë-inkriminuar, si pjesë e së drejtës për një gjykim të drejtë, i nënshtrohet një interpretimi strikt nga Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut, por kjo e drejtë nuk është absolute. Kur ngrihen akuza të sakta dhe sillen prova të mjaftueshme, sjellja e të pandehurit duke mos ju përgjigjur asnjë pyetje mund të konsiderohet si një tregues shtesë fajësie¹²⁶ . Deklaratat e siguruara nëpërmjet procedurave administrative, gjatë të cilave i

¹²⁴ Minelli kundër Zvicrës, 25. 3. 1983, No. 8660/79, marrë nga adresa zyrtare e HUDOC, [http://hudoc.Echr.coe.int/eng#{"appno":\["8660/79"\],"itemid":\["001-57540"\]}](http://hudoc.Echr.coe.int/eng#{), parë më 20 Prill 2014.

¹²⁵ Salabiaku kundër Francës, 7.10.1988, No. 10519/83, marrë nga adresa zyrtare e HUDOC, [http://hudoc.echr.coe.int/eng#{"appno":\["10519/83"\],"itemid":\["001-57570"\]}](http://hudoc.echr.coe.int/eng#{), parë më 20 Prill 2014.

¹²⁶ Murray kundër Mbretërisë së Bashkuar, 8.2.1986, no. 18731/91, marrë nga adresa zyrtare e HUDOC, [http://hudoc.echr.coe.int/eng#{"itemid":\["001-57980"\]}](http://hudoc.echr.coe.int/eng#{), parë më 20 Prill 2014.

dyshuari ka qenë i detyruar të tregojë të vërtetën janë të papranueshme në procedurat e mëtejshme penale¹²⁷.

- GjEDNj jep një përkufizim autonom për nocionet “dënim” dhe “masë”, dhe zbatimi i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut varet nga ky kualifikim¹²⁸. Kritere me rëndësi do të jenë nëse masa është vendosur në vijim të dënimit për një vepër penale, natyra dhe qëllimi i masës, karakterizmi i saj në ligjin vendas, procedurat e përdorura në krijimin dhe zbatimin e masës si dhe ashpërsia e saj.

Në çështjen Phillips¹²⁹, GjEDNj, mori në shqyrtim pajtueshmërinë me Konventën të disa prej dispozitave të ligjit kundër trafikut të drogës të Mbretërisë së Bashkuar, të vitit 1994 që kishin lidhje me konfiskimin e produkteve të krimit. Phillips u dënua me burgim për trafik të kanabisit dhe u urdhërua të paguante një shumë parash që gjykata çmoi se ai i kishte përfituar nga trafiku i drogës. Hetimi tregoi se Phillips nuk kishte deklaruar një burim fitimi të tatueshëm, megjithëse ai ishte pronari i një shtëpie dhe i disa pasurive të tjera, mes të cilave ishin dhe pesë makina. Ai kishte dënime të mëparshme, por asnjë dënim që të lidhej për veprën e trafikut të drogës. U supozua se Phillips kishte përfituar nga trafiku i drogës dhe u vlerësua fitimi i përgjithshëm. I pandehuri nuk arriti të sillte elemente të besueshme për të kundërshtuar supozimin se ai e kishte përfituar këtë shumë parash nëpërmjet trafikut të drogës. Gjykata komentoj se, në përpjekje për të hedhur poshtë supozimin dhe për të

¹²⁷ Saunders kundër Mbretërisë së Bashkuar, 17.12.1996, no. 19187/91, marrë nga adresa zyrtare e HUDOC, [http://hudoc.echr.coe.int/eng#{"appno":\["19187/91"\],"itemid":\["001-58009"\]}](http://hudoc.echr.coe.int/eng#{), parë më 20 Prill 2014.

¹²⁸ Welch kundër Mbretërisë së Bashkuar, 9.2.1995, no.17440/90, marrë nga adresa zyrtare e HUDOC, [http://hudoc.echr.coe.int/eng#{"appno":\["17440/90"\]}](http://hudoc.echr.coe.int/eng#{), parë më 20 Prill 2014.

¹²⁹ Philips kundër Mbretërisë së Bashkuar, 5.7.2001, no. 41087/98, marrë nga adresa zyrtare e HUDOC, [http://hudoc.echr.coe.int/eng#{"appno":\["41087/98"\]}](http://hudoc.echr.coe.int/eng#{), parë më 20 Prill 2014.

kundërshtuar akuzat e prokurorit, pala mbrojtëse kishte dështuar në ndërmarrjen e hapave të kuptueshëm, të thjeshtë dhe të zakonshëm, të cilat natyrisht do të merreshin parasysh nëse rrëfimi i tij do të kishte qenë i vërtetë. Phillips akuzoi se supozimi statutor i aplikuar nga Gjykata Angleze gjatë përlllogaritjes së shumës në urdhërin e konfiskimit, cënoi të drejtën e tij për t'u prezumuar i pafajshëm, bazuar në nenin 6 § 2 të ECHR-së. Gjykata Evropiane e refuzoi akuzën e tij dhe deklaroi se supozimi statutor nuk ishte aplikuar për të lehtësuar deklarimin fajtor të të pandehurit për veprën penale, por përkundrazi për t'i mundësuar gjykatës kombëtare vlerësimin e shumës, që duhej të pasqyrohej në urdhërin për konfiskimin. Prezumimi i pafajësisë është ne fuqi deri në çastin që një person deklarohet fajtor, por ky prezumim nuk vijon të jetë i zbatueshëm gjatë procesit të dënimit, me përjashtim të rasteve kur akuza të reja ngrihen në drejtim të të pandehurit.

Gjykata Evropiane rrëzoi po ashtu akuzën e Phillips se e drejta e tij për një gjykim të drejtë duke përfshirë dhe të drejtën për mos vetëinkriminim ishte cënuar për faktin se ai ishte thirrur që të jepte vetë sqarime mbi prejardhjen e pasurive që kishte disponuar gjatë gjashtë viteve të fundit. Gjykata Evropiane konkludoi se sistemi sipas të cilit ishin përdorur supozimet përmbante garanci të mjaftueshme për një gjykim të drejtë. Garancia kryesore ishte se supozimi i bërë në bazë të Ligjit të vitit 1994 mund të rrëzohej në qoftë se i padituri do të tregonte, përsëri duke balancuar probabilitetet, se ai i kishte përfituar pronat jo nëpërmjet trafikimit të drogës. Gjykata kishte gjithashtu kompetencë që të mos e bënte supozimin në qoftë se ngritja e këtij supozimi do të shkaktonte një rrezik të madh për padrejtësi. Phillips ngriti gjithashtu pretendimin, se masa e konfiskimit e zbatuar mbi të cënonte të drejtën e tij për të gëzuar në mënyre paqësore pronat e tij dhe si rrjedhojë ishte shkelur neni 1 i protokollit nr. 1 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Gjykata Evropiane u përgjigj se

urdhërat e konfiskimit të mbështetura në supozimet e bëra sipas ligjit të vitit 1994, veprojnë si një pengesë ndaj atyre që konsiderohen si të përfshirë në trafikun e drogës dhe se ato kanë si qëllim ta privojnë një person të caktuar nga përfitimet e nxjerra nga trafiku i drogës, si dhe të shmangin mundësinë e përdorimit në të ardhmen të këtyre të ardhurave në tregtinë e drogës. Prandaj, ndërhyrja që iu bë të pandehurit në gëzimin paqësor të zotërimeve të tij nuk ishte e padrejtë dhe nëpërmjet kësaj ndërhyrjeje u arrit një marrëdhënie e arsyeshme proporcionaliteti midis mjeteve të përdorura dhe objektivit që ishte në synim (Golobinek, 2006).

4.3 Përmbledhje e kapitullit

Ky kapitull trajton teoritë dhe instrumentet juridikë ndërkombëtarë, regjional dhe kombëtar mbi hetimet financiare dhe konfiskimin e produkteve të krimit, lidhur me kontributin që ata kanë dhënë në të drejtën e brendëshme të Shqipërisë për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit dhe korrupsionit nëpërmjet masave paraprake kundër pasurisë. Ka pikëpamje të ndryshme lidhur me llojin e konfiskimit penal apo civil sipas autorëve të cilëve jemi referuar në këtë kapitull, ku secili jep arësyet e zbatimit të secilit lloj të konfiskimit. Mendoj se konfiskimi penal është një kufizim, pasi zbatohet vetëm ndaj pasurisë së personave ndaj të cilëve ka të rregjistruar një çështje penale dhe standarti i provës është shumë i lartë, duke mos realizuar qëllimin e konfiskimit së pari në marrjen e përhershme të fitimeve të paligjshme dhe shpërndarjen e tyre, dhe së dyti në heqjen e kushteve që çojnë në aktivitete të paligjshme. Ndërsa konfiskimi civil, është më i gjerë, dhe mund të aplikohet edhe për vepra të tjera ose edhe ndaj personave ndaj të cilëve nuk ka një akuzë konkrete. Vështirësia e zbatimit është se kush do ti kryejë veprimet, pasi kërkohet ngritja e strukturave

të reja në zbatimin e tyre. Në rastin e Shqipërisë, qasja “*in rem*”, bazohet në një ligj specifik, siç është ligji për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit dhe korrupsionit, ku hetimi është autonom, i pavarur nga procesi penal apo civil. Megjithatë në këtë ligj mund të zbatohen masat parandaluese kundër pasurisë ndaj personave për të cilët ekziston një dyshim i arsyeshëm bazuar në indicje për ato vepra penale të përcaktuara në përmbajtjen e nenit 3 të ligjit specifik. Pavarësisht se krijohet ideja për mundësinë e marrjes së masave paraprake kundër pasurisë, gjatë zbatimit të tyre, për shkak të kufizimit të mësipërm, nuk mund të zbatohet për të gjithë krimet që sjellin dobi pasurore të paligjshme, trajtuar në kapitullin III të këtij studimi. Pavarësisht rolit që kanë luajtur instrumentet juridikë ndërkombëtarë dhe regjionalë, roli parësor mbetet kërkesat e instrumenteve kombëtarë në zbatimin në praktikë. Në këtë këndvështrim mendoj se *së pari* rishikimi i dispozitave konkrete për fushën e zbatimit dhe rrethin e personave ndaj të cilëve zbatohen këta masa është e domosdoshme, dhe së dyti rishikimi i strukturave të specializuara për zbatimin, ose ngritja e strukturave të reja me njohuri në disa fusha është po kaq e domosdoshme.

Trajtimi në këtë kapitull të praktikave gjyqësore të Gjykatës Kushtetuese¹³⁰, dhe të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë¹³¹, krijojnë akoma më shumë bindjen për të rishikuar këta dispozita dhe vetë emërtimin e ligjit. Iniciativat ligjore për të ndërhyrë tre herë për shtesa e ndryshime të ligjit për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, është një argument shtesë për rishikimin e ligjit dhe strukturave ligjzbatuese.

¹³⁰ Vendimi nr. 4, datë 23.02.2011, Gjykata Kushtetuese, Tiranë

¹³¹ Vendimi Nr. 1, datë 25.1.2007, Gjykata e Lartë, Tiranë.

KAPITULLI V: ANALIZA E INSTRUMENTEVE JURIDIK DHE EFEKTIVITETI I ZBATIMIT TË TYRE NË HETIMET FINANCIARE PËR PERIUDHËN 2004 – 2014 NË SHQIPËRI

Përpara se të bëjmë analizën e instrumenteve juridik dhe efektivitetin e zbatimit në praktikë, vlerësoj të theksoj termat bazë të temës doktrinale të cilat janë: hetimet financiare, konfiskimi i produkteve të krimit, efektshmëria e hulumtuar për një periudhë 10 vjecare, në Shqipëri. Më sipër kemi shpjeguar për pyetsorët e përgatitur dhe metodat cilësore dhe sasore të cilat janë përdorur për agrumentimin e tezave dhe dhënjen e përgjigjeve pyetjeve kërkimore. Sqaroj që në fillim se periudha 2004-2014, si periudhë hulumtuese, është marrë pasi në vitin 2004, ka hyrë në fuqi ligji 9284 “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar”, ose siç thirret ndryshe ligji antimafja, si dhe u krijuan struktura të reja të luftës kundër krimit, si ajo e Drejtorisë së Krimit të Organizuar, e cila funksionon brënda strukturës së Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit. Sic është shpjeguar dhe më sipër përpara vitit 2004, sekuestrimi dhe konfiskimi është mbështetur sipas dispozitave të Kodit Penal dhe Kodit procedural penal, dhe nuk bëhej fjalë për hetime financiare të mirefillta, sipas instrumenteve ndërkombëtare, të cilat përcaktojnë një standart minimal për kushtet e hetimit financiar. Pikërisht për këtë periudhë, e cila përkon dhe me përfundimin e analizës së pyestorëve, është bërë krahasimi dhe analizimi i zbatueshmerisë së dispozitave të shkruara, duke gjetur tregues për diferencën ndërmjet ligjit të shkruar dhe ligjit të zbatuar, si dhe të metat për secilin variabël dhe fazë të hetimit financiar.

Fillimisht është bërë një vlerësim i gjendjes së treguesve statistikore gjatë dhe për secilin vit, sipas veprave penale për të cilat lejohet hetimi financiar dhe për gjithë periudhën 10 vjecare.

Si burim, për gjendjen aktuale për këtë periudhë janë marrë treguesit e nxjerre nga analizat vjetore të Prokurorisë së Krimeve të Rënda, si institucioni kompetent për fillimin dhe ndjekjen penale të hetimeve financiare. Tabela 1, më poshtë, jep të dhëna të plota të publikuara të treguesve për veprat penale për të cilat mund të fillonin hetimet financiare 333, 333/a, 234/a, 234/b, 230, 230/a, 230/b, 230/c, 230/ç, 231, 232, 232/a, 232/b, 233, 234, 234/a, 234/b, 109, 109/a, 109/b, 110/a, 114/a, 114/b, 128/b, 278/a, 282/a, 283, 283/a, 284/a, 287, 164/a, 244, 244/a, 245, 260, 319 dhe 319/ç sipas viteve të periudhës së hulumtimit.

Nenet	2004	2005	2006	2007	2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014	Total
333				1						1	1	3
333/a				4	26	5	3		18			56
234/a										1		1
234/b												0
230			5						4	1		10
230/a												0
230/b												0
230/c												0
230/ç												0
231												0
232												0
232/a												0
232/b												0
233												0
234												0
234/a												0
234/b												0
109			8	2	10	1	7				4	32
109/a	2	2										4
109/b			4	6	7	7			27	18	23	92
110/a	2	3									7	12
114/a										2	1	3
114/b	34	34	15	6	30	11	11	19	2			162
128/b	1	1	6	4	6	4	1				6	29
278/a			10	11		36	2		7	15	1	82
282/a			1	5	21					2		29
283			2	66	59	123	69		86	6		411
283/a	12	12	42					114		132	132	444
284/a	3	3										6
287										1		1
164/a												0
244												0
244/a												0
245												0
260												0
319											1	1
319/ç												0
Shuma	54	55	93	105	159	187	93	133	144	179	176	1378

Tabela 11: Statistikat 2004-2014, sipas veprave penale, në Shqipëri¹³²

¹³² Burimi është marrë nga Raportet vjetore të Gjykatës së Krimeve të Rënda

Theksojmë se vepra penale e shfrytëzimit të prostitucionit në rrethana rënduese, parashikuar nga neni 114/a, vepra penale prodhimi dhe shitja e narkotikëve, parashikuar nga neni 283 dhe vepra penale pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarive kriminale, parashikuar nga neni 287 të Kodit penal, janë përfshirë në kompetencën e Gjykatës së Krimeve të Rënda, në vitin 2009, me hyrjen në fuqi të ligjit Nr.10192, datë 3.12.2009, “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar dhe trafikimit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”. Grafiku i mëposhtëm paraqet gjendjen dhe treguesit sipas veprave penale për periudhën 2004- 2014, në Shqipëri, ku shihet qartë se peshën specifike më të madhe e zënë vepra penale e prodhimi dhe shitja e narkotikëve, (411 raste), parashikuar nga neni 283, trafikimi i narkotikëve, (312 raste), parashikuar nga neni 283/a, trafikimi i femrave, (162 raste), parashikuar nga neni 114/b, trafikimi i armëve dhe municioneve, (81 raste), parashikuar nga neni 278/a, dhe grup i strukturuar kriminal, (56 raste), parashikuar nga neni 333/a të Kodit Penal.




Figura 7: Statistika sipas veprave penale, për periudhën 2004-2014, në Shqipëri

Sipas Tabeles 1 dhe Figurës 4, janë paraqitur veprat penale, për të cilat mund të bëhen hetime financiare, sipas viteve. Nga kjo paraqitje shihet qartë se treguesit për veprat penale në vitet 2009 dhe 2013, janë në numrin më të madh, (187 raste në vitin 2009 dhe 179 raste në vitin

2013 dhe 176 raste në vitin 2014), vite që përkojnë me vitet elektorale, për zgjedhje politike, në Shqipëri.




Figura 8: Paraqitja në formë grafike, statistikave 2004-2014, sipas veprave penale, në Shqipëri

Një situatë më të qartë lidhur me hetimet financiare do të na jepte nëse shohim kërkesat për sekuestime dhe konfiskime nga Prokuroria e Krimeve të Rënda, për secilin vit, lidhur me periudhën 2004-2014, periudhë e hulumtimit në këtë punim. Sipas statistikave të marra nga raportet vjetore të Prokurorisë për Krime të Rënda, rezultatet janë sipas tabelës së mëposhtme: (Tabela 3)

Vitet	2004	2005	2006	2007	2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014	Total
Kerkesa	14	14	41	27	22	18	22	17	21	13	32	241
Zgjidhur	9	9	32	16	18	18	17	15	18	10	27	189
Mbartur	5	5	9	11	4	0	5	2	3	3	5	52

Tabela 12: Statistika për çështjet e hetimit financiar 2004-2014, në Shqipëri

Nëse bëjmë krahasimin ndërmjet rasteve për secilin vit dhe kërkesave për hetime financiare, rezulton sipas tabelës dhe grafikut të mëposhtëm: (Tabela 4, Figura 9)

Vite	2004	2005	2006	2007	2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014
Raste	54	55	93	105	159	187	93	133	144	179	176
Kerkesa	14	14	41	27	22	18	22	17	21	13	31
Diferenca	40	41	52	78	137	169	71	116	123	166	145
%	26%	25%	44%	26%	14%	10%	24%	13%	15%	7%	18%

Tabela 13: Raste, për hetime financiare dhe diferenca sipas viteve, në Shqipëri¹³³ 2004-2014

¹³³ Raporte Vjetore të Gjykatës së Krimeve të Rënda 2004- 2014




Figura 9: Raste, për hetime financiare dhe diferenca sipas viteve, në Shqipëri 2004-2013

Nga tabela dhe grafiku i mësipërm rezulton se për vitin 2004 kemi 54 raste dhe 14 kërkesa, për vitin 2005 kemi 55 raste dhe 14 kërkesa, viti 2006, 93 raste dhe 41 kërkesa, viti 2007, 105 raste me 27 kërkesa, në vitin 2008, 159 raste me 22 kërkesa, në vitin 2009, 187 raste me 18 kërkesa, në vitin 2010, 93 raste me 22 kërkesa, në vitin 2011, 133 raste me 17 kërkesa, dhe në vitin 2012, 144 raste me 21 kërkesa.

Nga këta tregues dhe paraqitja në formë grafike rezulton qartë se jo për të gjitha rastet janë ushtruar kërkesat për hetime financiare, dhe kjo për disa arsye të cilat do ti shpjegojmë më poshtë. Nëse shohim trendin e rasteve ndër vite dhe trendin e kërkesave për konfiskim, hetim financiar, sipas Figures 10, del qartë se ka një lidhje negative, ose përpjestim të zhdrejtë ndërmjet rasteve në rritje dhe kërkesave në ulje për hetimet financiare.




Figura 10: Trendi i rasteve dhe kërkesave

E shprehur në përqindje, zbatueshmëria e ligjit për hetimet financiare pasqyrohet në Tabelën 4 dhe Figurën 11, ku jepet dhe trendi në vite. Rezulton se zbatueshmëria në përqindje sipas viteve është për vitin 2004 është 26%, viti 2005 është 25%, viti 2006 është 44%, viti 2007 është 26 %, viti 2008 është 14 %, viti 2009 është 10 %, viti 2010 është 24 %, viti 2011 është 13 %, viti 2012 është 15 %, viti 2013 është 7% dhe viti 2014 është 18%. Ka një trend rënje të kërkesave në gjykatë lidhur me hetimet financiare.




Figura 11: Kërkesa në gjykatë për sekuestime/konfiskime, për periudhën 2004-2013

Në total, zbatueshmëria e ligjit për hetime financiare, për periudhën 2004-2014, është 17 %.

	2004	2005	2006	2007	2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014
%	0.16667	0.16364	0.34409	0.15238	0.11321	0.09626	0.1828	0.11278	0.125	0.05587	0.15341
intervali	4	4	4	4	4	4	4	4	4	4	4
	0.666667	0.654545	1.376344	0.609524	0.45283	0.385027	0.731183	0.451128	0.5	0.223464	0.613636
	1	1	1	1	1	1	1	1	1	1	1
nota	1.666667	1.654545	2.376344	1.609524	1.45283	1.385027	1.731183	1.451128	1.5	1.223464	1.613636
nota*	TOTAL										1.7

Tabela 14: Koeficientët në përqindje dhe vlerësimi sipas viteve nga nota 1-5

Siç shihet dhe nga përlllogaritjet e mësipërme, Shqipëria për periudhën 2004- 2014, ka një zbatueshmëri të ligjit për hetimet financiare në masën 17 përqind, ose e vlerësuar në notë nga 1-5, me notën 1.7. Tregues ky mjaft i ulët i zbatueshmërisë së ligjit. Por cilat janë shkaqet të cilat kanë sjellë këtë tregues të zbatimit të ligjit për hetimet financiare? Nga një analizë e hollësishme e raporteve vjetore të Gjykatës së krimeve të rënda dhe analizës vjetore të Prokurorisë së Krimeve të Rënda, si dhe nga pyetsoret e përdorur për të matur

zbatueshmërinë sipas variablave të pasqyruar në pyetsor, dhe komentet e dhëna nga ekspertët rezulton se në fund të vitit 2004 ka hyrë në fuqi ligji antimafia. Në sanksionet lidhur me veprën penale të trafikimit janë aplikuar për herë të parë dy dënime kryesore si dhe dënimi plotësues konfiskimi i produkteve të vepres penale, por si dënim plotësues, jo si masë. Sipas raportit vjetor 2004, janë aplikuar 14 kërkesa për sekuestro dhe në dhënien e sanksioneve është pasur parasysh dhe aplikimi i njëkohshëm i dy dënimeve kryesore, atij me burgim dhe me gjobë, ndaj të pandehurve të gjetur fajtor për kryerjen e veprës penale të “Trafikimit”. Ndaj këtyre të pandehurve janë vendosur dhe sekuestro të pasurive të luajtshme dhe të paluajtshme, pasuri këto të ardhura nga kryerja e vepres penale (GJKR, Raport vjetor , 2004, p. 14). Për herë të parë u aplikuan dhe dispozitat e ligjit për parandalimin e krimit të organizuar dhe sipas raportit thuhet: “Ndaj këtyre të pandehurve janë vendosur dhe sekuestro të pasurive të luajtshme dhe të paluajtshme, pasuri këto të ardhura nga kryerja e veprës penale sipas dispozitave përkatëse të Kodit të Procedurës Penale si dhe në bazë të ligjit “Për goditjen dhe parandalimin e krimit të organizuar” (GJKR, 2005, p. 17). Implementimi i këtij ligji ka patur vështirësi edhe në kuptueshmërinë e termave të përdorura lidhur me veprimin e ligjit në kohë, sekuestrimin paraprak dhe sekuestrimin si faza të domosdoshme për konfiskimin, kuptimi i pezullimit të përkohshëm, duke u bërë dhe objekt i shqyrtimit gjyqësor. Sipas vendimit Nr.1, datë 25.1.2007 i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, është unifikuar praktika gjyqësore për çështje të tilla si: kuptimi i nenit 4/3 të ligjit LPGKO, për gjykatën kompetente, përbërjen e saj, natyrën e gjykimit, veprimin e ligjit në kohë, kuptimin e interpretimi i neneve 7 dhe 10 të ligjit dhe nëse sekuestrimi paraprak dhe sekuestrimi janë faza të domosdoshme që duhet ti paraprijnë konfiskimit, nëse konfiskimi bëhet vetëm pasi të jetë bërë sekuestrimi, cili është kuptimi i pezullimit të

përkohshëm. Për të bërë një analizë të plotë lidhur me hulumtimin për hetimet financiare, së pari termi hetim financiar përdoret në kuptimin e gjerë, për të gjithë masat dhe referuar dispozitave kombëtare mbi hetimet financiare dhe, së dyti hetimet financiare që kanë të bëjnë me dispozitat për kryerjen e hetimeve financiare për produktet e krimit, që lidhen me veprat penale të parashikuara në ligjin antimafia, që synojnë të privojnë kriminelet nga fitimet e tyre të paligjshme në tre faza: *Faza e hetimit*, që përfshin masat për identifikimin, zbulimin dhe gjurmimin e produkteve të krimit, për të identifikuar mjetet financiare, pasuritë, veprimtaritë ekonomike, mënyren e jetesës, si dhe burimet e të ardhurave të tyre; *Faza e gjykimit*, që përfshin shqyrtimin e kërkesave dhe dhënjen e vendimeve për sekuestrimet dhe konfiskimet e mjetet financiare, pasuritë, veprimtaritë ekonomike; *Faza e administrimit* dhe përdorimit, që përfshin masat për administrimin e pronës së sekuestruar dhe të konfiskuar dhe përdorimin e destinacionin e të ardhurave të konfiskuara. Kërkimi jep rezultate konkrete mbi zbatimin e ligjit në praktikë për masat e hetimeve financiare dhe konfiskimin e produkteve të krimit, diferencën ndërmjet ligjit të shkruar dhe ligjit të zbatuar, bazuar në teorinë e Roscoe Pound, diferenca ndërmjet “law in books” dhe “law in the action” (Pound R. , 1923). Përgjigjet e dhëna në pyetsor japin rezultatet e zbatimit në praktikë sipas fazave, hetimit, gjykimit dhe administrimit. Zbatimi i plotë i ligjit do të paraqitet në barazimin:

$$Lsh = (Lz * Fsf)$$

ku:

Lsh - ligji në fuqi për secilën fazë

Lz - Zbatimi i ligjit sipas fazave.

Fsf - Faktorët për secilën fazë

5.1 Faza e hetimit

Për fazën e hetimit, konsiderojmë që zbatimi i ligjit mund të shprehet me ekuacionin:

$$Lsh\ fh = (Lz\ fh * Fs\ fh)$$

ku:

Lsh fh - Ligji në fuqi për fazën e hetimit

Lz fh - Zbatimi i ligjit për fazën e hetimit

Fs fh - Faktorët për fazën e hetimit

Për të matur zbatimin e ligjit në praktikë të ligjit në fuqi për hetimet financiare, janë përzgjedhur variablat për ligjin në fuqi, dhe variablat për faktorët që ndikojnë në zbatimin e ligjit. Për fazën e hetimit janë përzgjedhur dy variabla për ligjin në fuqi, dhe 10 variabla për faktorët në fazën e hetimit, si më poshtë:

Variabli 1. Shpeshtësia e përdorimit të mjeteve speciale të hetimit, nëse përdorimi i tyre është parashikuar. Sa më i shpeshtë është përdorimi i mjeteve speciale të hetimit, nga shakalla 1 deri 5, aq më i mirë është zbatimi i ligjit në fuqi.

Variabli 2. Frekuenca e hetimeve financiare për palët e treta, duke menduar se ata janë mbështetës të të pandehurve për të fshehur pasurinë. Konsiderohet se sa më shpesh të kryhen hetime për palët e treta, nga shkalla prej 1 deri në 5, aq më shumë supozohet se zbatohet ligji në hetimet financiare.

Variabli 3. (Faktor) Niveli i bashkëpunimit të bankave në fazën hetimore. Konsiderohet se sa më i lartë të jetë niveli i bashkëpunimit me bankat, aq më i lartë është zbatimi i ligjit.

Bankat janë vendet në të cilat kriminelët vendosin ose investojnë produktet e krimit, me qëllim të fshehin origjinën e tyre të paligjshme. Në këto kushte bankat kontribuojnë fuqishëm

për identifikimin e pasurive të paligjshme, dhe për këtë arsye dhe ndihmojnë në zbatimin e ligjit për hetimet financiare¹³⁴.

Variabli 4. (Faktor) Niveli i bashkëpunimit nga ana e institucioneve financiare jo bankare në fazën e hetimit. Sa më i lartë niveli i bashkëpunimit nga ana e institucioneve financiare jo bankare, aq më mirë është supozuar të jetë zbatimi i ligjit.

Institucionet financiare jo bankare janë vendet në të cilat të ardhurat kriminale janë vendosur ose investuar në mënyrë që të fshehin origjinën e tyre të pistë, ata mund të kontribuojnë në mënyrë të konsiderueshme në identifikimin e pasurisë së paligjshme, dhe për këtë arsye plotësojnë zbatimin e dispozitave të hetimeve financiare dhe konfiskimit¹³⁵.

Variabli 5. (Faktor) Niveli i bashkëpunimit nga ana e institucioneve jo-financiare në fazën e hetimit. Sa më i lartë niveli i bashkëpunimit nga ana e institucioneve financiare jo bankare, aq më mirë është supozuar të jetë zbatimi i ligjit.

Institucionet jo-financiare janë vendet në të cilat të ardhurat kriminale janë vendosur ose investuar në mënyrë që të fshehin origjinën e tyre të pistë, ata mund të kontribuojnë në mënyrë të konsiderueshme në identifikimin e pasurisë së paligjshme, dhe për këtë arsye e bëjnë më të plotë zbatimin e dispozitave të hetimit financiar dhe konfiskimit¹³⁶.

¹³⁴ Këshilli i Evropës, Direktiva e Bashkimit 2001/97 / EC, 4 dhjetor 2001 e cila amendon Direktivën e Këshillit 91/308 / EEC të datës 10 qershor 1991 mbi parandalimin e përdorimit të sistemit financiar për qëllime të pastrimit të parave.

¹³⁵ Këshilli i Evropës, Direktiva e Bashkimit 2001/97 / EC, 4 dhjetor 2001 e cila amendon Direktivën e Këshillit 91/308 / EEC e 10 qershorit 1991 mbi parandalimin e përdorimit të sistemit financiar për qëllime të pastrimit të parave.

¹³⁶ Këshilli i Evropës, Direktiva e Bashkimit 2001/97 / EC e 4 Dhjetor 2001 amendon Direktivën e Këshillit 91/308 / EEC e 10 qershorit 1991 mbi parandalimin e përdorimit të sistemit financiar për qëllime të pastrimit të parave.

Variabli 6. (Faktor) Niveli i trajnimit për hetimin financiar. Sa më i lartë niveli i trajnimit për hetimin financiar, aq më mirë është supozuar të jetë zbatimi i ligjit.

Hetimet financiare janë shumë komplekse dhe kërkojnë që hetuesit të kenë forma të veçanta të ekspertizës (në të drejtën civile, ligjit financiar, të drejtën tregtare, etj). Zbatimi i plotë i ligjit kërkon trajnim të përshtatshëm dhe të veçantë për hetuesit¹³⁷.

Variabli 7. (Faktor) Niveli i përbërjes shumëdisiplinore të zyrës për kryerjen e hetimeve financiare. Sa më e gjerë përbërja multidisiplinare e zyrës për kryerjen e hetimeve financiare, aq më mirë është supozuar të jetë zbatimi i ligjit.

Hetimet financiare janë shumë komplekse. Zbatimi i plotë i ligjit varet nga të dhëna të aftësive, kompetencave dhe njohurive në fushat e kontabilitetit, të drejtës civile, të drejtës financiare, të drejtës tregtare, etj, që kanë agjenci të ndryshme në fazën e hetimit¹³⁸.

Variabli 8. (Faktor) Niveli i bashkëpunimit ndërmjet agjencive, dmth bashkëpunimit mes agjencive të ndryshme të zbatimit të ligjit kombëtar (forcave të policisë, agjencive të të ardhurave, shërbimeve të prokurorisë, etj, në zhvillimin e hetimeve financiare.

Sa më i lartë niveli i bashkëpunimit ndërmjet agjencive në zhvillimin e hetimeve financiare, aq më mirë supozohet se është zbatimi i ligjit. Agjenci të ndryshme të zbatimit të ligjit mbledhin informacion i cili ndihmon në hetimet financiare si informacion gjatë ndjekjes penale, informacion për aktivitetet dhe veprimtaritë ekonomike, pasuritë etj,

¹³⁷ Këshilli i Veprimit të Përbashkët të Bashkimit Evropian të datës 3 dhjetor 1998; Këshilli i Bashkimit Evropian (2000); Plani i Veprimit të Këshillit të datës 27 mars 2000; Europol (2000); Zyra e Kabinetit, Performanca dhe Njësia Inovacionit (2000); Këshilli i Europës (2001).

¹³⁸ Task Force e Veprimit Financiar mbi Pastrimin e Parave (2001); Bell (2003).

Shkëmbimi dhe kontrolli për të gjitha informacioneve të aseteve të një individi mund të mbështesë zbatimin e dispozitave ligjore dhe të rritur potencialin e tyre në hetimet financiare¹³⁹.

Variabli 9. (Faktor) Shkalla e bashkëpunimit nga informatorët, dëshmitarëve për hetimet financiare. Sa më e lartë shkalla e bashkëpunimit nga informatorët, dëshmitarët për hetimet financiare, aq më mirë supozohet se zbatohet ligji. Për shkak se ata kanë qenë të përfshirë në aktivitetet e organizatave kriminale ose të ketë njohuri për to, informatorët, dëshmitarët mund të zbulojnë detaje të dobishme në vendndodhjen e fitimeve të paligjshme, duke ndihmuar agjencitë e zbatimit të ligjit në zbatimin e dispozitave të konfiskimit¹⁴⁰.

Variabli 10. (Faktor) Frekuenca e hetimeve financiare në rastet e krimit të organizuar, duke marrë parasysh faza në të cilën ato janë kryer.

Sa më të shpeshta dhe më herët të fillojë kryerja e hetimeve financiare në rastet e krimit të organizuar, aq më mirë supozohet se është zbatimi i ligjit.

Duke pasur parasysh se krimet e organizuara zakonisht gjenerojnë të ardhura të mëdha, zbatimi i ligjit është mbështetur nga përdorimi sistematik të hetimeve financiare, veçanërisht nëse kryhet nga fillimi, për të parandaluar kriminelët që të fshehin pasuritë e tyre dhe për tu shmangur nga konfiskimi¹⁴¹.

Variabli 11. (Faktor) Përshtatshmëria e burimeve njerëzore të përkushtuara për identifikimin e produkteve të krimit, në lidhje me numrin e tyre të përgjithshëm.

¹³⁹ Këshilli i Bashkimit Evropian (2000); Këshilli i Europës (2001); Task Forca e Veprimit Financiar mbi Pastrimin e Parave (2001).

¹⁴⁰ Komisioni i Reformës Ligji i Irlandës (1991); Commissione Parlamentare Antimafia (1998).

¹⁴¹ Rekomandimi i Këshillit të 25 prillit 2002; Europol (2000); Zyra e Kabinetit, Performanca dhe Njësia Inovacionit (2000).

Sa më të përshtatshme të jenë burimet njerëzore dhe të përkushtuar për identifikimin e produkteve të krimit, më mirë supozohet zbatimi i ligjit. Pa burimeve njerëzore nuk mund të ketë zbatim të ligjit. Prandaj, zbatimi i plotë i ligjit kërkon një numër të përshtatshëm të burimeve njerëzore që të jenë të përkushtuara për hetimet financiare¹⁴².

Variabli 12. (Faktor) Përshtatshmëria e burimeve materiale për identifikimin e produkteve të krimit. Sa më të përshtatshme të jenë burimet materiale për identifikimin e produkteve të krimit, aq më mirë supozohet se zbatohet ligji. Pa burimet materiale nuk mund të ketë zbatim të ligjit. Prandaj, zbatimi i plotë i ligjit kërkon një fond të përshtatshëm të burimeve materiale të përcaktuar për hetimet financiare¹⁴³.

5.2 Faza e gjykimit

Për fazën e gjykimit, konsiderojmë që zbatimi i ligjit mund të shprehet me ekuacionin:

$$Lsh\ fgj = (Lz\ fgj * Fsfgj)$$

ku:

Lsh fgj - Ligji në fuqi për fazën e gjykimit

Lz fgj - Zbatimi i ligjit të shkruar për fazën e gjykimit

Fsfgj - Faktorët për fazën e gjykimit

Variabli 13. Niveli i pengesave ndaj çështjes së një konfiskimi, të ngritur nga nevoja për një bindje, arësye, në qoftë se një bindje e tillë është (gjithmonë ose nganjëherë) një parakusht

¹⁴² Plani i Veprimit të Këshillit të 27 Mars 2000; Këshilli i Europës (2001).

¹⁴³ Plani i Veprimit të Këshillit të Europës, 27 Mars 2000; Këshilli i Europës (2001).

për konfiskim. Sa më i ulët niveli i pengesave kundër çështjes së një të konfiskimit aq më mirë është supozohet se zbatohet ligji.

Variabli 14. Niveli i zbatimit të konfiskimit të zgjeruar, në qoftë se ekziston një dispozitë e tillë ligjore. Sa më i lartë niveli i zbatimit të konfiskimit të zgjeruar, aq më mirë është supozuar të zbatohet ligji.

Variabli 15. Frekuenca e konfiskimit, në qoftë se aplikimi i masës është nganjëherë apo gjithmonë diskrecionale.

Variabli 16. Niveli i zbatimit të dispozitës ligjore që lejon ndryshimin e barrës së provës, në qoftë se ekziston një dispozitë e tillë ligjore. Sa më i lartë niveli i zbatimit të dispozitës ligjore që lejon ndryshimin e barrës së provës, aq më mirë është supozuar të jetë zbatimi i ligjit.

Variabli 17. Niveli i zbatimit të konfiskimit të pronës, nëse parashikohet nga sistemi ligjor.

Variabli 18. Niveli i zbatimit të konfiskimit të vlerës, nëse parashikohet nga sistemi ligjor.

Sa më i lartë niveli i zbatimit të konfiskimit të vlerës, aq më mirë është supozuar të jetë zbatimi i ligjit.

Variabli 19. Niveli i zbatimit të një dispozite ligjore që kërkon sekuestrimin dhe konfiskimin e të ardhurave të cilat supozohet të jenë nxjerrë nga krimi, nëse është në pronësi ose mbahet nga një person i tretë, në qoftë se një dispozitë e tillë ligjore ekziston. Sa më i lartë niveli i zbatimit të dispozitës ligjore që kërkon sekuestrimin dhe konfiskimin e të ardhurave që supozohet të kenë nxjerrë nga krimi, nëse janë në pronësi ose mbahet nga një person i tretë, aq më mirë është supozuar të jetë zbatimi i ligjit.

Variabli 20. (Faktor) Përshtatshmëria e burimeve njerëzore për fazën e gjyqimit, duke iu referuar numrit të tyre të përgjithshëm. Pa burimeve njerëzore nuk mund të ketë zbatim të

ligjit. Prandaj, zbatimi i plotë i ligjit kërkon një numër tëçërshtatshëm të burimeve njerëzore të përkushtuar për fazën e hetimit¹⁴⁴.

Variabli 21. (Faktor) Përshtatshmëria e burimeve materiale të përcaktuara për fazën e gjykimit. Sa më të përshtatshme burimet materiale të përkushtuar për fazën e gjykimit, aq më mirë është supozuar të jetë zbatimi i ligjit. Pa burimet materiale nuk mund të ketë zbatim të ligjit. Prandaj, zbatimi i plotë i ligjit, kërkon një numër adekuat të burimeve materiale të përkushtuar për fazën e gjykimit¹⁴⁵.

Variabli 22. (Faktor) Niveli i trajnimit të zyrtarëve (të tillë si prokurorë publik) që ndërmarrin veprime ligjore kundër të pandehurve në proceset civile, penale në fushën e kapjes dhe konfiskimit të produkteve të krimit. Sa më i lartë niveli i trajnimit të zyrtarëve që ndërmarrin veprime ligjore kundër të pandehurve në procedurat civile, penale në fushën e sekuestrimit dhe konfiskimit të të ardhurave nga krimi, aq më mirë është supozuar të jetë zbatimi i ligjit. Për të siguruar zbatimin e plotë e ligjit, zyrtarët të cilët kryejnë veprime ligjore kundër të pandehurve duhet të kenë njohuri të plota për çështjet financiare, kontabilitet, e drejta civile, etj prandaj duhet të ofrohet trajnim i përshtatshëm për ta, në mënyrë që ata të interpretojnë saktë dhe të zbatojë dispozitat përkatëse ligjore, duke shfrytëzuar plotësisht potencialin e tyre¹⁴⁶.

Variabli 23. (Faktor) Niveli i trajnimit të gjyqtarëve në fushën e kapjes dhe konfiskimin e produkteve të krimit. Sa më i lartë niveli i trajnimit të gjyqtarëve në fushën e kapjes dhe

¹⁴⁴ Plani i Veprimit të Këshillit të 27 Mars 2000; Këshilli i Evropës, Bashkimi (2000); Këshilli i Europës (2001).

¹⁴⁵ Plani i Veprimit të Këshillit të 27 Mars 2000; Këshilli i Evropës, Bashkimi (2000); Këshilli i Europës (2001).

¹⁴⁶ Këshilli i Veprimit të Përbashkët të Bashkimit Evropian të datës 3 dhjetor 1998; Këshilli i Bashkimit Evropian (2000); Europol (2000); Këshilli i Europës (2001).

konfiskimit të produkteve të krimit, aq më mirë është supozuar të jetë zbatimi i ligjit. Për të siguruar zbatimin e plotë të ligjit, gjyqtarët duhet të kenë njohuri të shëndosha për çështjet financiare, të kontabilitetit, të drejtën civile, etj. Prandaj një trajnim i plotë duhet të sigurohet për ta, në mënyrë që ata të interpretojnë saktë dhe zbatojnë dispozitat përkatëse ligjore¹⁴⁷.

Variabli 24. (Faktor) Niveli i kompetencës të organit për menaxhimin e pasurisë së konfiskuar. Sa më i lartë niveli i kompetencave të autoritetit për menaxhimin e pasurisë së konfiskuar, aq më mirë është supozuar të jetë zbatimi i ligjit. Menaxhimi i aseteve të sekuestruara është një detyrë shumë komplekse e cila është vendimtare për zbatimin e dispozitave të konfiskimit. Menaxhimi i dobët, në fakt, mund të dobësojë pjesërisht ose tërësisht të gjitha përpjekjet e bëra nga agjencitë dhe prokurorët e zbatimit të ligjit për të siguruar vlerën e aseteve para konfiskimit. Prandaj, ekspertiza e specializuar e këtyre, për menaxhimin e aseteve të sekuestruara është një faktor që duhet të merret parasysh¹⁴⁸.

Variabli 25. (Faktor) Niveli i menaxhimit aktual të pasurisë së konfiskuar. Sa më i mirë menaxhimi aktual i pasurive të sekuestruara, aq më mirë është supozuar të jetë zbatimi i ligjit. Menaxhimi i aseteve të sekuestruara është vendimtarë për zbatimin e dispozitave të konfiskimit. Menaxhimi i keq, në fakt, mund të dobësojë pjesërisht ose tërësisht të gjitha përpjekjet e bëra nga agjencitë dhe prokurorët e zbatimit të ligjit për të siguruar vlerën e aseteve para konfiskimit¹⁴⁹.

¹⁴⁷ Këshilli i Veprimit të Përbashkët të Bashkimit Evropian të datës 3 dhjetor 1998; Këshilli i Bashkimit Evropian (2000); Europol (2000); Këshilli i Europës (2001).

¹⁴⁸ Këshilli i Bashkimit Evropian (1998); Këshilli i Veprimit të Përbashkët të Bashkimit Evropian të 3 dhjetor 1998.

¹⁴⁹ Këshilli i Veprimit të Përbashkët të Bashkimit Evropian të datës 3 dhjetor 1998; Komisioni Australian Ligji Reforma (1999); Këshilli i Bashkimit Evropian (2000).

Variabli 26. (Faktor) Periudha e kohës së nevojshme për përfundimin e procedurës gjyqësore çon në konfiskimin e produkteve të krimit. Sa më e shkurtër periudha kohore për përfundimin e procedurës gjyqësore për konfiskimin e të ardhurave nga krimi, aq më mirë është supozuar të jetë zbatimi i ligjit. Duke pasur parasysh kostot në aspektin e burimeve njerëzore dhe materiale të qëndrueshme nga shteti gjatë procedurës gjyqësore, si dhe natyrën delikate të disa kategorive të aseteve që i nënshtrohen konfiskimit, është e rëndësishme për të marrë parasysh faktorin kohë për vlerësimin e zbatimit të dispozitave ligjore, pasi një procedurë e gjatë pengon zbatimin e plotë të ligjit¹⁵⁰.

5.3 Faza e administrimit të aseteve kriminale

Për fazën e administrimit, konsiderojmë që zbatimi i ligjit mund të shprehet me ekuacionin:

$$Lsh\ fa = (Lz\ fa * Fsfa)$$

ku:

Lsh fa – Ligji në fuqi për fazën e administrimit

Lz fa - Zbatimi i ligjit për fazën e administrimit

Fsfa - Faktorët për fazën e administrimit

Variabli 27. Niveli i zbatimit të dispozitave ligjore për zbatimin e çdo mundësie të përdorimit të shitjes, shkatërrimit, përdorimit për qëllime sociale, qera, likuidim, etj.

Variabli 28. (Faktor) Niveli i bashkëpunimit ndërmjet agjencive, dmth bashkëpunimit midis zyrave të ndryshme të përfshira në fazën e administrimit të pasurisë së sekuestruar dhe

¹⁵⁰ Komisioni Parlamentar Antimafia (1997b); Komisioni Australian i Ligjit për Reforma (1999).

konfiskuar. Sa më i lartë niveli i bashkëpunimit ndërmjet agjencive gjatë fazës së administrimit, aq më mirë është supozuar të jetë zbatimi i ligjit. Menaxhimi i aseteve të konfiskuara zakonisht kërkon bashkëpunimin e më shumë se një agjenci. Kjo nënkupton që komunikimi i shpejtë dhe shkëmbimi i informacionit midis agjencive të përfshira mbështet zbatimin e dispozitave ligjore në fazën e administrimit¹⁵¹.

Variabli 29. (Faktor) Përshtatshmëria e burimeve njerëzore për zbatimin e urdhrave të konfiskimit, administrimin e aseteve të konfiskuara referuar numrit të tyre të përgjithshëm. Përshtatshmëria sa më e mirë e burimeve njerëzore të përkushtuar për zbatimin e urdhrave të konfiskimit, administrimin e aseteve të konfiskuara, aq më mirë është supozuar të jetë zbatimi i ligjit. Pa burimeve njerëzore nuk mund të ketë zbatim të ligjit. Prandaj, zbatimi i plotë i ligjit kërkon një numër të caktuar të burimeve njerëzore të cilët duhet të jenë të përkushtuar për fazën e administrimit¹⁵².

Variabli 30. (Faktor) Përshtatshmëria e burimeve materiale të përkushtuar për zbatimin e urdhrave të konfiskimit, administrimin e aseteve të konfiskuara. Sa më mirë të përshtaten burimet materiale të përkushtuar për zbatimin e urdhrave të konfiskimit, administrimit të aseteve të konfiskuara, aq më mirë është supozuar të jetë zbatimi i ligjit. Pa burimet materiale nuk mund të ketë zbatim të ligjit. Prandaj, zbatimi i plotë i ligjit kërkon një numër adekuat të burimeve materiale që të jenë të përkushtuara në fazën e administrimit¹⁵³.

Variabli 31. (Faktor) Niveli i kompetencës të organit për menaxhimin e pasurive të konfiskuara. Menaxhimi i aseteve të konfiskuara është vendimtar për zbatimin e dispozitave

¹⁵¹ Veprimi Financiar Task Forca të Pastrimit të Parave (2001).

¹⁵² Plani i Veprimit të Këshillit të 27 Mars 2000; Këshilli i Evropës Bashkimi (2000); Këshilli i Europës (2001).

¹⁵³ Plani i Veprimit të Këshillit të 27 Mars 2000; Këshilli i Evropës Bashkimi (2000); Këshilli i Europës (2001).

të konfiskimit. Menaxhimi i keq, në fakt, mund të dëmtojë pjesërisht ose tërësisht të gjitha përpjekjet e bëra nga agjencitë e zbatimit të ligjit, prokurorët dhe gjykatësit për të siguruar vlerën e aseteve gjatë administrimit. Prandaj ekspertiza e specialistëve është e nevojshme për ekzekutimin e urdhrave të konfiskimit¹⁵⁴.

Variabli 32. (Faktor) Periudha e kohës së nevojshme për administrimin e aseteve të konfiskuara. Duke pasur parasysh natyrën prishjes së disa kategorive të pasurive që i nënshtrohen konfiskimit, si dhe kostot në aspektin e resurseve njerëzore dhe materiale nga shteti gjatë fazës së administrimit, është e rëndësishme për të marrë parasysh faktorin kohë për vlerësimin e zbatimit të dispozitave ligjore¹⁵⁵.

Hapi 2. Përgatitja e një pyetësoi për drejtuesit e prokurorisë, gjykatës së krimeve të rënda dhe administratës së menaxhimit të aseteve kriminale, plotësuar në formë elektronike

Variablat për ligjin në veprim të çdo fazë të procedurës së konfiskimit u përfshinë në një pyetësor me tre pjesë, përgatitur për të shqyrtuar praktikën e të ardhurave nga konfiskimi kriminel (a) në fazën e hetimit (b) në fazën e gjykimit, dhe (c) në fazën e administrimit të aseteve kriminale të sekuestruara dhe konfiskuara.

Pyetësoi përbëhet nga pyetje sipas aktiviteteve në një procedurë konfiskimi, nga fillimi faza e hetimit, seksioni 1 i pyetësoi, faza e gjykimit, seksioni 2 i pyetësoi) dhe faza e administrimit të aseteve të sekuestruara dhe konfiskuara, pjesa 3 e pyetësoi. Secili variabël konsiderohet si një pyetje, me pesë përgjigje të mundshme për çdo pyetje. Siç tregohet më

¹⁵⁴ Komisioni i Reformës Ligjore Australian (1999); Këshilli i Bashkimit Evropian (2000).

¹⁵⁵ Veprimi Financiar Task Forca të Pastrimit të Parave (1997a).

lart duke paraqitur modalitetet e secilit variabël të zbatimit të ligjit, këto përgjigje kanë qenë gjithmonë në një shkallë nga 1 në 5.

Pyetësi u dha në këtë format në mënyrë që të arrihen dy objektiva kryesore.

Së pari, përdorimi i pyetjes për përgjigje sasiore të menjëhershme të ligjit në veprim (në këtë pikë, shih hapin 4). Kjo mënyrë e hartimit të pyetësorit potencialisht rriti normën e përgjigjeve, sepse mundësia për t'ju përgjigjur me shpejtësi inkurajoi të intervistuarit për t'iu përgjigjur pyetësorit.

Së dyti, kërkesa në pyetësor "Jepni arsyet e shkurtra për zgjedhjen tuaj" pas çdo pyetje, lejon studiuesit jo vetëm për kontroll në një farë mënyre për subjektivitetin e mendimit të ekspertit por edhe për të marrë nga komentet e ekspertit mendime të rëndësishme për të kuptuar më mirë pengesat aktuale, dhe për të mbledhur informacion cilësor.

Pyetësi është dërguar me e-mail për një ekspert të profilit të lartë për çdo drejtues institucioni dhe është administruar disa kohë pas dërgimit të tij me anë të postës elektronike, si dhe duke kontaktuar me telefon. Kjo mënyrë e administrimit të pyetësorit i dha studjuesit kontrollin nga afër mbi mbledhjen e të dhënave, në aspektin e sqarimit të menjëhershëm të formulimit, terminologjisë, identifikimin dhe zgjidhjen e keqkuptimeve, gjithashtu nxitjen e dialogut interaktive mes studiuesit dhe të intervistuarit. Gjithashtu u realizua një kontakt me të intervistuarin për të qartësuar më mirë konceptet, terminologjinë, qëllimin e studimit etj.

Sa më sipër nënkuptohet se, në mënyrë që të eksplorojë praktikën e konfiskimit, u vendos të mbështetet në mendimet e ekspertëve të profilit të lartë në fushën e konfiskimit të të ardhurave të krimit. Teknika e mbledhjes së të dhënave të zgjedhura, e cila është në fakt një lloj specifik i anketës, prandaj është përdor e ashtuquajtura metodë e "mendimit të ekspertit". Kjo është një teknikë për mbledhjen e të dhënave që mbështetet në pikëpamjet subjektive të

ekspertëve të zgjedhur në bazë të njohurive dhe përvojës së tyre në një faze të caktuar, në mënyrë që të hedhë dritë mbi objektin e studimit. Ideja themelore e kësaj metode është se personat me njohuri të drejtpërdrejtë dhe të thellë të fenomenit janë në gjendje të ofrojnë njohuri të dobishme.

Kjo teknikë e mbledhjes së të dhënave u zgjodh duke marrë në konsiderate: *së pari*, eksperiencia në punë vlerësohet veçanërisht e dobishme në fushat përkatëse, pasi të dhënat objektive, treguesit statistikorë janë të varfër. Kështu, në mungesë të informacionit të besueshëm sasior dhe cilësor mbi zbatimin dispozitave të konfiskimit të të ardhurave të krimit, eksperiencat e punës së ekspertëve janë shfrytëzuar për të patur një pasqyrë të plotë në praktikën e konfiskimit. Ata janë në gjendje për të identifikuar se çfarë probleme lindin në zbatimin e këtyre dispozitave dhe çfarë aspektesh, për të bërë më të mundur identifikimin, konfiskimin dhe asgjësimin e pasurive të fituara ilegalisht. Ata janë konsideruar si burime kryesore të informacionit për të filluar ndërtimin e njohurive mbi këtë temë. Gjithashtu duhet të kihet parasysh se kjo teknikë bën të mundur mbledhjen e informacionit në një mënyrë mjaft të lirë dhe të shpejtë.

Natyrisht, dobësitë e metodës nuk mund të mos trajtohen. Ashtu si çdo gjykim subjektiv, një mendim i ekspertit ngre një problem besueshmërie. Për më tepër, është vënë re se ekspertët kanë gjasa të jenë uniformë dhe plotësisht të informuar për një fushë të caktuar.

Janë ndjekur disa rregulla themelore në mënyrë që të rregullohen këto dobësi sa më shumë të jetë e mundur.

Së pari, ekspertët e përzgjedhur ishin ekspertë të profilit të lartë, ata janë të identifikuar, titullarë institucionesh që merren me hetimet financiare dhe konfiskimin e produkteve të

krimit dhe menazhimin e aseteve kriminale. Janë persona me ekspertizë të veçantë në fushën e të ardhurave nga konfiskimi i produkteve të krimit.

Së dyti, nëpërmjet kërkesës "Jepni arsyet e shkurtra për zgjedhjen tuaj" pas çdo pyetjeje, siç e përmendëm më lart, ka mundësuar një lloj kontrolli të ushtruar në subjektivitetin e mendimin e ekspertit, sepse kjo i kërkohet atij për të shpjeguar rezultatin e dhënë vetëm në përgjigje të pyetjes. Eksperti u thirr në një farë mënyre për të "justifikuar" përgjigjen dhe për të komentuar mbi atë më tej. Një problem tjetër i mundshëm, duke u mbështetur në mendimin e ekspertëve është se ata nuk mund të jenë uniforme dhe plotësisht të informuar për një fushë të caktuar. Zgjedhja e prokurorëve publik është mënyra më e mirë për të minimizuar efektin e kësaj vështirësie, për shkak se ata janë praktikues të përfshirë në procedurën më të ngushtë të konfiskimit dhe në hetimet penale në përgjithësi.

Hapi 3. Ndërtimi i një profili që përshkruan zbatimin e ligjit dhe ballafaqon atë me ligjin në fuqi. Kjo është bërë në bazë të përgjigjeve të ekspertëve të pyetësorit, dhe në veçanti mbi bazën e komenteve të stimuluar nga kërkesa "Jepni arsyet e shkurtra për zgjedhjen tuaj" pas çdo pyetjeje. Komente të tilla, në fakt, kanë bërë të mundur për të marrë komente të rëndësishme për të kuptuar më mirë pengesat dhe praktikatat më të mira nga ekspertit. Përshkrimi i zbatimit të ligjit të bazuar në mendimin e ekspertit ishte e integruar, ku është e mundur, me burime dytësore, të tilla si raportet e prodhuara nga institucionet kombëtare.

Hapi 4. Përcaktimi sasior i zbatimit të ligjit. Hapi i katërt ishte për të përcaktuar nga ana sasiore zbatueshmërinë e ligjit, nivelin e zbatimit të dispozitave ligjore, të rëndësishme në secilin nga tre fazave të procedurës së konfiskimit.

Në bazë të përgjigjeve nga ana e ekspertëve për pyetjet, një vlerë numerike në një shkallë nga 0 në 100 është caktuar për secilin modalitet të secilit variabël për fazën e përzgjedhur.

Sa më afër vlerës 100, aq më mirë zbatimi i ligjit Këto vlera pasi u mbledhën për secilën fazë, (a) në fazën e hetimit, (b) në fazën e gjykimit dhe (c) në fazën e administrimit të aseteve kriminale të sekuestruara dhe të konfiskuara u bë indeksimi i zbatueshmërisë së ligjit me një shkallë nga 0 në 100, për çdo fazë. Ata janë marrë duke llogaritur mesataren e vlerave të caktuara për modalitetet e secilit variabël për fazën. Sa më i lartë indeksi, aq më mirë zbatueshmëria e ligjit. Kur indeksimi i pikëve shkon drejt 100, kjo tregon situatën ideale në të cilën zbatohet ligji dhe është më e mira e mundshme. Në të kundërtën, kur indeksimi i pikëve shkon drejt 0, kjo tregon gjendjen më të keqe të mundshme të zbatimit të ligjit.

Shqipëria

Hetimet financiare në Shqipëri janë ndërmarrë pas vitit 2004, me hyrjen në fuqi të Ligjit Nr. 9284, datë 30.9.2004 “ Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar”, në të cilin janë parashikuar kompetencat dhe krieteret për sekuestrimin dhe konfiskimin e pasurive që lidhen me krimet e përcaktuara në nenin 3 të këtij ligji. Qëllimi i këtij ligji ishte parandalimi dhe goditja e krimit të organizuar nëpërmjet zbulimit, identifikimit, sekuestrimit dhe konfiskimit të pasurive të paligjshme të personave të dyshuar si pjesëmarrës në krimin e organizuar, si dhe përcaktimi i mënyrës së përdorimit të këtyre pasurive¹⁵⁶. Prokurorët dhe oficerët e policisë gjyqësore, mund të përdorin mjetet speciale të hetimit si përgjimi, vëzhgimi, simulimi, infiltrimi etj, për veprat penale të parashikuara në nenin 3 të ligjit, dhe për pasojë konsiderohet se kjo masë shërben dhe për hetimet financiare për të zbuluar informacione

¹⁵⁶ Neni 3 i ligjit nr. 9284, datë 30.09.2004, “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar”

lidhur me pasuritë apo mjetet financiare¹⁵⁷. Në këtë ligj përcaktohet dhe konfiskimi i shtrirë, për personat që konsiderohen lidhje e afert si dhe ndaj personave fizik dhe juridik, sipas përcaktimeve të pikës 2, të nenit 3 të ligjit 9284, datë 30.9.2004, ndryshuar me ligjin 10192, datë 3.12.2009, “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar dhe trafikimit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”, ku shprehet se dispozitat e këtij ligji zbatohen edhe ndaj pasurive të: a) personave të afërm (bashkëshorti, fëmijët, të paralindurit, të paslindurit, vëllezërit, motrat, ungjërit, emta, nipërit, mbesat, fëmijët e vëllezërve dhe të motrave, vjehrrri, vjehrra, dhëndri, nusja, kunata, kunati, bashkëjetuesi, thjeshtri, thjeshtira, njerku dhe njerka) të subjekteve të pikës 1 të këtij neni; b) personave fizikë ose juridikë, për të cilët ka të dhëna të mjaftueshme se pasuritë ose veprimtaritë e tyre zotërohen, pjesërisht ose plotësisht, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, a janë përdorur, kanë lehtësuar apo në një formë kanë ndikuar në kryerjen e veprimtarive të jashtëligjshme nga personat e parashikuar në pikën 1 të këtij neni. Masat parandaluese mund të kërkohen dhe ndaj trashëgimtarëve të personit, subjekt i zbatimit të këtij ligji, por, në çdo rast, jo më vonë se 5 vjet nga data e vdekjes. Ky ligj zbatohet edhe për pasuritë e personave, të krijuara përpara hyrjes në fuqi të këtij ligji, me kusht që pasuritë të jenë vënë gjatë përfshirjes së dyshuar të tij në veprimtarinë kriminale, sipas këtij ligji.

Sipas ligjit, nuk ka pengesa të cilat do të pengonin në kohë kryerjen e procedurave për hetime financiare. Kjo shprehet qartë në nenin 5, “marrdhënjet me procedimin penal” të ligjit nr. 10192, datë 3.12.2009, “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar dhe trafikimit

¹⁵⁷ Pyetësor me ekspertë të ndjekjes penale, (Kod. 1/1), Prill 2014

nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”, neni 5, pika 1 ku thuhet se procedura e caktimit dhe e zbatimit të masave parandaluese, sipas këtij ligji, është autonome nga gjendja, shkalla apo përfundimi i procedimit penal që zhvillohet në ngarkim të personave, subjekte të këtij ligji.

Barra e provës, sipas parashikimeve të dispozitës neni 21 “kërkesa për konfiskimin e pasurisë dhe barra e provës”, në pikën 3 dispozita shprehet se barra e provës, për të vërtetuar se pasuritë janë fituar në mënyrë të ligjshme, i përket personit, kundër pasurive të të cilit kërkohet konfiskimi. Lidhur me administrimin e pasurisë dhe përdorimin e pasurive të konfiskuara, parashikohen në dispozitat sipas neneve 29, 30, 31, 32, 33, 34, të ligjit Nr. 10192, datë 3.12.2009, “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar dhe trafikimit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”.

Në lidhje me zbatimin e ligjit në fazën e hetimit, është për tu theksuar se në përgjithësi njihet filozofia e hetimeve financiare, dhe se janë krijuar struktura në Prokurorinë e krimeve të rënda dhe policinë e shtetit. Është mundësia e përdorimit të mjeteve speciale të hetimit, por përdorimi i tyre për rastet e hetimeve financiare është i lidhur me përdorimin për hetimin e krimit të kryer dhe ndaj personave për të cilët bëhet ndjekja penale, duke dhënë një rezultat të dobët në treguesit e përdorimit. Sipas ekspertit të intervistuar, në lidhje me pyetjen “jepni arësyet për zgjedhjen tuaj”, ai shprehet se në Shqipëri hetimi i produkteve të aktivitetit kriminal bëhet mbi bazën e Ligjit Nr.10192, datë 03.12.2009 “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar dhe trafikimit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë” Kompetente për të aplikuar këtë ligj është Prokuroria dhe Gjykata për Krime të Rënda. Për zbatimin e ligjit ndiqen procedura civile ashtu siç përcakton edhe vetë ligji. Në rastet kur verifikimi i aseteve bëhet paralelisht me procesin penal është mundësia për të aplikuar mjete

speciale hetimi për të kërkuar produktet e krimit në aplikim të nenit 294/a të Kodit të Procedurës Penale, për të zbuluar të dhëna financiare ose pronësie të një personi. Në vlerësimin që eksperti i intervistuar ka bërë në lidhje me shpeshtësinë e aplikimit, ka vlerësuar me 1, që tregon rezultat të dobët të zbatimit të ligjit¹⁵⁸.

Eksistojnë dispozita ligjore për konfiskimin e zgjeruar dhe kryerjen e hetimeve financiare për palët e treta, sipas përcaktimeve të nenit 3 të ligjit Nr.10 192, datë 03.12.2009 “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar dhe trafikimit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”. Zbatueshmëria e tyre në praktikë sipas vlerësimit të ekspertëve është në vlerat 1, që do të thotë se zbatueshmëria është 0.

Lidhur me faktorët që ndikojnë në zbatueshmërinë e variablave 1 dhe 2 të fazës së hetimit vlen të theksohet se bashkëpunimi me bankat, variabli 3, është shumë i mirë, vlerësuar me 5, gjithsesi po bëhen përpjekje për të lidhur marrveshje për akses në bazën e të dhënave të institucioneve të tjera si dhe krijimin e aksesit në librin e llogarive bankare.

Variabli 4, Nëse ka ndonjë dispozitë ligjore që kërkon një përbërje multidisiplinare të zyrës apo zyrave që kryejnë hetime financiare, si punësimi brenda këtyre njësive të oficerëve me aftësi dhe shkathtësi të ndryshme (p.sh. nëpunës të zbatimit të ligjit, kontabilistë, analistë financiarë , etj), përgjigja është negative, vlerësimi 0. Lidhur me variablin 5, nëse ka një dispozitë ligjore që kërkon bashkëpunim ndërmjet agjencive të ndryshme kombëtare të zbatimit të ligjit (forcave të policisë, agjencive të ardhurave, shërbimeve të prokurorisë, etj) në zhvillimin e hetimeve financiare, përgjigja është negative, ndërkohë që bashkëpunimi në

¹⁵⁸ Pyetësor me ekspertë të ndjekjes penale, (Kod. 1/1), Prill 2014

rastet e hetimeve financiare bëhet sipas rastit, me marrveshje ndërinstucionale në mënyrë të pranueshme. Vlerësimi është 3. Sipas ekspertit¹⁵⁹, ekziston një memorandum bashkëpunimi institucional i cili ka lidhje me Njësitë e Përbashkëta Hetimore të krijuara në 8 prokurori rrethesh. Në këtë memorandum janë përfshirë Prokuroria, SHISH, FIU, Hetimi Tatimor, Hetimi Doganor, ILDKPI dhe KLD¹⁶⁰. Variabli 6, nëse ka një dispozitë ligjore që kërkon nga të penduar ose dëshmitarë që të bashkëpunojnë me agjencitë hetimore në zbulimin e të ardhurave nga krimi, përgjigja është pozitive, dhe vlerësimi është 2, pra shumë pak e vlerësuar. Kjo edhe sipas ekspertit të intervistuar sepse, dispozitat e Kodit Penal dhe Kodit të Procedures penale për bashkëpunëtorët në procesin e hetimit pasuror nuk njihet termi i pandehur¹⁶¹. Lidhur me sa shpesh hetimet financiare janë filluar në rastet e krimit të organizuar, gjithashtu duke marrë parasysh skenën në të cilën ato janë përdorur, variabli 7, përgjigja është se ato gjithmonë janë bërë me vonesë, pas akuzave, kjo për arsye se sipas ligjit duhet të ekzistojë një dyshim i arsyeshëm për kryerjen e veprës penale në fushën e zbatimit të ligjit¹⁶². Lidhur me përshtatshmërinë e (a) burimet njerëzore dhe (b) burimet materiale të përkushtuar për identifikimin e produkteve të krimit, duke iu referuar numrit të tyre të përgjithshëm, për burimet njerëzore, për burimet materiale, variabli 8, është vlerësuar me 3, që tregon se janë jo plotësisht të mjaftueshme. Numri i nivelit të përgjithshëm të trajnimit për hetimin financiar, variabli 9, është vlerësuar me 4, por sipas ekspertit, janë zhvilluar trajnime të shumta por transferimi i oficerëve të policisë gjyqësorë krijon problem

¹⁵⁹ Pyetësor me ekspertë të ndjekjes penale, (Kod. 1/2), Prill 2014

¹⁶⁰ Pyetësor me ekspertë të ndjekjes penale, (Kod. 1/1), Prill 2014

¹⁶¹ Pyetësor me ekspertë të ndjekjes penale, (Kod. 1/3), Prill 2014

¹⁶² Pyetësor me ekspertë të ndjekjes penale, (Kod. 1/3), Prill 2014

në këtë fushë¹⁶³. Periudha kohore, variabli 10, është e shkurtër, vlerësuar me 2, kjo për faktin se kërkohet një numër i madh veprimesh për tu kryer, dhe del qartë edhe nga përgjigjet e variablave për mjaftueshmërinë e burimeve njerëzore dhe atyre financiare, si dhe nga lëvizjet e shpeshta pa kriter të personave të trajnuar. Lidhur me variablin 11, nëse kërkohet parakusht, dhe sa e pengon kjo hetimin financiar, përgjigja është dhënë se kërkohet dyshimi i arësyeshem. Nëse një bindje është e nevojshme për konfiskim, a ka një dispozitë ligjore që e bën të mundur konfiskimin jo vetëm të ardhurat e krimit nga vepra penale të cilat i pandehuri është dënuar, por edhe të ardhurat e krimeve të mëparshme nga të cilat ai nuk është i dënuar, variabli 12, përgjigja është pozitive, por aplikimi është i dobët.

Variablat 13 deri në 19, parashikojnë zbatimin e ligjit për fazën e gjykit, ndërsa variablat 20 deri në 26, japin zbatueshmërinë e ligjit faktorët që ndikojnë në zbatimin ose moszbatimin e variablave 13 deri 19, në fazën e gjykit. Në përgjigje të variablit 13, nëse parakushtet ligjore janë plotësuar, konfiskimi i të adhurave nga krimi në procedurë penale është gjithmonë e detyrueshme. Vendosja e masave ndonjëherë është në diskrecion të gjykatësve, e cila në vlerësimin e përgjithshëm vlerësohet me 2. Sipas ekspertit, periudha kohore e vënies së pasurisë duhet të përputhet me periudhën e aktivitetit kriminal¹⁶⁴. Lidhur me barrën e provës, në çdo rast ka kaluar tek i pandehuri, dhe zbatueshmëria në rastet kur janë kryer hetime është e lartë, është aplikuar në një masë të kënaqëshme. Variabli 14, është vlerësuar me 5. Këtu vlen të theksohet se janë vlerësuar vetëm në rastet kur janë kryer, të cilat edhe sipas statistikave është i ulët. Vetëm për 17 përqind të rasteve të kryerjes së

¹⁶³ Pyetësor me ekspertë të ndjekjes penale, (Kod. 1/2), Prill 2014

¹⁶⁴ Pyetësor me ekspertë të ndjekjes penale, (Kod. 1/2), Prill 2014

veprave penale sipas nenit 3 të ligjit, është aplikuar kërkesa për hetime financiare, dhe kjo vetëm për të pandehurit dhe jo për gjithë rrethin e personave përcaktuar sipas ligjit. Ekzistojnë parashikime ligjore edhe për konfiskim të pronës edhe për konfiskim të vlerës, variabli 15. Zbatueshmeria mbetet e ulët, në nivelin 2, sipas vlerësimit të ekspertit. Lidhur me sekuestrimin tek të tretët, variabli 16, ekziston dispozita ligjore, por zbatueshmëria është e ulët, në nivelin 2. Arësyet sipas ekspertit është për shkak të ekzistencës së informalitetit e cila vështirëson të provohet se pasuria i takon personit të dyshuar për aktivitet kriminal, duke i dhënë mundësi palës për tu mbrojtur. Gjithashtu ka dispozita ligjore për menaxhmin e aseteve kriminale, variabli 17, por niveli i kënaqësise është i ulët, niveli 3 sipas ekspertëve të cilët thonë: - Pranë Ministrisë së Financave është krijuar një agjensi për administrimin e pasurive e cila ka vështirësi në administrimin e aktiviteteve. Lidhur me përshtatshmërinë e (a) burimet njerëzore dhe (b) burimet materiale të përkushtuar për fazën gjyqësore, duke iu referuar numrit të tyre të përgjithshëm për burimet njerëzore, për burimet materiale, variabli 18, është vlerësuar me 3, nivel ky jo i kënaqshëm.

Numri i nivelit të përgjithshëm të trajnimit, në fushën e kapjes dhe konfiskimin e produkteve të krimit, i (a) zyrtarët që ndërmarrin veprime ligjore kundër një të pandehuri në procedurën penale (si prokurorë publikë) dhe (b) gjyqtarët, variabli 19, është në nivelin 4, jo plotësisht i kënaqshëm. Përshtatshmëria e burimeve njerëzore për fazën e gjyqimit, duke ju referuar numrit të përgjithshëm, variabli 20, vlerësohet me nivelin 2, jo plotësisht e mjaftueshme. Përshtatshmëria e burimeve materiale për fazën gjyqësore duke ju referuar konsistencës së tyre të përgjithshme, variabli 21, vlerësohet me 2, jo e mjaftueshme. Niveli i trajnimit të zyrtarëve, variabli 22, vlerësohet me 3, nivel jo i lartë i trajnimit për marrjen e përgjegjësi. Niveli i trajnimit të gjyqtarëve, variabli 23, vlerësohet 4, jo plotësisht i lartë i trajnimit. Niveli

i menaxhimit aktual të pasurive, variabli 24, vlerësohet me 3, dhe periudha e kohës së nevojshme për të përfunduar procedurën gjyqësore që çon në konfiskimin e produkteve të krimit, variabli 26, vlerësohet me 3, konsiderohet mesatare.

Në fazën e administrimit, niveli i zbatimit të dispozitave ligjore që rregullojnë administrimin, shitjen, dhënjën me qera, përdorimin për qëllime sociale, likuidim etj, variabli 27, vlerësohet me 2, nuk aplikohet në një masë të kënaqshme. Referuar statistikave sipas Tabeles 6, asnjë nga pronat e konfiskuara nuk është shitur. Lidhur me faktorët që ndikojnë, si niveli i bashkëpunimit, variabli 28, përshtatshmëria e burimeve njerëzore, variabli 29, përshtatshmëria e burimeve materiale, variabli 30, niveli i kompetencës së autoritetit, variabli 31 dhe periudha e kohës së nevojshme, variabli 32, janë dhe faktorët që ndikojnë në zbatueshmërinë e ligjit. Në formë të përmbledhur, rezultatet e vlerësimit nga 1 në 5 jepen në tabelën më poshtë:

Faza I- Hetimi		Faza II- Gjykimi		Faza III- Administrimi	
Variabli	Vlerësimi	Variabli	Vlerësimi	Variabli	Vlerësimi
1	1	13	2	27	2
2	1	14	3	28	2
3	5	15	2	29	2
4	3	16	2	30	1
5	3	17	3	31	2
6	3	18	2	32	3
7	2	19	3		
8	3	20	3		
9	3	21	3		
10	3	22	2		
11	3	23	3		
12	1	24	3		
		25	3		
		26	3		
	39%		45%		25%

Tabela 15: Vlerësimi i variablave sipas fazave të hetimit financiar¹⁶⁵

Zbatueshmëria e ligjit e përlogaritur me indeksimin nga 0 në 100, sipas vlerave të

¹⁶⁵ Sipas fazave a) hetim, b) gjykim dhe c) administrim janë testuar variablat respektivisht 2, 7, dhe 1, dhe janë vlerësuar faktorët për secilin variabël sipas fazave

vlerësimi, zbatueshmëria për secilën fazë a) hetimi, b) gjykimi dhe c) administrimi është përkatësisht hetimi - 39%, gjykimi – 45 % dhe administrimi – 25 %. (Figura 12)




Figura 12: Paraqitja grafike sipas fazave të hetimit financiar

Këto shprehin, në shkallën nga 0 në 100, nivelin e zbatimit të ligjit në secilën fazë. Ata janë marrë duke llogaritur mesataren e vlerave të caktuara për secilin variabël për fazën. Sa më i lartë indeksi, aq më mirë është zbatuar ligji. Të dy situatat ekstreme përshkruar nga ky përcaktim tregojnë: a) situatën ideale të zbatimit të ligjit kur indeksi është në vlerën 100, dhe b) gjëndjen më të keqe të mundshme kur indeksi është në vlerën 0.

Siç shihet dhe nga tabela e mësipërme variablat e fazës hetimore si: Frekuenca e përdorimit të mjeteve speciale të hetimit dhe frekuenca e hetimeve financiare për palët e treta, janë në vlera të ulëta të zbatueshmërisë. Kjo për faktin se nuk përdoren drejtpërdrejt mjetet speciale të hetimit vetëm për hetimet financiare, por përdoren për personat nën hetim, për pasojë edhe shtrirja e hetimit për palët e treta ka më pak mundësi të ndodh, pasi kërkohet dyshimi i arsyeshëm i bazuar në indicje.

Për fazën gjyqësore, variablat 13, 15, 16 dhe 18, janë në parametra të ulëta. Parakushti për ekzistencën e dyshimit të arsyeshëm bazuar në prova sipas ligjit 9284 të vitit 2004, ishte pengesë e madhe për hetimet financiare. Ndryshimi ka ndodhur me hyrjen në fuqi të ligjit 10192, të vitit 2009, ku u ndryshua kjo pengesë, duke sjellë një standart tjetër, atë të

“dyshimit të arsyeshëm bazuar në indicje”. Shihet qartë dhe nga rezultatet. Megjithatë diskrecioni (variabli 15), mbetet një problem serioz për aplikimin e masave parandaluese të konfiskimit. Kjo dhe për faktin e korrupsionit të lartë në organet e drejtësisë. Barra e provës, (Variabli 16), pavarësisht se gjen zbatim, nuk është e suksesshme për faktin e ekzistencës së ekonomisë informale, dhe korrupsionit si dy faktorët kryesore që bëjnë të mundur palët për të justifikuar pasurinë. Konfiskimi në vlerë, (Variabli 18) mbetet në vlera të ulëta, kjo për arsye se gjetja, identifikimi, ndarja kërkon profesionalizëm, kohë dhe shpenzime, si dhe rregjistra publike të saktë. Në fazën e administrimit mbetet problem shitja e pasurive. Siç shihet dhe nga tabelat më poshtë asnjë pasuri e konfiskuar nuk ka mundur të shitet, për gjithë periudhën e studimit. Kjo për arsye të vetë institucionit, por edhe të faktit se është e vështirë të gjenden blerës për pasuritë e konfiskuara, për shkak të frikës, dhe blerësit nuk rrisin pasurinë e tyre, për të blerë pasuri të cilat janë të pasigurta për ti gëzuar.

Sipas treguesve të tabelave 16, 17, 18, vlera e përgjithshme e pasurive të sekuestruara dhe të konfiskuara për periudhën në studim është gjithësej 666.827.718 lekë, me urdhër ministri vlera 287.102.470 dhe vendim të Gjykatës për Krime të Rënda në vlerën 379.725.248 lekë. Nga studimi i këtyre të dhënave dhe verifikimi i gjëndjes së pasurive të sekuestruara rezulton se vetëm në tre raste është bërë e mundur që të jepen me qera, ndërsa rastet e tjera, ndonëse janë bërë njoftimet publike, nuk është shprehur interes për ti marrë me qera nga individë apo subjekte të ndryshme. Ndërsa për rastet e konfiskimeve me vendim të gjykatës në asnjë rast nuk kemi pasuri të shitur apo të dhënë me qera. Përdorimi për qëllime sociale, shitjet dhe likuidimi mbeten me vlerësim të dobët¹⁶⁶.

¹⁶⁶ Pyetësor me ekspertë të menaxhimit të pasurive të sekuestruara dhe konfiskuara, (Kod. 1/4), Maj 2014

Nr	Qyteti	Vendimi/Urdheri	Statusi	Vlera (Lekë)	Gjendja
1	Tiranë	Urdhri i Ministrit të Financave, nr.2 datë 03.12.2004 "Per sekuestrimin e asetëve te shtetasit arab Yasin Al-Qadi i njohur dhe si: a) Shaykh Yassin Abdullah Kadi, b) Yasin Kahdi, c) Yassin Kadi, c) Kadi Yassin, d) Yassin Abdullah Kadi"	E sekuestruar	16,775,000	Jepet me Qira
2	Tiranë	Urdhri i Ministrit të Financave, nr.2 datë 03.12.2004 "Per sekuestrimin e asetëve te shtetasit arab Yasin Al-Qadi i njohur dhe si: a) Shaykh Yassin Abdullah Kadi, b) Yasin Kahdi, c) Yassin Kadi, c) Kadi Yassin, d) Yassin Abdullah Kadi"	E sekuestruar	14,335,000	Jepet me Qira
3	Tiranë	Urdhri i Ministrit të Financave, nr.2 datë 03.12.2004 "Per sekuestrimin e asetëve te shtetasit arab Yasin Al-Qadi i njohur dhe si: a) Shaykh Yassin Abdullah Kadi, b) Yasin Kahdi, c) Yassin Kadi, c) Kadi Yassin, d) Yassin Abdullah Kadi"	E sekuestruar	17,080,000	Jepet me Qira
4	Tiranë	Urdhri i Ministrit të Financave, nr.2 datë 03.12.2004 "Per sekuestrimin e asetëve te shtetasit arab Yasin Al-Qadi i njohur dhe si: a) Shaykh Yassin Abdullah Kadi, b) Yasin Kahdi, c) Yassin Kadi, c) Kadi Yassin, d) Yassin Abdullah Kadi"	E sekuestruar	14,411,250	Jepet me Qira
5	Tiranë	Urdhër Nr. 36 datë 27.11.2006 të Ministrit të Financave	E sekuestruar	18,422,000	Jepet me Qira
6	Tiranë	Vendimi Nr. 4, datë 17.01.2011 të Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda	E Konfiskuar	4,187,700	Jepet me Qira
7	Kukës	Urdhri i Ministrit të Financave, nr.Nr.28 datë 05.07.2006."Per sekuestrimin e subjektit Abdyl Latif A.A.Saleh" si dhe Urdheri i brendshëm Nr 578 datë 14.04.2011	E Sekuestruar	1,700,000	Jepet me Qira
8	Kukës	Urdhri i Ministrit të Financave, nr.Nr.28 datë 05.07.2006."Per sekuestrimin e subjektit Taibah International" si dhe Urdheri i brendshëm Nr 578 datë 14.04.2011	E Sekuestruar	1,700,000	Jepet me Qira
9	Tiranë	nr. 04, date 25/02/2010, nga Gjykata e Shkallës së Pare për Krime të Rënda	E Sekuestruar	20,274,875	Jepet me Qira
10	Lushnje	nr. 04, datë 25/02/2010, nga Gjykata e Shkallës së Parë për Krime të Rënda	E Sekuestruar	8,540,000	Jepet me Qira
11	Tiranë	Nr. 10 datë 11.07.2005 të Gjykatës së Shkallës Parë për Krime të Rënda	E Konfiskuar	865,000	Shitet
12	Tiranë	Nr. 2 datë 8.01.2010 Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda	E Konfiskuar	85,000	Shitet
13	Tiranë	Nr. 10 datë 11.07.2005 të Gjykatës së Shkallës Parë për Krime të Rënda	E Konfiskuar	385,000	Shitet
14	Tiranë	Nr. 37 datë 03.05.2006 Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda	E Konfiskuar	258,000	Shitet
15	Tiranë	Nr. 2 datë 8.01.2010 Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda	E Konfiskuar	650,000	Shitet
16	Permet	Nr. 37 datë 03.05.2006 të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda	E Konfiskuar	775,000	Shitet
17	Tiranë	Nr. 2 datë 8.01.2010 Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda	E Konfiskuar	350,000	Shitet
18	Durrës	Nr. 5 datë 7.04.2011 të Gjykata e Shkallës së Parë për Krime të Rënda, Tiranë	E Konfiskuar	2,095,500	Jepet me Qira
19	Bulqizë	Urdhri i Ministrit të Financave, nr.Nr.29 datë 05.07.2006."Per sekuestrimin e subjektit Taibah International" si dhe Urdheri i brendshëm Nr 578 datë 14.04.2011	E sekuestruar	7,071,120	Jepet me Qira
20	Bulqizë	Urdhri i Ministrit të Financave, nr.Nr.29 datë 05.07.2006."Per sekuestrimin e subjektit Taibah International" si dhe Urdheri i brendshëm Nr 578 datë 14.04.2011	E sekuestruar	11,614,400	Jepet me Qira
21	Bulqizë	Urdhri i Ministrit të Financave, nr.Nr.29 datë 05.07.2006."Per sekuestrimin e subjektit Taibah International" si dhe Urdheri i brendshëm Nr 578 datë 14.04.2011	E sekuestruar	6,114,640	Jepet me Qira
22	Kukës	Urdhri i Ministrit të Financave, nr.Nr.28 datë 05.07.2006."Per sekuestrimin e subjektit Abdyl Latif A.A.Saleh" si dhe Urdheri i brendshëm Nr 578 datë 14.04.2011	E sekuestruar	543,950	Jepet me Qira
23	Lushnje	nr. 12, date 03/06/2008, nga Gjykata e Shkallës së Pare për Krime të Rënda	E konfiskuar	12,223,733	Jepet me Qira
24	Lushnje	nr. 04, date 25/02/2010, nga Gjykata e Shkallës së Pare për Krime të Rënda	E sekuestruar	2,080,790	Jepet me Qira
25		nr. 12, date 03/06/2008, nga Gjykata e Shkallës së Pare për Krime të Rënda	E Konfiskuar	50,700,000	Jepet me Qira
26	Durrës	Nr. 5 datë 7.04.2011 të Gjykata e Shkallës së Parë për Krime të Rënda, Tiranë	E Konfiskuar	2,095,500	Jepet me Qira
27	Tiranë	Urdhri i Ministrit të Financave, nr.2 datë 03.12.2004 "Per sekuestrimin e asetëve te shtetasit arab Yasin Al-Qadi i njohur dhe si: a) Shaykh Yassin Abdullah Kadi, b) Yasin Kahdi, c) Yassin Kadi, c) Kadi Yassin, d) Yassin Abdullah Kadi"	E sekuestruar	6,710,000	Jepet me Qira
28	Durrës	Nr. 5 datë 7.04.2011 të Gjykata e Shkallës së Parë për Krime të Rënda, Tiranë	E konfiskuar	9,159,150	Jepet me Qira
29	Vlore	Urdher i Ministrit te Financave nr. 03 date 07.01.2011	E sekuestruar	3,496,500	E dhene me
30	Vlore	Urdher i Ministrit te Financave nr. 03 date 07.01.2011	E sekuestruar	3,496,500	Jepet me Qira
31	Tiranë	Urdhri i Ministrit të Financave, nr.2 datë 03.12.2004 "Per sekuestrimin e asetëve te shtetasit arab Yasin Al-Qadi i njohur dhe si: a) Shaykh Yassin Abdullah Kadi, b) Yasin Kahdi, c) Yassin Kadi, c) Kadi Yassin, d) Yassin Abdullah Kadi"	E sekuestruar	2,839,550	Jepet me Qira
32	Tiranë	Urdher Nr. 36 datë 27.11.2006 të Ministrit të Financave	E sekuestruar	9,174,400	Dhene me qera
33	Fier	Urdher i Ministrit te Financave nr. 16 datë 27.12.2010 i Gjykatës së Shkallës së Parë	E sekuestruar	12,681,900	Dhene me qera
34	Tiranë	Urdhëri nr. 02, datë 03.12.2004 dhe Nr. 36, datë 27.11.2006 të Ministrit të Financave	E sekuestruar	138,936,260	Jepet me qera
35	Vlore	Nr 12 datë 07.10.2010 i Gjykatës së Shkallës së Parë për Krimet e Rënda	E sekuestruar	20,000,000	Jepet me qera
36	Durrës	Nr. 06, datë 23/07/2009 nga Gjykata e Shkallës së Parë për Krime të Rënda, Tiranë si dhe e lënë në fuqi nga Gjykata e Lartë me vendimin Nr.04, datë 17/02/2010	E konfiskuar	100,800,000	Jepet me qera
37	Durrës	Nr. 06, date 23/07/2009 nga Gjykata e Shkallës së Pare për Krime të Rënda, Tirane si dhe e lene ne fuqi nga Gjykata e Larte me vendimin Nr.04, date 17/02/2010	E konfiskuar	74,520,000	Jepet me qera
38	Durrës	Nr. 06, date 23/07/2009 nga Gjykata e Shkallës së Pare për Krime të Rënda, Tirane si dhe e lene ne fuqi nga Gjykata e Larte me vendimin Nr.04, date 17/02/2010	E konfiskuar	49,680,000	Jepet me qera
39	Tiranë	Nr 12 datë 07.10.2010 i Gjykatës së Shkallës së Parë për Krimet e Rënda	E sekuestruar	20,000,000	Jepet me qera
		Totali		666,827,718	

Tabela 16: Përmbledhëse e urdhërave të sekuestrimit dhe vendimeve të konfiskimit¹⁶⁷

¹⁶⁷ Marrë nga Agjensia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara e të Konfiskuara (APPSK)

Nr	Qyteti	Vendimi/Urdheri	Statusi	Vlera (Lekë)	Gjendja
1	Tirane	Urdhri i Ministrit të Financave, nr.2 datë 03.12.2004 "Per sekuestrimin e asetëve të shtetasit arab Yasin Al-Qadi i njohur dhe si: a) Shaykh Yassin Abdullah Kadi, b) Yasin Kahdi, c) Yassin Kadi, ç) Kadi Yassin, d) Yassin Abdullah Kadi"	E sekuestruar	16,775,000	Jepet me Qira
2	Tirane	Urdhri i Ministrit të Financave, nr.2 datë 03.12.2004 "Per sekuestrimin e asetëve të shtetasit arab Yasin Al-Qadi i njohur dhe si: a) Shaykh Yassin Abdullah Kadi, b) Yasin Kahdi, c) Yassin Kadi, ç) Kadi Yassin, d) Yassin Abdullah Kadi"	E sekuestruar	14,335,000	Jepet me Qira
3	Tirane	Urdhri i Ministrit të Financave, nr.2 datë 03.12.2004 "Per sekuestrimin e asetëve të shtetasit arab Yasin Al-Qadi i njohur dhe si: a) Shaykh Yassin Abdullah Kadi, b) Yasin Kahdi, c) Yassin Kadi, ç) Kadi Yassin, d) Yassin Abdullah Kadi"	E sekuestruar	17,080,000	Jepet me Qira
4	Tirane	Urdhri i Ministrit të Financave, nr.2 datë 03.12.2004 "Per sekuestrimin e asetëve të shtetasit arab Yasin Al-Qadi i njohur dhe si: a) Shaykh Yassin Abdullah Kadi, b) Yasin Kahdi, c) Yassin Kadi, ç) Kadi Yassin, d) Yassin Abdullah Kadi"	E sekuestruar	14,411,250	Jepet me Qira
5	Tirane	Urdhër Nr. 36 datë 27.11.2006 të Ministrit të Financave	E sekuestruar	18,422,000	Jepet me Qira
6	Kukes	Urdhri i Ministrit të Financave, nr.Nr.28 datë 05.07.2006."Per sekuestrimin e subjektit Abdyl Latif A.A.Saleh" si dhe Urdheri i brendshëm Nr 578 datë 14.04.2011	E Sekuestruar	1,700,000	Jepet me Qira
7	Kukes	Urdhri i Ministrit të Financave, nr.Nr.28 datë 05.07.2006."Per sekuestrimin e subjektit Taibah International" si dhe Urdheri i brendshëm Nr 578 datë 14.04.2011	E Sekuestruar	1,700,000	Jepet me Qira
8	Bulqize	Urdhri i Ministrit të Financave, nr.Nr.29 datë 05.07.2006."Per sekuestrimin e subjektit Taibah International" si dhe Urdheri i brendshëm Nr 578 datë 14.04.2011	E sekuestruar	7,071,120	Jepet me Qira
9	Bulqize	Urdhri i Ministrit të Financave, nr.Nr.29 datë 05.07.2006."Per sekuestrimin e subjektit Taibah International" si dhe Urdheri i brendshëm Nr 578 datë 14.04.2011	E sekuestruar	11,614,400	Jepet me Qira
10	Bulqize	Urdhri i Ministrit të Financave, nr.Nr.29 datë 05.07.2006."Per sekuestrimin e subjektit Taibah International" si dhe Urdheri i brendshëm Nr 578 datë 14.04.2011	E sekuestruar	6,114,640	Jepet me Qira
11	Kukes	Urdhri i Ministrit të Financave, nr.Nr.28 datë 05.07.2006."Per sekuestrimin e subjektit Abdyl Latif A.A.Saleh" si dhe Urdheri i brendshëm Nr 578 datë 14.04.2011	E sekuestruar	543,950	Jepet me Qira
12	Tirane	Urdhri i Ministrit të Financave, nr.2 datë 03.12.2004 "Per sekuestrimin e asetëve të shtetasit arab Yasin Al-Qadi i njohur dhe si: a) Shaykh Yassin Abdullah Kadi, b) Yasin Kahdi, c) Yassin Kadi, ç) Kadi Yassin, d) Yassin Abdullah Kadi"	E sekuestruar	6,710,000	Jepet me Qira
13	Vlore	Urdher i Ministrit te Financave nr. 03 date 07.01.2011	E sekuestruar	3,496,500	E dhene me Qira
14	Vlore	Urdher i Ministrit te Financave nr. 03 date 07.01.2011	E sekuestruar	3,496,500	Jepet me Qira
15	Tirane	Urdhri i Ministrit të Financave, nr.2 datë 03.12.2004 "Per sekuestrimin e asetëve të shtetasit arab Yasin Al-Qadi i njohur dhe si: a) Shaykh Yassin Abdullah Kadi, b) Yasin Kahdi, c) Yassin Kadi, ç) Kadi Yassin, d) Yassin Abdullah Kadi"	E sekuestruar	2,839,550	Jepet me Qira
16	Tirane	Urdher Nr. 36 datë 27.11.2006 të Ministrit të Financave	E sekuestruar	9,174,400	Dhene me qera
17	Fier	Urdher i Ministrit te Financave nr. 16 datë 27.12.2010 i Gjykatës së Shkallës së Parë	E sekuestruar	12,681,900	Dhene me qera
18	Tirane	Urdhëri nr. 02, datë 03.12.2004 dhe Nr. 36, datë 27.11.2006 të Ministrit të Financave	E sekuestruar	138,936,260	Jepet me qera
		Totali		287,102,470	

Tabela 17: Urdhëra të Ministrit të Financave për sekuestrimin e pasurive, 2004-2014

Në Tabelën 16 janë pasqyruar të gjithë urdhërat dhe vendimet për sekuestrimet dhe konfiskimet të cilat i janë lënë në administrim AAPSK-së. Siç shihet urdhërat janë dhënë edhe nga GJKR-ja dhe nga Ministri i Financave. GJKR nxjerr urdhëra sekuestrimi dhe konfiskimi për rastet e krimeve të rënda, ndërsa Ministri i Financave nxjerr urdhër për pasuritë e personave që janë në listën e Këshillit të Sigurimit si financues terrorizmi. Në Shqipëri, pra ka edhe autoritete të tjera, siç është Ministri i Financave, për ngrirjen e pasurive të financuesve të terrorizmit. Totali i vlerave të sekuestruara dhe të konfiskuara për periudhën në studim është në shifrën 287.102.470 lekë. Një ndarje për efekte të analizës do

na jepte situata të ndryshme për rastet kur konfiskohen nga gjykata dhe rastet kur vendoset nga Ministri i Financave. Tabelat 17 dhe 18 paraqesin këto raste si më poshtë:

Nr	Qyteti	Vendimi/Urdheri	Statusi	Vlera (Lekë)	Gjendja
1	Tirane	Vendimi Nr. 4, datë 17.01.2011 të Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda	E Konfiskuar	4,187,700	Jepet me Qira
2	Tirane	Nr. 04, date 25/02/2010, nga Gjykata e Shkalles se Pare per Krime te Renda	E Sekuestruar	20,274,875	Jepet me Qira
3	Lushnje	Nr. 04, datë 25/02/2010, nga Gjykata e Shkallës së Parë për Krime të Rënda	E Sekuestruar	8,540,000	Jepet me Qira
4	Tirane	Nr. 10 datë 11.07.2005 të Gjykatës së Shkallës Parë për Krime të Rënda	E Konfiskuar	865,000	Shitet
5	Tirane	Nr. 2 datë 8.01.2010 Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda	E Konfiskuar	85,000	Shitet
6	Tirane	Nr. 10 datë 11.07.2005 të Gjykatës së Shkallës Parë për Krime të Rënda	E Konfiskuar	385,000	Shitet
7	Tirane	Nr. 37 datë 03.05.2006 Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda	E Konfiskuar	258,000	Shitet
8	Tirane	Nr. 2 datë 8.01.2010 Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda	E Konfiskuar	650,000	Shitet
9	Permet	Nr. 37 datë 03.05.2006 të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda	E Konfiskuar	775,000	Shitet
10	Tirane	Nr. 2 datë 8.01.2010 Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda	E Konfiskuar	350,000	Shitet
11	Durres	Nr. 5 datë 7.04.2011 të Gjykata e Shkallës së Parë për Krime të Rënda, Tiranë	E Konfiskuar	2,095,500	Jepet me Qira
12	Lushnje	Nr. 12, datë 03/06/2008, nga Gjykata e Shkallës së Pare per Krime te Renda	E konfiskuar	12,223,733	Jepet me Qira
13	Lushnje	Nr. 04, date 25/02/2010, nga Gjykata e Shkallës së Parë për Krime të Rënda, Tiranë	E sekuestruar	2,080,790	Jepet me Qira
14		Nr. 12, date 03/06/2008, nga Gjykata e Shkalles se Pare per Krime te Renda	E Konfiskuar	50,700,000	Jepet me Qira
15	Durres	Nr. 5 datë 7.04.2011 të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda	E Konfiskuar	2,095,500	Jepet me Qira
16	Durres	Nr. 5 datë 7.04.2011 të Gjykata e Shkallës së Parë për Krime të Rënda, Tiranë	E konfiskuar	9,159,150	Jepet me Qira
17	Vlore	Nr 12 datë 07.10.2010 i Gjykatës së Shkallës së Parë për Krimet e Rënda	E sekuestruar	20,000,000	Jepet me qera
18	Durres	Nr. 06, datë 23/07/2009 nga Gjykata e Shkallës së Parë për Krime të Rënda, Tiranë si dhe e lënë në fuqi nga Gjykata e Lartë me vendimin Nr.04, datë 17/02/2010	E konfiskuar	100,800,000	Jepet me qera
19	Durres	Nr. 06, date 23/07/2009 nga Gjykata e Shkalles se Pare per Krime te Renda, Tirane si dhe e lene ne fuqi nga Gjykata e Larte me vendimin Nr.04, date 17/02/2010	E konfiskuar	74,520,000	Jepet me qera
20	Durres	Nr. 06, date 23/07/2009 nga Gjykata e Shkalles se Pare per Krime te Renda, Tirane si dhe e lene ne fuqi nga Gjykata e Larte me vendimin Nr.04, date 17/02/2010	E konfiskuar	49,680,000	Jepet me qera
21	Tirane	Nr 12 datë 07.10.2010 i Gjykatës së Shkallës së Parë për Krimet e Rënda	E sekuestruar	20,000,000	Jepet me qera
		Totali		379,725,248	

Tabela 18: Vendime të Gjykatës së Krimeve të Rënda, 2004-2012

Masa				Njoftim		Njoftim	
	Raste	Sekuestruar	Konfiskuar	Shitje	Shitur	Qera	Dhënë
Urdhër Ministri	18	18	0	0	0	15	3
Vendim Gjykate	21	4	17	7	0	14	0
TOTALI	39	22	17	7	0	29	3

Tabela 19: Përmbledhëse e Urdhërave të Minsitrit dhe Vendimeve të GJKR




Figura 13: Paraqitja grafike Urdhërave të Minsitrit




Figura 14: Paraqitja grafike e Vendimeve të GJKR




Figura 15: Paraqitja grafike e Urdhërave të Minsitrit dhe Vendimeve të GJKR

Siç shihet dhe nga paraqitjet e mësipërme asnjë pasuri nuk është shitur, Vetëm tre objekte, banesa kane arritur që të jepen me qera. Treguesit e menaxhimit janë shumë të ulta, për arësytet që u shpjeguan më sipër.

Nr	Shtetet	Hetimi	Gjykimi	Menaxhimi
1	Albania	39	45	25
2	Austria	55	61	60
3	Belgjika	49	45	35
4	Danimarka	85	90	92
5	Finland	55	78	75
6	France	40	38	50
7	Gjermani	81	63	62
8	Greqi	71	45	71
9	Irland	63	52	80
10	Italia	41	52	46
11	Luksemburg	61	64	85
12	Holande	69	70	83
13	Portugalia	32	25	6
14	Spanja	53	50	49
15	Suedia	65	52	45
16	Anglia	59	59	54

Tabela 20: Krahاسimi i gjetjeve të Shqipërisë me 15 vendet e Bashkimit Europian¹⁶⁸




Figura 16: Paraqitja grafike e krahasimit të rezultateve të Shqipërisë me 15 vendet e BE-së

Krahasimi me të dhënat e 15 vendeve të BE-së e rendit Shqipërinë në një mesatare të zbatimit të ligjit për hetimet financiare sipas fazave të hetimit, gjykimit dhe administrimit të pasurive të sekuestruara dhe të konfiskuara.

¹⁶⁸ Të dhënat për shtetet e tjera janë marrë nga libri i autores Barbara Vettori “Vështirësitë mbi pasuritë kriminale”

5.4 Përmbledhje e kapitullit

Në këtë kapitull janë analizuar instrumenteve juridikë dhe efektiviteti i zbatimit të tyre për hetimet financiare në Shqipëri, për periudhën në studim. Analizat statistikore e raporteve vjetore 2004-2014 të Gjykatës së Krimeve të Rënda dhe raportet vjetore të Prokurorisë së Krimeve të Rënda, si dhe vlerësimi i ekspertëve në pyetësorët e përgatitur nxjerr treguesit konkretë të rezultateve të zbatueshmërisë së legjislacionit në praktikë, në tre fazat e hetimit, gjykitimit dhe administrimit të pasurisë së sekuestruar dhe konfiskuar, duke dhënë dhe një pasqyrë me tregues dhe gjetje lidhur me diferencën ndërmjet ligjit dhe zbatimit në praktikë. Analiza është mbështetur në praktikën që është përdorur në vendet e Bashkimit Europian për vlerësimin e efikasitetit të masave parandaluese kundër pasurisë. Analiza është bërë për secilën fazë, hetimi, gjykimi dhe administrimi, duke përdorur pyetësor për mbledhjen e të dhënave dhe marrjen e komenteve dhe mendimit të ekspertëve të institucioneve që merren me hetimet financiare, konfiskimin e produkteve të krimit dhe administrimin e pasurive që rrjedhin nga krimi. Për nga kontributi që ky kapitull sjell në studim është më i rëndësishmi, pasi trajtohen të gjitha pyetjet kërkimore dhe i jepet përgjigje pyetjes kryesore kërkimore se cili është efektiviteti i masave ligjore, institucionale dhe operacionale në fazat e a) hetimit, b) gjykitimit dhe c) administrimit të pasurive të sekuestruara dhe konfiskuara për periudhën 2004-2014, në Shqipëri. Nga analiza e rezultateve, të përshkruar hollësisht në këtë kapitull, rezulton se zbatimi i ligjit për hetimet financiare, konfiskimin dhe administrimin e pasurive është përkatësisht 39% për fazën e hetimit, 45% për fazën e gjykitimit dhe 25% për fazën e administrimit të pasurive të sekuestruara dhe të konfiskuara. Në të tre fazat, përqindja e zbatimit të ligjit është nën mesataren, por më dobët paraqitet faza e administrimit të pasurive. Arësyet e rezultateve dhe faktorët që ndikojnë në moszbatimin e ligjit, janë nxjerrë nga

analiza e pyetësorëve ku rezulton se faktorët që kanë ndikuar në këtë rezultat sipas fazave janë: a) për fazën e hetimit, *së pari* përdorimi i shpeshtë i mjeteve speciale të hetimit nuk është i mundur për hetimet financiare në veçanti. Vetëm në rastet kur verifikimi i aseteve bëhet paralelisht me hetimin penal është e mundur për të aplikuar mjete speciale të hetimit për të kërkuar produktet e krimit në zbatim të nenit 294/a të Kodit të Procedurës Penale, për të zbuluar të dhëna financiare ose pronësie të një personi¹⁶⁹, ndërsa në rastet kur bëhet hetim bazuar në ligjin për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit dhe korrupsionit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë nuk mund të aplikohen mjete speciale të hetimit, *së dyti* lidhur me hetimet financiare për palët e treta, është përcaktuar në përmbajtjen e nenit 3 fusha e zbatimit të ligjit dhe rrethi i personave ndaj të cilëve mund të zbatohen masat kundër pasurisë, por kushti është që ndaj tyre të ketë një dyshim të arësyeshëm, bazuar në indicje¹⁷⁰, *së treti*, nuk ka zyra me përbërje multidisiplinare për hetimet financiare, në rastet kur kërkohet mendim i specializuar thirret eksperti nga ana e prokurorit, sipas rastit¹⁷¹.

b) *për fazën e gjyqimit*, vlen për tu theksuar se sipas dispozitave të ligjit barra e provës kalon tek i dyshuari por vështirësitë qëndrojnë në përcaktimin e vlerës së pasurisë dhe aplikimin nga gjykatat ku për shkak të ekzistencës së ekonomisë informale dhe korrupsionit, mundësitë për të justifikuar ligjshmërinë nga ana e personit janë të mëdha. Këtë e tregon dhe vlerësimi dobët në përgjigjen e pyetësorit¹⁷². Në përgjigjen e pyetësorit eksperti shprehet se “për shkak

¹⁶⁹ Pyetësor me ekspertë të ndjekjes penale, (Kod. 1/1), Prill 2014

¹⁷⁰ Neni 3 pika 1 e ligjit 10192, datë 3.12.2009, “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit dhe korrupsionit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”, ndryshuar me ligjin 24/2014

¹⁷¹ Pyetësor me ekspertë të ndjekjes penale, (Kod. 1/1), Prill 2014, pika 4.1

¹⁷² Pyetësor me ekspertë të ndjekjes penale, (Kod. 1/1), Prill 2014, pika 15

të informalitetit është e vështirë të provohet se pasuria i është në pronësi të personit të dyshuar për aktivitet kriminal¹⁷³.

c) *për fazën e administrimit të pasurive të sekuestruara dhe të konfiskuara*, duhet theksuar se nuk zbatohen procedura të menaxhimit aktiv të pasurive të sekuestruara dhe të konfiskuara. Gjithashtu agjencia për administrimin e pasurive të sekuestruara dhe të konfiskuara, megjithëse është krijuar me ligj që në vitin 2004, aktiviteti i saj ka filluar në vitin 2008, për shkak të mosnxjerrjes së akteve nënligjore për funksionimin e saj¹⁷⁴. Për sa i përket bashkëpunimit ndërmjet agjencive, vlerësimi sipas ekspertit¹⁷⁵ është dobët. Nuk ka dispozita ligjore konkrete për bashkëpunimin, por ka memorandum bashkëpunimi i cili nuk është vënë në zbatim¹⁷⁶. Gjithashtu ekzekutimi i vendimeve të konfiskimit bëhet nga zyra e përmbartimit, dhe shpesh herë ekzekutimi i vendimeve është kryer me vonesë, sepse këta të fundit kanë mungesa në burime njerëzore¹⁷⁷.

Nisur nga gjetjet e mësipërme dhe analiza e detajuar e faktorëve që ndikojnë në zbatimin e ligjit, mendoj se ideja për të krijuar një strukturë me specialistë të fushave të ndryshme, dhe mbështetja me burime njerëzore dhe materiale të saj është e domosdoshme, me qëllim rritjen e zbatimit të ligjit në fushën e hetimeve financiare, konfiskimit dhe administrimit të pasurive të sekuestruara dhe të konfiskuara.

¹⁷³ Pyetësor me ekspertë të ndjekjes penale, (Kod. 1/1), Prill 2014, pika 16.1

¹⁷⁴ Pyetësor me ekspertë të administrimit të pasurive të sekuestruara dhe konfiskuara, (Kod. 1/4), Maj 2014

¹⁷⁵ Pyetësor me ekspertë të administrimit të pasurive të sekuestruara dhe konfiskuara, (Kod. 1/4), Maj 2014, pika 21.1

¹⁷⁶ Pyetësor me ekspertë të administrimit të pasurive të sekuestruara dhe konfiskuara, (Kod. 1/4), Maj 2014, pika 21.1

¹⁷⁷ Pyetësor me ekspertë të administrimit të pasurive të sekuestruara dhe konfiskuara, (Kod. 1/4), Maj 2014, pika 22

KAPITULLI VI: VËSHTRIM KRAHASUES I LEGJISLACIONIT ME VENDET E BALLKANIT PERËNDIMOR

6.1 Të përgjithshme

Goditja e të ardhurave nga krimi është një mjet efikas në luftën kundër krimeve të rënda dhe krimin të organizuar, ku motivi kryesor është arritja e përfitimit. Për shkak të rrezikshmërisë që krimi i organizuar, veçanërisht ai transnacional paraqet ndaj shoqërisë, komuniteti ndërkombëtar ka vënë në qendër të vëmendjes çështjen e konfiskimit të produkteve të krimin dhe ka miratuar instrumente të ndryshme ligjore, standartet minimale për një punë efektive dhe për bashkëpunim në këtë fushë. Edhe vendet e Ballkanit Perëndimor, Kroacia, Bosnje Hercegovina, Serbia, Shqipëria, Kosova, Mali i Zi dhe Maqedonia, kanë qënë pjesë e projekteve të Këshillit të Europës, për forcimin e kapaciteteve për të zhvilluar hetime financiare që synojnë konfiskimin e produkteve të krimin. Në këtë kapitull do të trajtojmë disa çështje lidhur me legjislacionin, institucionet, hetimet financiare dhe konfiskimin e produkteve të krimin në Ballkanin Perëndimor. Këta vende, kanë nënshkruar, pranuar ose përfshirë në të drejtën e brendshme (rasti i Kosovës) të gjitha instrumentet juridikë ndërkombëtare. Ato kanë nënshkruar strategjinë rajonale mbi mjetet kundër krimin të organizuar dhe krimin ekonomik, finalizuar me Deklaratën e Përbashkët, nënshkruar me 23 Shtator 2005, në Brijuni, Kroaci.

E përbashkëta e legjislacioneve të këtyre vendeve është fakti se hetimet drejtohen nga prokurori. Kjo e lehtëson bashkëpunimin ndërmjet prokurorive, bashkëpunim i cili shpesh është burokratik dhe formal. Të gjitha vendet kanë miratuar ligje të cilat lejojnë të bëjnë identifikimin, zbulimin, sekuestrimin dhe konfiskimin e produkteve të krimin. Praktikë e

zbatuara në këto vende është e ndryshme. Në disa shtete si Kroacia, Bosnje Hercegovina, Serbia dhe Maqedonia, dispozitat ligjore për hetimet financiare dhe konfiskimin e produkteve të krimit i përfshijnë në të drejtën penale dhe procedurale penale. Ndërsa Shqipëria dhe Kosova, përveç dispozitave të veçanta në Kodin penal dhe procedural penal, kanë miratuar ligje specifike, siç është ligji antimafia në Shqipëri, dhe ligji Nr. 04/l-140, datë 11.2.2013 “Për kompetencat e zgjeruara për konfiskimin e pasurisë së përfituar me vepër penale”, në Kosovë. Sfida për të gjitha vendet e Ballkanit Perëndimor mbetet eficaenca e zbatimit në praktikë, sjellja e rezultateve konkrete dhe dispozitat dhe eficaenca në administrimin e pasurisë së konfiskuar. Ekzistenca e ekonomisë informale, korrupsioni i lartë, mungesa e bazave të të dhënave të përshtatshme mbi hetimin financiar, konfiskimin e përkohshëm, sekuestrimin, dhe konfiskimin përfundimtar, sjellin mungesë të statistikave, të cilat do të bënin të mundur analiza strategjike dhe nxjerrjen e konkluzioneve sa më reale si dhe rekomandime të vlefshme. Në formë të përmbledhur, më poshtë, për secilin shtet, do trajtohen çështje legjislativë, institucionale, të konfiskimit të zgjeruar dhe barrës së provës, për hetimet financiare dhe konfiskimin e produkteve të krimit. Analiza e këtyre aspekteve do ta bëjë të mundur krahasimin ndërmjet vendeve të Ballkanit Perëndimor, sidomos në dy drejtime kryesore, legjislativë dhe institucionale. Të gjitha vendet e rajonit kanë ratifikuar Konventat e Kombeve të Bashkuara dhe Konventat e Këshillit të Europës siç është theksuar dhe më lart.

6.2 Kroacia

Zyra e Prokurorit të Republikës së Kroacisë (DORH) është autoriteti i ndjekjes penale. Kur kanë të bëjnë me çështjet brenda juridiksionit të tyre, prokurorët publikë kanë autoritetin për

të bërë kontakte të drejtpërdrejta dhe të kërkojnë ndihmë nga policia. Megjithatë, Akti i ri i Procedurës Penale i miratuar në dhjetor të vitit 2008 përmban ndryshime të rëndësishme në lidhje me fazën e hetimeve. Policia dhe DORH kanë rolin udhëheqës në kryerjen e hetimeve penale, ndërsa gjyqtarët janë të kufizuar në kontrollin e të drejtave themelore. Në Qershor të vitit 2009 është miratuar ligji¹⁷⁸ “Mbi zyrën për luftimin e korrupsionit dhe krimit të organizuar”, i cili ka hyrë në fuqi më 1 Korrik 2009. Zyra për goditjen e krimit të organizuar dhe korrupsionit (USKOK) është themeluar në kuadër të Zyrës së Prokurorisë së Shtetit. Përgjegjëse për ndjekjen e akteve të korrupsionit dhe krimit të organizuar në Kroaci: “Zyra për luftimin e korrupsionit dhe krimit të organizuar” (USKOK) me degët në qarqet (Zagreb, Split, Rijeka, Osijek) për korrupsionin dhe rastet e krimit të organizuar. Pavarësisht legjislacionit të plotë dhe ekzistencën e një kuadri ligjor për korrupsionin, ende ka vështirësi të konsiderueshme në zbatimin e dispozitave ligjore. Konfiskimi i shtrirë rregullohet me dispozitat e Kodit Penal,¹⁷⁹ Kodit të Procedurës Penale¹⁸⁰, si dhe me ligjin mbi Zyrën për goditjen e korrupsionit dhe krimit të organizuar, (USKOK)¹⁸¹

Neni 80 i Kodit Penal kroat përcakton masat e sigurimit për konfiskimin (sekuestrimin) e objektit i cili ishte parashikuar të përdorej ose është përdorur për kryerjen e një vepre penale, ose është rezultat i kryerjes së një vepre penale, kur egjstion rreziku se objekti mund të përdoret përsëri për kryerjen e një vepre penale, si dhe për shkak të sigurisë publike dhe arsye morale. Gjithashtu, kodi penal (neni 82) rregullon konfiskimin e detyruar të

¹⁷⁸ Zakon o uredu za suzbijanje korupcije i organiziranog kriminaliteta, 2009, marrë nga <http://www.dorh.hr/Default.aspx?art=7498>

¹⁷⁹ NN 110/1997, NN 27/98, NN 129/00, NN 51/01, NN 111/03, <http://www.vsrh.hr/EasyWeb.asp?pcpid=286> (parë më 25 Maj 2015)

¹⁸⁰ Ligji mbi zyrën për luftimin e korrupsionit dhe krimit të organizuar http://narodnenovine.nn.hr/clanci/sluzbeni/2009_07_76_1834.html

¹⁸¹ NN 152/08, NN 76/09, NN 48/05

produkteve të drejtpërdrejta dhe të tërthorta të krimit, pas marrjes së vendimit nga Gjykata. Produktet e krimit mund të konfiskohen edhe kur i kanë kaluar një pale të tretë ose një personi juridik, nëse ato nuk janë marrë prej tyre në mirbesim. Kodi penal kroat parashikon përgjegjësinë penale të personave juridikë. Konfiskimi i bazuar në vlerë parashikohet nga dispozitat e nenit 82/2 të KP dhe nenit 20/4 të Ligjit mbi përgjegjësinë penale të personave juridikë. Si masë e përkohshme përcaktohet dhe monitorimi i transakioneve bankare. Konfiskimi i aseteve kriminale, sipas legjislacionit penal dhe procedural penal kroat, bëhet vetëm pasi vendimi për fajësinë të jetë i formës së prerë, dhe vetëm për konfiskime të përkohshme legjislacioni lejon për një periudhë të caktuar. Gjithashtu Kroacia ka miratuar dhe ligjin mbi procedurën për konfiskimin nga aktivitetet kriminale¹⁸². Me interes është analiza e këtij ligji në aspektin e organizimit institucional të kësaj strukture. USKOK është zyrë pranë Prokurorit të shtetit, si zyrë e prokurorit special¹⁸³, e cila është themeluar në Republikën e Kroacisë dhe ka selinë e saj në Zagreb. Në fushën e zbatimit të këtij ligji është përcaktuar dhe sigurimi i konfiskimit të fondeve, të ardhurave apo pasurive të fituar me anë të veprës penale¹⁸⁴, e cila ka interes për punimin. Konfiskimi i mjeteve, fitimeve ose pasurive, rregullohet nga përmbajtja e dispozitës 50 të ligjit ku shprehet: (1) Dispozitat e kësaj pjese të ligjit përcaktojnë procedurën me të cilën Zyra dhe gjykatat marrin masat e përkohshme (masat e sigurisë), për të ardhurat ose asetet në lidhje me veprat penale të

¹⁸² Ligji mbi procedurën për konfiskimin e fitimit nga aktivitetet kriminale, NN145/10, i kaluar me 24.12.2010

¹⁸³ Neni 2 pika 1 e ligjit nr. 215-01/09/01/04, 2009, shih: <http://www.dorh.hr/Default.aspx?art=7498>

¹⁸⁴ Neni 1 pika 4 e ligjit nr. 215-01/09/01/04, 2009, shih: <http://www.dorh.hr/Default.aspx?art=7498>

përmendura në nenin 21 të këtij ligji. (2) Procedura nga paragrafi 1 i këtij neni nuk është një çështje penale dhe në mënyrë të përshtatshme zbatohen dispozitat e Ligjit për Zbatimin¹⁸⁵ në qoftë se në dispozitat e këtij ligji nuk është përcaktuar ndryshe. (3) Konfiskimi i pasurisë së siguruar, të ardhurave ose pasurisë së përmendur në paragrafin 1 të këtij neni do të bëhet sipas dispozitave për konfiskimin e pronave në Ligjin e Procedurës Penale. Në përmbajtjen e nenit 55 të këtij ligji jepen kushtet¹⁸⁶ duke u shprehur se gjykata mund të marrë një vendim konfiskimi me kusht që të ekzistojë dyshimi i arsyeshëm se një person fizik ose juridik ka kryer veprën penale sipas nenit 21 të këtij ligji dhe ka baza të arësyeshme. Ndërsa në nenin 56 të këtij ligji përcaktohet procedura për fillimin e një hetimi financiar, kërkesë e cila përfshin: 1) një përshkrim të shkurtër faktik i veprës dhe emri i tij ligjor, 2) informacion për personin fizik apo juridik për të cilat është paraqitur kërkesa, 3) përshkrimin e pasurisë, të ardhurave apo pasurisë të cilën personi fizik ose juridik zotëron, 4) arsyet për bindjen e ekzistencës së pabarazisë së dukshme të konsiderueshme në mes të vlerës së aseteve, të ardhurave dhe aseteve të cilin personi fizik ose juridik ka vlerë dhe organeve kompetente shtetërore raportuar pagat dhe të ardhura të tjera, 5) arsyet për të besuar se kundërshtari do të çaktivizoni sigurinë ose të bëjë të vështirë marrja e pronës, pasurive ose të ardhurave duke zbatuar masat e referuara në nenin 82 paragrafi 2 i Kodit Penal¹⁸⁷.

Praktika kroate për konfiskimin e aseteve kriminale është një praktikë e mire për disa arsye: *Së pari*, strukturat përgjegjëse për konfiskimin janë të përqëndruara në një zyrë qendrore dhe degët e saj siç u shpjegua më sipër, *së dyti*, janë përcaktuar në ligj mënyra e emërimit, detyrat

¹⁸⁵ Gazeta Zyrtare, nr. 57/96, 29/99, 173/03, 194/03, 151/04, 88/05, dhe 67/08.

¹⁸⁶ Neni 55 pika 1, 2 të ligjit nr. 215-01/09/01/04, 2009, shih: <http://www.dorh.hr/Default.aspx?art=7498>

¹⁸⁷ Neni 56 pika 1, 2,3,4,5 të ligjit nr. 215-01/09/01/04, 2009, shih: <http://www.dorh.hr/Default.aspx?art=7498>

që duhet të kryhen dhe mënyra e bashkëpunimit me agjencitë e tjera që disponojnë të dhëna për fondet pasuritë që rrjedhin nga aktivitet kriminale, së treti, krijimi i databazave që ndihmojnë në identifikimin e pasurive që rrjedhin nga krimi, së katërti, përcaktimi i afateve për procedurat e konfiskimit¹⁸⁸.

6.3 Bosnje-Hercegovina

BiH ka zyra të një prokurori të nivelit shtetëror, si dhe zyra të ndara në dy njësitë administrative. Prokuroria e BeH është themeluar në vitin 2002. Kjo zyrë përbëhet nga tre departamente: Departamenti Special për Krimet e Luftës; Departamenti Special për Krimin e Organizuar, Krimin Ekonomik dhe Korrupsionit; dhe Departamenti i cili merret me çështjet që bien jashtë juridiksionit të dy departamenteve të tjera (të tilla si veprat penale të terrorizmit, mbrojtjen e të drejtës së autorit, falsifikimit të parave, dhe bashkëpunimit ndërkombëtar në çështjet penale). Prokuroria e BiH nuk është mbi prokurorite e njësive të vecanta, përveçse në rastet e mësipërme. Sipas një vlerësimi të BE-së, shumë prokurorë dhe policë kanë vështirësi në të kuptuarit dhe zbatimit të kodeve të ndryshme penale substanciale në fuqi (Raporti i Progresit i BE-së të vitit 2008, 13-14). Hetimet financiare, sekuestrimi e konfiskimi rregullohen me dispozitat e parashikuara në Kodin Penal¹⁸⁹ dhe Kodi i Procedurës Penale¹⁹⁰. Nuk ka një ligj specifik, siç ka Shqipëria, Kosova apo Kroacia, në bazë të të cilit bëhen hetimet financiare dhe konfiskimi i produkteve të krimit. Reformat në legjislacionin penal të vitit 2003 sollën si rezultat shumë ndryshime si heqjen e hetimit

¹⁸⁸ Për më shumë shih përmbajtjen e neneve 56 e vijues të ligjit, në adresën <http://www.dorh.hr/Default.aspx?art=7498>

¹⁸⁹ Official Gazette of Bosnia and Herzegovina” No. 3/03, 32/03, 37/03, 54/04, 61/04, 30/05

¹⁹⁰ Official Gazette” of Bosnia and Herzegovina, 3/03, 32/03, 36/03, 26/04, 63/04, 13/05, 48/05

gjyqësor, drejtimin e hetimit nga prokuroria. Konfiskimi parashikohet në nenin 74 të KP dhe nenin 110 i KP, i cili shërben si bazë për konfiskimin e produkteve të krimit. Produktet konfiskohen me vendim të gjykatës e cila vendos nëse vepra penale është kryer. Në këtë kuptim konfiskimi i produkteve të krimit është i lidhur drejtpërdrejt me veprën penale. Agjencia kryesore që merret me hetimin është Agjencia Shtetërore e Hetimit dhe Mbrojtjes (SIPA), e cila është krijuar në vitin 2004.

6.4 Serbia

Zyra e Prokurorit Publik, e vendosur në Beograd, mbulon tërë territorin e Serbisë. Sipas nenit 56 të Ligjit për Zyrën e Prokurorit Publik, prokurorët emërohen nga Kuvendi Popullor me propozimin të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Funksionet kryesore të prokurorëve publikë janë të përcaktuara në nenin 46 të Kodit të Procedurës Penale. Ato përfshijnë kryerjen e procedurës para-gjyimit, duke kërkuar që hetimi të kryhet, drejtojnë procedurën paraprake, paraqesin një padi para gjykatës kompetente, apelojnë vendimin në gjykatë dhe dorëzojnë mjetet e jashtëzakonshme juridike kundër vendimit të përfundimtar të gjykatës. (GRECO 2005 10.) Kodi i ri i Procedurës Penale i miratuar nga Asambleja Kombëtare më 25 maj 2006 i jep më shumë autoritet dhe përgjegjësi prokurorëve publikë gjatë fazës hetimore të procedurës. Hetimet financiare dhe konfiskimi i produkteve të krimit gjen zbatim sipas dispozitave të Kodit penal¹⁹¹, dhe Kodit të Procedurës Penale¹⁹². Nuk ka ligj specifik për konfiskimin e produkteve të krimit.

¹⁹¹ Official Gazette of RS, Nos. 85/2005, 88/2005, 107/2005

¹⁹² OJ RS 46/2006, 49/07

6.5 Mali i Zi

Nenet 2 dhe 3 të Ligjit për Prokurorine sanksionojnë se prokurorët "do të jenë autonom dhe të pavarur"¹⁹³. Në bazë të dispozitave të nenit 44 të Kodit të Procedurës Penale, funksioni kryesor i prokurorëve është ndjekja penale e kryerësve të veprave penale. Prokurorët janë kompetentë për të kryer procedimet para-gjyqësore, të kërkojnë që një hetim të kryhet, të kryejë procedura të drejtpërdrejta dhe të paraqesë aktakuzë para gjykatës kompetente, ankojë vendimet gjyqësore që nuk janë përfundimtare dhe të ndërmarrë veprime të tjera nën të njëjtin Kod¹⁹⁴. Të gjitha organet që marrin pjesë në procedurën paraprake janë të detyruar të njoftojnë prokurorin e shtetit para se të kryejnë ndonjë veprim. Oficerët e policisë dhe autoritetet e tjera shtetërore përgjegjëse për hetimin e veprave penale janë të detyruar të vazhdojnë me çdo kërkesë nga ana e Prokurorit të Shtetit. Hetimet financiare dhe konfiskimi i produkteve të krimit gjen zbatim sipas dispozitave të Kodit Penal¹⁹⁵ dhe Kodit të Procedurës Penale¹⁹⁶.

6.6 Maqedonia

Prokuroria Publike është organ i vetëm i pavarur shtetëror përgjegjës për ndjekjen e kryerësve të veprave penale dhe të tjera të përcaktuara ligjërisht të dënueshme. Funksioni i prokurorisë publike kryhet nga Prokurori Publik dhe prokurorët publikë. Ligji për Këshillin e Prokurorëve Publikë të 2007 ka përforcuar autonominë e prokurorisë publike përmes

¹⁹³ Neni 2 dhe 3 i ligjit për prokurorinë në Malin e Zi

¹⁹⁴ Law on state prosecutor's office, (published in the "official gazette of the Republic of Montenegro", no. 69/2003 and "official gazette of montenegro" 40/2008)

¹⁹⁵ Neni 67, 68 i Kodit penal të Malit të Zi (The Code was published in the Official Gazette of the Republic of Montenegro 70/2003, 13/2004, 47/2006 and in the Official Gazette of Montenegro 40/2008).

¹⁹⁶ Neni 470-488 të Kodit të Procedurës Penale (Official Gazette of Montenegro 57/09 of 18 August 2009)

ridefinimit të sistemit për zgjedhjen dhe shkarkimin e prokurorëve publikë (Ministria e Drejtësisë 2007b, 12.) Ligji për Zyrën e Prokurorit Publik është miratuar në fund të vitit 2007. Në bazë të ligjit të ri, prokurorët publikë kanë më shumë kompetenca në udhëheqjen dhe koordinimin e procedurës para-hetimore: ata mund të kërkojnë personel të caktuar nga agjencitë e tjera të zbatimit të ligjit, dhe mund të veprojnë në emër të Ministrisë së Brendshme, Policisë Financiare dhe Drejtorisë doganore, nëse këto organe nuk veprojnë për çështjet brenda kompetencave të tyre.¹⁹⁷ Prokurori Publik i Shtetit emërohet nga Kuvendi. Prokurorët publikë janë të zgjedhur dhe të emëruar nga Këshilli i prokurorëve publik. Hetimet financiare dhe konfiskimi i produkteve të krimit gjen zbatim sipas dispozitave të Kodit Penal¹⁹⁸ dhe Kodit të Procedurës Penale¹⁹⁹.

6.7 Kosova

Në Kosovë, dispozitat për hetimin financiar dhe konfiskimin e produkteve të krimit janë përfshirë në të drejtën e brendshme me ndryshimet që i janë bërë Kodit Penal²⁰⁰ dhe Kodi i Procedurës Penale²⁰¹. Sikurse Shqipëria edhe Kosova ka miratuar një ligj specifik “Për kompetencat e zgjeruara për konfiskimin e pasurisë së përfituar me vepër penale”²⁰², i cili përcakton rrethin e personave, kompetencat dhe kriteret për sekuestrimin dhe konfiskimin.

¹⁹⁷ Neni 77 i Ligjit për prokurorinë publike, marrë nga <http://www.legislationline.org/documents/action/popup/id/7949>

¹⁹⁸ Neni 61, 62, 68, 92 të Kodit penal të Maqedonisë

¹⁹⁹ Neni 133, 147, 155, 178, 208 të Kodit të procedurës penale të Maqedonisë

²⁰⁰ Gazeta Zyrtare /Nr.19/13 Korrik 2012, Prishtinë

²⁰¹ Gazeta Zyrtare /Nr.37/28 Dhjetor 2012, Prishtinë

²⁰² Ligj Nr. 04/l-140, “Për kompetencat e zgjeruara për konfiskimin e pasurisë së përfituar me vepër penale”, Gazeta Zyrtare /Nr.5/8 Mars 2013, Prishtinë

Në Kapitullin VII, të KP të RKS-së, të titulluar “Konfiskimi i dobisë pasurore të fituar me anë të kryerjes së veprave penale”, parashikohen dispozitat për konfiskimin. Gjithashtu Kodi i Procedurës Penale, në një kapitull me vehte parashikon gjithë procedurat për konfiskimin, duke duke bërë të qarta procedurat, kompetencat, marrdhënjet mes prokurorisë, gjykatë, agjensisë së menaxhimit të aseteve. Në mendimin tim, është pozitiv fakti se në këtë kapitull janë të ndara masat gjatë fazës së hetimit, të gjykimit dhe menaxhimit të aseteve kriminale. Në nenin 1 të ligjit Nr. 04/l-140, “Për kompetencat e zgjeruara për konfiskimin e pasurisë së përfituar me vepër penale” përcaktohet qëllimi i ligjit sipas të cilit përcakton kompetencat e zgjeruara për konfiskimin e pasurisë së fituar nga personat që kanë kryer vepër penale, kur procedurat e përcaktuara në Kodin e Procedurës Penale nuk janë të mjaftueshme”. Nga vetë përmbajtja e kësaj dispozite duket qartë se për konfiskimin e zgjeruar në Kosovë, parësore është Kodi i Procedurës Penale, dhe vetëm nëse dispozitat nuk janë të mjaftueshme, atëherë zbatohen dispozitat e këtij ligji. Kushtet për konfiskimin e zgjeruar përcaktohen në nenin 6 të ligjit sipas të cilit konfiskimi i pasurisë së fituar me vepër penale kërkohet nga prokurori *së pari*, pasi autori është shpallur fajtor dhe vendimi ka marrë formë të prerë²⁰³, *së dyti*, të provohet shkaku i bazuar, *së treti*, autori të jetë shpall fajtor dhe vendimi të ketë marrë formë të prerë, për një ose disa nga veprat penale: a) kundër njerzimit dhe vlerave të mbrojtura me të drejtën ndërkombëtare²⁰⁴, b) veprat penale të narkotikëve²⁰⁵, c) krimi i

²⁰³ Sipas pikës 1 të nenit 1 të ligjit Nr. 04/l-140, “Për kompetencat e zgjeruara për konfiskimin e pasurisë së përfituar me vepër penale” parashikohet që brenda tridhjetë (30) ditësh nga aktgjykimi i formës së prerë me të cilin i pandehuri shpallet fajtor për vepër penale nga Kapitujt XV, XXIII, XXIV, XXV ose XXXIV të Kodit Penal, dhe nëse Prokurori i shtetit mund, në një kërkesë tjetër paraqitur Gjyqtarit të vetëm gjykues apo kryetarit të trupit gjykues, të ofrojë prova për të treguar shkak të bazuar.

²⁰⁴ Kap. XV, Nenet 148-177, të KP të RKS-së

²⁰⁵ Kap. XXIII, Nenet 273-282, të KP të RKS-së

organizuar²⁰⁶, ç) veprat penale kundër ekonomisë²⁰⁷, d) korrupsioni zyrtarë dhe veprat penale kundër detyrës zyrtare²⁰⁸.

Nga analiza krahasuese e legjislacioneve në vendet e Ballkanit Perëndimor arrijmë në përfundimin se: *së pari*, të gjitha vendet kanë parashikuar në legjislacionin e tyre penal dhe procedural penal, dispozita ligjore për konfiskimin e produkteve që rrjedhin nga veprimtari kriminale. Mali i Zi, Bosnje Hercegovina, dhe Maqedonia, i parashikojnë dispozitat ligjore për konfiskimin në ligjin penal dhe procedural të tyre, ndërsa Kroacia, Shqipëria, Serbia dhe Kosova, përveç parashikimit në kodin penal dhe procedural penal, kanë miratuar ligje specifike për konfiskimin e pasurisë që rrjedh nga veprat penale, *së dyti*, shtetet si Shqipëria dhe Kroacia kanë prokuror që janë të ngarkuar me hetimet financiare dhe konfiskimet, ndërsa në shtetet e tjera këto detyra i kryejnë prokurorët publikë, *së treti*, pasuritë e konfiskuara kanë shpërndarje të ndryshme në vende të ndryshme, për shembull në Shqipëri, përdorimi i pasurisë së konfiskuar bëhet sipas dispozitave të ligjit Antimafia²⁰⁹ dhe akteve në zbatim të tij, duke përfshirë dhe shpërblimin e viktimave.

Nga analiza e legjislacioneve në fushën e konfiskimit dhe administrimit të pasurive të konfiskuara, mendoj se legjislacioni shqiptar ka përparësi në krahasim me legjislacionet e tjera të vendeve të Ballkanit Perëndimor, kjo për arësye se: *së pari*, është një procedurë konfiskimi e përzierë, penale dhe civile duke i dhënë mundësi organit të prokurorisë për zbatimin e gjerë të masave të konfiskimit, *se dyti*, nuk kërkon domosdoshmërisht vendim të

²⁰⁶ Kap. XXIV, Nenet 283, i KP të RKS-së

²⁰⁷ Kap. XXV, Nenet 284-318, të KP të RKS-së

²⁰⁸ Kap. XXXIV, Nenet 422-437, të KP të RKS-së

²⁰⁹ Në kreun VI, "Përdorimi i pasurive të konfiskuara" të ligjit nr. 10192/2009, neni 29, 30 përcaktohet kalimi i pasurive të konfiskuara në pronësi të shtetit, kompetencat për mënyrën e përdorimit të pasurive të konfiskuara, neni 32 përcakton përdorimin e pasurive të luajtshme dhe i jeteve monetare dhe neni 33 përcakton përdorimin e pasurive të paluajtshme dhe i atyre, që shërbejnë për veprimtaritë ekonomike, tregtare dhe profesionale

formës së prerë për zbatimin e këtyre masave, siç e kërkojnë legjislacionet e vendeve tjera *së treti*, standarti i provës është më i ulët, pasi kërkohet “ ekzistenca e një dyshimi të arsyeshëm, bazuar në indicje”²¹⁰, *së katërti*, rrethi i personave është shumë i gjerë.

6.8 Përmbledhje e kapitullit

Ky kapitull përmbledh gjëndjen e legjislacionit ekzistues në fushën e indentifikimit, zbulimit (hetimit financiar), ngrirjes dhe sekuestrimit (masa të përkohshme), si dhe konfiskimit të produkteve të krimit në vendet e rajonit, Kroacia, Bosnje Hercegovina, Serbia, Mali i zi, Maqedonia dhe Kosova. Të gjitha vendet e rajonit kanë të njëjtën histori për sa i përket legjislacionit. Hartimi i legjislacionit penal është bërë duke respektuar zhvillimet në të drejtën e ndërkombëtare dhe specifikat e brendshmenë vendet e tyre. E përbashkëta është se këta shtete kanë hequr dorë nga hetimi gjyqësor formal, drejtuar nga gjyqtari hetues duke orientuar hetimet e drejtuara nga prokurori. Ky ndryshim krijon një mundësi bashkëpunimi ndërmjet vendeve të rajonit, për shkëmbimin e informacionit gjatë fazës së hetimit. Në aspektin ligjor vendet e rajonit në Kodet Penale dhe Proceduriale Penale, kanë bërë ndryshime, duke përfshirë dispozita për sekuestrimin dhe konfiskimin e produkteve të krimit. Disa vende si Kroacia, Kosova kanë miratuar dhe ligje specifike për konfiskimin e produkteve të krimit. Konfiskimi i produkteve të krimit është një mjet efikas në luftën kundër krimeve të rënda dhe atij të organizuar, megjithatë aplikimi në praktikë i standarteve ndërkombëtare e për më tepër i dispozitave ligjore ekzistuese vazhdon të paraqesë sfidë edhe

²¹⁰ Neni 3 i ligjit nr. 10192, datë 3.12.2009, “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar dhe trafikimit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”

për vendet e rajonit. Një tjetër aspekt për tu përmendur është fakti se në të gjitha vendet e rajonit, përgjegjëse për identifikimin, gjurmimin, dhe zbulimin e produkteve të krimit janë policia dhe prokuroria, një mundësi tjetër kjo për bashkepunimin rajonal, për shkëmbim të informacionit në kohe reale, dhe krijimin e kushteve për të marre masa sigurimi për pasuritë që rrjedhin nga krimi. Një praktikë e mirë për sekuestrimin dhe konfiskimin e produkteve të krimit është praktika Kroate, e cila përveç masave ligjore për goditjen e korrupsionit dhe krimit të organizuar, ka një departament të posaçëm brenda zyrës USKOK, i cili merret me identifikimin dhe zbulimin e pasurive që rrjedhin nga krimi. Kjo zyrë ka qasje ose merr informacion në institucionet që disponojnë të dhëna për fondet, të ardhurat ose pasuritë e fituara me anë të veprës penale, për personat objekt të ligjit për luftimin e korrupsionit dhe krimit të organizuar. Krijimi i një baze të dhënash dhe menaxhimi i tyre sipas rregullave specifike në përputhje me rregullat për mbrojtjen e konfidencialitetit të të dhënave dhe mbrojtjen e të dhënave personale është një praktikë e mirë, zbatimi i të cilës do të shkurtonte kohën e identifikimit të përfitimeve nga aktivitete kriminale, dhe rriste efikasitetin e zbatimit të ligjit për hetimet financiare dhe konfiskimin e produkteve të krimit.

Sfidat për zbatimin e ligjeve në fushën e hetimeve financiare, konfiskimit dhe menaxhimit të pasurive të sekuestruara dhe konfiskuara, edhe në vendet e rajonit mbetet identifikimi, krijimi i databazave ose qasjeve në institucionet që disponojnë të dhëna si edhe ndërgjegjësimi, trajnimet e avancuara, motivimi financiar i hetuesve dhe siguria e tyre, pasi mungesa e tyre mund të çojë në "presion" hetuesit nga kriminelët duke rritur mundësitë e korrupsionit.

KAPITULLI VII: KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME

7.1 Të përgjithshme

Qëllimi i këtij punimi është trajtimi i aspekteve teorike dhe problemeve praktike lidhur me hetimet financiare dhe konfiskimin e të ardhurave nga krimi në përgjithësi, dhe në Shqipëri në veçanti. Kjo dije përgjithësisht është e kufizuar me ligjin e shkruar. Qasja praktike, e cila hedh dritë mbi zbatimin e ligjit, ose siç quhet ndryshe ligji në veprim, në Shqipëri është pjesë e këtij punimi. Një rezultat i përgjithshëm për zbatimin e dispozitave të konfiskimit në Shqipëri, bazuar në njohuritë e fituara nga ky studim nuk mund të jenë optimiste. Edhe pse shenjat e rritjes së ndërgjegjësimit për rëndësinë e masave të konfiskimit për të goditur bazën financiare të organizatave kriminale janë treguar kohët e fundit, ku më shumë burime dhe trajnime janë bërë për këtë çështje, zbatimi i ligjit është ende larg nga të qenit i kënaqshëm. Sigurisht, kufizimet buxhetore për veprimtarinë e aktorëve institucionalë nënkuptojnë se vetë ideja e zbatimit të plotë të ligjeve, përfshirë ligjet për konfiskimin, duket larg në të gjithë sektorët publikë. Për më tepër, siç vihet re edhe nga analiza e legjislacionit dhe të dhënave të mbledhura nga studimi i kryer në terren, procedurat gjyqësore janë vendosur por nuk janë të mjaftueshme për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve mbi origjinën si burime të ligjshme ose kriminale të pasurive dhe aseteve. Një nga arësyet e mungesës së efektshmërisë për hetimin e burimeve të aseteve është ekzistenca e ekonomisë informale. Koha që nga fillimi i hetimeve financiare, për të cilat kërkohet të ekzistojë “dyshimi i arsyeshëm, bazuar në indise²¹¹”, i cili ka ndryshuar standardin e “dyshimit të arsyeshëm, të bazuar në prova²¹²”,

²¹¹ Ligji Nr. 10192, datë 3.12.2009, “ Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar dhe trafikimit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”

²¹² Ligj Nr. 9284, datë 30.9.2004, “ Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar”

deri në marrjen e vendimit të konfiskimit dhe koha për menaxhimin e aseteve kriminale, ndikon negativisht në zbatimin e ligjit. Mendimi i përgjithshëm në përfundim të këtij studimi është se filozofia “të ashpër ndaj pasurisë kriminale” është larg nga të qenit i rrënjësuar thellë në praktikën e përditshme të agjencive të zbatimit të ligjit (Vettori, 2006). Hetimet financiare dhe konfiskimi është një sfidë kundër krimit të organizuar, pastrimit të parave, trafikimit dhe korrupsionit. Organet e ndjekjes penale janë të përqëndruar ndaj krimineleve, *in personam*, si qëllim kryesor i sistemit të drejtësisë penale. Fakti që me ndryshimet e bëra në legjislacion konfiskimi i aseteve nuk vazhdon të kërkojë dënimin paraprak të personit të dyshuar, padyshim është pozitive dhe një mundësi për konfiskimin e aseteve kriminale, por në praktikë nuk ka rezultate të kënaqshme. Mungesa e agjencive multidisiplinare me përbërje të eksperteve të, ndjekjes penale, të fushës së ekonomisë vlerësues të pasurisë dhe njohës të mënyrave të funksionimit të institucioneve që disponojnë të dhëna për veprimtaritë ekonomike dhe pasuritë e vështirësojnë punën e prokurorisë, gjykatës dhe agjencisë së menaxhimit të aseteve kriminale. Bashkëpunimi ndërinstytucional dhe mungesa e databazave dhe një banke të dhënash si dhe aksesave në to, e bëjnë të pamundur zbulimin, identifikimin e aseteve kriminale produkte krimi. Punimi është përpjekur për të dhënë një përkufizim të hetimit financiar si tërësia e masave për zbulimin, identifikimin, sekuestrimin dhe konfiskimin e pasurive të paligjshme të personave të dyshuar si pjesëmarrës në krimin e organizuar dhe të rrethit të personave të afërm dhe personave juridikë e fizik, të cilët zotërojnë plotësisht ose pjesërisht pasuritë e ardhura nga krimi. Gjithashtu bën operacionalizimin e procesit të hetimit financiar në tre fazat, a) hetim, b) gjykim dhe c) administrimit të pasurisë, duke evidentuar pengesat për secilën fazë si dhe rekomanduar

përmirësime dhe marrje të masave, të cilat do ta bënin më efikënte goditjen e pasurisë kriminale.

Nevoja për të mbledhur statistika të besueshme mbi zbatimin e konfiskimit të të ardhurave të krimit, mbetet një sfidë. Këto statistika duhet të paraqesin, numrin dhe vlerën e sekuestruar, konfiskuar dhe asgjësuar të aseteve, kohën për konfiskimin dhe shkatërrimin e aseteve, shpenzimet e qëndrueshme të procedurës së konfiskimit nga shteti dhe nga individët e përfshirë në të tilla procedura. Gjithashtu për t'u theksuar është se përpjekjet e ardhshme kombëtare për të mbledhur këto të dhëna duhet të koordinohet me nivelin e Bashkimit Evropian, në mënyrë që të standardizojë procedurat e mbledhjes së të dhënave dhe kështu të mundësojnë prodhimin e të dhënave të krahasueshme me të gjitha shtetet anëtare të Bashkimit Evropian. Kjo në fakt do të jetë një ndihmë të mëtijshme për identifikimin e pengesave dhe marrja e praktikave më të mira në lidhje me hetimet financiare, konfiskimin e produkteve të krimit dhe menaxhimin e aseteve kriminale. Krahasimi i shpenzimeve që bëhen nga shteti dhe individi për hetimet financiare dhe konfiskimin e të ardhurave nga aktivitetet kriminale, dhe krahasimi me përfitimet që sjell hetimi financiar, do ta çonte diskutimin nëse ja vlejnë masa të tilla të rrepta ndaj pasurisë. Në punim ofrohet një pasqyrë e zbatimit të të ardhurave të konfiskimit të krimit në Shqipëri. Në bazë të analizave të secilës fazë është kryer një analizë horizontale e institucioneve të përfshira në hetimet financiare, konfiskimin dhe menaxhimin e aseteve kriminale.

Analiza e rezultateve dhe gjetjeve për secilin faktor që ndikon në secilën fazë, hetim, gjykim dhe administrim të pasurive të sekuestruara, mendoj se është një kontribut real për marrjen e masave në politikëbërje për mbështetjen e strukturave përgjegjëse për hetimet financiare.

7.2 Gjetjet kryesore të punimit

Problemet kryesore që pengojnë zbatimin e plotë të dispozitave të konfiskimit janë paraqitur sipas mënyrës logjike që ndjek zhvillimi i procedurave të hetimit financiar nga faza e hetimit në fazën e gjykit dhe në fund të fazës së administrimit të pasurive të sekuestruara dhe të konfiskuara.

Një gjetje e parë është përdorimi përgjithësisht i rrallë i mjeteve speciale të hetimit për të gjetur të ardhurat nga krimi, për shkak të një sërë faktorësh. Arsyeja kryesore për përdorimin të kufizuar të mjeteve për të gjetur të ardhurat nga krimi është se sistemi është i fokusuar tek autorët e kryerjes së veprave penale për të cilat parashikohet një dënim jo më pak në maksimum së shtatë vjet²¹³, në vend që të përdoret dhe për pasurinë e tyre. Përdorimi i mjeteve speciale të hetimit ka për qëllim kryesisht në mbledhjen e provave për krimin e kryer (autor, rrethanat, etj). Rrjedhimisht, përfitimi i tyre për konfiskim është vetëm indirekt, dhe në atë masë që marrja e provave mbi krimin rrit gjasat e një bindje për dyshim të arsyeshëm bazuar në indicje²¹⁴, që është përgjithësisht një parakusht për hetimin financiar dhe sekuestrimin e më pas konfiskimin. Kodi i procedurës penale të Shqipërisë parashikon se përgjimi mund të urdhërohet kundër: ..., c) personit që merr pjesë në transaksione me të dyshuarin²¹⁵. Kjo është një mundësi e mirë e përdorimit të mjeteve speciale për identifikimin e transaksioneve dhe mundësi për identifikimin e llojeve dhe vendndodhjeve të pasurive kriminale, por në praktikë nuk ka gjetur zbatim, si dhe mungojnë statistika për përdorimin e tyre. Një faktor tjetër i evidentuar është fakti se sipas dispozitës së parashikuar

²¹³ Neni 221, pika 1, germa “a” e Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Shqipërisë.

²¹⁴ Neni 3 pika 1 e ligjit nr.10192, datë 3.12.2009, “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar dhe trafikimit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”.

²¹⁵ Neni 221, pika 3 germa “c”, e Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Shqipërisë.

në nenin 8 të ligjit nr. 10192, veprimet paraprake, pika 1 thuhet; Prokuroria dhe policia gjyqësore marrin dijeni për pasuritë që duhen verifikuar, sipas këtij ligji, me iniciativën e vet ose me njoftim të bërë nga të tretët²¹⁶. Sipas kësaj dispozite kërkohet marrja dijeni ose me iniciativë të prokurorit, ose me njoftim të bërë nga të tretët. Lidhësja “ose”, jep mundësinë për marrjen dijeni mjafton njeri nga kushtet. Por veteiniciativa është në diskrecion të prokurorëve, dhe fakti që ata janë të përqëndruar tek autorët dhe vepra, iniciativën për të vepruar për pasurinë e lë në plan të dytë, nuk i kushtohet rëndësia, gjithashtu njoftimi nga të tretët është e vështirë pasi siç dhe u shpjegua më sipër, nuk ka një bashkëpunim dhe besim të qytetarëve për të inicuar procedura të tilla. Së fundmi, kultura për hetime financiare nuk është në nivelin e duhur, duke u perceptuar si proces civil nga prokurorët, megjithëse kjo ka lidhje të drejtpërdrejtë me dyshime të bazuara në indicje për kryerjen ose pjesëmarrjen në veprat penale të parashikuar nga neni 3 i ligjit 10192. Praktika italiane është një praktikë e mirë e përdorur për mjetet speciale të hetimit ku përdorimi i mjeteve speciale të hetimit zbatohen më shpesh, për shkak së këta hetime bëhen nga një institucion siç është Drejtoria Kombëtare Antimafia, ku kultura financiare e së cilës është më e lartë se mesatarja (Vettori, 2006).

Një problem tjetër është niveli përgjithësisht i ulët i bashkëpunimit nga ana e institucioneve jo-financiare me hetimet financiare. Faktori kryesor duket të jetë një mënyrë strikte ligjore, përkatësisht zgjerimi i fundit për këto institucione të detyrimit për të bashkëpunuar me hetuesit. Lidhur me këtë është mungesa e një sistemi të mbikëqyrjes disiplinore (dhe

²¹⁶ Neni 8 pika 1 e ligjit nr.10192, date 3.12.2009, “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar dhe trafikimit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”

sanksione të ngjashme), aq i mirë sa ajo e zhvilluar në sektorin financiar, dhe veçanërisht bankar. Si rezultat, masat e ndërmarra nga institucionet jo-financiare me qëllim të identifikimit operacionet e pastrimit të parave kanë qenë më të kufizuara sesa ato të ndërmarra nga institucionet financiare. Kjo është reflektuar, për shembull, në organizimin e brendshëm të institucioneve jo-financiare, e cila është e dobët në drejtim të trajnimit të punonjësve për t'u marrë me operacionet e dyshimta. Për më tepër, për shkak se këto institucione kanë pasur pak kontakte me agjencitë e zbatimit të ligjit se sa kanë institucionet financiare, ata shpesh nuk e dinë se çfarë hetuesit kanë nevojë; kjo mosnjohje kontribuon për të bërë bashkëpunimin e tyre me hetuesit më pak të kënaqshëm se bashkëpunimi me bankat. Një gjetje tjetër është paaftësia e institucioneve për të shfrytëzuar dëshmitarë, dhe mbi të gjitha informatorë, për të hedhur dritë mbi pasurinë e një organizate kriminale.

Për sa i përket dëshmitarëve, kjo varet ngushtësisht nga interesat personale të përfshira, dhe nëse dëshmitari ka frikë nga të dyshuarit.

Përsa i përket informatorëve, kjo varet nga faktorë të ndryshëm, disa lidhen me kuadrin ligjor, disa me aftësinë dhe gatishmërinë e agjencive të zbatimit të ligjit që të përdorin këtë burim të informacionit mbi pasurinë kriminale. Në Shqipëri ka program të mbrojtjes së dëshmitarëve por frika e hakmarrjes e kufizon në masë të madhe bashkëpunimin me hetuesit. Programi mbrojtjes zbatohet për çështjet penale, ku procedurat janë më të formalizuara, dhe nuk përdoret për procedura civile. Në Irlandë, në kundërshtim me atë që ndodh në procedurën penale, niveli i bashkëpunimit me informatorët në procedurat civile është i shkëlqyer. Ata kanë një qëndrim krejtësisht të ndryshëm për bashkëpunim për shkak se ata nuk kanë për të dhënë dëshmi të plotë (në procedurat civile zbatohet një standard më i ulët i provës) dhe anonimitetin e tyre është siguruar. Arsye të tjera për përdorim shumë të rrallë i

informatoreve është dyshimi me të cilën ata përgjithësisht shihen, dhe fakti që në disa raste ato mund të sigurojë vetëm një sasi të kufizuar të informacionit, për shkak të mungesës së njohurive të detajuar të shpërndarjes së pasurisë në organizata kriminale (Vettori, 2006).

Duke iu referuar bashkëpunimit ndërmjet agjencive, një problem i madh është kontributi i pakët i bërë nga organet tatimore për vendndodhjen e të ardhurave nga krimi. Kontributi i këtyre autoriteteve në vend të kësaj mund të jetë veçanërisht e dobishme, duke pasur parasysh se regjistrat e taksave të ndihmojë në përcaktimin e të ardhurave të një personi, për shembull, kur kërkesa është bërë për konfiskimin e zgjeruar, kontributi i autoriteteve tatimore do ishte shume i vlefshëm. Arsyet kryesore për këtë bashkëpunim të pakënaqshëm nga organet tatimore janë ligjet dhe kultura. Një vështirësi tjetër e evidentuar është informaliteti. Ekonomia informale jep shumë mundësi për të fshehur pasuritë e ardhura nga krimi. Hetimet financiare kërkojnë shumë kohë, dhe gjurmimi i tyre, përveç mjeteve kërkon dhe burime njerëzore. Fusha e hetimit financiar është shumë e gjerë, ku kërkohet gjurmimi dhe identifikimi i mjeteve financiare, pasurive, veprimtarive ekonomike, tregëtare, profesionale, niveli ekonomik si dhe burimet e të ardhurave²¹⁷, si edhe verifikimi për secilin person të afërt, bashkëshorti, fëmijët, të paralindurit e të paslindurit, vëllezërit, motrat, ungjërit, emta, nipërit, mbesat, fëmijet e vëllezerve dhe të motrave, vjehrit, vjehrës, dhëndrit, nusja kunata, kunati, bashkëjetuesi, thjeshtri, thjeshtira, njerku dhe njerka të supjekeve të pikës 1 të nenit 3 të ligjit 10192, personat fizik dhe juridik si dhe trashëgimtarët e personit ndaj të cilit ka dyshim të arsyeshëm të bazuar në indicje. Hetuesit duhet të përpunojë një

²¹⁷ Neni 6 pika 1 e ligjit nr.10192, date 3.12.2009, “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar dhe trafikimit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”

masë të madhe të informacionit, dhe ajo gjithashtu merr kohë për të marrë informacion nga institucionet financiare dhe jo-financiare. Supozohet së është një ngarkesë e rëndë, dhe në asnjë rast nuk është bërë një hetim i plotë për të gjithë llojet e të ardhurave dhe të gjithë personat e parashikuar në ligj, që do të thotë se rastet nuk mund të hetohen. Në praktikë, hetuesit miratojnë kritere të ndryshme për prioritetet e rasteve.

Nga analiza e kryer ka treguar se në përgjithësi kultura e hetimeve financiare është rritur në vitet e fundit, dhe se trajnimi është përmirësuar. Megjithatë, duhet theksuar se, trajnimi i dhënë hetuesve është ende larg nga të qenit e kënaqshme, duke marrë formën e udhëzimeve të përgjithshme dhe pothuajse tërësisht neglizhon aspektet financiare. Gjithashtu e rëndësishme është për tu theksuar levizjet pa kriter të personave që kanë marrë trajnimet e domosdoshme për hetimet financiare. Legjislacioni në Shqipëri lejon kalimin e barrës së provës tek i dyshuar. Referuar nenit 21, pika 3 të Ligjit 10192, datë 3.12.2009, parashikohet se barra e provës, për të vërtetuar se pasuritë janë fituar në mënyrë të ligjshme, i përket personit, kundër pasurive të të cilit kërkohet konfiskimi. Në praktikë nuk është efiçente, kjo për disa arsye. *Së pari*, ekzistenca e ekonomisë informale dhe mungesa e bashkëpunimit të dëshmitarëve dhe informatorëve në hetimet financiare, i lejojnë të dyshuarit justifikimin e burimit të pasurisë dhe *së dyti*, korrupsioni i i lartë i gjyqtarëve dhe zyrtarëve të zbatimit të ligjit, lehtësojnë dhënjen e vendimeve në favor të të dyshuarve.

Trajnime të vazhdueshme janë ofruar nga Këshilli i Europës dhe organizata të tjera ndërkombëtare, por pjesëmarrja e prokurorëve dhe gjyqtarëve ka qënë e ulët. Kjo lidhet dhe me kulturën dhe marrjen e përgjegjësisve nga prokurorët dhe gjyqtarët për përgjegjësinë që kanë në hetimet financiare, si dhe mungesën e strukturave të kontrollit dhe kritereve që duhet të vendosen në kualifikimet për hetimet financiare. Trajnime të shumta janë bërë me

pjesëmarrjen e oficerëve të policisë gjyqësore, por edhe ata janë lëvizur pa kriter nga eprorët e tyre, fakt ky që tregon mos marrjen seriozisht të shqyrtimit të rasteve të hetimit financiar. Ekziston një lloj paragjykimi kulturor kundër sekuestrimit dhe konfiskimit të ardhurave nga krimi, në mënyrë që prokurorët dhe gjyqtarët publikë shpesh kanë dëshirë për të zbatuar legjislacionin projektuar për të privuar kriminelët nga fitimet e tyre të paligjshme, praktika këto që hasen edhe në vendet e Bashkimit Europian. Si rezultat i kësaj ata mund të vënë çështjen mënjanë gjatë gjykimit pa ndonjë motiv të arsyeshëm për këtë, siç ndodh në Gjermani. Në raste të tjera, Belgjika dhe Portugalia për shembull, natyra diskrecionale për marrjen e masës do të thotë që në praktikë shpesh nuk zbatohet, edhe pse standardi penal i provës është përmbushur (Vettori, 2006). Një nga aspektet më problematike gjatë fazës gjyqësore dhe pas përfundimit të kësaj faze, është menaxhimi i aseteve kriminale. Kjo vjen për disa arsye, së pari, mënyra e menaxhimit nga agjensitë e menazhimit të aseteve është pasive dhe jo aktive për të gjeneruar vlera dhe zhvilluar pasurinë, së dyti, personeli është i pakët në numër dhe jo specialistë të menaxhimit të pasurive, së treti kuadri ligjor është jo i plotë, dhe së pesti asetet e sekuastuara dhe të konfiskuara nuk shiten, për shkak të ndonjë hakmarrje të mëvonshme nga kriminelët. Këta faktorë e bëjnë jo eficiente fazën e tretë të hetimeve financiare, fazën e menaxhimit dhe shpërndarjes e përdorimit të aseteve kriminale. Vonesat dhe kohëzgjatja e procedurës gjyqësore është një faktor tjetër pengues, për arsye se ka interesa të mëdha ekonomike, dhe taktikat e përdorura nga avokatët, si ankesa, pretendime për shkelje të të drejtave të njeriut etj, bëhen objekt i shqyrtimit nga gjykatat dhe për pasoje kalojnë afatet e konfiskimit. Këto taktika janë të inkurajuar edhe nga fakti se legjislacioni është ende relativisht i ri, i kohëve të fundit dhe shpesh ka dhe interpretime të paqarta. Në Shqipëri asnjë nga pasuritë e konfiskuara nuk është shitur, dhe në asnjë rast nuk

është bërë e mundur dhënja e pasurive për qëllime sociale. Një rrezik tjetër është se edhe nëse shiten, ata shiten me kosto të ulët, duke humbur vlerën e konfiskimit. Kjo dhe për shkak të korrupsionit të lartë. Një faktor tjetër që ndikon në shitjen dhe përdorimin e pasurive është frika për hakmarrje nga kriminelët.

Ka një rritje të ndërgjegjësimit për rëndësinë e masave të konfiskimit për të goditur bazën financiare të organizatave kriminale janë treguar kohët e fundit, ku më shumë burime dhe trajnime janë përkushtuar për këtë çështje, zbatimi i ligjit është ende larg nga të qenit i kënaqshëm.

Kufizimet buxhetore për veprimtarinë e aktorëve institucionalë nënkuptojnë se vetë ideja e zbatimit të plotë të ligjeve, përfshirë ligjet për konfiskimin duket larg.

Procedurat gjyqësore janë vendosur por nuk janë të mjaftueshme për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve mbi origjinën si burime të ligjshme ose kriminale të aseteve.

Një nga arësyet e mungesës së efektshmërisë për hetimin e burimeve të aseteve është ekzistenca e ekonomisë informale.

Koha që nga fillimi i hetimeve financiare, për të cilat kërkohet të ekzistojë “dyshimi i arsyeshëm, bazuar në indisje”, i cili ka ndryshuar standardin e “dyshimit të arsyeshëm, të bazuar në prova”, deri në marrjen e vendimit të konfiskimit dhe koha për menaxhimin e aseteve kriminale, ndikon negativisht në zbatimin e ligjit. Ligji Nr. 10192, datë 3.12.2009, “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar dhe trafikimit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”, të ndryshuar, me ligjin 24/2014 “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit dhe korrupsionit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”.

Mungesa e agjencive multidisiplinare me përbërje të eksperteve të ndjekjes penale, të fushës së ekonomisë, vlerësues të pasurisë vështirësojnë punën e prokurorisë, gjykatës dhe agjencisë së menaxhimit të aseteve kriminale.

Bashkëpunimi ndërinstytucional dhe mungesa e databazave dhe një banke të dhënash si dhe aksesave në to, e bëjnë të pamundur zbulimin, identifikimin e aseteve kriminale.

përdorimi përgjithësisht i rrallë i mjeteve speciale të hetimit për të gjetur të ardhurat nga krimi.

Veteiniciativa është në diskrecion të prokurorëve, dhe fakti që ata janë të përqëndruar tek autorët dhe vepra, iniciativën për të vepruar për pasurinë e lë në plan të dytë, nuk i kushtohet rëndësia, gjithashtu njoftimi nga të tretët është e vështirë pasi siç dhe u shpjegua më sipër, nuk ka një bashkëpunim dhe besim të qytetarëve për të inicuar procedura të tilla.

Kultura për hetime financiare nuk është në nivelin e duhur, duke u perceptuar si proces civil nga prokurorët, megjithëse kjo ka lidhje të drejtpërdrejtë me dyshime të bazuara në indicje për kryerjen ose pjesëmarrjen në veprat penale të parashikuar nga neni 3 i ligjit 10192.

Niveli përgjithësisht i ulët i bashkëpunimit nga ana e institucioneve jo-financiare me hetimet financiare.

Vonesat dhe kohëzgjatja e procedurës gjyqësore është një faktor tjetër pengues, për arsye se ka interesa të mëdha ekonomike, dhe taktikat e përdorura nga avokatët, si ankesa, pretendime për shkelje të drejtave të njeriut etj, bëhen objekt i shqyrtimit nga gjykatat dhe për pasoje kalojnë afatet e konfiskimit. Këto taktika janë të inkurajuar edhe nga fakti se legjislacioni është ende relativisht i ri, i kohëve të fundit dhe shpesh ka dhe interpretime të paqarta.

Një nga aspektet më problematike gjatë fazës gjyqësore dhe pas përfundimit të kësaj faze, është menaxhimi i aseteve kriminale. Kjo vjen për disa arsye, së pari, mënyra e menaxhimit nga agjensitë e menaxhimit të aseteve është pasive dhe jo aktive për të gjeneruar vlera dhe zhvilluar pasurinë, së dyti, personeli është i pakët në numër dhe jo specialistë të menaxhimit të pasurive, së treti kuadri ligjor është jo i plotë, dhe së pesti asetet e sekuestruara dhe të konfiskuara nuk shiten, për shkak të ndonjë hakmarrje të mëvonshme nga kriminelët. Këta faktorë e bëjnë jo eficiente fazën e tretë të hetimeve financiare, fazën e menaxhimit dhe shpërndarjes e përdorimit të aseteve kriminale.

7.3 Rekomandime

Zgjerimi i veprave penale për të cilat të zhvillohet detyrimisht hetim financiar, e cila do të mundësonte identifikimin e pasurive të paligjshme jo vetëm për veprat penale kryesore, por për të gjitha shkeljet që sjellin dobi pasurore të paligjshme.

Krijimin e një data-baze kombëtare elektronike, duke garantuar sekretin e informacionit, të dhënat personale dhe të drejtat e njeriut sipas akteve dhe praktikës ndërkombëtare.

Krijimin e një agjensie kombëtare me departamentet përkatëse, specialistë dhe ekspertë nga fusha të ndryshme, për të bërë të mundur identifikimin, zbulimin, kapjen, sekuestrimin, konfiskimin dhe menaxhimin e aseteve kriminale.

Mbështetjen financiare për burimet njerëzore dhe materiale, si dhe trajnimin e vazhdueshëm të tyre, duke garantuar besueshmërinë, kujdesin, dhe sanksionin në raste të shkeljes.

Rrethi i personave të përcaktuar sipas nenit 3 të ligjit “për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit dhe korrupsionit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”,

duhet rishikuar, pasi sjell kosto të larta për hetimin dhe kohë të gjatë hetimi duke ulur efektivitetin e hetimeve financiare.

Efektiviteti i hetimeve financiare varet shumë nga bashkëpunimi ndërinstitucional për shkëmbimin e të dhënave në kohë reale. Për realizimin e cilësisë, qëndrueshmërisë dhe gjithëpërfshirjes, kërkohet shfrytëzimi i teknologjisë dhe inovacionit për gjetjen e formave të reja të bashkërendimi institucional nëpërmjet zhvillimit të sistemeve të raportimit të dhënave një agjensi kombëtare.

Problem mbetet ekzistenca e “parajsave fiskale”. Ajo që pengon institucionet përgjegjëse të hetimit është se zonat e quajtura “parajsa fiskale” ruajnë me fanatizëm privatësinë e klientit.

BIBLIOGRAFIA

LITERATURË

- Alan Wright, (2006), *Organized Crime*, Willan Publishing
- Albanese, J. S. (2007). *Organized crime in our time (Fifth edition ed.)*. NJ.
- Barbara Vettori, (2006), *Tough on Criminal Wealth: Exploring the Practice of Proceeds from Crime Confiscation in the EU*, Springer
- Bob Matthews, Liz Ross. (2010). *Metodat e hulumtimit*. Tiranë: (CDE).
- Burton, S. J. (2007). *Hyrje në të drejtën dhe arsyetimin ligjor*. Tiranë: UET/PRESS.
- Caroline E. Foster, (2011), *Science and the Precautionary Principle in International Courts and Tribunals, Expert evidence, burden of proof and finality*, Cambridge University Press
- Christop H. Schreuer, Loretta Malintoppi, August Reinisch and Anthony Sinlar, (2009), *The ICSID Convention: A comentary*, Second edition, Cambridge.
- Christopher Harding, (2007), *Criminal Interprice: Individuals, organisations and criminal resposibility*, WILLAN Publishing
- Christopher Westphal, (2010), *Anatomy of a Financial Crime*.
- Council of Europe, (2000), *Reversal of the burden of proof in confiscation of the proceeds of crime: a Council of Europe Best Practice Survey*, (Best Practice Survey No. 2), Strasbourg.
- Cyrille Fijnaut and Letizia Paoli, *Organised Crime in Europe: Concepts, Patterns and Control Policies in the European Union and Beyond*, Volume 4, Springer
- Çukaj, L. (2014). *Sekuestrimi dhe konfiskimi i produkteve të veprave penale, jashte procedimit penal ne Shqiperi ne nje kendveshtrim krahasues me sistemin Amerikan te konfiskimeve, administrimi i ketyre produkteve*. Tirane: Fakulteti i Drejtesise.
- Elezi, E. (2013). *Efektiviteti i legjislacionit dhe sistemit te drejtesise penale kunder kriminalitetit ne procesin e integritetit europian*. Tirane: Fakulteti i Drejtesise.
- Elezi, I. (2009). *E drejta penale (Pjesa e Posaçme)*. Tiranë: Botimet ERIK.
- Frederic R. Kellogg, (2007), Oliver Wendell Holmes, Jr., *Legal Theory, and Judicial Restraint*, Cambridge University Press
- G.Vula, V. (2010). *Kriminaliteti kompjuterik*. Prishtinë: Koha.
- Gabriel Hallevy, (2010), *A modern Treatise on the Principle of Legality in Criminal Law*, Springer

- Gary R. Gordon, R.Bruce McBride, (2008), *Criminal Justice: Internships: Theory into practice*, Sixth edition, LexisNexis
- Geert- Jan Alexander Koops, Martinus, (2008), *Defence in contemporary international criminal law*, Second edition, Nijhoff Publisher
- George A. Manning, (2005), *Financial Investigation and forensic Accounting*, Second Edition, CRC Press
- George P. Fletcher, (1998), *Basic Concepts of Criminal Law*, Oxford University Press
- Gerald E. McDowel. (1998). *Financial Investigation Guide*.
- Gerard M. Zack, (2013), *Financial Statement Fraud: Strategies for Detection and Investigation*, WILEY
- Golobinek, R. (2006). *Manuali i Hetimeve financiare dhe konfiskimi i produkteve të kimit*. GuttenberG.
- Hagan, F. E. (1993). *Introduction to criminology*. Chicago: Nelson-Hall Inc.
- Halili, R. (2008). *Kriminologjia*. Prishtine.
- Halim Islami, Artan Hoxha, Ilir Panda. (2003). *Procedura penale (Komentar)*. Tirane: Botimet Morava.
- Ian Ward, (1998), *An introduction to critical legal theory*, Cavendish Publishing Limited, United Kingdom
- Janet Leveless, (2012), *Criminal Law: text, Cases and Materials*, Third edition, Online Resource Centre, Oxford University Press
- Jean Louis Briquet, Gilles Favareli Garrigues. (2010). *Organised Crime and States*. Palgrave Macmillan.
- Jean Pradel, G. C. (2009). *E drejta penale Europiane*. Tiranë: Papirus.
- Jill Marshall, (2009), *Personal Freedom through Human Rights Law? Autonomy, Identity and Integrity under the European Convention on Human Rights, International Studies in Human Rights*, Vol. 98, MARTINUS NIJHOFF PUBLISHERS
- John L. Evans, (2000), *The proceeds of crime: Problems of investigation and prosecution*, Columbia University
- Joycelyn M. Pollok, (2010), *Ethical Dilemmas and Decisions in Criminal Justice*, Sixth Edition, WADSWORTH
- K.H.Spencer Pickett and Jennifer Pickett, (2002), *Financial Crime Investigation and Controll*, JOHN WILEY & SONS, INC.

- Kambovski, V. (2010). *E drejta penale*. Shkup: Furkan ISM.
- Karen Bullock, Ronald V. Clarke & Nick Tilley, (2010), *Situation Prevention of Organised Crimes*, William Publishing
- Katri K. Sieberg, (2005), *Criminal Dilemmas: Understanding and Preventing Crime*, Second Edition, Springer
- Larry May & Zachary Hoskins, (2009), *International Criminal Law and Philosophy*, CAMBRIDGE University Press
- Leila Nadya Sadat, Michael P. Scharf, (2008), *The theory and Practice of International Criminal Law*, Martinus Nijhoff Publishers
- Mark Milke, (2012), *Stealth Confiscation: How governments regulate, freeze, and devalue private property- without compensation*, The Fraser Institute
- Mark Peith, Lucinda A. Low and Peter J. Cullen, (2007), *The OECD Convention on Bribery: A commentary*, CAMBRIDGE
- Mëçalla, N. (2007), *Pastrimi i parave, kërcenim për sigurinë kombëtare*, Tiranë, Dita 2000
- Michael Bohlander, (2008), *Studies in International & Comparative Criminal Law*, Oxford and Portland, Oregon
- Michael Levi, Lisa Osofsky, (1995), *Investing, seizing and confiscating the proceeds of crime*, *Crime Detection & Prevention Series Paper 61*
- Michel Dion, (2013), *Financial Crimes and Existential Philosophy*, Springer
- Neil McCormick, (1997), *Constructing legal systems: "European Union" in legal theory*, *Reprinted from Law and Philosophy*, 1997, SPRINGER
- Neil Murray and David Beglar 2009, *Writing dissertations and theses*, Pearson Logman
- OECD, (2008) *Corruption, A glossary of International Standards in Criminal Law*
- Petter Gottschalk, (2009), *Entrepreneurship and Organised Crime*, Eduard Elgar
- Rafael Domingo, (2010), *The New Global Law*, Cambridge University Press
- Robert Cryer, Håkan Friman, Darryl Robinson, Elisabeth Wilmshurst, (2010), *An introduction to International Criminal Law and Procedure*, Second Edition, Cambridge University Press
- Ronald Dworkin, (1997), *Jurists: Profiles in Legal Theory*, Stanford University Press
- Roscoe Pound, (1923) *Interpretations of Legal History*, The MacMillan Company
- Sabrina Adamoli, Andrea Di Nicola, Ernesto U. Savona and Paola Zoffi, *Organised Crime Around the World*, Publication Series No.31

- Stephen Shute, John Gardner and Jeremy Horder, (2003), *Action and value in criminal law*, Clarendon Press.OXFORD
- UNODC, (2013), *Business, Corruption and Crime in Albania: The impact of bribery and other crime on private enterprise*.

KONVENTA TË KOMBEVE TË BASHKUARA DHE KËSHILLIT EUROPIAN

- Konventa e Kombeve të Bashkuara kundër Krimit të Organizuar Ndërkombëtar, Palermo, 15 Nëntor 2000
- Konventa e Kombeve të Bashkuara kundër Trafikut të paligjshëm të drogave narkotike dhe lëndëve psikotrope, Vjenë, 19 Dhjetor 1988.
- Konventa mbi mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe lirive themelore CETS 005, 04.11.1950 dhe protokollet e saj shtesë.
- Konventa mbi pastrimin, depistimin, sekuestrimin dhe konfiskimin e produkteve të krimit dhe të financimit të terrorizmit, CETS 198, Varshavë, 16 Prill 2005.
- Konventa mbi pastrimin, depistimin, sekuestrimin dhe konfiskimin e produkteve të krimit, Strasburg, ETS 141, 8.11.1990.
- Konventa penale mbi korrupsionin, ETS 173, 27.01.1999
- Konventa civile mbi korrupsionin, ETS174, 1999

LEGJISLACIONI KOMBETAR DHE RAJONAL

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë
- Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Bosnje-Hercegovina
- Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Malit të Zi
- Kodi i Procedurës Penale i Republikës të Maqedonisë
- Kodi i Procedurës Penale i Republikës të Sërbisë
- Kodi i Procedurës Penale të Republikës Kosovës
- Kodi i Procedurës Penale të Republikës së Kroacisë
- Kodi i Procedurës Penale të Republikës së Shqipërisë
- Kodi Penal i Republikës së Bosnje-Hercegovina
- Kodi Penal i Republikës së Kosovës
- Kodi Penal i Republikës së Kroacisë
- Kodi Penal i Republikës së Malit të Zi

- Kodi Penal i Republikës së Maqedonisë
- Kodi Penal i Republikës së Sërbisë
- Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë
- Ligj nr.8646, datë 20.7.2000, Për ratifikimin e Konventës Europiane “Për pastrimin, depistimin, kapjen dhe konfiskimin e produkteve të krimit” (Konventa e Strasburgut)
- Ligji nr. 04/l-140, “Për kompetencat e zgjeruara për konfiskimin e pasurisë së përfituar me vepër penale” i Republikës së Kosovës;
- Ligji nr. 9284, datë 30.9.2004, “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar”
- Ligji nr. 10192, datë 3.12.2009, “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar dhe trafikimit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”
- Ligji 24/2014, “Për ndryshimin e ligjit nr. 10192, datë 3.12.2009, “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar dhe trafikimit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”
- Ligji nr.8722, datë 26.12.2000, Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në “Konventën e Kombeve të Bashkuara kundër trafikut të paligjshëm të drogave narkotike dhe të lëndëve psikotrope” (Konventa e Vjenës)
- Ligji nr.8920, datë 11.7.2002, Për ratifikimin e Konventës së Kombeve të Bashkuara kundër krimit të organizuar ndërkombëtar” dhe dy protokolleve shtesë të saj (Konventa e Palermos)
- Ligji nr.9646, datë 27.11.2006, Për ratifikimin e Konventës Europiane “Për pastrimin, depistimin, kapjen dhe konfiskimin e produkteve të krimit dhe financimin e terrorizmit” (Konventa e Varshavës)

AKTE TË TJERA NDËRKOMBËTARE

- Rekomandimi i Këshillit, 25.04.2002, mbi përmirësimin e metodave të hetimit në luftën kundër krimit të organizuar të lidhur me trafikun e organizuar të trafikut të drogës, hetimet e njëkohshme mbi trafikun e drogës nga organizatat kriminale dhe mbi financat e pasuritë e tyre, OJC 114, 15.05.2002.
- Vendimi kuadër i Këshillit (2005 212 JHA), 24.02.2005 mbi konfiskimin e të ardhurave të lidhura me krimin, instrumenteve dhe pronës, OJL 068,15.03.2005.
- Vendimi kuadër i Këshillit (2001 500 JHA), 26.06.2001 mbi pastrimin e parasë, identifikimin, gjurmimin, ngrirjen, sekuestrimin dhe konfiskimin e instrumentave dhe të ardhurave nga krimi, OJL 182, 05.07.2001.

- Vendimi kuadër i Këshillit (2003 577 JHA), 22.07.2003 mbi ekzekutimin në Bashkimin European të urdhërave për ngrirjen e pronës ose të provave, OJL 196, 02.08.2003.
- Vendimi kuadër i Këshillit mbi zbatimin e parimit të njohjes së ndërsjellë të urdhërave të konfiskimit, 24.02.2005.
- Plani i veprimit i Këshillit, parandalimi dhe kontrolli i krimit të organizuar, një strategji e Bashkimit European për fillimin e Mijevjecarit të Ri, OJC 124, 03.05.2000.
- Plani i veprimit të Këshillit për të luftuar krimin e organizuar, 24.04.1997, OJL 251, 15.08.1997
- Veprimi i përbashkët, 03.12.1998 i miratuar nga keshilli në bazë të nenit 3 të traktatit të Bashkimit European, mbi pastrimin e parave, identifikimin, gjurmimin, ngrirjen, sekuestrimin dhe konfiskimin e instrumenteve dhe të ardhurave nga krimi (98 699 JHA), OJL 333, 09.12.1998
- Këshilli i Europës, (2003), Manual Nr.1: *E drejta për respektimin e jetës private dhe familjare*. Një udhëzues për zbatimin e Nenit 8 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, Shtypur Gent Grafik
- Këshilli i Europës, (2003), Manuali Nr.2: *Liria e Shprehjes. Një udhëzues për zbatimin e Nenit 10 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut*, Shtypur Gent Grafik
- Këshilli i Europës, (2003), Manuali Nr.3: *E drejta për një proces të drejtë gjyqësor*. Një udhëzues për zbatimin e Nenit 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, Shtypur Gent Grafik
- Këshilli i Europës, (2003), Manuali Nr.4: *E drejta e pronës*. Një udhëzues për zbatimin e Nenit 1 të Protokollit Nr.1 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, Shtypur Gent Grafik

RAPORTE TË KËSHILLIT TË EUROPËS DHE KOMISIONIT EUROPIAN

- Raporti “*Mbi gjendjen e krimit të organizuar dhe krimit ekonomik në Europën Juglindore*”, Strasburg: CoE, 2007.
- Raporti “*Mbi gjendjen e krimit të organizuar dhe krimit ekonomik në Evropën Juglindore*”. Strasburg: CoE, 2006.
- Komisioni European. (2003). *Albania 2003 Progress Report*. Brussels.
- Komisioni European. (2005). *Albania 2005 Progress Report*. Brussels.
- Komisioni European. (2006). *Albania 2006 Progress Report*. Brussels.

VENDIME TË GJYKATËS KUSHTETUESE DHE GJYKATËS SË LARTË

- Vendimi nr. 4, datë 23.02.2011, Gjykata Kushtetuese, Tiranë
- Vendimi Nr. 1, datë 25.1.2007, Gjykata e Lartë, Tiranë.

PRAKTIKA TË GJYKATËS EUROPIANE PËR TË DREJTAT E NJERIUT

- Minelli kundër Zvicrës, No. 8660/79, datë 25. 3. 1983.
- Salabiaku kundër Francës, No. 10519/83, datë 7.10.1988.
- Murray kundër Mbretërisë së Bashkuar, No. 18731/91, datë 8.2.1986.
- Saunders kundër Mbretërisë së Bashkuar, No. 19187/91, datë 17.12.1996.
- Welch kundër Mbretërisë së Bashkuar, No.17440/90, datë 9.2.1995.
- Philips kundër Mbretërisë së Bashkuar, No. 41087/98, datë 5.7.2001.

RAPORTE VJETORE TË GJYKATËS SË KRIMEVE TË RËNDA

- Analiza vjetore 2004, Gjykata e Krimeve të Rënda, Tiranë.
- Analiza vjetore 2005, Gjykata e Krimeve të Rënda, Tiranë.
- Analiza vjetore 2006, Gjykata e Krimeve të Rënda, Tiranë.
- Analiza vjetore 2007, Gjykata e Krimeve të Rënda, Tiranë.
- Analiza vjetore 2008, Gjykata e Krimeve të Rënda, Tiranë.
- Analiza vjetore 2010, Gjykata e Krimeve të Rënda, Tiranë.
- Analiza vjetore 2012, Gjykata e Krimeve të Rënda, Tiranë.

PYETËSOR/INTERVISTA

- Pyetësor me ekspertë të menaxhimit të pasurive (Kod. 1/4), Maj 2014
- Pyetësor me ekspertë të menaxhimit të aseteve (Kod. 1/4), Korrik 2014
- Pyetësor me ekspertë të ndjekjes penale, (Kod. 1/1), Prill 2014
- Pyetësor me ekspertë të ndjekjes penale, (Kod. 1/2), Prill 2014
- Pyetësor me ekspertë të ndjekjes penale, (Kod. 1/3), Korrik 2014

BURIME INTERNETI

- http://ec.europa.eu/enlargement/archives/pdf/key_documents/2005/package/sec_1421_final_progress_report_al_en.pdf
- http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/key_documents/2007/nov/albania_progress_reports_en.pdf
- http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/key_documents/2009/al_rapport_2009_en.pdf
- http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/key_documents/2010/package/al_rapport_2010_en.pdf
- http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/key_documents/2011/package/al_rapport_2011_en.pdf
- http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/key_documents/2013/package/al_rapport_2013.pdf
- http://www.coe.int/t/dghl/cooperation/economiccrime/corruption/projects/car_serbia/ECtHR%20Judgements/English/SALABIAKU%20v%20FRANCE%20-20ECHR%20Judgment%20_English_.pdf
- http://www.coe.int/t/dghl/cooperation/economiccrime/corruption/projects/car_serbia/ECtHR%20Judgements/English/PHILLIPS%20v%20THE%20UK%20-20ECHR%20Judgment%20_English_.pdf
- http://www.coe.int/t/dghl/cooperation/economiccrime/corruption/projects/car_serbia/ECtHR%20Judgements/English/SALABIAKU%20v%20FRANCE%20-20ECHR%20Judgment%20_English_.pdf
- http://www.coe.int/t/dghl/cooperation/economiccrime/corruption/projects/car_serbia/ECtHR%20Judgements/English/PHILLIPS%20v%20THE%20UK%20-20ECHR%20Judgment%20_English_.pdf
- http://www.coe.int/t/dghl/cooperation/economiccrime/corruption/Publications/PACA/PACA_Training%20manual%20for%20Law%20Enforcement%20Agencies,%20Prosecutors%20and%20Judges,%20Albanian.pdf
- http://www.coe.int/t/dghl/cooperation/economiccrime/corruption/Publications/PACA/PACA_Training%20manual%20for%20Law%20Enforcement%20Agencies,%20Prosecutors%20and%20Judges,%20Albanian.pdf
- http://www.coe.int/t/dghl/cooperation/economiccrime/corruption/Publications/PACA/PACA_Training%20manual%20for%20Law%20Enforcement%20Agencies,%20Prosecutors%20and%20Judges,%20Albanian.pdf
- <http://www.coe.int/t/dghl/cooperation/economiccrime/SpecialFiles/CARPO-FI-Report-Albanian.pdf>
- <http://www.coe.int/t/dghl/cooperation/economiccrime/SpecialFiles/CARPO-FI-Report-Albanian.pdf>
- <http://www.coe.int/t/dghl/cooperation/economiccrime/SpecialFiles/CARPO-FI-Report-Albanian.pdf>
- <http://www.doktoratura.unitir.edu.al/2013/11/doktoratura-ela-elezi-fakulteti-i-drejtewise-departamenti-i-te-drejt-es-penale/>
- <http://www.doktoratura.unitir.edu.al/category/fakulteti-i-drejtewise-departamenti-i-se-drejt-es-penale/page/2/>
- <http://www.doktoratura.unitir.edu.al/wp-content/uploads/2013/11/Doktoratura-Ela-Elezi-Fakulteti-i-Drejtewise-Departamenti-i-te-Drejt-es-Penale.pdf>
- http://www.echr.coe.int/Documents/Pub_coe_Criminal_procedure_2009_ENG.pdf

- http://www.echr.coe.int/Documents/Pub_coe_Criminal_procedure_2009_ENG.pdf
- [http://www.europarl.europa.eu/RegData/docs_autres_institutions/commission_europeenne/sec/2003/0339/COM_SEC\(2003\)0339_EN.pdf](http://www.europarl.europa.eu/RegData/docs_autres_institutions/commission_europeenne/sec/2003/0339/COM_SEC(2003)0339_EN.pdf)
- <http://www.qbz.gov.al/botime/permbledhese/Permlledhese%20e%20akteve%20nderkombetare%20per%20Drejtisine.pdf>
- <http://www.uni-mannheim.de/edz/pdf/sek/2006/sek-2006-1383-en.pdf> (parë më 15 Mars 2014)
- [http://hudoc.echr.coe.int/eng#{"appno":\["8660/79"\],"itemid":\["001-57540"\]}](http://hudoc.echr.coe.int/eng#{)
- [http://hudoc.echr.coe.int/eng#{"appno":\["10519/83"\],"itemid":\["001-57570"\]}](http://hudoc.echr.coe.int/eng#{)
- [http://hudoc.echr.coe.int/eng#{"itemid":\["001-57980"\]}](http://hudoc.echr.coe.int/eng#{)
- [http://hudoc.echr.coe.int/eng#{"appno":\["19187/91"\],"itemid":\["001-58009"\]}](http://hudoc.echr.coe.int/eng#{)
- [http://hudoc.echr.coe.int/eng#{"appno":\["17440/90"\]}](http://hudoc.echr.coe.int/eng#{)
- [http://hudoc.echr.coe.int/eng#{"appno":\["41087/98"\]}](http://hudoc.echr.coe.int/eng#{)
- http://gjkr.gov.al/previewdoc.php?file_id=10
- http://gjkr.gov.al/previewdoc.php?file_id=12
- http://gjkr.gov.al/previewdoc.php?file_id=13
- http://gjkr.gov.al/previewdoc.php?file_id=14
- http://gjkr.gov.al/previewdoc.php?file_id=15
- http://gjkr.gov.al/previewdoc.php?file_id=16
- http://gjkr.gov.al/previewdoc.php?file_id=17
- http://gjkr.gov.al/previewdoc.php?file_id=18
- http://gjkr.gov.al/previewdoc.php?file_id=19
- http://gjkr.gov.al/previewdoc.php?file_id=21
- http://gjkr.gov.al/previewdoc.php?file_id=22
- http://gjkr.gov.al/previewdoc.php?file_id=25

SHTOJCA 1

PYETSORËT

Kjo shtojcë përmban një pyetësor të përgatitur për zhvillimin e studimit.

Është projektuar për të shqyrtuar praktikën e hetimit financiar, konfiskimit të produkteve të krimit në procedurat penale/civile/autonome dhe menaxhimin e aseteve të sekuestruara dhe konfiskuara.

HETIMI, KONFISKIMI DHE SISTEMIMI I PRODUKTEVE NGA KRIMI NË PROCEDURE PENALE

Pjesa 1: Hetimet financiare me qëllim për të gjetur të ardhurat nga krimi gjatë/ paralel me procesit penal (Faza e hetimit)

1.A ekzistojnë dispozita ligjore të cilat bëjnë të mundshme përdorimin e mjeteve speciale të hetimit (si vëzhgimi elektronik, operacione të fshehta etj) për kërkimin e produkteve të krimit?

	PO
	JO

1.1 Nëse PO, sa shpesh janë aplikuar mjetet speciale në shkallën nga 1 në 5 (ku 1= asnjëherë, 5=gjithmonë)

1	2	3	4	5

Jepni arësytet për zgjedhjen tuaj.

2. A ekziston një dispozitë ligjore ku hetimet financiare duhet të kryhen jo vetëm ndaj të dyshuarve, por edhe ndaj palëve të treta?

	PO
	JO

2.1 Nëse PO, sa shpesh janë aplikuar mjetet speciale në shkallën nga 1 në 5

(ku 1= asnjëherë, 5= gjithmonë)

1	2	3	4	5

Jepni arësytet për zgjedhjen tuaj.

3. A ka ndonjë dispozitë ligjore që kërkon në (a) banka, (b) institucione të tjera financiare dhe (c) institucionet jo-financiare për të bashkëpunuar me agjencitë hetimore në identifikimin e produkteve të krimit?

	PO	JO
a) Bankat		

b) Institucionet e tjera financiare

(të cilat ofrojnë shërbime të tilla si këmbime, shërbimet e transferimit të parave, garancitë financiare etj)

c) Institucioneve jofinanciare

--	--

(të tilla si agjentët e shitjes të gurëve dhe metaleve të çmuara dhe sektorin e pasurive të patundshme)

3.1 Nëse kjo dispozitë ligjore ekziston apo jo, ju lutem sasinë në një shkallë nga 1 deri në 5 shkalla e bashkëpunimit të (a) bankave, (b) institucionet e tjera financiare dhe (c) institucionet jo financiare në hetimet financiare (ku 1 = aspak bashkëpunuese, 5 = shumë bashkëpunuese):

	1	2	3	4	5
a) Bankat					
b) Institucionet e tjera financiare					
c) Institucionet jo financiare					

Jepni arësyet për zgjedhjen tuaj.

4. A ka ndonjë dispozitë ligjore që kërkon një përbërje multidisiplinare të zyrës/ve që kryejnë hetime financiare, si punësimi brenda këtyre njësive të oficerëve me aftësi dhe shkathhtësi të ndryshme (p.sh. nëpunës të zbatimit të ligjit, kontabilistë, avokatë, analistë financiarë , etj)?

	PO
	JO

4.1 Nëse kjo dispozitë ligjore ekziston apo jo, ju lutem sasinë në një shkallë nga 1 në 5 nivelin aktual të përbërjes multidisiplinar të zyrës /ve kryejnë hetime financiare (ku 1 = nuk ka përbërje shumë-disiplinare, 5 = shënuar përbërjen shumë-disiplinare):

1	2	3	4	5

Jepni arësyet për zgjedhjen tuaj.

5. A ka një dispozitë ligjore që kërkon bashkëpunim ndërmjet agjencive të ndryshme kombëtare të zbatimit të ligjit (forcave të policisë, agjencive të të ardhurave, shërbimeve të prokurorisë, etj) në zhvillimin e hetimeve financiare?

	PO
	JO

5.1 Nëse kjo dispozitë ligjore ekziston ose jo, ju lutem vlerësimin në një shkallë nga 1 deri në 5 të nivelit të bashkëpunimit ndërmjet agjencive (ku 1 = nuk ka bashkëpunim, 5 = niveli i lartë i bashkëpunimit):

1	2	3	4	5

--	--	--	--	--

Jepni arësytet për zgjedhjen tuaj.

6. A ka një dispozitë ligjore që kërkon nga të penduar / dëshmitarë që të bashkëpunojnë me agjencitë hetimore në zbulimin e të ardhurave nga krimi?

	PO
	JO

6.1 Nëse kjo dispozite ekziston apo jo, ju lutem sasinë në një shkallë nga 1 në 5 për shkallën e bashkëpunimit të dhënë nga të penduarit / dëshmitarët në hetimet financiare (ku 1 = nuk bashkëpunojnë, 5 = shumë bashkëpunuese):

1	2	3	4	5

Jepni arësytet për zgjedhjen tuaj.

7. Sa shpesh janë filluar hetimet financiare në rastet e krimit të organizuar?

	Asnjëherë ose rrallë, në një fazë të hershme (dmth. para akuzave)
	Asnjëherë ose rrallë, me vonesë (dmth. pas akuzave)
	Ndonjëherë, në një fazë të hershme (dmth. para akuzave)
	Ndonjëherë, me vonesë (dmth. pas akuzave)
	Shpesh ose gjithmonë, në një fazë të hershme (dmth. para akuzës)
	Shpesh ose gjithmonë, me vonesë (dmth. pas akuzave)

Jepni arësytet për zgjedhjen tuaj.

8. Në një shkallë nga 1 në 5 (ku 1 = dobët, 5 = plotësisht të mjaftueshme), si do ta vlerësojë përshtatshmërinë e (a) burimet njerëzore dhe (b) burimet materiale të përcaktuara për identifikimin e produkteve të krimit , duke iu referuar numrit të tyre të përgjithshëm (për burimet njerëzore) / konsistencës (për burimet materiale)?

	1	2	3	4	5
a) Burimet njerëzore (si hetuesit, stafi administrativ, etj)					
	1	2	3	4	5
b) Burimet materiale (të tilla si pajisjet kompjuterike, etj)					

Jepni arësytet për zgjedhjen tuaj.

9. Në një shkallë nga 1 në 5 (ku 1 = nuk ka trajnim, 5 = niveli i lartë i trajnimit), ju lutem më jepni një numër të nivelit të përgjithshëm të trajnimit për hetimet financiare:

1	2	3	4	5

Jepni arësytet për zgjedhjen tuaj.

10. Në një shkallë nga 1 në 5 (ku 1 = e gjatë, 5 = të shkurtër), si do ta përcaktoni periudhën kohore të nevojshme për të përfunduar hetimet financiare për gjetjen e të ardhurave nga krimi?

1	2	3	4	5

Jepni arësytet për zgjedhjen tuaj.

Pjesa 2: Sekuestrimi dhe konfiskimi i produkteve të krimit gjatë/ paralel/autonom me procedimin penal në gjykatë (Faza e gjykimit)

11. [Ju lutemi të përgjigjeni në këtë pyetje vetëm nëse një bindje është (gjithmonë ose ndonjëherë) një parakusht për konfiskim] Sipas përvojës suaj, në qoftë se një bindje është e nevojshme për konfiskim, si do të ndikojë ky parakusht në praktikë, çështjen e një konfiskimi (p.sh. për shkak të vështirësive të marrjes së një bindje) në një shkallë nga 1 në 5 (ku 1 = ky parakusht nuk e pengon çështjen e një konfiskimi, 5 = ky parakusht pengon çështjen e një të konfiskimi)?

1	2	3	4	5

Jepni arësytet për zgjedhjen tuaj.

12. [Ju lutemi të përgjigjeni në këtë pyetje vetëm nëse një bindje është (gjithmonë ose nganjëherë) parakusht për konfiskim] Nëse një bindje është e nevojshme për konfiskim, a ka një dispozitë ligjore që e bën të mundur për konfiskimin jo vetëm të ardhurat e krimit nga vepra penale të cilat i pandehuri është dënuar, por edhe të ardhurat e krimeve të mëparshme nga të cilët ai nuk është i dënuar?

	PO
	JO

12.1 Nëse kjo dispozitë ligjore egziston, si është zbatuar në praktikë në një shkallë nga 1 në 5 (ku 1 = nuk aplikohet në një masë të kënaqshme, 5 = aplikuar në një masë të kënaqshme)?

1	2	3	4	5

Jepni arësytet për zgjedhjen tuaj.

13. Nën sistemin ligjor, parakushtet e nevojshme ligjore (p.sh. dënimi) janë plotësuar, konfiskimi e të ardhurave nga krimi në procedurën penale është:

	Gjithmonë e detyrueshme (kalo tek pyetja 14)
	Ndonjëherë apo gjithmonë diskrecionale (kalo tek pyetja 13.1)

13.1 Në qoftë se konfiskimi është nganjëherë apo gjithmonë diskrecionale, sa shpesh është masa e zbatuar në praktikë në një shkallë nga 1 në 5 (ku 1 = nuk zbatohet, 5 = aplikuar gjithmonë)?

1	2	3	4	5

Jepni arësytet për zgjedhjen tuaj.

14. A ka ndonjë dispozitë ligjore që lejon ndryshimin të barrës së provës, duke e vendosur barrën mbi të pandehurit për të treguar origjinën e ligjshme të aseteve të tij?

	PO
	JO

14.1 Nëse PO, si është zbatuar në praktikë në një shkallë nga 1 në 5 (ku 1 = nuk aplikohet në një masë të kënaqshme, 5 = aplikuar në një masë të kënaqshme)?

1	2	3	4	5

Jepni arësytet për zgjedhjen tuaj.

15. A siguron sistemi ligjor për (a) konfiskimin e pasurisë produkt i një krimi (konfiskim të pronës), ose (b) konfiskimin e një shume të hollash të barabartë me vlerën e produkteve të krimit (vlerës konfiskimit), ose (c) të dyja?

	a) konfiskimi vetëm për pasurinë është e lejuar
	b) konfiskimin vetëm për vlerat është e lejuar
	c) Të dy konfiskimin e pronës dhe konfiskimi e vlerës lejohen

15.1 Nëse lejohet vetëm konfiskimi i pronës, si është zbatuar në praktikë në një shkallë nga 1 në 5 (ku 1 = nuk aplikohet në një masë të kënaqshme, 5 = aplikuar në një masë të kënaqshme)?

1	2	3	4	5

Jepni arësytet për zgjedhjen tuaj.

15.2. 15.2. Nëse lejohet vetëm konfiskimi i vlerës, si është zbatuar në praktikë në një shkallë nga 1 në 5 (ku 1 = nuk aplikohet në një masë të kënaqshme, 5 = aplikuar në një masë të kënaqshme)?

1	2	3	4	5

Jepni arësytet për zgjedhjen tuaj.

16. A ekziston një dispozitë ligjore e cila kërkon sekuestrimin dhe konfiskimin e të ardhurave të supozuara që kanë rrjedh nga krimi qoftë në pronësi apo që mbahen nga një person i tretë, që është, një person tjetër nga i pandehuri?

	PO
	JO

16.1. Nëse një dispozitë e tillë ligjore ekziston, si është zbatuar në praktikë në një shkallë nga 1 në 5 (ku 1 = nuk aplikohet në një masë të kënaqshme, 5 = aplikuar në një masë të kënaqshme)?

1	2	3	4	5

Jepni arësytet për zgjedhjen tuaj.

17. A ekziston një dispozitë ligjore për administrimin e pasurive të sekuestruara që synon

maksimizimin e vlerës së tyre / minimizuar shkatërrimin e tyre para se ata të konfiskohen (p.sh. nëpërmjet shitjes së aseteve)?

	PO
	JO

17.1. Nëse kjo dispozitë ligjore ekziston ose jo, si do ta përcaktoni menaxhimin aktual të pasurive të sekuestruara në një shkallë nga 1 në 5 (ku 1 = jo i kënaqshëm, dmth nuk është në gjendje për të maksimizuar vlerën / minimizuar përkeqësimin e pasurive të sekuestruara, 5 = kënaqshme, pra në gjendje për të maksimizuar vlerën / minimizuar përkeqësimin e aseteve të sekuestruara)?

1	2	3	4	5

Jepni arsytet për zgjedhjen tuaj.

18. Në një shkallë nga 1 në 5 (ku 1 = dobët, 5 = plotësisht të mjaftueshme), si do ta vlerësoni përshtatshmërinë e (a) burimeve njerëzore dhe (b) burimeve materiale të përkushtuar për fazën gjyqësore, duke iu referuar numrit të tyre i përgjithshëm (për burimet njerëzore) / konsistenca (për burimet materiale)?

	1	2	3	4	5
a) Burimet njerëzore (siç janë prokurorët, personelin administrativ, etj)					
b) Burimet materiale (të tilla si pajisjet kompjuterike, etj)					

Jepni arsytet për zgjedhjen tuaj.

19. Në një shkallë nga 1 në 5 (ku 1 = nuk ka trajnim, 5 = niveli i lartë i trajnimit), ju lutem më jepni një numër të nivelit të përgjithshëm të trajnimit, në fushën e kapjen dhe konfiskimit të produkteve të krimit, i (a) zyrtarët që ndërmarrin veprime ligjore kundër një të pandehuri në procedurën penale (si prokurorë publikë) dhe (b) gjyqtarët:

	1	2	3	4	5
a) Zyrtarët që ndërmarrin veprime ligjore kundër të pandehurit në procedurën penale (të tilla si prokurorë publik)					
b) Gjyqtarët					

Jepni arsytet për zgjedhjen tuaj.

20. Në një shkallë nga 1 në 5 (ku 1 = pa aftë, 5 = shumë kompetent), ju lutemi të japë një numër të nivelit të përgjithshëm të kompetencës së autoritetit / eve për menaxhimin pasuritë e konfiskuara.:

1	2	3	4	5

Jepni arsytet për zgjedhjen tuaj.

21. Në një shkallë nga 1 në 5 (ku 1 = e gjatë, 5 = të shkurtër), si do ta përcaktoni periudhën kohore zakonisht të nevojshme për të përfunduar procedurën gjyqësore që çon në konfiskimin e produkteve të krimit?

1	2	3	4	5

Jepni arsytet për zgjedhjen tuaj.

Pjesa 3: Administrimi i të ardhurave nga krimi gjatë/ paralel/autonom me procedimin penal (Faza e administrimit)

22. Ju lutem shënoni më poshtë opsionin e administrimit të lejuar sipas sistemit ligjor. Për secilin, ju lutem, jepni hollësisht tipologjitë e mallrave që ata janë të lidhur me të (para të gatshme, pronë e paluajtshme, pronë personale, kompanive, stoqet, etj). Së fundi, specifikoni se si dispozitat ligjore disiplinojnë çdo opsion të administrimit që zbatohen në praktikë në një shkallë nga 1 në 5 (= 1 ku nuk aplikohet në një masë të pranueshme, 5 = aplikuar në një masë të pranueshme):

Opsion e administrimit të pasurisë sipas sistemit ligjor të pasurive të konfiskuara	Si janë dispozitat ligjore për administrimin e çdo opsioni në dispozicion, aplikuar në praktikë (ku 1 = nuk aplikohet në një masë të kënaqshme, 5 = aplikuar në një masë të kënaqshme)?				
	1	2	3	4	5
a) SHKATËRRIMI (për tipologjitë e mëposhtme të mallrave)					
b) SHITJE (për tipologjitë e mëposhtme të mallrave)					
c) PËRDORIMIT PËR QËLLIME SOCIALE (për tipologjitë e mëposhtme të mallrave)					
d) QERA (për tipologjitë e mëposhtme të mallrave)					
e) LIKUIDIMI (për tipologjitë e mëposhtme të mallrave)					
f) TE TJERA, (për tipologjitë e mëposhtme të mallrave)					

Jepni arsytet për zgjedhjen tuaj.

23. A ka një dispozitë ligjore që kërkon bashkëpunim ndërmjet agjencive, në mes të zyrave të ndryshme të përfshira në fazën e administrimit?

	PO
	JO

23.1. Nëse kjo dispozitë ligjore ekziston apo jo, ju lutem sasinë në një shkallë nga 1 në 5 nivelin e bashkëpunimit ndërmjet agjencive (ku 1 = nuk ka bashkëpunim, 5 = niveli i lartë i bashkëpunimit):

1	2	3	4	5

Jepni arsytet për zgjedhjen tuaj.

24. Në një shkallë nga 1 në 5 (ku 1 = dobët, 5 = plotësisht të mjaftueshme), si do ta vlerësoni përshtatshmërinë e (a) burimeve njerëzore dhe (b) burimet materiale të përkushtuara për zbatimin e urdhrave të konfiskimit / shitja e aseteve të konfiskuara, duke iu referuar numrit të tyre të përgjithshëm (për burimet njerëzore) / konsistencës (për burimet materiale)?

	1	2	3	4	5
a) Burimet njerëzore (të tilla si oficerë të ngarkuar me zbatimin e urdhrave të konfiskimit / dispozicion të pasurive të konfiskuara, të personelit administrativ, etj)					
b) Burimet materiale (të tilla si pajisjet kompjuterike, etj)					

Jepni arësyet për zgjedhjen tuaj.

25 Në një shkallë nga 1 në 5 (ku 1 = pa aftë, 5 = shumë kompetent), ju lutemi të jepni një numër të nivelit të përgjithshëm të kompetencës së autoritetit /eve për menaxhimin e pasurisë së konfiskuar.:

1	2	3	4	5

Jepni arësyet për zgjedhjen tuaj.

26. Në një shkallë nga 1 në 5 (ku 1 = e gjatë, 5 = të shkurtër), si do ta përcaktoni periudhën kohore zakonisht e nevojshme për administrimin e pasurive të konfiskuara / për të zbatuar urdhërat konfiskimit?

1	2	3	4	5

Jepni arësyet për zgjedhjen tuaj.

SHTOJCA 2

METODOLOGJIA

Siç tregohet në çështjen 2.2, hulumtimi është kryer në katër hapat e mëposhtëm:

Hapi 1. Fazat e konceptit "zbatim i ligjit".

Hapi 2. Përgatitja e një pyetësi, dhe plotësimi i tij nga një ekspert i profilit të lartë me anë të një interviste.

Hapi 3. Ndërtimi i një profili që përshkruan zbatimin e ligjit dhe duke krahasuar atë me ligjin e shkruar.

Hapi 4. Vlerësimi i zbatimit të ligjit.

Kjo shtojcë është e përqëndruar për shpjegim të detajuar të HAPI-it 4, që përfshin vlerësimin e zbatimit të ligjit, i cili është niveli i zbatimit të dispozitave ligjore në fuqi, të rëndësisë në secilën nga tri fazat e konfiskimit.

Pasi janë identifikuar variablat matëse të zbatimit të ligjit (Hapi 1) dhe të përkthyer në një pyetësor (Hapi 2), për çdo variabël, në bazë të përgjigjes së dhënë nga eksperti, është caktuar një vlerë për secilin modalitet në një shkallë nga 0 në 100. Sa më afër vlerës 100, aq më mirë është zbatuar ligji. Vlerat e mëposhtme janë caktuar për modalitetet e variablave të përzgjedhur për secilën nga tri fazat e procedurës së konfiskimit.

PËR FAZEN E HETIMIT

VARIABLI 1. Frekuenca e përdorimit të mjeteve speciale të hetimit, nëse përdorimi i tyre është parashikuar

1	0
2	25
3	50
4	75
5	100

ku 1 = nuk përdoren; 5 = përdorur gjithmonë.

VARIABLI 2. Frekuenca e hetimeve financiare për palët e treta, nëse hetime të tilla të palëve të treta janë parashikuar.

1	0
2	25
3	50
4	75
5	100

ku 1 = asnjëherë; 5 = bërë gjithmonë.

VARIABLI 3. Niveli i bashkëpunimit nga ana e bankave në fazën hetimore

1	0
2	25
3	50
4	75
5	100

ku 1 = jo për të gjitha; 5 = niveli i lartë i bashkëpunimit.

VARIABLI 4. *Niveli i bashkëpunimit nga ana e institucioneve financiare jo-bankare në fazën e hetimit.*

1	0
2	25
3	50
4	75
5	100

ku 1 = nuk ka bashkëpunim në të gjitha; 5 = niveli i lartë i bashkëpunimit.

VARIABLI 5. *Niveli i bashkëpunimit nga ana e institucioneve jo-financiare në fazën e hetimit.*

1	0
2	25
3	50
4	75
5	100

ku 1 = nuk ka bashkëpunim në të gjitha; 5 = niveli i lartë i bashkëpunimit.

VARIABLI 6. *Niveli i trajnimit për hetimin financiar*

1	0
2	25
3	50
4	75
5	100

ku 1 = nuk ka trajnim; 5 = niveli i lartë i trajnimit.

VARIABLI 7. *Niveli i përbërjes multidisciplinare të zyrës /-ve për kryerjen e hetimeve financiare.*

1	0
2	25
3	50
4	75
5	100

ku 1 = jo përbërje multidisciplinare; 5 = përbërje multidisciplinare.

VARIABLI 8. *Niveli i bashkëpunimit ndërmjet agjencive të zbatimit të ligjit kombëtar (forcat e policisë, agjencitë e të ardhurave, të prokurorisë, etj) në zhvillimin e hetimeve financiare.*

1	0
2	25
3	50
4	75
5	100

ku 1 = jo bashkëpunim; 5 = niveli i lartë i bashkëpunimit.

VARIABLI 9. *Shkalla e bashkëpunimit nga informatorët / dëshmitarët për hetimet financiare*

1	0
---	---

2	25
3	50
4	75
5	100

ku 1 = nuk ka bashkëpunim; 5 = niveli i lartë i bashkëpunimit.

VARIABLI 10. Frekuenca e hetimeve financiare në rastet e krimit të organizuar, gjithashtu duke marrë parasysh fazën në të cilën ato janë kryer

1. Asnjëherë ose rrallë, dhe në përgjithësi me vonesë (dmth. pas akuzave)	0
2. Asnjëherë ose rrallë, dhe në përgjithësi në një fazë të hershme (dmth. para akuzave)	20
3. Bërë ndonjëherë, dhe në përgjithësi me vonesë (dmth. pas akuzave)	40
4. Bërë ndonjëherë, dhe në përgjithësi në një fazë të hershme (dmth. para akuzave)	60
5. Shpesh ose gjithmonë bërë, dhe në përgjithësi me vonesë (dmth. pas akuzave)	80
6. Shpesh ose gjithmonë të bërë, dhe në përgjithësi në një fazë të hershme (dmth. para akuzave)	100

VARIABLI 11. Përshtatshmëria e burimeve njerëzore të përkushtuar për identifikimin e produkteve të krimit, duke iu referuar numrit të tyre të përgjithshëm

1	0
2	25
3	50
4	75
5	100

ku 1 = jo të mjaftueshme; 5 = plotësisht të mjaftueshme.

VARIABLI 12. Përshtatshmëria e burimeve materiale të përkushtuar për identifikimin e produkteve të krimit, duke iu referuar konsistencës së tyre të përgjithshme.

1	0
2	25
3	50
4	75
5	100

ku 1 = jo të mjaftueshme; 5 = plotësisht të mjaftueshme.

PËR FAZËN E GJYKIMIT

VARIABLI 13. Niveli i pengesës ndaj çështjes së një konfiskimit të ngritura nga nevoja për një dënim, nëse një bindje është (gjithmonë ose ndonjëherë) një parakusht për konfiskim

1	100
2	75
3	50
4	25
5	0

ku 1 = nuk ka pengesë; 5 = pengesë të rëndësishme.

VARIABLI 14. Niveli i zbatimit të konfiskimit të zgjeruar, në qoftë se një dispozitë e tillë ligjore ekziston.

1	0
2	25
3	50
4	75
5	100

ku 1 = nuk aplikohet në një masë të kënaqshme; 5 = aplikohet në një masë të kënaqshme.

VARIABLI 15. Frekuenca e konfiskimit, në qoftë se aplikimi i masës është nganjëherë apo gjithmonë diskrecionale.

1	0
2	25
3	50
4	75
5	100

ku 1 = nuk zbatohet; 5 = zbatohet gjithmonë.

VARIABLI 16. Niveli i zbatimit të dispozitës ligjore që lejon kalimin e barrës së provës, nëse një dispozitë e tillë ligjore ekziston.

1	0
2	25
3	50
4	75
5	100

ku 1 = nuk aplikohet në një masë të kënaqshme; 5 = aplikohet në një masë të kënaqshme.

VARIABLI 17. Niveli i zbatimit të konfiskimit të pronës, nëse parashikohet nga sistemi ligjor.

1	0
2	25
3	50
4	75
5	100

ku 1 = nuk zbatohet në një masë të kënaqshme; 5 = zbatohet në një masë të kënaqshme.

VARIABLI 18. Niveli i zbatimit të konfiskimit të vlerës, nëse parashikohet nga sistemi ligjor.

1	0
2	25
3	50
4	75
5	100

ku 1 = nuk zbatohet në një masë të kënaqshme; 5 = zbatohet në një masë të kënaqshme.

VARIABLI 19. Niveli i zbatimit të një dispozite ligjore që kërkon sekuestrimin dhe konfiskimin e të ardhurave nga krimi qoftë në pronësi apo që mbahen nga një person i tretë, në qoftë se një dispozitë e tillë ligjore ekziston

1	0
2	25
3	50
4	75
5	100

ku 1 = nuk zbatohet në një masë të kënaqshme; 5 = zbatohet në një masë të kënaqshme.

VARIABLI 20. Përshtatshmëria e burimeve njerëzore të përkushtuara për fazën gjyqësore, duke iu referuar numrit të tyre të përgjithshëm

1	0
2	25
3	50
4	75
5	100

ku 1 = jo të mjaftueshme; 5 = plotësisht të mjaftueshme.

VARIABLI 21. Përshtatshmëria e burimeve materiale të përkushtuara për fazën gjyqësore, duke iu referuar konsistencës së tyre të përgjithshme

1	0
2	25
3	50
4	75
5	100

ku 1 = jo të mjaftueshme; 5 = plotësisht të mjaftueshme.

VARIABLI 22. Niveli i trajnimit të zyrtarëve (si prokurorë publik) që bëjnë veprime ligjore kundër të pandehurit në procedurë civile / penale/autonome në fushën e kapjes dhe konfiskimin e produkteve të krimit

1	0
2	25
3	50
4	75
5	100

ku 1 = nuk ka trajnim; 5 = niveli i lartë i trajnimit.

VARIABLI 23. Niveli i trajnimit të gjyqtarëve në fushën e kapjes dhe konfiskimin e produkteve të krimit

1	0
2	25
3	50
4	75
5	100

ku 1 = nuk ka trajnim; 5 = niveli i lartë i trajnimit.

VARIABLI 24. Niveli i kompetencës të organit /-ve për menaxhimin e pasurive të konfiskuara

1	0
---	---

2	25
3	50
4	75
5	100

ku 1 = pa aftë; 5 = shumë kompetent.

VARIABLI 25. *Niveli i menaxhmentit aktual të pasurive të sekuestruara*

1	0
2	25
3	50
4	75
5	100

ku 1 = nuk është e kënaqshme, nuk është në gjendje për të maksimizuar vlerën / minimizuar përkeqsimin e pasurive të konfiskuara; 5 = e kënaqshme, është në gjendje për të maksimizuar vlerën / minimizuar përkeqsimin e pasurive të sekuestruara.

VARIABLI 26. *Periudha e kohës së nevojshme për të përfunduar procedurën gjyqësore që çon në konfiskimin e produkteve të krimit*

1	0
2	25
3	50
4	75
5	100

ku 1 = e gjatë; 5 = e shkurtër.

PËR FAZËN E ADMINISTRIMIT

VARIABLI 27. *Niveli i zbatimit të dispozitave ligjore që dispijlojnë çdo opsjon të administrimit (p.sh. shitja, administrimi, përdorimi për qëllime sociale, qira, likuidim, etj.)*

1	0
2	25
3	50
4	75
5	100

ku 1 = nuk zbatohet në një masë të kënaqshme; 5 = zbatohet në një masë të kënaqshme.

VARIABLI 28. *Niveli i bashkëpunimit ndërmjet agjencive, bashkëpunimi mes zyrave të ndryshme të përfshira në fazën e administrimit.*

1	0
2	25
3	50
4	75
5	100

ku 1 = nuk ka bashkëpunim; 5 = niveli i lartë i bashkëpunimit.

VARIABLI 29. Përshtatshmëria e burimeve njerëzore të përkushtuara për zbatimin e urdhrave të konfiskimit / administrimit të pasurive të konfiskuara, duke iu referuar numrit të tyre të përgjithshëm

1	0
2	25
3	50
4	75
5	100

ku 1 = jo të mjaftueshme; 5 = plotësisht të mjaftueshme.

VARIABLI 30. Përshtatshmëria e burimeve materiale të përkushtuar për zbatimin e urdhrave të konfiskimit / administrimit të pasurive të konfiskuara, duke iu referuar konkonsistencës së përgjithshme.

1	0
2	25
3	50
4	75
5	100

ku 1 = jo të zbatueshme; 5 = plotësisht të mjaftueshme.

VARIABLI 31. Niveli i kompetencave të autoritetit /-ve për menaxhimin e pasurisë së konfiskuar

1	0
2	25
3	50
4	75
5	100

ku 1 = paafte; 5 = shumë kompetent.

VARIABLI 32. Periudha e kohës zakonisht e nevojshme për të zbatuar urdhërat e konfiskimit

1	0
2	25
3	50
4	75
5	100

ku 1 = e gjatë; 5 = e shkurtër.

Në rast të mos përgjigjes, variabli nuk është marrë në konsideratë në llogaritje.

Këto vlera më pas janë ndarë, për secilën fazë, a) të hetimit, b) të gjykimit dhe c) të administrimit, për të llogaritur indeksin e zbatimit të ligjit.

Këto shprehin, në shkallën nga 0 në 100, nivelin e zbatimit të ligjit në secilën fazë. Ata janë marrë duke llogaritur mesataren e vlerave të caktuara për modalitetet e secilit variabël për fazën. Sa më i lartë indeksi, aq më mirë është zbatuar ligji i shkruar dhe i miratuar.

Të dy situatat ekstreme përshkruar nga ky përcaktim tregojnë: a) situatën ideale të zbatimit të ligjit kur indeksi është në vlerën 100, dhe b) gjendjen më të keqe të mundshme kur indeksi është në vlerën 0.